Prof.dr.sc. ISAK SHEMA

JOSIP V. RELA

JETA DHE KRIJIMTARIA LETRARE

Dituria 2015

Prof.dr.sc. Isak Shema

JOSIP V. RELA
JETA DHE KRIJIMTARIA LETRARE

© 2015. Autori

Botuesi *Dituria 2015*

Redaktore
Mr. Sc. Bardha Shema-Qirezi

Recensues
Prof. Dr. sc. Liman Matoshi
Prof. Dr. sc. Bashkim Kuçuku

Redaktura kompjuterike dhe kopertina
Prof.dr.sc. Lulëzim Lajçi

Përgatitja kompjuterike
Fatos Shema

CIP zapis dostupan u računalnom katalogu
Nacionalne knjižnice Kosova „Pjetër Bogdani“
u Prištini pod brojem

ISBN 978-9951-8919-1-2

Prof. dr. sc. ISAK SHEMA

JOSIP V. RELA

JETA DHE KRIJIMTARIA LETRARE

Dituria 2015
Prishtinë
2015

Prof. dr. sc. ISAK SHEMA

JOSIP V. RELA

LA VIE ET L`OEUVRE LITTÉRAIRE

Dituria 2015
Prishtina
2015



Isak Shema (Arbënesh, 1973)

LIBRI I KUSHTOHET

SHKRIMTARIT RAMIZ KELMENDI



MONOGRAFIA RIBOTOHET
ME RASTIN E 120 VJETORIT TË LINDJES
SË KRIMTARIT JOSIP V. RELA

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....15

PJESA E PARË

KAPITULLI I

FËMIJËRIA.....27
VENDLINDJA DHE RRETHI FAMILJAR.....27
SHKOLLIMI FILLOR.....32
MËSIMI I GJUHËS SHQIPE
NË ARBËNESH TË ZARËS.....47
SHKOLLIMI I MESËM.....56

KAPITULLI II

VITET E MËSUESISË.....63
NË ISHUJT E DALMACISË.....63
RELA MIDIS BASHKATDHETARËVE.....65

KAPITULLI III

NË FLAKËN E LUFTËS.....75
TREGIME PËR OKUPACIONIN 75
FJALA E KËNGËS SË POETIT.....76

KAPITULLI IV

JETA NË ARBËNESH.....81
KTHIMI NË VENDLINDJE 81
MISIONI ARSIMOR DHE KULTUROR.....84
"MARTESA" NGAZËLLOI ARBËNESHËT 85
FRYMËZIME TË REJA LETRARE.....87

KAPITULLI V

RRJEDHA LETRARE.....91
DY VIZITA NË KOSOVË.....91
FAZA E FUNDIT E KRIJIMTARISË LETRARE.....93
HUMBJE E MADHE E LETËRSISE SHQIPE.....95

PJESA E DYTË

KAPITULLI VI

FILLIMET E KRIJIMTARISË LETRARE.....103
KRIJIMET E PARA POETIKE 103
PROVA TË KRIJIMTARISË DRAMATIKE.....107

KAPITULLI VII

POEZIA.....111
MOTIVE POETIKE ARBËNESHE..... 111
POEZIA E DASHURISË.....117
LIRIKA PATRIOTIKE 121
POEZIA SOCIALE 127
POEZIA ELEGJIAKE.....134
POEZIA HUMORISTIKE SATIRIKE.....136
POEZIA PËRFËMIJË.....138
POEZIA NË GJUHËN KROATE.....143

KAPITULLI VIII

PROZA.....149
PROZA TREGIMTARE 149
TRAJTIMI I TEMËS SOCIALE 150
TRAJTIMI I TEMËS SË LUFTËS.....152
RRËFIMI I KUJTIMEVE.....154
SKICAT TREGIMTARE.....158

KAPITULLI IX

DRAMA.....163
KRIJIMTARIA DRAMATIKE.....163
KOMEDITË E RELËS.....169
MELODRAMA "MARTESA".....174

KAPITULLI X

TRAJTIMI I TEMËS HISTORIKE.....179
DRAMA “NITA”.....179
HISTORIA E LAVDISHME E ALI PASHË TEPELENËS.....193

KAPITULLI XI

DRAMA ME TEMËN E LUFTËS.....199
AKUZË KUNDËR LUFTËS.....199
DRAMA "IK, JAK, IK".....202

KAPITULLI XII

TRAJTIMI I TEMËS SOCIALE.....209
DRAMA JETËSORE ARBËNESHE.....209
DRAMA “DILA”.....212
FISI I MALLKUAR.....214
VIZIONI I LIRISË.....217

KAPITULLI XIII

DRAMA PSIKOLOGJIKE.....223
ZËRI I NDËRGJEGJJES.....223

KAPITULLI XIV

DRAMA JETON NË SKENË.....227
SHFAQJE TEATRORE QË NUK HARROHEN.....227
SKENOGRAFIA FUNKSIONALE.....235


KAPITULLI XV

VEÇORITË STILISTIKE DHE GJUHËSORE.....243
KARAKTERISTIKAT E STILIT.....243
GJUHA – MJET I SHPREHJES GJUHËSORE DHE LETRARE.....246
SHPJEGIMI I FJALËVE.....254

PËFUNDIMI.....269
BIBLIOGRAFIA.....275
ARKIVI. DORËSHKRIMET DHE MATERIALET E TJERA.....277
BURIMET.....279
LITERATURA.....281
LES ÉTUDES DE LA LITTÉRATURE ALBANAISE (Résumé).....303
LES MOUVEMENTS LITTÉRAIRES DANS LA LITTÉRATURE ALBANAISE DU XXe SIÈCLE(Résumé).....311

PJESA E TRETË

BIBLIOGRAFITË E LETËRSISË SHQIPE.....317
PROGRAMI KULTUROR NË ARBËNESH 2013-2015.....327
SHËNIME PËR AUTORIN.....355
ALBUMI.....377


ISAK SHEMA
JOSIP RELA
JETA DHE KRIJIMTARIA LETRARE
DUKAGJINI

HYRJE

Në fushën e studimeve historike letrare hartimi i monografive për jetën dhe krijimtarinë letrare të shkrimtarëve të njohur të letërsisë shqiptare ka rëndësi të madhe. Studimet monografike janë kontribute shkencore me të cilat, në mënyrë të gjithanshme dhe të thelluar, trajtohen të gjitha çështjet e një teme të rëndësishme për shkencën e letërsisë. Duke qenë të bindur se një studim monografik kushtuar jetës dhe krijimtarisë letrare të shkrimtarit Josip Rela është me interes të veçantë shkencor dhe kontribut historisë së letërsisë shqiptare, e pamë të arsyeshme që këtë studim monografik ta paraqesim dhe ta punojmë si temë të disertacionit të doktoratës.

Ideja për të studiuar jetën dhe krijimtarinë letrare të Josip Relës është e hershme. Ajo është kristalizuar pastaj si rezultat i dëshirës për të dhënë një kontribut të çmuar shkencor, i bindjes së thellë se bota interesante e arbëneshëve dhe kultura e tyre duhet të studiohet dhe të integrohet në kuadër më të gjerë të kulturës kombëtare shqiptare

Josip Vlladoviq Rela, shkrimtar i Arbëneshit të Zarës, është krijuesi më i shquar i kësaj kolonie shqiptare. Ai bën pjesë në atë grup personalitetesh të dalluara të arsimit, të kulturës dhe të letërsisë, për të cilët profesori Eqrem Çabej ka shkruar: "... i kanë lënë nder atdheut të të parëve të tyre dhe atdheut të tyre të ri".[1] Rela, si edhe disa krijues të tjerë të kësaj pjese të diasporës shqiptare, i ka lënë nder edhe Kosovës dhe mbarë Shqipërisë. Që nga koha e botimit të parë të veprës së vet letrare në gjuhën shqipe në revistën letrare "Jeta e re", ai ka qenë shpirtërisht i lidhur më së shumti me këtë vend aq shumë të adhuruar.

---

[1] Eqrem Çabej, "Ngulimet shqiptare jashtë atdheut", "Ylli", Tiranë, 1967, nr.1, f.24.

Shkrimtari Josip Rela në letërsinë shqiptare është afirmuar si poet, prozator dhe veçanërisht si dramaturg. Kujtimet tona për plakun e Arbëneshit janë të paharrueshme. Takimi ynë i parë me Josipin dhe me botën – jetën e arbëneshëve ka qenë ai i verës së vitit 1958. Miqësia e sinqertë është vazhduar për shumë vjet me radhë. Ka mbetur i gjallë përherë kujtimi për njeriun e dashur, për shkrimtarin, që ka dhënë kontributin e vet në lëmin e kulturës shqiptare. Njëkohësisht ka lënë trashëgim krijimtarinë e pasur letrare. Jetëshkrimi i këtij krijuesi arbënesh është mjaft interesant. Duke gjurmuar për shtegtimet jetësore dhe krijuese të tij, mund të ndriçohen disa aspekte të historisë, të kulturës dhe të jetës së arbëneshëve dhe të popullit shqiptar në koordinatat më të gjera ballkanike dhe evropiane. Krijimtaria letrare e këtij krijuesi është e shtrirë në një gjysmë shekulli (1916-1966). Kjo i përket, me pjesën e parë, letërsisë së traditës, ndërsa me pjesën tjetër, letërsisë bashkëkohore shqiptare. Me krijimtarinë letrare të Relës një ambient i veçantë, ai i arbëneshëve të Zarës dhe i Dalmacisë, përfshihet në mënyrë mjaft specifike në letërsinë kombëtare shqiptare. Edhe një rrjedhë e natyrshme, që për fat të keq është në rrezik të shuhet, është shkrirë në deltën e letërsisë shqiptare.

Josip Rela ka qenë dhe ka mbetur përfaqësuesi më i denjë arbënesh. Pas tij edhe shkrimtari Shime Deshpali e ka përfunduar krijimtarinë e vet letrare, prandaj është detyrë e shkencës së letërsisë që ky thesar kulturor dhe letrar të studiohet me përkushtim të duhur dhe rezultatet e këtyre studimeve të integrohen në sintezën e studimeve tona historike letrare.

Për arbëneshët e Zarës në të kaluarën janë shkruar studime, monografi të veçanta dhe vështrime të ndryshme ku, përveç të tjerash, janë trajtuar dhe ndriçuar çështjet historike të shpërnguljes së tyre nga trojet etnike shqiptare të Krajës: Brisku, Shestani etj., kryesisht gjatë viteve 1726-1733, por edhe më vonë, si edhe aspekte të ndryshme të jetës arsimore, kulturore dhe letrare. Gjatë viteve të fundit gjithashtu janë botuar materiale studimore me interes të madh shkencor.

Eqrem Çabej ka shkruar: "Afër Zarës së Dalmacisë, ka një vend me banorë shqiptarë, që Italianët e thërrasin Borgo Erizzo, Kroatët e rretheve Arbanasi, banorët vetë Arbënesh. U themelua më 1734, një

valë e dytë erdhën e u shtruan më 1750. Banorët janë Gegë. Këta, sikur e kanë parë T. Erberi e G. Weigandi dhe më në fund me dokumentin e plotë C. Tagliavini, rrjedhin prej Briskut dhe Shestanit në bregun jugperëndimor të Liqenit të Shkodrës.



Eqrem Çabej

Në Dalmaci gjatë gjithë bregdetit si edhe nëpër ishuj ka pasur edhe të tjera koloni të shpërndara shqiptare".[2]

Pasqyrën më të plotë të studimeve për arbëneshët, dhe sidomos për gjuhën e arbëneshëve të Zarës, e gjejmë në studimin monografik "Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës"[3] të akademik Idriz Ajetit. Më 1987 është botuar "Fjalori i të folmes së arbëneshëve të arës".[4]

Shumë autorë të tjerë kanë studiuar aspekte të ndryshme të historisë, të arsimit dhe të kulturës së kësaj bashkësie etnike shqiptare. Studimi më i plotë për krijimtarinë letrare të Josip Relës është ai i

---

[2] Dr.Eqrem Çabej, "Studime gjuhësore I", "Rilindja", Prishtinë, 1975, f.59.

[3] Idriz Ajeti, "Istorijski razvitak gegijskog govora arbanasa kod Zadra", Sarajevë, 1961. Idriz Ajeti, VEPRA I - "Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës", Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1997.

[4] Dr.Kruno Krsti◊ , "Rje◊nik govora zadarskih arbanasa", Bashkësia Lokale e Arbëneshëve, Zarë, 1987.

akademik Rexhep Qosjes "Josip Vlladoviç – Rela (1895-1966)".[5] Bibliografia e arbëneshëve të Zarës, e cila është shumë e pasur, në mënyrë adekuate do të përfshihet në kapitujt vijues të këtij studimi.

Puna kërkimore disa vjeçare më ka forcuar bindjen se për këtë shkrimtar ka rëndësi të veçantë shkrimi i një studimi monografik, ku të gjitha aspektet e jetës dhe të veprimtarisë letrare do të analizoheshin të sistemuara në mënyrë të gjithanshme. Në aspektin metodologjik studimi do të dalë gjithëpërfshirës. Në të do të shfrytëzohet tërë lënda ekzistuese, pra edhe ajo e pa përfshirë në shkrimet e deritanishme kritike dhe historike letrare. Do të analizohet arkivi personal i Josip Relës, të cilin pati mirësinë ta lë në dispozicion për qëllime studimi shkrimtari Ramiz Kelmendi. Pra, do të shfrytëzohen si lëndë burimore dhe si literaturë e domosdoshme dorëshkrimet, materialet arkivore, shkrimet e botuara në shtypin dhe periodikun e kohës, artikujt dhe krijimtaria letrare në të gjitha variantet ekzistuese në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja. Me përkushtim të posaçëm përcjellët evoluimi i procesit krijues, bëhet krahasimi i varianteve në të gjitha gjinitë dhe llojet letrare. Pikëpamjet sociale dhe idetë humaniste, shoqërore, filozofike, politike etj., analizohen në tërë kronologjinë e shfaqjes së tyre dhe njëkohësisht ndriçohen dukuritë kryesore letrare, si edhe raporti i tyre me fenomenet sociale në procesin aq të gjatë të krijimtarisë. Duke zbatuar metodat e veçanta dhe atë integrale në studimin e letërsisë, pra edhe të analizës së veprave letrare në veçanti, bëhet interpretimi dhe vlerësimi kritik shkencor i opusit letrar. Gjithherë merren parasysh rrethanat kur janë krijuar poezitë, skicat, tregimet, dramat dhe komeditë. Poetika e Josip Relës meriton studim më të gjithanshëm. Në këtë studim me objektivitet shkencor shquhen vlerat artistike të krijimtarisë letrare, por edhe të metat në planin e realizimit artistik. Kjo krijimtari vlerësohet në bazë të kritereve adekuate, ashtu siç e kërkon fenomeni letrar dhe problematika komplekse e letërsisë si art.

Meqë drama ka shtrirje më të madhe në opusin letrar të Relës, edhe hapësira që në këtë studim i kushtohet kësaj gjinie letrare është në përpjesëtim të drejtë dhe përfshin më shumë kapituj. Në kuadër më

[5] Rexhep Qosja, "Shkrimtarë dhe periudha", Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1975 f.189-232.

të plotë bëhet shqyrtimi i artikujve të ndryshëm, i epistolarit dhe i intervistave. Kjo zgjeron dhe e thellon njohjen e gjithanshme të çështjeve të trajtuara. Lënda e hulumtuar, faktet, idetë, vështrimet dhe dokumentet e ndryshme, krahas krijimtarisë letrare, literatura e lexuar, komunikimi me bashkëkohësit dhe jehona që ka pasur vepra letrare te lexuesit shqiptarë, janë gjithashtu çështje që studiohen me përkushtim dhe përfshihen në kuadër të këtij punimi.

Rela ka jetuar dhe ka krijuar në një ambient specifik, ku gjatë shekujve të kaluar janë gërshetuar kultura të ndryshme. Krahas kulturave dhe letërsive të popujve të atyre hapësirave gjeografike të Dalmacisë, kanë depërtuar e janë përhapur edhe gjuhët dhe kulturat e popujve të tjerë fqinjë si edhe të shteteve që kanë shtrirë ndikimin e tyre në ato vise. Gjatë periudhave të ndryshme historike ka pasur prandaj ndikime të vazhdueshme në kulturën e arbëneshëve e cila, pa pasur kontakte të vazhdueshme me kulturën kombëtare shqiptare, për disa shekuj me radhë kjo popullsi ka bërë përpjekje të ruajë gjuhën, veçoritë e tjera kombëtare, doket, zakonet, veshjet, artin, virtytet pozitive etnike dhe kulturën shqiptare të traditës. Në të njëjtën kohë janë krijuar edhe vlera të reja, me të cilat ky etnitet është dëshmuar gjatë historisë si element i qëndrueshëm dhe ka përballuar procesin e asimilimit të plotë.

Për të ndriçuar këto rrethana komplekse që lidhen në një mënyrë, ose në një tjetër, me kulturën e arbëneshëve dhe veçanërisht me jetën dhe krijimtarinë e Josip Relës, janë konsultuar shumë vështrime dhe punime që kanë vlerën e tyre të veçantë. Jeta dhe vepra e Relës edhe më parë ka qenë në fokusin e interesimeve shkencore të studiuesve shqiptarë. Që nga fillimi i viteve '50 dhe deri më sot janë shkruar shumë vështrime dhe punime shkencore. Josip Relës i janë kushtuar shumë poezi dhe në këtë mënyrë figura e këtij krijuesi është përjetësuar në letërsinë shqiptare. Numri i zërave bibliografikë në shtypin dhe në periodikun shqiptar është mjaft i madh.

Në vazhdim të hulumtimeve shkencore janë konsultuar disa fonde arkivore në Arkivin e Zarës, në Arkivin e Kroacisë në Zagreb, në Arkivin e Vjenës, në Arkivin e Shtetit në Tiranë, në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, në Arkivin e Kosovës në Prish-

tinë etj. Për qëllime studimi është konsultuar literatura e pasur në bibliotekat e ndryshme dhe me interesim është përcjellë shtypi dhe periodiku i kohës si edhe botimet e veçanta.

Një pjesë e mirë e dokumenteve arkivore është përkthyer në gjuhën shqipe dhe është përdorur në atë masë sa ka qenë e doemosdoshme për këtë punim. Janë shikuar edhe mikrofilmat, letrat, fotografitë dhe materialet e tjera të rëndësishme për këtë periudhë historike.

Josip Rela shkollimin fillor dhe atë të mesëm e ka kryer në Zarë. Me atë vend lidhet edhe formimi i përgjithshëm arsimor dhe kulturor i tij. Në këtë studim, për këtë arsye, duke shqyrtuar lëndën arkivore lidhur me mësimin e gjuhës shqipe ndër arbëneshët, ndriçohen edhe aspekte të tjera të arsimit dhe të kulturës në këtë lokalitet dhe në disa vise të tjera shqiptare. Në fillim të shekullit XX në kuadër të politikës së përgjithshme kulturore dhe arsimore të Austro-Hungarisë, është dhënë orientimi që nga arbëneshët gjuha shqipe të mësohet si lëndë mësimi e detyrueshme në shkollë që nga viti 1901 deri më 1918.

Me interes shkencor është ndriçimi më i gjithanshëm i rrethanave të atëhershme kulturore, lufta kundër ndikimeve asimiluese, përpjekja për nxjerrjen e gazetës në gjuhën shqipe, qëndrimi ndaj mësuesve shqiptarë, disponimi i popullsisë ndaj mësimit të gjuhës shqipe dhe ndaj kulturës kombëtare, çështja e botimit të teksteve shkollore, kontributi i arsimtarëve shqiptarë (Pashk Bardhi, Shtjefën Gjeçovi, Gjergj Koleci, Anton Paluca, Mati Logoreci etj.). Ndikimi i tyre dhe i shkrimtarëve të tjerë siç janë: Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, Faik Konica etj., ka qenë i madh, ndërsa puna e tyre shumë e dobishme. Rilindja kulturore e arbëneshëve ka marrë hov dhe është përfshirë në rrjedhat e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Shtypi dhe periodiku i asaj kohe ka pasqyruar ngjarjet dhe ka trajtuar problemet aktuale shoqërore, politike dhe kulturore. Mendimi shoqëror dhe politik i Rilindjes ka depërtuar edhe në këtë pjesë të diasporës dhe ka nxitur aktivitete kulturore dhe shoqërore me jehonë të theksuar patriotike. Mësimi i gjuhës shqipe, njohja e historisë dhe e kulturës shqiptare, ka forcuar rezistencën kombëtare dhe ka penguar, aq sa ka qenë e mund-

shme, përçarjen kombëtare, dominimin e rrymave të huaja politike dhe asimilimin. Përkthimi dhe botimi në vazhdime i veprës "Shcyptaret e Borgo – Erizzos" të Tullio Erberit në revistën "Albania" të Faik Konicës, botimi i poezisë popullore dhe i materialeve të tjera folklorike nga Arbëneshi, vështrimet për gjuhën, historinë dhe për kulturën e shqiptarëve të Zarës, ia kanë bërë të njohur më mirë opinionit më të gjerë shumë aspekte të së kaluarës dhe të realitetit aktual të Arbëneshit. Në revistën "Albania" janë botuar shumë artikuj dhe materiale të tjera lidhur me arbëneshët. Po aty është hapur edhe tribuna e përhershme "Zani préje arbnéshvét". Formimi i shoqërisë kombëtare në Kuvendin e mbajtur më 8 prill 1903 në Arbënesh ka qenë ngjarje e rëndësishme për shqiptarët e këtij lokaliteti. Në pikën e parë të dëshirave të shqiptarëve është përfshirë ky tekst:

"I. Jemi é levdohémi ce jémi Shciptare nga ghaku é nga zemera. Si Shciptare, nohim per déture te shentmé te duhémi te ghithe sa jemi Shciptare, te jémi te bashkuar é te japim, mish é shpirt per te shellbuar ghakun t'on, – ghuhen t'one". [6]

Gjatë dekadave të mëvonshme arbëneshët vazhdimisht kanë bërë përpjekje ta ruajnë gjuhën dhe kombin, ta zhvillojnë kulturën e tyre dhe ta kultivojnë letërsinë dhe artin në përgjithësi. Studimi i historisë kulturore në planin më të gjerë paraqet baticat dhe zbaticat në jetën shoqërore dhe kulturore të tyre. Sa krenari dhe njëkohësisht sa dhembshuri në jetën e kësaj populsie, e cila prore ka synuar të ngadhnjejë.

Bibliografia e punimeve për arbëneshët e Zarës[7], e hartuar nga Aleksandër Stipçeviqi me rastin e 250-vjetorit të shpërnguljes së arbëneshëve të Zarës, dhe vepra "Historia dhe bibliografia e arbëreshëve të Zarës"[8] tregojnë se çfarë ka qenë interesimi i studiuesve, i publicistëve dhe i udhëpërshkruesve për t'u marrë me probleme të ndryshme shkencore të historisë, të gjuhësisë, të letërsisë dhe të kulturës ma-

---

[6] Fk Bej Konitza, "Shoceria kombetaré é Borgo Eritsos", "Albania", Bruxelles, 1901, nr.4, f.67.


[7] Aleksandar Stipčević, "Kulturno povijesni spomenici u Arbanasima", Zadar, 1977.

[8] Zeqirja Neziri & Aleksandër Stipçeviçi," Historia dhe bibliografia e arbëreshëve të Zarës", Shkup, 1997.

teriale dhe shpirtërore të arbëneshëve. Lënda e pasur studimore dhe rezultatet shkencore të studimeve albanologjike, që lidhen me diasporën shqiptare të Zarës, nxisin punonjësit shkencorë për të zgjeruar dhe thelluar studimet shkencore dhe për të ndriçuar problemet e veçanta në dritën e qasjeve të avancuara të shkencës së letërsisë.

Pjesa e parë e kësaj monografie përfshin fazat kryesore të jetës dhe të krijimtarisë së shkrimtarit Josip Rela: fëmijëria, vitet e rinisë, vitet e mësuesisë, përjetimet e viteve të luftës, jetën në Arbënesh dhe rrjedhat e krijimtarisë letrare. Në pjesën e dytë objekt studimi është krijimtaria letrare (poezia, proza tregimtare, drama dhe shkrimet e tjera). Vlerësimet kritike dhe veçoritë stilistike dhe gjuhësore janë pjesë e këtij studimi integral.

Përfundimi sjell rezultatet e studimit monografik si tërësi. Bibliografia, burimet dhe literatura e përdorur, që kanë rëndësi të veçantë shkencore, përfshijnë informacion të pasur shkencor lidhur me këtë objekt studimi.




Ndihmesa që kanë dhënë individët dhe institucionet kulturore dhe shkencore për ta kryer me sukses këtë studim monografik, ka qenë e konsiderueshme. Mirëkuptimi dhe mikpritja e arbëneshëve, i të gjithë atyre njerëzve të dashur, më ka frymëzuar dhe më ka nxitur në punën hulumtuese shkencore. Me këtë rast ndjej kënaqësi të veçantë të falënderoj të gjithë ata që, në mënyra të ndryshme, kanë dhënë ndihmesën e duhur dhe me vlerë. Falënderimi u drejtohet edhe të gjitha

institucioneve ku kam kryer hulumtimet dhe ku kam siguruar literaturën dhe materialet e tjera, siç janë: Arkivi Historik i Zarës, Biblioteka e Qytetit të Zarës, Bashkësia Lokale e Arbëneshit, Arkivi i Shtëpisë Oborrit dhe Shtetit në Vjenë, Arkivi i Shtetit në Tiranë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë, Biblioteka Kombëtare në Tiranë, Arkivi i Kosovës në Prishtinë, Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës në Prishtinë etj.

Falënderoj përzemërsisht mentorin akademik Rexhep Qosjen dhe profesorët e nderuar, akademik Idriz Ajetin dhe Prof. dr. Gani Lubotenin për kontributin e tyre me vlerë si anëtarë të komisionit.

Prishtinë, 1999 I. SHEMA


ASSOCIATION INTERNATIONALE D'ÉTUDES
DU SUD-EST EUROPÉEN
IX CONGRÈS INTERNATIONAL
D'ÉTUDES SUD-EST EUROPÉENNES
IX-th INTERNATIONAL CONGRESS
OF SOUTH- EAST EUROPEAN STUDIES
PROGRAMME
TIRANA, 30 AOÛT - 3 SEPTEMBRE, 2004
ACADÉMIE DES SCIENCES D'ALBANIE

PJESA E PARË



ARBËNESHI

KAPITULLI I

FËMIJËRIA

VENDLINDJA DHE RRETHI FAMILJAR

Në juglindje të qytetit të vjetër të Zarës shtrihet ngulimi shqiptar, Arbëneshi. Aty, në territorin e atëhershëm të Venedikut, që nga viti 1726-1733, janë vendosur shqiptarë të shpërngulur nga venduanimet shqiptare të rrethit të Shkodrës, nga disa lokalitete të Krajës: Brisku, Shestani, Livari etj., vise të Shqipërisë që ishin të pushtuara nga Turqia.

Lajmi i parë për arbëneshët e shpërngulur në rrethinë të Zarës, siç ka shkruar në studimin e vet Kruno Kërstiqi,[9] është kumtuar më 23 mars 1726. Që atëherë dhe deri më sot kanë kaluar shumë vjet dhe historia e arbëneshëve është shkruar brez pas brezi. Dokumentet historike për këtë pjesë të diasporës shqiptare dhe shumë studime shkencore me vlerë të qëndrueshme, janë botuar në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e huaja. Më 1977 është shënuar 250 vjetori i ardhjes së shqiptarëve në këtë vend historik të Dalmacisë, ndërsa më 1996 u mbushën 270 vjet të themelimit të Arbëneshit të Zarës.

Familja Rela ka origjinë nga një brez i shqiptarëve gegë, të përkatësisë fetare katolike. Arbëneshi, vendlindja e Josip Relës, gjendet në pjesën juglindore të Gadishullit të Zarës. Për këtë lokalitet

---

[9] Kruno Krstiç, "Doselenje Arbanasa u Zadar", "Zadar", Zagreb, "Matica hrvatska", 1964, f.169-194.

kanë shkruar shkencëtarët arbëneshë: Kruno Kërstiqi, Aleksandër Stipçeviqi dhe shumë të tjerë. Me këtë rast po veçojmë njësinë enciklopedike "Arbanasi" të Enciklopedisë së Jugosllavisë.[10] Për historinë e këtij lokaliteti është shkruar si vijon:

"... Fshati i sotëm dhe shumica e popullsisë së sotme rrjedh nga shqiptarët e ardhur. Ata zunë vend në çerekun e dytë të shek. XVIII nga Kraja (Shestani – Kraja), që gjendet midis Liqenit të Shkodrës dhe bregdetit të Tivarit – dikur trekufi i territorit turk, venedikas dhe malazias – kryesisht gjatë tri shpërnguljeve të mëdha në grupe, më 1726-1733. Arsyet e shpërnguljes ishin të shumta: tatimet shumë të rënda dhe keqtrajtimet e rajës shqiptare katolike nga ana e funksionarëve turq të Tivarit dhe të Shkodrës, frika nga murtaja, e cila atëbotë u përhap gjithnjë deri në Pashallëkun e Shkodrës, konfliktet e pareshtura në trekufi dhe marrja me dhunë në shërbimin ushtarak gjatë luftës turko – persiane (1725-36). Merita kryesore për pranimin e të ikurve shqiptarë dhe për strehimin e tyre në rrethin e Zarës i përket V. Zmajeviqit, politikan dhe shkrimtar kishtar i shquar, që në atë kohë ishte arqipeshkëv i Zarës. Pjesa më e madhe e të ikurve rrjedh nga fshati Brisk, Ljarë, Dobrec, Shestan dhe nga mëhallët e Shestanit. Fshati që vendasit e quajnë Arbënesh (si fshati me po këtë emër afër kufirit jugosllav – shqiptar nën Tarabosh), ndërsa kroatët përreth e quanin në fillim qyteza e Ereçinit ose fshati i Ericos (sipas ital. Borgo Erizzo), dhe më vonë Arbanasi, zuri fillin me njëzet kasolle që i ngriti pushteti venedikas për kolonistët. Zmajeviqi ndërtoi në fshat kishën me kombonare dhe godinën e famullisë. Meqë pjesa më e madhe e tokës që iu dha ardhacakëve (diçka më tepër se një hektar për një anëtar të familjes) gjendej në rajonin e fshatit Zemunik, një pjesë e ardhacakëve u vendos në Zemunik përgjithnjë, kurse një pjesë e arbëneshëve ngulën nëpër fshatrat e rrethinës së Zarës... Fshatin e administronte që nga themelimi kapedani i fshatit (shkopi i katundit)... Arbëneshët, të cilët në fillim ishin bujq me pagë dhe barinj të zotërinjve të Zarës, të famullive dhe të katundeve, u bënë shumë shpejt (gjatë një gjysmë shekulli) pronarë ose kolonë të përhershëm të pjesës më të madhe të tokës përreth Zarës. Ata ishin të parët që mbollën

[10] "Enciklopedia e Jugosllavisë" I, Botimi në gjuhën shqipe, Zagreb, 1984, f.234.

misër në rrethin e Zarës, e në saje të punës së tyre sipërfaqet shumë të mëdha të shkëmbinjve, të livadheve dhe të kullosave në rrethinën e afërt dhe të largët të Zarës, u shndërruan në ara dhe në vreshta. Ngritjen e shpejtë ekonomike të ardhacakëve e ndihmoi – të shumtën – tregtia ilegale me prodhimet bujqësore dhe blegtorale, hapja e pijetoreve etj. Disa arbëneshë ishin krahas grekëve anëtarët më autoritativë të esnafit të suxhukxhinjve, kurse në gjysmën e dytë të shek. XVIII disa prej tyre u bënë eksportues kryesorë të bagëtisë dalmatine dhe boshnjake në Venedik. Ata nuk merrnin pjesë në shërbimet publike, përpos në ato klerikale dhe ushtarake, po edhe zejtaria kishte karakter krejt lokal. Këto mjeshtri në fshat nuk ndryshuan deri në gjysmën e dytë të shek. XIX, kur në fshat u hap shkolla fillore. Atëbotë shumë nga ata vazhduan shkollimin dhe zunë të bëhen nëpunës, mësues, juristë, mjekë, etj."

Sipas një statistike të vitit 1881 Arbëneshi ka pasur 1354 banorë arbëneshë, ndërsa në vitin 1900 kishte 5000 banorë. Familjet kishin shumë anëtarë dhe shumë fëmijë. Fshati Arbënesh ishte shumë i madh. Josip Rela në fejtonin për bashkëvendësit e vet më vonë ka shkruar: "... arbëneshët e Zarës janë shtathedhur, të gjatë e thatakë, kreshnikë të sinqertë e liridashës, të shpejtë në punë e në fjalë, të vyeshëm e të zellshëm... Gratë i kishin po ashtu shtathedhura e të drejta, të njohura anembanë si të bukura. Si të martuara ato nuk kujdeseshin më për bukurinë e tyre, por u kushtoheshin burrit, fëmijëve dhe shtëpisë..., ishin të sinqerta, të çiltëra, të vendosura dhe burrnore. Në fillim shtëpitë i kishin përdhese, po të pastërta e të rregulluara mirë. Më vonë fillojnë të ndërtojnë "kulla" me dysheme (kat), e rrallëherë me dy sosh. Pothuaj kurrë nuk i lenin dritaret nga ana e rrugës, por gjithmonë kah oborret e shtëpisë së tyre. Këto janë, pa mëdyshje, rrjedhim i zakoneve nga viset e tyre të vjetra.

Martoheshin vetëm ndër vete, kështu që të gjithë janë të lidhur midis tyre me gjak. Kjo dukuri e martesave vetëm ndër vete i ka kufizuar nga ndikimi i racave të tjera dhe i ka ruajtur gjer në ditët tona.

Është interesant të përmendet se sot të rinjtë martohen vetëm e vetëm me femra të viseve të tjera, e po kështu bëjnë edhe vashat, duke u martuar me djelmosha të viseve të tjera! Për fat të keq, kjo është një

nga parakushtet për humbjen e shpejtë të individualitetit të tyre, ndonëse sjell edhe një të mirë – freskimin e gjakut".[11]

Historia e Zarës, prandaj edhe e Arbëneshit është mjaft komplekse dhe interesante. Gati pas katër shekujsh të dominimit të Venedikut, që nga vitet 1797-1806, ky territor bie nën sundimin e Austrisë. Në periudhën kohore 1806-1823 është shtrirë sundimi i Francës. Zara atëherë ishte qendra e Dalmacisë. Pas luftës midis Francës e Austrisë, në Zarë përsëri hyn ushtria austriake, por kësaj radhe edhe ajo e Anglisë, që gjendej në bregdetin dalmatin. Kjo ishte koha e sundimit të dytë të Austrisë dhe më tej e Austro – Hungarisë, që ka zgjatur deri në vitin 1918, kur pas kapitullimit të ushtrisë së Austro – Hungarisë vazhdonte lufta diplomatike për Zarën dhe Dalmacinë, që ka zgjatur që nga viti 1915-1922. Në anën tjetër Italia luftonte për të shtrirë sundimin e vet në Dalmaci dhe në disa vise e qytete të tjera të Adriatikut. Më 1918 Zara bie nën sundimin italian.

"Pas Luftës së Parë Botërore – ka shkruar Josip Rela – Zara bashkë me Arbëneshin i takojnë Italisë. Nga arbëneshët për Jugosllavi shpërngulet 1/3 e familjeve të shkolluara. Regjimi fashist nuk u lejonte të flasin në familje gjuhën shqipe, apo atë kroate! Fëmijët detyroheshin të regjistrohen në organizatat, si p.sh. "Bijtë e ujkut" e në "Balila", kurse prindërit e tyre detyroheshin, në mënyra të ndryshme, të regjistrohen në "Fashio".[12]

Që nga viti 1918-1943 Zara ishte në kuadër të Italisë. Pas kapitullimit të Italisë fashiste, Zarën e pushtojnë njësitë ushtarake gjermane. Më 1945 Zara dhe bregdeti i Dalmacisë i bashkohen Jugosllavisë së pasluftës.

"Pas Luftës së Dytë Botërore, kur Zara me Arbëneshin i bashkohen Jugosllavisë – ka shkruar Josip Rela... disa nga arbëneshët shpërngulen në Itali e disa në Amerikë, Kanada dhe Australi, afër 1/3, burra, gra e të rinj, meqë nuk u vjen përdore të gjenden në rrethana të reja, e madje trajtoheshin si fashistë. Arbëneshët nuk pranonin

[11] Josip Rela, "Arbëneshët e Zarës", Vepra II, "Rilindja", Prishtinë, 1971, f.265-266

[12] Po aty, f.269

kombësi tjetër, pos asaj arbëneshe (shqiptare), ndonëse disa ishin me kroatët, e disa të tjerë me italianët. Don M. Çurkoviqi ka shkruar në broshurën e vet: "Shqiptari nuk do ta mohonte kombësinë shqiptare për hatër të askujt"! Emrin "shqiptar" arbëneshët nuk donin ta pranonin ngase ky emër ishte përhapur pas shpërnguljes së tyre."[13]

Më në fund, pas shpartallimit të Jugosllavisë, në rrethanat aktuale, sot Zara bën pjesë në Republikën e Kroacisë, e cila është pranuar nga OKB shtet i pavarur dhe sovran. Arbëneshët sot janë shtetas të Kroacisë.

Këto fakte historike të pozitës gjeografike, shoqërore dhe politike të Zarës dhe historinë e Arbëneshit, i paraqitëm në këtë vështrim përmbledhës për të njohur gjendjen e përgjithshme të arbëneshëve dhe për të kuptuar më mirë rrethanat shoqërore dhe kulturore të jetës dhe të veprimtarisë së arbëneshëve në të kaluarën dhe deri në ditët e sotme. Familja e Josip Relës ka origjinë nga një brez i shqiptarëve gegë, të ikur nga atdheu i parë për shkaqe të dhunës së regjimit të atëhershëm të Turqisë në viset shqiptare. Mbiemri Rela nuk është i hershëm, sepse nuk është përfshirë në listat e emrave të kryepleqve të familjeve të shpërngulura. Në një regjistrim të pushtetit venedikas nga viti 1756, përveç tjerash, janë evidencuar gjashtë familje me mbiemrin Vladagni (Vladoviq). [14] Mbiemrin Relja – Vladoviq e gjejmë në listën e familjeve të Arbëneshit të përpiluar nga Çurkoviq. [15]Këtë mbiemër e ka përfshirë në listën e përgjithshme edhe Tullio Erber. [16]

Në fejtonin "Arbëneshët e Zarës"[17] Kruno Kërstiq dhe Zekeria Cana kanë përcaktuar origjinën e familjes Rela: "Nga ato familje që në muajin tetor dhe nëntor të vitit 1733 u vendosën në Zarë, rrjedhin familjet arbëneshe: Duka, Pema (të shuara fare), Mazi, Cotiqi (dega e shuar e familjes Mazi), Marushiqi, Ratkoviqi, Kërstiqi, Stipçeviqi,

---

[13] Po aty, f.269.

[14] Po aty, f.269.

[15] Curkovi◊ Don Mijo, "Povijest Arbanasa kod Zadra", Šibenik, 1922, f.31.

[16] Prof.Tullio Erber, "La colonia Albanese di Borgo Erizzo presso Zara", Dubrovnik, 1883, f.59.

[17] Kruno Kërstiq-Zekeria Cana, "Arbëreshët e Zarës", "Bota e re", Prishtinë 1988, 15 mars, f.17.

Mazhunoviqi (në fillim të quajtur Kovaçi), Marshani, Vladoviqi (Vladoviqi – Vladanji me prejardhje nga Shkodra, hyjnë edhe në fisnikërinë e Venecisë), Rela (degë e Vladoviqëve)..."

Josip N. Vladoviq Rela është i lindur në Arbënesh, më 6 prill 1895. Në "Autobio – bibliografinë" e Josip Relës janë dhënë shënime interesante[18]: "Prindërit e mi janë, i ati , Nikolla i të ndjerit Mate, bujk gjysmë analfabet, i lindur në Arbënesh më 10 nandor 1857 dhe vdekë në Arënesh (Zarë) më 25 tetor 1924. E ëma Mariana Vukiq e të ndyerit Andria, amvise, e lindur më 18 mars 1860 në Arbënesh, analfabete dhe vdekë më 25 maj 1931. Të dytë kanë qenë me origjinë nga shqiptarët e ikun, bujq, të cilët e quajshin vendin "Arbënesh", të vendosun në këtë anë më 1726, 1729 dhe 1733 nga Malësia e Shkodrës, prej katundeve Brisku, Shestani dhe Zjare, nën Rumi e në drejtim të Liqenit të Shkodrës. Kanë pasë 11 fëmijë (gjashtë djem dhe pesë vajza)..."

Josipi ka qene fëmija i tetë me radhë. Fëmijërinë e kaloi në vendlindje. Kujtimet e tij dhe të bashkëvendasve paraqesin mjaft mirë atmosferën e jetës së fëmijëve dhe të familjeve arbëneshe, argëtimet, lojën, shqetësimet. Gëzimi për pranverën, për lodrat, për festat e motmotit janë motive të fëmijërisë të pranishme edhe në poezitë: "Loja", "Nër Kolovare", "Pulimbardi e cilikoku", "Shiu", etj.


SHKOLLIMI FILLOR

Josip Rela shkollën fillore e ka kryer në vendlindje. Ende pa i mbushur shtatë vjet, filloi vitin e parë shkollor 1902/1903. Për atë kohë kjo nuk ishte e zakonshme, sepse fëmijët fillonin shkollën në moshën shtatëvjeçare, e shumë prej tyre edhe në moshë më të rritur. Gjashtë klasë i ka vijuar deri më 1907/1908. Josipi ishte mjaft i zellshëm në mësime dhe dallohej nga nxënësit e tjerë me sukses të shkëlqyeshëm, por edhe me interesimin që kishte për fitimin e diturive shkollore. Shkolla ku mësoi ishte "Ushtrimorja" pranë

[18] Josip Rela, “Autobio-bibliografia”, Vepra I, “Rilindja”, Prishtinë, 1968, f.543-551




Nita.exe



Biografija
Kadoré - Reja N. Josifa

Kadoré - Reja N. Josif, rođen je u Arbanasima, sada reon Zadra, 6.-IV.-1895.
- Nije upotrebljavao pseudonim. -
Roditelji: N. Pjetar i Nafe rođen u Arbanasima 10-XII-1857 zemljoradnik, slabo pismen, umro u Zadru 25/8-1934.
Marijana Vasić k. Andrije domaćica, rođena 18/3 1860. g. u Arbanasima a umrla 25-I-1931. Vrlo poštjeću od zemljoradničke porodice /Srpkinja/, koji su sebe nazivali Arbënesh /arbanasi/, doseljenih u ove krajeve 1716.-1733. g iz sela Brisku, Kšlani i Livari Kadarske krajine. -
Oni su imali 11 djece /šest sinova i 5 kćeri/ i to:
1/ Mate, poštanski činovnik, umro kao ratni zarobljenik u Rusiji, ostavio za sobom 2 sina i 3 kćeri;
2/ Pjetar, zemljoradnik, umro 1969 u Zadru, ostavio za sobom samo kćer Mariju;
3/ Vaso, student prava, poginuo u Prvom svjetskom ratu;
4/ Simun, činovnik, umro kao -"- -"- -"-;
5/ Troje umrlih;
6/ Stanko, zemljoradnik, živi, ima 3 sina i 1 kćer Kćeri:
1/ Rina, udata Cerovac, umrla 1935 u Zadru: 2 sina;
2/ Ljubica, udata Klarić, umrla 1950 u Zadru: 3 sina;
3/ Marica, udata Kordić, živa u Italiji, 2 sina 1 kćer;
4/ Danica, udata Bajlo, živa u Americi, 1 sina;
5/ Nojemka, udata Kordić, živa u Zadru, 2 sina.
Josip je završio 6 razreda osnovne škole 1909.-1910/5.




-2-

u Albanasima, pa pošto ga njesu primili u Učiteljsku školu
pa je bio prisiljen, to je tomu godinu pomagao Jos. Stefanović
oko domaćih i pojedinih poslova. - 1909/10 završio je pr.
prvi razred /bac niže srednje škole/, a 1910/11 - 1913/14 ist.
su razreda Učiteljske škole. - Kolike u učiteljskoj školi
Estike i u starijim razredima concerne škole, u kojo
su primjenjeni domaći /Albanasi/ da uče albanski
jezik; to je bilo sedmično. U to je vrijeme došao iz
Albanije 4 učitelja: 1/Anton Paštu, fratar, 2/Jerej Koleci,
fratar, 3/Stjepan Rela, profesor i 4/Prèke Palaja nas-
tavnik. Bac peti izadnji bio je domaći Paško Gjeja,
učitelj, koji je nije godina bio u Albaniji. -

Jesen je prije mjesto službovanja bila Špeta kod
svoga ujaka Petra, i ma da je bio domaći pisac a uz
to, bio je oslobođen vojske, jer je bio sam u školi /u ko
joj je bilo 156 đaka u 6 razreda/. Međutim, kada je
austro-ugarska vojska zauzela Crnu Goru, a jer je malo
slabo poznavao albanski jezik, upućen je 1916 godine
/kao i ostale učitelji albanaze/ u Crnu Goru - albanske pred
jele - bac učitelja nove otvorenih albanskih škola. Tom
je prilikom bio u Vukoji, blizu Skadra. Ljeti 1917 bio
5 pricac o Božićnoj školi: Ni Anglim mesnji pčelji a druge
1917/18. godine u Prizri /Turci/, pa poslije u Tetovi, gdje je
ugašanom otvorio đačnicu od sto lajuka. - Tu je završio
i počeo pisati dramu „Jacci" koju nije dovršio, koju je spre-
mio u kofer, sa ostalom robom. Taj je kofer, koji Roma i
pratioci sve-u vojske, kod Prizrena na mađarsko hrvat-
skoj granici, od mađarskih vojnika zaplijenjen. Jocik se,
preko Zagreba i Rijeke, vratio u Zadar, koji je već bio oslo
bođen od talijanske vojske. U Zadru je 1919 napisao prvi pri
povijetke za omladinu: „Božićni dar" koji je pribavljen od
Albanskih emigrata 1919. god. a u kući braće Đidića Albanskog
narodnjaka dr Frana Ferončića /Albanaza/ i u Kotoreu.

Na njegovu molbu postavljen je 1919 kao učitelj u upra-




-3-

Velja škola u Vižinadi gdje se 1921 g. iz Labara otseli sa učiteljicom Marijom Waldstein, dirigentom Ivanom Matošom, službenikom, i Virginije Furlanić domaćice.

U Vižinadi se je bavio, osim službene dužnosti, na kulturno-prosvjetnom radu i organizirao je pjevački zbor, uspostavio dilletantsku seliju s djecom i s omladinom, ustanovio i vodio tamburaški zbor, otvorio mjesnu čitaonicu, vladovao Vižinadu, pjesnika, ilirca iz Vinjeca. Organizirao proslavu 60 godišnjice otvora škole, ustanovio knjigu knjiga i mjesta i td. Za rat i boravak njegov pod Italijani, okupatori su ga internirali, kenjcirali i skoro pola zatvorili je nekoliko dana, ali se je rado mješani volio, sijeli i pjevali tako da ga je još i danas svi mila sjećanje naš učitelj. —

Poslije mu je žena bila bolesna, te poslo se je liječe dielazile se kupalista i ljetovca 1928 g. je nastavi u prosvjetnu u Zaštel-Novi, blizu Splita, sad upravitelj škole. Tu je nastavio da radi na kulturno-prosvjetnom radu sa djecom i odraslima. Režirao je razne vrste igre, pa je i sam napisao komediju u 3 čina: „Do zore dana", koja je i njegovom priredbama ali nije nikad štampana. Zatim je napisao komediju u tri čina: „Proba" sada štampana i izvrsna, dočim je sastavio dilletanata na pučana. Ta je komedija tako mnogo djelovala na dilletante, da se je čitava seliju raspršila. —

Iz je je ujedno režiser i izvršitelj, pa je sa njom Banovina hrvatska 1939. za Varnu premjestila u Srijane, mjesto iza planine Učka, gdje je putem izbacila u 11 sati i zapadala u 14 sati. — Nakon 6 mjeseci su ga premjestili u Kaštine kod Splita, gdje je doživao slom jugosl. vojske, i doživao dolazak pul okupatora. Tu je organizirao ženski iz Orani hor. Tu je organizirao pomagače NOP. Tu je napisao humoristične crtice: „Kaštinske radne fotografije". — Kada su Italijani nijesu dozvoljavali da pjevaju u školi, Tu je održio Ivanu Matošu, o kojemu dosla piše u „Dronadama" don Mije, župnika Kaština.




-4-

Hodajući po Kršu oltra Čiova, koji se proteže od Trogira do Splitskog Majdana, naišao je na Dameju, koji je pod nogama, zvonilo. To mu je dalo poticaja da zadubljen tadove Dameje, i bas je valjalo brdo Tadovog Dameja, dao se na sortiranje i tražnje ćistih glasova, po akromatičnoj skali. I mnogo astetskog i lucida upio je da postani čitavu oktavu ispod tonova i podtonova (od g do ē), na čijima se je moglo od srpali udarajući sve crne pjesme). Oraj ga je Klarin spasio od internacije i drugih progona okupatora. Pri odlasku iz Splitina 1945 g. spremio ga je u podkrovlju škole, ali kad se vratio 1946, po poluistvo, nije ga više našao. O Splitinama je napisao poemu: Skrovi planemori, u kojoj ima 15 pjesama.

Po oslobođenju Zadra, u novembru 1944, poveo je grupu djaka iz Splita u Preko, gdje je tada, na očevu želju radio kao pomoćni učitelj. Tu je ostao nešto vrijeme kao nastavnik, dok za Okružni NO u Zadru 1945. nije povukao za svoje potrebe, najprije ga je zadužio za upravitelja Narodnog kazališta grada Zadra, koji se formirao od skeletnog stožla iz torbe. Poslije ga je izabrali za upravitelja učiteljske škole u obnovi. Nešto je vrijeme bio zadužen i za upravitelja Ženskog /Biskupskog/ doma učiteljske škole, te napokon upravitelj osnovne škole "Voćarska" u Zadru, kad mu 1948. god. umrije žena.

Kroz ovo kratko vrijeme isticao se i u vanškolskom radu. Osnovao je sa drugovima prof. B. Katalanom, Biloglavom i drugima "Akademsko društvo" Zadar. Sa drugovima I. Bilopavom, B. Peroničem osnovao kult.-prosv. društvo "Lubenovo". Tu rodnju je prim kult.-političkim društvima, kao SSRNJ, sindikatima itd. Nedavno, nije član SKJ. Tri puta je birao za gradskog i općinskog odbornika. Za vrakog



- 5 -


Hrvatske
ga pad Ministar Prosvjete Broj 34967 od 30-VI-1949.g. potvrđuje,
1950.g. je napunio 35 godina radnog staža, i na vlastiti zah-
tjev penzija, da i dalje radi i kao nastavnik, i kao
organizator pensijskog osiguranja u okrugu Zadar, a
i Split.—

Kad se je nakon 25 godina izbivanja vratio u svoje rod-
no mjesto Arbanase (Zadar), i čuo je vidio koliko se je raz-
vila sjećala, koliko u samom jeziku, toliko i u svijetu
njegovih Arbanasa, koji se bijelu naše u novim uvjetima
života, prinudilo ga je, da na svom arbanaškom dijalektu
napiše lakšu i vedriju dramu: "Ženidba" iz života samih
Arbanasa, ne bi li time probudio, ohrabrio svoje Arbanase,
da da im ulije vjeru u život, u prošnju, i vedru budućnost,
Dva se je drama jedala na javnu pozornici mjestana, gdje
je prošla nezapaženo, uspjeh, ali nije uspjela da bude
štampana.

Dogodilo se, da je mjesto jza Boga stigao u Zadar prof. Vaso
Bartolović iz Beograda sa šiptarskim studentima al-
banologima. Došli su, da obadu neke Arbanase/Albanas rom
grada Zadra/. Njeboli su došli u dolicaj sa nastavnikom
Budimirom Dereticem, a preko oroga sa piscem drame, koje
im je, od samog autora, pročitana i koja je na njih ostav-
vila snažan i nezaboravan utisak.

Na zamolbu i nastojanje prof. V. Bartolića, ona je i štam-
pana u Onjičevoj reviji, Jela-e-re" 1962, u broju 2 sa Kral-
kim predgovorom profesora Bartolića. To je bila prva
veza Josipa Vladović-Reljić sa "Jela-e-re" sa Komitom
i sa Onjičevim radom istoga na šiptarskom jeziku.—


Prigodom savjetovanja Onjičevića Skopje, koliko sje-
seca jula 1955. godine održalo se je u inicijativu Predsjedništva
SSRNJ i "Jela-e-re", dug Vladović-Reljić Josip posjetio je
prijatelj Komet sa Budimirom Dereticem, kom se je pri-
godom upoznao sa drugovima Esad Mekuljem, Vasom



Mekulijem, Pietro Fanurom i mnogim drugima a još prije u Zadru se upoznao sa drugovima Danir Pelmendijem, Rekap Shitom, Pejic Qelijem i drugima.
Drugi put je posjetio Prištinu prigodom 10godišnjice književnog časopisa „Jeta e re" 1954., pa je protirio druge svoje prijatelje u Kosmetu, a upoznao se i sa eminentnim književnicima Jugoslavije M. Popovićem, A. Vučom, D. Trifićem i Sijarićem i ... (?)
Josip Vladović-Relja živi u Zadru i još pomalo radi. Njegov je stvarni poziv bio „učitelj", a njegov književni cilj bio mu je, kako sam kaže: „Nastojanje da uredno, da oplemeni i pisanjem širi književnost u „sebi i oko sebe".
Nije inače djeca. Drugi put se oženio 1962.g. sa Jelenom Kosta, Austrom, domaćicom.

II


Spomenusmo da je Vladović-Relja Josip pisao i na srpsko-hrvatskome jeziku ali to mu nije štampano. (Nije ni tražio). Tek je u Zadru u Zadarskoj reviji" 1952. broju 3 štampana njegova pjesma: „Okupator priča", a 1953. u broju 1 pjesma: „Partizanu."
Tjednik „Glas Zadra" objavio je prigodom proslave 10godišnjice oslobođenja Zadra pjesmu: „Zadru", a povodom godišnjice 1968. pjesmu: „Razgovor djeda Mraza s djecom." - Prosvjetni njegovi radovi u srpsko-hrvatskom su zatvoreni (ili razbacani) po kabinetima.
Sa njegovim radovima na albanskom jeziku stoji nešto drugačije: Njegova prva drama: „Kartesa" štampana je, kako ranije spomenusmo, u „Jeta e re" književnom časopisu za Kosovo i Metohiju 1952. u broju 2 (drama u 3 čina).
„Jeta e re" je njegove radove objavila godine:



- 7 -

1952. broj 4 „Prindit fmijve" - 3 gjesla
broj 5,6 „Zani i le birucit" - vjeshë
1953. broj 2 „Lungalli" dramë në 3 akte
3 „Breqa i Kbos" - vjeshë
1954 broj 5 „Kujtoni kujtoni mua" - vjeshë
broj 1,2,3,4 „Nita" - dramë në 4 akte
„Kroni le filan" vjeshë
1955/4 „Kka jam unë" - vjeshë
1956/2 „Liris" - vjeshë
1959/1 „Tri vjesha" - vjeshë
/3 „Bota vdes" - vjeshë
/4 „Gjeshtës s' Kati" - vjeshë
/5 „Fjala e lavgës jime" - -"-
1960/3 „Kujtimi" -"-
1962/6 „Lundëza e Jorkes" - dramë në tre akte
/5 „Kisha me dashtë" - vjeshë
1963/1 „Gjaloshi" - -"-
/3 „E du me je" - -"-

Dhe disa fjera. - Gjithsej objavila una je
ilustrjaua perjo za mlagost u
1953 „Yellat thirmani" vjeshë
1953/4 „Fulëbotli" "
1954/6 „Koti i Arq." "
1954/12 „Kkoferi i re" -"-
1955/6 „Fergjeja l'esltnave" -"-



– 8 –

1960/1 „Të dua Partizan" – vjersh
1960/2 „Agonia" – " –
1960/23-24 „Fjalë gjyqi e malsorit" – " –
1963/1,2,3 „Kaltër i ëmbël" – " –


Dhe disa fjalë

Dyjeti list „Dëshmi" sjellë je 1955/2 „Gëzohu të prekur" vjersh
e Flakës e vllaznimit 1955 brij 312 „Lahu të trëndafilt" – vjersh
Ovdji nije pre i znijato što je objavljeno, jer je mnogo šta izbjeglo
s obzirom da su mu neki brojevi (Jeta e të) ujela godina (nestali).

Prozom se je vrlo malo bavio. Tek „Jeta e të" mu je objavila
1954 u broju 5 „Ni kujtim me nji pendje" – prepovjest, a
Zani i pirus 1954 „Në pun Zhvenije" skica i
„Vepra e fjollës t' Arbëneshë e zadrë" feljton

III

Osvrti na rad i djela Hadžić-Relja Josipa nalaze se:
„Zani i pirus"
1954/10 „Adhuket me përkthye Nilen..." Ramiz Kelmendi,
1955/6 „Nita ne theatrin e Prishtines"...
„Rilindja"
1955 me 6 Qeshmor: Festivali i tretë... Vilson Shita,
1955 me 13 mars: "Nga provat e N. Tës"... Ramiz Kelmendi,
1955 me 24 mars: "J. V.-Relja N. ta"... Vilson Shita,
1955 me 14 prill: "Me dramen Nita"... Vilson Shita,
1955 me 19 maj: "N. ta fiton një prej...
Valjda i grupoja.



-9-

Jela e re' shqipja je shfaqur ketu:

1954/4 "Fregim i dramatizuem ose..." Dauiz Kelmendi
1954/6 "Nga festivali i parë..." Kolaq Shla
"Disa fjale para paragitje..." Dauiz Kelmendi
1955/12 Kritika e "Nites" - - - Kolaq Shla

Mozda i jos nqoje.

Jugosllovenski listovi Borba, Vjesnik, Politika" Njëzeme novine" dhanjele su prjodno kratke vjerte na djela "E.R. Jeff.

- + -

U Antologiji "Iplarske književnosti H. Horki, Q. Nimani i S. Hatipi - Sarajevo 1954. iznijet je prikaz Josipa V. Relje s izvatkom os, Karlese i pjesmom "Zavi" i te bjesnit, a u Gjeme gorde i ponosne - poezija Shiptar FNR J. - Nolit - Bjebgrad 1962. izdsao je kratak prikaz kritika poezji V. R. Josipa i prevedene na srpsko-hervat-skom pjesme: Zeleo bih" i "Sto sam".

Sretno" o Vasu jamoni radu Su. -

Zadar, 17/VIII 1963

Shkollës Normale të Arbëneshit. Ajo ishte shkollë e veçantë, ku vijonin mësimet kryesisht nxënësit arbëneshë. Shkolla shërbente edhe për ushtrimet praktike të nxënësve të Normales. Josip Rela dhe nxënësit e tjerë të Arbëneshit patën rastin të mësojnë gjuhën shqipe si gjuhë mësimi në shkollë që nga viti i parë 1901 dhe deri më 1918, 2-3 orë në javë. Mësimi i shqipes dhe hapja e disa shkollave shqipe në viset shqiptare, lidhet me interesimin dhe politikën e Austro – Hungarisë për të shtrirë ndikim e vet ne Ballkan, prandaj edhe në Shqipëri.

Përpjekjet për hapjen e kurseve të gjuhës shqipe kishin filluar më herët dhe veçanërisht që nga viti 1897. Dokumentet e Arkivit të Vjenës përmbajnë të dhëna të shumta për këtë çështje, por edhe për rrethanat shoqërore, kulturore dhe arsimore të arbëneshëve.

Josipi nxënës gjuhën shqipe e fliste në familje dhe në rrethin e arbëneshëve. Në shkollë ai ka filluar ta mësojë gjuhën shqipe që nga viti 1903, sepse atë vit, pasi më parë kursi i shqipes kishte filluar në shkollë të mesme, filloi mësimi edhe për filloristët, 3 orë në javë. Numri i nxënësve ishte 60-70. Në një raport të mësimdhënësit të shqipes, të Atë Pashk Bardhit, Ordo Fratrum Minorum (O.F.M.)[19] jepen të dhëna interesante. Mësues të Josipit kanë qenë: Atë Shtjefën Gjeçovi O.F.M. dhe Gjergj Koleci. Për mësimin e gjuhës shqipe në Arbënesh kanë shkruar: Dr. Jashar Rexhepagiqi, Dr. Hasan Kaleshi, Dr. Ivo Periq, etj.

Ante Bushkuliq, shok i fëmijërisë së Josipit, ka shkruar: "Kemi qenë bashkë që nga klasa e parë e shkollës fillore dhe deri më 1915, kur shkova në shërbimin ushtarak. Së bashku kemi shkuar dhe jemi kthyer nga shkolla, së bashku kemi ruajtur bagëtinë në fushë dhe kemi zënë peshq, shejtanllëqe të përbashkëta, tallje, ngacmime, përqeshje, si dukuri të pashmangshme te fëmijët, të cilët ashtu ishin mësuar nën ndikimin e arbëneshëve më të moshuar, të cilët atë mënyrë ndikimi e kishin adet si korektiv primitiv për përvetësimin e marrëdhënieve të zakonshme midis fshatarëve, qysh nga koha para shpërnguljes së tyre në Zarë. Kemi vijuar shkollën fillore kroate dhe në mënyrën instiktive kemi ardhur në kundërshtim me fëmijët, të cilët vijonin shkollën fillore italiane në fshat, si fëmijë të prindërve të varur nga administrata italiane në komunën e Zarës. Shpesh jemi rrahur me ashpërsi, derisa jemi përgjakur. Bepo, si e kemi quajtur Josipin, ka qenë midis nesh më luftarak.

Nën mbikëqyrjen e prindërve të ashpër dhe të familjes së bujkut me shumë anëtarë, nuk ka pasur ledhatime, vetëm se në ato rrethana është vënë baza për formimin e karakterit të tij. Shoqërimi deri në vetëmohim, bashkëndjeshmëria deri te zemërbutësia, ndërsa glorifikimi i trimërisë tradicionale është shtuar me rritjen e tij. Afërsia e të pasurve dhe kryelartësia e zotërinjve në Zarë, kryeqytetin e Dalmacisë, ia ka imponuar krahasimin, përfundimet për pabarazinë ekonommike, sociale dhe kulturore, që ka pasur ndikim të fuqishëm në lindjen

[19] Raport i Pashk Bardhit, i cili bënte pjesë në "Urdhërin e vëllezërve të vegjël françeskanë".

dhe zhvillimin e qëndrimit të tyre revolucionar qysh nga vëzhgimet e para si nxënës.[20]

Në formimin e Josipit ka ndikuar edhe rrethi familjar dhe ai i arbëneshëve në tërësi. Arbëneshët në atë kohë, në familje dhe në rrugë, në punë dhe gjetiu, në mes vete kanë komunikuar në gjuhën shqipe. Ata kultivonin kulturën e tyre popullore dhe këndonin këngët popullore, kultivonin tregimet dhe format e tjera dramatike dhe lojërat arbëneshe. Krenaria kombëtare, kujtimi për Skënderbeun, për ngjarjet e ndryshme historike etj., prore frymëzonin arbëneshët.

Këngët popullore të djepit, të dasmës, këngët patriotike, përshkruese, ato të riteve të motmotit etj. kanë kënaqur fëmijët dhe të rriturit dhe kanë zgjuar te ata vetëdijen kombëtare, për të dashur gjuhën, të folmen arbëneshe të të parëve, kanë zgjuar interesimin për të njohur kulturën dhe traditën kombëtare shqiptare.

Në një ninullë arbëneshe fëmijës i këndohej me dashuri:

"Aj nini, nini, miu tem
Flej, flej zogu jem
Unë të ruaj ty
Si zemrën, si sytë."

Disa materiale folklorike nga Arbëneshi janë botuar edhe në librin "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1633-1912)"[21] dhe në publikime të tjera. Kënga e vjetër e dasmës arbëneshe, që është shumë e përhapur edhe sot e kësaj dite, është shënuar gati nga të gjithë studiuesit që janë marrë me studimin e gjuhës dhe të kulturës arbëneshe. Vajza dhe djali janë lule drandofilesh të ambientit arbënesh:

"Këndon zogu, zog mullinja

[20] Ante Bushkuliq, "Vladoviq Rela Josip". Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së tij, më 30.XII.1966, shkrim i dërguar nga Rijeka, më 21.XII.1967 - Redaksisë së revistës "Jeta e re" në Prishtinë (Dorëshkrim).

[21] "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912)", III, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1962, f.487.

Ndërmjet lulesh, drandofilesh
(Në dy lule drandofile)
Djali i ri çili sytë
Mos merr vajzën për pajë
Paja vjen, paja shkon
Erxha (njeriu i keq) vjen e kurr nuk shkon"

Një tjetër këngë e shënuam me këtë përmbajtje:

"Atje lart në fushë të malit
Ku po kalben djemt e ri
E të ritë, të rit' e Skënderbeut
Nana kjahet shoqnis' saj,
Për biq (bijt) që ka bri n' ratë (luftë)
Nana thot: mos ndigjoni fjalt' e hallkut
Ata flasin keq për ne" [22]

Kujtimet nga koha e fëmijërisë dhe krijimtaria popullore i kanë lënë Josip Relës përshtypje të paharrueshme. Ai do t'i evokojë ato më vonë në poezitë e përmbledhjeve: "Dhimbjet e mija" dhe "Rreth vendlindjes." Në poezinë "Nana birit në prehën" do të përfshijë vargjet:

"Edhe në prendë po më fle
Punë të mdhaja do' me dijt'!
Për të ndret', trimi po m'pëvet,
Po njerzi ti s'do m'u rrit'..."

Josip Rela ka shkruar për kohën e fëmijërisë: "Kujtohem si fëmi, kur verës binte shi, na fëmija, u gëzoheshim tue recitue kangën "Shi, shi në Shumbëri...":[23]

[22] Nasho Jorgaqi, "Zëra prej së largu...", Tiranë, 1979, nr.4, f.197-198.
[23] Nga dorëshkrimet e Josip Relës.

"Shi, shi në Shumbëri
A do vén a raki?
– Faleminders nuk ta pi
Pse m'ó burri në Istri,
Kur t'më vinje pe Istrije
Gji' ta pi".

Në epistolarin e Relës gjejmë edhe këtë shënim: "Babai im... Me keqardhje i lëshonte fëmijët të largohen nga prehëri i tij... Nëna Marije... ka insistuar që fëmijët të shkollohen... Shkollimi im: 1902 deri më 1908, gjashtë klasë të shkollës fillore në Arbënesh. Një vit u kam ndihmuar prindërve në punët e fushës, sepse nuk kisha vite të moshës së mjaftueshme të më pranonin në Shkollën Normale, më 1909/10 klasën përgatitore të Shkollës Normale, (Ashtu është dashur për Dalmacinë gjatë kohës së Austrisë). Gjithë shkollimi ka qenë në gjuhën kroate. Nga klasa e katër fillore deri në fund), edhe në Shkollën Normale, kemi qenë të detyruar të mësojmë gjuhën shqipe një orë në javë. Më kujtohen arsimtarët: Pashk Bardhi, Gjergj Koleci, (fratri), S. Rrota dhe Ndoc Paluca".[24]

Në një letër tjetër Rela ka shkruar: "Në Zarë (më mirë në Arbënesh)... nuk ka pasur kurrfarë shkolle në gjuhën shqipe... në shkollën fillore të Arbëneshit mësimin e obliguar në gjuhën shqipe, 2 herë në javë në klasat e larta (klasa e IV, V dhe VI), të detyruar, po ashtu për arbëneshët (shqiptarët). Për nxënësit e tjerë fakultativisht. Për këtë qëllim pushteti a-h pruri mësimdhënës të ndryshëm nga Shqipëria...".[25]

[24] Nga doreshkrimet e Josip Relës.
[25] Nga epistolari i Josip Relës, vepra II, f.250.

MËSIMI I GJUHËS SHQIPE NË ARBËNESH TË ZARËS

Çështja e mësimit të gjuhës shqipe në Arbënesh të Zarës është studiuar për një kohë të gjatë nga studiues shqiptarë dhe të huaj. Lidhur me këtë temë ka shumë dokumente arkivore dhe materiale të tjera të shkruara nga hulumtues të ndryshëm shkencorë. Megjithatë, në këtë vështrim ndriçohen aspekte interesante dhe paraqiten të dhëna plotësuese për veprimtarinë arsimore dhe edukative në këtë ngulim shqiptar.

Në Arkivin Shtetëror të Vjenës dokumentet janë sistemuar në kuti të veçantë me shënimin "Gjuha shqipe në Arbënesh të Zarës (1897-1913)"[26]. Aty ka shkresa zyrtare, relacione të ndryshme, letra, raporte, dokumente shkollore në gjuhën gjermane, italisht, kroatisht etj. Në gjuhën shqipe janë shkruar disa letra, përkthime dhe raporte të mësuesve shqiptarë. Një pjesë e këtij dokumentacioni është fotokopjuar pastaj nga arkivat e tjerë. Dokumentet ruhen në Arkivin e Zarës, në Arkivin e Kosovës, në Arkivin e Institutit të Historisë (Tiranë), në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë (Tiranë), në Arkivin e Shtetit të Shqipërisë etj. Një pjesë e këtij materiali është përkthyer në gjuhën shqipe dhe përfshin informacion të rëndësishëm për ndriçimin e problemeve të zhvillimit të arsimit dhe të kulturës në këtë pjesë të diasporës shqiptare.

Në bazë të dokumenteve autentike arkivore ndriçohen aspekte të veçanta të mësimit të shqipes dhe jehona që ka pasur në rrjedhat e përgjithshme arsimore dhe kulturore të Arbëneshëve. Interesimi i Austro – Hungarisë për të zhvilluar aktivitete kulturore dhe arsimore në Arbënesh të Zarës, e pastaj edhe në disa vise të tjera shqiptare, për të punuar "në interes të lëvizjes shqiptare", është shfaqur më herët. Në dokumentet e Arkivit të Vjenës, posaçërisht në një raport të Këshilltarit të Oborrit, Fon Tallozhi [27], më 5.10 1897, ka shkruar: "Borgo

[26] Haus-Hof-und Staatsarchiv (Arkivi i Shtëpisë-Oborrit dhe Shtetit), Vjenë. Signatura XIV.3 - Arkivi Polititk - Shqipëria I. (Fondi P.A. XIV/3.)

[27] Mikrofilmi nr.1/1 (1987-'98). Fashikulli XIV, 5. (Material arkivor që ruhet në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë).

Erico pranë Zarës është vendi ku mund të vihesh në skenë një lëvizje letrare e drejtuar simbas kuptimit tonë. Në Zara qeveria mund të kontrollojë çdo gjë, t'i japë kësaj lëvizjeje mbrojtjen e përshtatshme... Detyra e ngarkuar ishte, që t'u jepte banorëve të kuptonin, se pikëpamjet e tyre, të partive lokale të bashkoheshin fare mirë me gjuhën e tyre amtare shqiptare...

Banorët e Borgo Ericos flasin vërtetë në përgjithësi shqip, por si përgjithësisht shqiptarët, ata nuk janë të stërvitur në leximin e gjuhës së tyre amtare. Prandaj ata dëshirojnë një shkollë nate në të cilën fëmijët e tyre të mësojnë, shkruajnë dhe të lexojnë prej teksteve shkollore shqip dhe prej një mësuesi shqiptar gjuhën e tyre amtare. Sipas ligjeve provinciale të Dalmacisë për një shkollë fillore shqipe nuk mund të bëhet asnjë fjalë".

Më tutje, në këtë raport të udhëtimit në Arbënesh, në shtator të vitit 1897, bëhet fjalë për detyrën që "tekstet shkollore të plotësoheshin sa më parë, shkruhet për gazetën "Zani i Shqiptarit", e cila do të kishte 8-12 faqe dhe do të kishte këtë fizionomi: a) pjesën letrare, b) pjesën praktike ekonomike, c) pjesën tregtare, d) artikujt letrarë dhe një pasqyrë të ngjarjeve politike. "Artikujt t'i vihen në dispozicion redaksisë prej Vjenës dhe prej Shkodrës. Është e natyrshme se nuk do të botohen korrespondenca të ndryshme prej Shqipërisë". Pastaj parashikohej përkthimi i librave të shkollave fillore.

Redaksia e gazetës, sipas tij, do të fillonte në nëntor, ndërsa numri i provës do të dilte në dhjetor 1897.

"Nevojës së shqiptarëve për të lexuar mund t'u shërbesh në qoftë se do të shpërndanim libra të lira popullore, si: gjeografi, ekonomi etj.

Në fillim do të botohej një kalendar popullor, e pastaj, në bashkëpunim me klerin, do të botoheshin disa libra laike... se elementët shqiptarë të drejtuara dhe të udhëhequra prej neve do të arrijnë me siguri në formimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare..."

Interesimi për organizimin e mësimit të shqipes ka qenë edhe veprim për të penguar depërtimin italian në Arbënesh, por edhe synim që aty të përgatiteshin mësuesit shqiptarë të cilët do të shërbenin më vonë në shkollat katolike në Shqipëri.

Autoritetet e atëhershme përgjegjëse të Austro – Hungarisë, që merreshin me këtë problematikë, i kanë kushtuar kujdes të veçantë zgjedhjes së mësuesit të parë të shqipes në Arbënesh. Në rrethin e kandidatëve të mundshëm për mësues të gjuhës shqipe kanë qenë: Niko Muriçiqi (mësues me origjinë nga Arbëneshi), Kristo Çurkoviqi (mësues në shkollën qytetëse në Makarska), At Gjergj Fishta (famullitar i Gomsiçës), Dom Andrea Mjeda (famullitar i Mirditës), Mati Logoreci (mësues nga Prizreni), Patër Pashk Bardhi etj. Patër Bardhi kishte propozuar që si mësues të caktohej Dom Andrea Mjeda (famullitar i Vigut). Pas të gjitha këtyre propozimeve, mësues i parë i gjuhës shqipe në Arbënesh është caktuar Pashk Bardhi. Zgjedhja është bërë midis dy kandidatëve më të mirë: Pashk Bardhit dhe Gjergj Fishtës. Është interesant krahasimi që bëhet midis këtyre dy mësuesve të mundshëm. Në raportin e vet Ippen ka shkruar: "... Patër Bardhi është më serioz dhe më i thellë se Patër Gjergj Fishta, ai ka më tepër durim dhe probabilisht edhe më tepër njohuri. Patër Gjergj Fishta ka më tepër prirje artistike. Ai ka një talent të rrallë për të vizatuar dhe për të pikturuar. Karakteri i artistit shfaqet tek ai që punët i merr lehtë, në mungesë konsekuence dhe durimi".

Fillimin e punës së Pashk Bardhit si mësues Shtjefen Gjeçovi e përshëndet me një poezi:

"UDH'E MAAR!

U nisé e shkové o Atdhetar
Tuj lan pragun é Atdhéut tann
Shnetia t'prift! Se'dhe' ta jan Shcyptar
Vllaznit aatdhetare Tyy, é Atdhétarvé
t'atjeit". [28]

Para se të fillonte punën, Pashk Bardhi ishte ftuar të shkojë në Vjenë për konsultime të duhura. Ai i ka shkruar një letër Faik Koni-

[28] Lkeni i Hasit, "Udh'e maar!", "Albania", Bruxelles, 1902, nr.1, f.15.

cës: "Përpara se me ngulë në Zarë, shkova në Wien për me u marrë vesh për mësimet qi do të nepsha në shkollë të Borgo Ericos". Konica më 17. XII. 1901 i ka shkruar Bardhit: "I lutem Zotit që puna e shkollës të vejë nure e të kesh durimin për të shpënë mbarë një pun' aq të bukur e aq atdhetare. Besonj se tani të japësh mësime edhe në djem të italofilë, se edhe mua më pyeti një zotëri nga ata miqtë, e i thashë se kishte me kenë gabim i math sikur të mos mësojin shqip edhe ata të lagjës italiane në Borgo Erizzo".

Dy çështje të tjera: sigurimi i teksteve shkollore dhe i bursave janë diskutuar për një kohë të gjatë. Këshilli arsimor provincial për Dalmacinë kishte vendosur "që provizorisht të përdoreshin tekstet e gjuhës shqipe të botuara në Itali, por me që ato ishin vepra letrare, nuk u morën në konsiderim si tekste shkollore. Konstatohet se edhe gramatika e De Radës dhe libri i leximit nuk ishin të përdorshme. Më në fund njoftohet se: "... ka dalë një libër leximi për shkollat elementare, pjesa I dhe pjesa II, një gramatikë është në shtyp e sipër dhe që ka për të qenë pa tjetër gati në fillim të vitit shkollor 1901-1902".

Në mënyrë të veçantë parashiheshin bursa "për ata nxënës të Institutit Pedagogjik, që do të merrnin pjesë në kurset e gjuhës shqipe, se Ministria p. dhe mbretërore e jashtme është me gëzim gati që pas organizimit të kurseve të shqyrtojë më imtë këtë ide...". Parashihej gjithashtu që tekstet shkollore të jepeshin gratis.

Më vonë është dhënë edhe propozimi që në Arbënesh, në kurset e shqipes, të përdoreshin tekstet shkollore të botuara prej shoqërisë linguistike të Shkodrës": libri i leximit, pjesa I dhe II, gramatika dhe si libra ndihmës: gjeografia dhe katekizmi. Megjithatë, në letrën që Ippen, konsull i përgjithshëm në Shkodër, ia ka dërguar Kontit Goluhovski, ministër i jashtëm i Vjenës, edhe më tutje ishte e hapur çështja e caktimit të mësuesit të shqipes. Kishte më shumë argumente që për mësues të caktohej Andrea Mjeda. Ippen mendonte se duhej mbyllur mosmarrëveshjet midis Mjedës dhe Doçit dhe pastaj, "... në postin e tij në Zara Dom Andrea mund të bëjë shumë për zhvillimin letrar të gjuhës shqipe... ai është një nga klerikët shqiptarë më mirë i kultivuar dhe veçanërisht një njohës i gjuhës shqipe dhe i studimeve linguistike,

si dhe pastaj një punonjës i zellshëm, që është një cilësi e rallë ndërmjet klerikëve shqiptarë".

Më 28 maj 1901 përfundimisht ishte vendosur që Pashk Bardhi të caktohej mësues i shqipes dhe ai duhej të fillonte punën arsimore në javën e parë të shtatorit të po atij viti në Arbënesh. Mësimi i shqipes aty kishte zgjuar interesim të madh, prej këndej edhe insistimi i tyre që shqipja të mësohej në të gjitha shkollat ku mësonin fëmijët shqiptarë. Lidhur me këtë Guvernatori i Dalmacisë, në një raport dërguar Ministrisë së Kultit dhe Arsimit, më ll janar 1902, ka shkruar: "... por duke marrë parasysh popullarizimin e studimit të gjuhës shqipe. të dëshiruar prej Ministrisë së Jashtme, Këshilli i Arsimit provincial e ka shfaqur mendimin e tij... në qoftë se do të viheshin në veprim kurse të natës, me nga dy orë në javë, ose kurse për të rritur në Borgo Erico në ditët e djela dhe në ditët e pushimit dhe se për këtë qëllim mund të vihesh në dispozicion Patër Bardhit një lojal i përshtatshëm i Institutit Pedagogjik... Nderohemi të theksojmë gjithashtu, se në shkollën ekzistuese të ushtrimores, fryma lojale dhe ideja patriotike e rinisë shkollore po lëvrohet dhe po favorizohet me plan dhe në mënyrë insistuese... Më në fund marrim lejen, vazhdon Ippen, të vërtetojmë marrjen në dorëzim të një arke që përmbante tekste shkollore për kursin e gjuhës në Borgo Erico...". Informata se botohej revista "Albania", e cila kishte materiale interesante letrare dhe kulturore, pastaj edhe artikuj për arbëneshët, i nxit autoritetet arsimore që të rekomandohet për përdorim në funksion të mësimit të shqipes. Gjithashtu bëhen porosi për sigurimin e librit "Historia e Shqipnisë" e Ndoc Nikajt si lëndë mësimore. Nga publikimet e zgjedhura për përdorim duhet veçuar:

1. Libri i leximit shqip, Pjesa III, e botuar nga shoqëria "Bashkimi",

2. Teksti i gjeografisë, i botuar prej të njëjtës shoqëri,

3. Historia e Turqisë, e botuar tani afër, e cila mos të konfondohet me "Historinë e Shqipnisë", të propozuar atëherë prej P. Bardhit dhe që pastaj u gjet e papërshtatshme,

4. Revista "Albania" që botohet në Londër.

Tekstet e tjera shqipe mund të përdoreshin vetëm me lejen e veçantë të Ministrisë.

Në raport është shënuar se në kursin për të rritur vijonin mësimin 22 persona që nga 16-40 vjeç. Që nga 13 tetori i vitit 1902 mësimi i shqipes mbahej dy herë në javë (të mërkurave dhe të shtunave) prej orës 5½ në orët e mbrëmjes. Kërkesat për zhvillimin e kulturës në Arbënesh shtoheshin vazhdimisht.

Përveç botimit të librave shkollore, shtimit të kurseve të gjuhës shqipe, formimit të shoqërive shqiptare, më 1907 kërkohet hapja e sallës së leximit, ku do të lexoheshin libra, gazeta dhe revista shqipe. "Banorët e vendit do të dëshironin shumë, sikur të kishin edhe një famullitar shqiptar të tyrin, dhe një i tillë klerik me mendime kombëtare do të kontribuonte sigurisht shumë për të zbutur kontradiktat, për eliminimin e përçarjes dhe për bashkimin e banorëve."

Në një ekspozicion të At Pashk Bardhit, O. F. M., mësimi i gjuhës shqipe në shkollën normale "perandorake dhe mbretërore" të Arbëneshit të Zarës, të datës 25 korrik 1905, që i paraqitet Konsullit të përgjithshëm perandorak dhe mbretëror austrohungarez në Shkodër, shkruhet si vijon: "Në vitin 1901 filloi të jepet mësimi i gjuhës shqipe në shkollat e Arbëneshit. Së pari filluan në Shkollën Normale dhe në shkollën profesionale të ngjitur Normales. Në Normale jepej mësimi tri orë në javë... Në shkollën profesionale jepet mësimi i gjuhës shqipe katër orë në javë, dy orë në klasën e dytë dhe dy në të tretën. Numri i nxënësve sillet aproksimativisht nga gjashtëdhjetë deri në shtatëdhjetë. Me përjashtim të një numri të vogël, të gjithë të tjerët janë shqiptarë. Përparimi është i kënaqshëm...".

Në vazhdim ai konstaton se më 1903 filloi mësimi i shqipes në shkollat femërore nga tri orë në javë, "një orë në klasën e dytë dhe dy orë në të tretën". Në Arbënesh ekzistonte edhe shkolla fillore mashkullore me mësim në gjuhën italiane, por atje në fillim nuk mësohej gjuha shqipe. "Lega Nazionale" synonte italianizimin e arbëneshëve. Në këtë kohë ishte hapur çerdhja për fëmijë prej tri deri gjashtë vjet. "Fëmijët frekventues të kësaj, ka shkruar Bardhi, dëgjohen duke folur italisht nëpër rrugët e Arbëneshit, gjë që përpara themelimit të kësaj

çerdhe nuk ndodhte kurrë, sepse shqiptarët e Arbëneshit nuk flasin kurrë midis tyre tjetër gjuhë përveç shqipes".

Popullsia e Arbëneshit në thyerjet politike të kohës një pjesë përkrahte politikën e Austro – Hungarisë dhe ishte edhe prokroate, ndërsa një pjesë tjetër atë italiane dhe ishte italofile. Kjo ndasi është reflektuar edhe në arsim, prandaj edhe në mësimin e shqipes. Pashk Bardhi për këto rrethana ka shkruar: "Në Borgo Erizzo ishin atëherë dy shkolla për djem, një shkollë normale me shkollë praktike, në të cilën mësimet i nepshin kroatisht, e kjo ishte shkollë shteti; e një fillore private, në të cilën mësimet u nepshin italisht. Këtë shkollë e mbajte nji shoqni italiane emnue "Lega Nazionale". Gjeverija austrijake këtë shkollë e tolerojte, por nuk e njifte. Mbasi Shqyptarët e Borgo Erizzos politikisht u dajshin në dy parti, italjane e kroate, kështu edhe fëmit i çojshin në njenën shkollë a në tjetrën.

Unë prej ministrije kishe urdhen me dhanë mësime të gjuhës shqype në shkollën kroate qi ishte shkollë shteti. Por edhe ata të partis italjane dishrojshin që fëmija e tyne të nxane shqyp, e ata të "Lega Nazionale", jo vetëm nuk kundërshtojshin, por edhe ishin gati me e pague ata vetë mësuesin e gjuhës shqype. Prandaj un për pesë vjet qi kam ndejë atje, pa pra jam mundue me ja mbushë mendjen ministris austrijake, qi të më lejonte me dhanë mësime të gjuhës shqype edhe në shkollën italjane. Po kurr nuk kan ndigjue, pse u kundërshtojte Mkambsja e Dalmacis"[29].

Mbas Pashk Brdhit, që ka shërbyer aty që nga viti 1901-1905, mësues i shqipes ka qenë edhe Shtjefen Gjeçovi. Ai në fillim kishte kundërshtuar punën si mësues të shqipes, sepse kishte reaguar ashpër për shkarkimin me të padrejtë të Pashk Bardhit nga ky post dhe veçanërisht për dyshimet e pa baza ndaj qëndrimit të Bardhit në Arbënesh. Siç dihet, krahu italofil kundërshtonte grupin tjetër që përkrahte politikën austrohungareze. Me këtë rast është dashur të ndërhyjë edhe At Gjergj Fishta dhe më 1906 mësimin e shqipes e vazhdoi Gjeçovi. Ai në një letër dërguar konsullit austrohungarez, më 20 shkurt 1906, ka shkruar: "Me shkollat jam i kënaqur dhe punët

[29] A. Pashk Bardhi, O.F.M., "Faik Konica", "Hylli i dritës", Shkodër, 1942, nr.1-2, f.475.

përparojnë mirë. Me të gjitha fuqitë përpiqem të vazhdoj metodën e At Bardhit... Do t'ishte gjë e mrekullueshme që së paku këtu (në Lega Nazinale – I. Sh.) të futej sa më parë mësimi i gjuhës shqipe dhe së paku në këtë semestër të mësonin pak lexim dhe fjalë shqipe. Unë do të jem më se i gatshëm t'i kushohem edhe kësaj pune, vetëm që italianizimi mos t'i mbys.



Gjergj Fishta

Përveç kësaj, kisha me lutë, nëse rastësisht hasim në nja dhjetë kopje të librit "Historia e Shcypnis" të Dom Nikajt të m'i dërgoni që t'ua shpërndajë këtyre normalistëve...".


Shtjefen Gjeçovi më 1905 jep dorëheqje nga puna si mësues i shqipes dhe në një letër dërguar Konsullit, ka shkruar: ... duke parë se At Pashk Bardhi, për përgojime e shpifje të thjeshta është shkarkuar nga kjo detyrë, duke ndërprerë aq turpshëm vitin shkollor, as mua nuk më bie ndërmend të mbetem në këtë kuvend ku ne, fretërit shqiptarë, nuk mund të llogarisim se ndodhemi midis bashkëvllezërve tanë.

Që edhe mua të mos më ngjajë i njëjti rast, unë dua të para evitoj dhe me këtë (letër) unë dua të jap dorëheqjen time formale...".[30]

Nga dokumetet arkivore mësojmë se Provinciali i Zarës, At Gjyzepe Karvini, italianofil, e kishte akuzuar Pashk Bardhin, se ai gjoja është kërcënuar, t'i dëbojë të gjithë fretërit". Gjeçovi ka dekla-

[30] Dr. Hasan Kaleshi, Dokumenta të Arkivit të Vjenës mbi mësismet e shqipes në Arbënesh të Zarës, "Vjetari II-III", Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1970, f.180.

ruar: Kjo është një gënjeshtër e bukur... Përkundrazi, kam pasur rastin të bindem mbi një respekt të madh që gëzon At Bardhi si midis klerit po aq midis qytetarëve të Zarës, e posaçërisht midis shqiptarëve të Arbëneshit, të cilët derdhin lotë për humbjen e At Bardhit".



Mbas Gjeçovit si mësues të shqipes propozohen: Don Mark Shllaku (prift i Dajçit mbi Bunë), mësuesi Matej Logoreci dhe përsëri At Pashk Bardhi. Kraus i ka shkruar Ministrisë në Vjenë se "Këtu në Rend kurrëkush nuk mendon se është e vërtetë akuza nga e cila ai (Bardhi – I.Sh.) ka ra si viktimë... Njëkohësisht bëhen përpjekje që të reformohen institucionet edukative të Rendit në Shqipëri, për të siguruar kuadër profesional dhe lektorë.

Më vonë shqyrtohet mundësia që mësues të caktohet At Pashk Prela, të angazhohet ndonjë student i teologjisë që studion në Tirol dhe që ka marrë bekimin si prift, ose të caktohej Dr Gjergj Koleci (nxënës i Propagandës). Më vonë si kandidat serioz propozohet Pren Doçi.

Më 1906 është dhënë pëlqimi që Gjergj Koleci të vazhdojë punën e mësuesit aty ku e kishte lënë Shtjefen Gjeçovi. Në vazhdim, deri më 1918, mësues të shqipes kanë qenë: Anton Paluca, Nikollë Rrota dhe Pal Gjergja (nga Arbëneshi).

Mësimi i gjuhës shqipe, dhe veçanërisht Shkolla Normale me veprimtarinë e vet, kanë ndikuar në jetën kulturore, arsimore dhe ko-

mbëtare të arbëneshëve të Zarës. Nga Gjimnazi dhe nga Shkolla Normale kanë dalë intelektualë të shumtë. Mësimi i shqipes për një kohë të gjatë ka pasur jehonë pozitive, jo vetëm midis arbëneshëve, por edhe në gjithë hapësirën etnike shqiptare dhe në diasporë.

SHKOLLIMI I MESËM

Pas përfundimit të klasës përgatitore, gjatë vitit shkollor 1909/10, Josipi vazhdoi shkollimin e mesëm në Shkollën Normale të Arbëneshit.

Shkolla Normale në Arbënesh është hapur më 1866 dhe ka vazhduar punën deri më 1921. Gjatë kohës së pushtimit italian, deri më 1944, është mbyllur si institucion arsimor. Në këtë shkollë janë arsimuar edhe shumë arbëneshë të rinj. Josip Rela ka qenë nxënës i rregullt i kësaj shkolle dhe është regjistruar në vitin shkollor 1909/10, në numrin rendor 40 të regjistrit ku bëjnë pjesë 43 nxënës. Gjatë atij viti shkollor janë organizuar katër kurse mësimore. Josipi nuk ka shfrytëzuar bursë dhe as ndihma materiale, sepse nuk është shënuar në listën e shfrytëzuesve të beneficioneve materiale të vitit 1910.

Qeveria austriake, edhe pse ka pasur kërkesa që Shkolla Normale të zhvendosej nga Arbëneshi në qytetin e Zarës, ka vendosur që shkolla të jetë vazhdimisht në këtë lokalitet të arbëneshëve. "Qeveria në të cilën vërtetë, siç ka shkruar Ilija Dizdar, ka menduar që ky ent, mu pse është në Arbënesh, mund të shërbejë si fidanishte për shkëlqimin e mendimit austriak" në Shqipëri. Dhe për këtë arsye, posaçërisht gjatë njëzet vjetëve të fundit, është përpjekur që midis nxënësve të këtë sa më shumë arbëneshë, për të cilët gjuha shqipe është lëndë e obligueshme dhe është mësuar edhe në ushtrimore".

Është kjo periudha e luftës së popullit shqiptar për pavarësi kombëtare. Arbëneshët me interesim përcillnin ngjarjet historike dhe ka dëshmi të shumta që në mënyra të ndryshme kanë përkrahur kryengritësit shqiptarë dhe përpjekjet për forcimin e lëvizjes së Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Në Arbënesh, në mars të vitit 1911 është formuar Komiteti për mbledhjen e ndihmave financiare, për ushqime etj., për të përkrahur kryengritjen e malësorëve të udhëhequr nga Dedë Gjo Luli. "Ndihma të hollash mjaft të mëdha u dërguan... prej shqiptarëve të Dalmacisë, të Rumanisë, të Misirit, të Amerikës e të gjitha qendrave ku kishte hi shkëndija e atdhedashtnisë".[31]

Arbëneshët dhanë kontributin e vet duke përkrahur krijimin e shtetit shqiptar më 1912. Përveç aksionit të mbledhjes së ndihmave "për shqiptarët në robëri", ishin të interesuar të organizonin mitingje dhe demonstrata. Për këtë çështje ka shkruar Prof. Dr. Aleksandër Stipçeviqi dhe është mbështetur në dokumentet e Arkivit të Zarës. [32]



Në Zagreb në vitin 2013

Policia austriake bëri përpjekje të ndalojë çdo demonstratë ku "shprehej përkrahja e shqiptarëve për pavarësi". Ajo "ishte njoftuar se nën maskën e përkrahjes së shqiptarëve do të dërgoheshin në Shqipëri për ta ndihmuar luftën për pavarësi". Megjithatë, mitingu u mbajt më 15 shtator 1912, para kishës së Arbëneshit. Në të mori pjesë tërë Arbëneshi dhe sidomos rinia. "Në një pemë ishte varur fotografia e

[31] Nga revista "Leka", Shkodër, 1937, nr.6, f.393.

[32] Prof. Dr. Aleksandar Stipçeviq, "Arbëneshët e Zarës dhe krijimi i shtetit shqiptar", "Bujku", Prishtinë, 1993, 6 dhjetor, f.4-5.

Gjergj Kastriotit – Skënderbeut". Folën disa përfaqësues dhe intelektualë të Arbëneshit dhe të gjithë folën në gjuhën shqipe. Në fund të mitingut u miratuan dy rezoluta. E para ishte shkruar në gjuhën shqipe, kroate dhe italishte dhe iu dorëzua policisë, ndërsa e dyta u është drejtuar fuqive të mëdha evropiane, "Komitetit Shqiptar" në Prishtinë dhe shtypit. Me këtë rezolutë arbëneshët e Zarës shprehën solidaritetin me vëllezërit e tyre në Shqipëri...". Tubimi u përfundua me parullën "Shqipëria e shqiptarëve" dhe u shtruan edhe kërkesa të tjera të rëndësishme për arbëneshët.

Ata, siç bëhet e ditur nga materiale të ndryshme, kanë dhënë edhe ndihma materiale për luftëtarët e lirisë. Veprimtaria kulturore dhe patriotike gjatë epokës së Rilindjes Kombëtare ka qenë mjaft e gjerë dhe janë bërë përpjekje që ajo të integrohet në rrjedhat e gjithëmbarshme kombëtare. Edhe pse në kushte të vështira, arbëneshët kanë formuar shoqëri të ndryshme dhe janë interesuar të botojnë gazeta në gjuhën shqipe. Në Arbënesh, siç është e njohur, më 25 shtator 1897, dy vjet pas hapjes së sallës së leximit, bëhet shpallja për botimin e gazetës "Zani i Shcyptarit" dhe formulari, numri paraprijës "T'pajtimit të gazetës" në gjuhën shqipe dhe në atë kroate. Këtë përpjekje për botimin e gazetës së arbëneshëve e bënë katër patriotë arbëneshë: Don Mijo Çurkoviqi, Don Kristofor Stipçeviqi, Pietro Marushiqi dhe Luçi Pavao Relja. Kjo shpallje u shtyp në 500 kopje, prej të cilave 150 u shpërndanë në Arbënesh. Gazeta do të botohej dy herë në muaj. Si edhe gazetat e revistat e tjera shqipe në kolonitë e tjera shqiptare dhe në qendra të ndryshme evropiane, do të bëhej tribunë e informimit dhe e mendimit të arbëneshëve të Zarës. "Albania" e Faik Konicës për këtë ngjarje ka shkruar rregullisht. Aty u hap edhe rubrika e veçantë "Zani preje Arbneshvet". Më 8 prill 1901 arbëneshët mbajtën një "Kuvend për t'u marrë vesh per lerim e per perparim të ghuhes shcipe". Kanë marrë pjesë shtatëdhjetë anëtarë dhe kanë folur pesëmbëdhjetë arbëneshë. Në mbledhje janë përuruar dëshirat e Shoqërisë Kombëtare të Arbëneshit:

I. Jemi é levdohémi ce jemi Shciptare nga gjaku é nga zemera. Si Shcipetare, ñjohim për detyre të shentnné te duhémi te ghithe sa

jemi shciptare, te jemi te bashkuar e të japim mish e shpirt për të shelbuar ghakun t'one ghuhen t'on.

II.Ghuha shcipé eshte (hezinéja) jone, sé ghuha eshte më i pari shenim ci rrefen kombesine. Po zghedhim ñe keshill shtate krénesh, të tsileve Mbledhja u jép plot fuci te perpicén me sa u mundet ce Cévéria Austriané te kllase ne shkollat t'ona mésimin é ghuhes shqipe".[33]

Krenëve të Mbledhjes së Arbëneshit të Zarës, "Tek e cila me nji atdhedashuni të flaktë u themelue të ngrehunit e nji Qortores".

Për nder të të Madhit Skanderbeg, Jakin Shkodra (Luigj Gurakuqi) u shpreh nderimin dhe mirënjohjen dhe më 15 shkurt 1903 ua kushton poezinë "Kangë". Pasi të ketë evokuar kujtimet e luftës dhe të fitores së Skënderbeut, Gurakuqin e gëzon zgjimi i vetëdijes kombëtare te arbëneshët:

"Oh! Ju lumtë, e ndihma e Zotit
Me 'ta kjoftë! Mos ju voftë tretun
Zelli i naltë! Unë n' ditë t' sotit
Kam dishir me ta me u gjetun;
Eni, pra, ngani, o skyfterë,
Te ata burra t' mërrijmë me 'i herë!"

Një atdhetar ka shkruar artikullin "Kuvendi i Shcyptarve n' Arbënesh", të botuar në "Albania" në rubrikën "Zani preje Arbeneshvet". Aty, përveç të tjerash, është shkruar: "... Na deri tash nuk jenna marre vesht aspak se si me muejt me u nimue vllazneve t' one n' Shcypni. Jo me u nimue me pushk e me shpate, por me kulture. Per si kena ne me u nimue vllazneve me kulture, masi as na vete kulture nuk kemi? Ktu marr vesht kulturen shcype.Vllazen! Ka ardhë koha m' u - chue preje ghumit...".

[33] Fk Béj Konitza, "Shoqëria kombetare e Borgo Eritsos", "Albania", Bruxelles, 1901, nr.4. f.67.



Rinia e Arbëneshit, si edhe shtresat e tjera të popullsisë, me interesim të veçantë ka përcjellë ngjarjet aktuale që lidheshin me emancipimin kulturor, arsimor e kombëtar. Në shkollat e Arbëneshit dhe në ato të Zarës ku kishte më shumë nxënës shqiptarë, gjuha shqipe mësohej si gjuhë e obligueshme dhe nota shënohej edhe në dëftesa shkollore. Në vitin 1908 nga 165 normalistët e regjistruar, 109 nxënës kanë mësuar shqipen.



Rela mësimet i ka vijuar në këto rrethana të përgjithshme shoqërore dhe politike të vendlindjes. Ai ka treguar interesim të veçantë për shkencat shoqërore dhe sidomos për letërsinë. Ka qenë mjaft aktiv

në jetën e rinisë dhe sidomos për përgatitjen e programeve kulturore dhe argëtuese. Me poezi Rela ka filluar të merret kur ishte nxënës i shkollës së mesme, sidomos në klasat e fundit të Normales. Poezia përshkruese dhe ajo e dashurisë, me frymëzime të fuqishme rinore, bën fillimet letrare të tij. Ato kanë qenë sprova poetike dhe nuk janë botuar. Një pjesë e krijimtarisë së hershme letrare dhe disa shkrime të tjera, për fat të keq, i kanë humbur.



Në Arbënesh

Ante Bushkuliq, shok i shkollës, për angazhimet kulturore të Josipit, ka shkruar: "... Kemi qenë aktivistë në seksionin e rinisë "Hrvatski sokol", ku përveç pjesëmarrjes në grupin e tamburistëve, kemi ushtruar shfaqjet teatrale diletante në të cilat ai është shquar posaçërisht. Kemi qenë anëtarë të Organizatës përparimtare revolucionare jugosllave dhe kemi marrë pjesë në manifestime dhe në demonstrata në Zarë".

Në këtë qytet ka qenë e formuar edhe Shoqëria e Arbëneshit e Shën Josipit si edhe shoqata të tjera sportive dhe muzikore, ku është tubuar rinia e Arbëneshit. Arbëneshët dëshironin të kenë disa këngë të komponuara shqipe. Shkolla Normale gjithashtu kishte ndikim të madh në jetën kulturore dhe arsimore të arbëneshëve. Në skenën teatrore zbavitëse në Sallën e leximit të Arbëneshit dhe në lokalet e shoqërisë shqiptare, janë shfaqur vepra të ndryshme dramatike.



Shtjefen Gjeçovi

Lektura shkollore e normalistëve ishte mjaft e pasur. Nxënësit, ku bënte pjesë edhe Josip Rela, lexonin veprat letrare të shkrimtarëve të njohur, siç janë: Turgenjevi, Pushkini, Ksaver Shandor Gjallski (pseudonim i Lubo Tadiqit), Tolstoji, Gorki, Stjepan Radiqi dhe shumë autorë të tjerë të letërsisë botërore. Nga autorët shqiptarë janë lexuar veprat e botuara në Zarë, pastaj ato të Ndoc Nikajt dhe sidomos veprat e shkrimtarëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.



Ndoc Nikaj

Gjatë vitit shkollor 1913/14 Rela kreu shkollën e mesme të mësuesisë. Gjendja e përgjithshme shoqërore dhe politike në atë kohë ishte ashpërsuar edhe më shumë. Edhe para fillimit të Luftës së Parë Botërore ishte ndërmarrë aksioni i mobilizimit të rinisë për ushtrinë Austro – Hungareze. Rela ishte mobilizuar për luftë më 1914.

KAPITULLI II

VITET E MËSUESISË

NË ISHUJT E DALMACISË

Josip Rela kishte fituar diplomën e mësuesisë më 1914. Mësuesi i ri dhe entuziast kishte dëshirë të madhe të arsimojë bashkatdhetarët e vet aty në vendlindje dhe të punojë për gjallërimin e kulturës në Arbënesh. Ishte përgatitur shpirtërisht të bëjë çdo sakrificë për realizimin e idealeve të rinisë. Ngjarjet që pasuan çrregulluan megjithatë planet dhe penguan realizimin e dëshirave të tij që në fillim të karrierës së mësuesisë. Lufta e Parë Botërore, siç dihet, zgjerohej gjithnjë e më tepër. Posaçërisht ishte ashpërsuar konfrontimi i hershëm midis Austro – Hungarisë dhe Italisë për territoret e bregdetit dalmatin dhe për zgjerimin në Ballkan. Po atë vit filloi mobilizimi i të rinjve për të kryer shërbimin ushtarak. Josip Rela më parë ishte caktuar mësues në Supetarska Draga në ishullin Rab, e jo në Arbënesh. Së shpejti atë e mobilizuan në ushtri. Organet e atëhershme arsimore kërkonin që mësuesit të vazhdonin punën në shkolla dhe për këtë arsye, shumë punëtorë arsimorë u liruan nga ushtria, për të vazhduar detyrën në institucionet arsimore në rrethana shumë të vështira të luftës. Në fillim Rela ka punuar në një shkollë gjashtë klasëshe që kishte 156 nxënës. Angazhimi i mësuesit të ri, përkushtimi në punën arsimore dhe edukative me nxënësit, afërsia me njerëzit në ambientin e ri, qëndrimi stabil i tij në rrethana të luftës etj., bënë që vendësit të kenë simpati të veçantë ndaj arsimtarit të tyre. "Nxënësit e tij edhe pas shumë vitesh e kujtojnë meshuesin e tyre të mirë", ka shkruar Ante Bushkuliq.

Në "Autobio-bibliografinë" e vet për vitet e mësuesisë Josip Rela ka shkruar më gjerësisht. Të dhëna interesante për jetëshkrimin e Relës dhe veçanërisht për periudhën kohore kur ai ka shërbyer si mësues, larg vendlindjes dhe arbëneshëve të dashur, ka shkruar Ante Bushkuliq. Në kujtimet e tij ka pohuar: "Këtë shkrimin kujtime në mikun t'em të dashtun Vladoviq Relja Josip, të parën vjete mbas dekje të ti, ju qoj dot mbledhet të tana kujtime qi i kena.

Në mendime të mija ka shum detalja prej jetimit të Bepos (si e kena emnue), e me limbe të male kujtoem në ata...

Ne kena ken gjithmon bashk deri 20 vjet të gjalum jon. Unë shkova tjetrës rug...

Ma ndyeni se shkruoj kështu vorfun në gjuh shqype, pse prej 1914 nuk shkrova e pak fola".

Teksti i shkrimit që pason është në gjuhën kroate. Me këtë rast kemi zgjedhur disa shënime me të cilat plotësohet jetëshkrimi dhe veprimtaria e Relës.

"I entuziazmuar që mbas rënies së Austro – Hungarisë më në fund me gëzim është pritur liria, shumë e ka shqetësuar okupimi italian i Zarës. Kur ushtria është nisur të okupojë katundin Arbënesh, ai e të rinjtë nga fshati, me gurë i kanë pritur okupatorët dhe ushtria ka qenë e detyruar të kthehej në qytet. Vetëm gjatë ditës së dytë formacioni më i madh ushtarak dhe fort i armatosur ka arritur të marrë katundin. Nga nxënësit që bënë rezistencë nuk është zbuluar askush".[34]

Në Vinjerc Josip Rela bënte përpjekje të zhvillojë te nxënësit idetë patriotike dhe demokratike. "Për aktivitete të tilla pushteti okupues italian, në kohën e okupimit të zonës së III të Dalmacisë, e ka ndjekur. Karabinierët gjashtë – shtatë herë kanë ardhur në Vinjerc, para nxënësve në shkollë e kanë lidhur dhe rrahur dhe ashtu të lidhur e kanë çuar në burg të Zarës dhe atje e kanë maltretuar. Sipas rrëfimeve të nxënësve të tij, të gjithë kanë qarë dhe kanë dalë nga shkolla, vendasit kanë dalë në rrugë, kanë protestuar dhe e kanë përcjellë "mësuesin e vet" si e quajnë edhe sot, nga dashuria..."

[34] Ante Bushkuliq, Shkrimi i cituar më parë (Dorëshkrim).

Vendësit kanë treguar se, me rastin e festës së 50-vjetorit të shkollës, më 1923, kanë organizuar festën, është tubuar populli i bregdetit, ndërsa kori i tij ka kënduar këngë patriotike. Atë ditë gjithë fshati ka organizuar demonstrata anti – italiane në kohën kur anija e rregullt italiane e udhëtarëve është dashur të ndalet në bregdet. Për shkak të atyre demonstratave anija nuk është ndalur. Ky është shkak për të cilin karabinierët e kanë lidhur dhe të rrahur e kanë nisur në burg.

Vinjercasit me respekt dhe dashuri e kujtojnë mësuesin e tyre, i cili me angazhimin e vet ka arritur të ngrejë nivelin arsimor e kulturor të fshatit deri në shkallën më të lartë. "Nuk ka njeri të tillë" përsërisin. "Kam pasur fuqi dhe dëshirë që vetveten ta shkrijë në shpirtërat e rinj të nxënësve dhe të bëjë çka ka qenë e mundur me të gjitha mjetet për ngritjen e fshatit" – ka deklaruar (Josip Rela – I. Sh.) në atë fjalim.

RELA MIDIS BASHKATDHETARËVE

Përshtypje të paharrueshme dhe përjetime të rralla Josip Rela ka pasur gjatë qëndrimit midis bashkatdhetarëve në Vuthaj, në Guci, në Arzë dhe në Triebsh, si mësues i shkollave shqipe. Pas pushtimit të Malit të Zi dhe të Shqipërisë, Austro – Hungaria ka zbatuar planin e mëparshëm për përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe. Në shkollat shqipe ka caktuar edhe disa mësues të Arbëneshit, të cilët e njihnin dhe e flisnin gjuhën shqipe. Kështu, më 1916, së bashku me disa mësues të tjerë nga Arbëneshi, Josip Rela është caktuar mësues në viset shqiptare në Mal të Zi. Në shkrimin "Nji kujtim me ni pëvetje".[35]

Rela ka shkruar: "Në durim të luftës së Parë botnore, Austrija e ka okupat Malin e Zi. Neve disa meshtra Arbënesh të Zadrës, përse e dijshim ko pak gynë shqipe, na shtivi guverni i Austrisë përpara alternativave: në Cërnagorë në rrethin ku jetojnë shqiptarët – për msuosa, ose në front. Pe dy të këqijash zgidhjet mo e vogla. Ashtu na u dasht me votë në Mal të Zi e mua në Vuthaj".

[35] Josip Vlladoviq-Relja, "Nji kujtim me ni pëvetje", "Jeta e re", Prishtinë, 1954, nr.5, f.445-450.

Disa mësues të tjerë si: Kërsto Peroviq (mësues, rreshter, njëherit inspektor i shkollave shqipe në Mal të Zi), Toma (Ivo) Maroviqi (mësues, rreshter), Nikolla Peroviqi (mësues, ushtar), është caktuar në shkollën shqipe në Martinoviq etj.



Ramiz Kelmendi

Për qëndrimin e tij si mësues në Vuthaj, Rela ka shkruar: "Pothuaj të gjitha këto shkolla shqipe kanë qenë "vetëm në letër", pos shkollës së Gucisë. Unë kam pasur për detyrë të krijoj shkollën e Vuthajve. Kjo "shkollë" ka qenë 4 X 3,5 m., lart pa tavan, poshtë tokë, pa tavolinë, pa kurrfarë bankash, pa dërrasë të zezë, pa shkumës, pa ngjyrë, pa leckë, pa... pa... madje edhe pa nxënës. Kur ju ankova komandantit të rrethit, në fillim m'u përgjigj që të mos mërzitem, sepse çdo gjë do rregullohet, kurse pas ankesës sime tjetër, pas 15 ditësh, më pyeti rreptë: "A kam ku të fle, ku të ushqehem? Dhe ç'kërkoj më tepër ?!". Po kështu, të thuash, ka qenë edhe në Arzë (rrethi i Tuzit) dhe në Triesh (Grudë), ku kreva detyrën e sekretarit të Bashkisë. Mendoj se pasi këto kanë qenë hapa të diplomacisë a-h, nuk kanë ndonjë vlerë të posaçme dokumentare. Më në fund, dokumente mbi këtë nuk ka kurrfarë, e po ashtu edhe të tjerët. Çdo gjë që është zhvilluar ushtarakisht (me "urdhra të drejtpërdrejta" të cilat me të arritur

në vend, mirreshin). Si në Vuthaj, ashtu edh në Arzë e në Triesh popullsia ka qenë 100 për qind shqiptare".[36]

Ishte vjeshtë e vitit 1917. Mësuesi së pari kishte kërkuar katundin e pastaj kryetarin. Vuthaj përshkruhet si vend i vogël afër Gucisë, por me bukuri të rralla natyrore, i shtrirë buzë liqenit. Godina e shkollës ishte e papërshtatshme për mësim dhe s'kishte orendi dhe asgjë tjetër që kërkohet për një institucion arsimor. Takimi i parë me nëntë nxënës. Në orën e parë njoftohet me "nëntë djaloça", i pyet për familjen dhe për gjëra të tjera. Të nesërmen në shkollë vijnë tre nxënës, ndërsa në orën e tretë në shkollë nuk vjen asnjë nxënës. Mësuesit s'i mbetet tjetër pos të bisedojë me komandantin dhe të kërkojë sqarime. Nga dialogu me një vajzë të fshatit, të quajtur Merima, Zefi (Josip Rela – I. Sh.) kupton shkaqet e abstenimit të nxënësve: vendësit kishin dezinformuar se mësuesi është i krishterë dhe se kërkon t'i pagëzojë fëmijët, se ai është kaur dhe fëmijët don t' i bëjë të krishtërë etj.



Akademik Idriz Ajeti

[36] Ramiz Kelmendi, "Nga epistolari i Relës", "Rilindja", Prishtinë, 1970, 10.XI, f.13.

Josip Rela ka shërbyer në Vuthaj, në Arzë dhe në Triebsh. Rexhep Qosja në studimin për Josip Vlladoviq Relën gjithashtu ka përfshirë të dhëna interesante për qëndrimin e mësuesit nga Arbëneshi në fshatrat shqiptare dhe sidomos në Vuthaj. Ai shkruan: "Megjithëse i mësuar në horizontet e gjera dhe të çelura të detit dhe me klimën e butë mediterane të Zarës, Relën nuk e kanë hutuar as dëshpëruar ngushtica dhjetë kilometra e gjerë e Plavës dhe Gucisë e as horizonti gjithmonë i terratisur i këtij fshati të gozhduar ndërmjet Bjeshkëve të Nemuna. Po djaloshi i ardhur prej një ambienti, në krahasim me Vuthajn, pothuaj i civilizuar, nuk ka mundur të gjejë gjuhë të përbashkët me fëmijët e fshatarëve të veshur me tirq e në zhguna, që asokohe ishin posaçërisht të mvrenjtur. Ndonëse i pushtuar prej mallit për njerëzit e gjakut të vet që e bënte t'i dukej edhe e keqja më e lehtë, Rela ishte në gjendje të vërente se vuthjanët nuk dëshironin t'i dërgonin fëmijët në shkollë dhe se nuk kishin besim ndaj mësuesit të tyre, që s' dinte mirë shqipen. Ai nuk dinte të kuptonte pse ata vëllezër të lashtë nuk kishin ndonjë disponim të mirë ndaj tij, nuk dinte se ai fshat ishte atëherë i shkretëruar, se burrat e gratë, në vend që të mendonin si t'i çonin fëmijët në shkollë, shtrengoheshin më parë të siguronin hithat dhe barishtet e tjera për ushqimin e tyre. Rela i ardhur prej një mjedisi plotësisht tjetër, e kishte vështirë të vërente se ata nuk kishin kohë të mendonin për shkollimin e tyre, pse ishin të vetëdijshëm që gjendeshin përpara tragjedisë së tyre të madhe: shpërnguljes së plotë nën zjarr e flakë nga viset e veta dhe arratisjes kush kah për të gjetur, pastaj vdekjen me qinda e qinda nëpër tendat e fuqive ndërkombëtare në Shkodër, Babullush dhe në vendet e tjera të shkretëruara shqiptare".[37]

Ne këto vise shqiptare nuk dërgoheshin vetëm mësuesit por edhe ushtarakët e përgatitur në mënyrë të veçantë. Në Arkivin e Kroacisë kemi gjetur materiale në të cilat është paraqitur strategjia më e gjerë e Austro-Hungarisë për depërtimin në tokat shqiptare. Në Vjenë janë organizuar kurse të posaçme gjashtëmujore të gjuhës shqipe për oficerë të ushtrisë austriake. Gjatë vitit 1913/14 mësimin e shqipes e kanë vijuar 18 oficerë. Ata kanë qenë instruktorë dhe kanë pasur për

[37] Rexhep Qosja, "Shkrimtarë dhe periudha", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1975, f.193.

detyrë të përgatisin ushtrinë shqiptare në kohën e Princ Vidit. Pas intërvenimit të Italisë, kjo detyrë u është besuar oficerëve holandezë. Më 1916, kur ushtria austro – hungareze e okupoi Shqipërinë, të gjithë këta ushtarakë që dinin shqipen dhe disa të tjerë, janë caktuar në shërbime të ndryshme në Shqipëri. Komanda e ushtrisë austrohungareze ishte vendosur edhe në Plavë e Guci. Rela në të vërtetë bie në kontakt më disa eprorë ushtarakë, të cilët mbikëqyrnin gjendjen e përgjithshme dhe veçanërisht atë të mbrojtjes.



Në Arbënesh me Nasho Jorgaqin

Vitin shkollor 1917/18 Rela e kaloi si mësues në Triebsh."Aty e mendoi dhe provoi me shkrue dramën "Pengtarët", të cilën nuk e mbaroi dhe e la në valixhe, së bashku me gjerat e tjera. Kjo valixhe, me rastin e shkatërrimit dhe të tërheqjes së ushtrisë austrohungareze mbërrijti deri në Gjekenjesh, në kufirin kroato – hungarez, ku u muer nga ushtarët hungarezë. Nëpër Zagreb e Rijekë, Josipi u kthye në Zarë, të cilën tashmë e kishte okupuar ushtria italiane. Në Zarë e shkroi

të parën pjesë teatrale për të rinj "Lundërza e Jozhës", të cilën e relizuan në skenë amatorët arbëneshë (studentët) më 1919, në shtëpinë e të vëllait të ish regjentit mbretëror Dr. Ivo Peroviqit (arbënesh) dhe në Vinjerc.

Me lutje të tij e dërguan në vitin 1919 si mësues dhe drejtor shkolle në Vinjerc, ku më 1921, me dashuri, u martua me ndihmës – mësuesen Marija Kristofoli, të bijën e Ivanit, nëpunës me origjinë nga Venediku dhe Virgjinisë Jurjeviq, amvise me origjinë malazeze.

Në Vinjerc, pos detyrës së tij zyrtare, u muer edhe me punë kulturo – arsimore. Organizoi një kor vokal, formoi seksionin diletant me fëmijë dhe të rinj, themeloi dhe i priu një orkestrine mandolinash, hapi bibliotekën e vendit "Vlladisllav Vezhiq", poet, ilirian nga Vinjerci. Organizoi 50 vjetorin e hapjes së shkollës, themeloi Kryqin e Kuq në Vinjerc etj. Për këtë aktivitet të tij italianët, okupatorët, e ndoqën, e konfinuen dhe shumë herë e burgosën nga disa ditë, mirëpo vendasit e dojshin dhe nderojshin, kështu që edhe sot e kësaj dite e thërrasin "mësuesi ynë".

Meqë gruan e kishte të sëmurë e ishte vështirë të siguronte mjekimin dhe barnat, me dëshirën e tij transferohet në Kashtel Novi, afër Splitit, si drejtor shkolle. Aty vazhdoi të punojë në punë kulturo – arsimore më fëmijë dhe të rritur. Bëni regjinë e shumë pjesëve serioze teatrale (dramave) e mandej edhe vetë luajti në to. Aty, për seksionin e tij diletant të "Sokolëve" e shkroi komedinë me dy akte "Sot tetë ditë", e cila u shfaq disa herë me sukses, por kurrë nuk u botua. Më vonë e shkroi edhe komedinë në tri akte "Provat", me përmbajtje nga jeta dhe përjetimet e vetë diletantëve në prova. Kjo komedi ndikoi aq pafat, sa që krejt seksioni u shpartallue.

Ka qenë i orientuar si "jugosllav", e së këndejmi Banovina e Kroacisë, më 1939, për dënim, e transferoi në Srijane, një vend mbas malit Mosor, ku lindte dielli në orën 11, e perëndonte në orën 14. Mbas gjashtë muajsh e transferuan në Sllatinë afër Splitit, ku e përjetoi thyerjen e ushtrisë jugosllave dhe i priti së dyti okupatorët".[38]

[38] Nga dorëshkrimet e Josip Relës.

Më 1930 Josip Rela ka shkruar një ligjëratë me titull: "Ligjërtatë për Masarikun", me rastin e 80-vjetorit të lindjes së këtij filozofi, kritiku, sociologu dhe poltikani të njohur të Çekisë, i cili ka pasur merita të mëdha për çlirimin e vendit të tij nga Austro – Hungaria. Rela e admironte Masarikun dhe me interesim kishte lexuar veprat e tij.

Në Kashtel Novi Rela gjithashtu ka mbajtur një ligjëratë tjetër me titull: "Përjetimet në mësim". Më 1935 ka mbajtur "Ligjëratën mbi jugosllavizmin" para prindërve dhe nxënësve të shkollës në Kashtel Novi. Tema e zgjedhur për përhapjen e idesë jugosllave ishte mbajtur në kuadër të ciklit të temave: "Bashkësia e familjes dhe shkollës". Ky tekst ka 11 faqe të formatit të madh ku përfshihet përmbajtje mjaft e gjerë. Aty paraqitet historia e lindjes dhe e zhvillimit të idesë për formimin e Jugosllavisë. Ky shkrim nuk është botuar dhe nuk është përfshirë në autobio – bibliografinë e Josip Relës

Për shkak të pikëpamjeve të shfaqura në disa ligjërata, por edhe për arsye të tjera, Josip Rela transferohet në fshatin Srijane, përtej malit Mosor. Kjo ishte zonë okupuese italiane. Në një letër të Mate Zoricës, të dërguar më 10.VII.1940 Marko Marinit, mbikëqyrës i shkollave në Zagreb, mbrohet Rela si mësues dhe njeri i ndërgjegjshëm, sepse ishte dënuar pa kurrfarë faji. Mate ka shkruar: "Në korrik të këtij viti, me rastin e ardhjes sime në Zagreb, isha i lirë t'ju kërkoj në banesën tuaj dhe me ju të flas për disa mësues. Midis tyre e kam përmendur edhe z. Josip Relën, i cili atëherë ka qenë drejtor i shkollës fillore në K. Novi. Dhe tash, z. Rela është transferuar në njëfarë katundi të shkretë dhe të papërshtatshëm në mes të Mosorit, i cili më duket – Srijane. Më besoni, Zotëri, se z. Rela nuk meriton dënim të tillë. Nuk meriton atë dënim për dy arsye: së pari se njeriu është shumë i sëmurë, si edhe gruaja e tij e sëmurë, dhe së dyti, ai, sa mund të dihet, në kohën e persekutimeve dhe vuajtjeve më të mëdha, askend nuk e ka akuzuar as persekutuar. Unë në Kashtelin e Poshtëm kam qenë 12 vjet dhe i njoh rrethanat e mëparshme dhe të tashme. Me rastin e zgjedhjeve të pesë majit, kur te ne ka dominuar terrori i tmerrshëm, z. Rela ka qenë kryetar i vendvotimit Kashtel Novi, ndërsa unë kam qenë përfaqësues i listës së Dr. Maçekut, dhe sikur mos të ishte z. Rela, mua ushtarët së paku do të më qitnin jashtë nëpër dritare. Më janë kërcënuar... me gojë dhe me shkrim (ndërsa zëvendësin tim e

kanë burgosur, kanë folur dhe e kanë porositur të më rrahin për vdekje... nëse do të vija në vend të votimit). Dhe, megjithatë, s'pat ndodhur asgjë, sepse prej asaj më ka shpëtuar z. Rela.

Në kohën e presionit të organeve arsimore, që nëpërmjet të mësuesve dhe të prindërve nxënësit të regjistrohen në "sokolashë", z. Rela me rastin e padisë sime kundër zonjës Paviçiq Maries, mësuese, në mënyrë solemne më ka thënë se ai nuk e ka dhënë atë urdhëresë që fëmijët t'i detyrojë të regjistrohen. Më vonë i kam pyetur fëmijët e mi dhe të tjerët, dhe të gjithë më kanë thënë së për regjistrim i kanë detyruar z. Matas dhe z. Paviçiq, ndërsa të tjerët (si edhe z. Rela) vetëm u kanë folur nxënësve të regjistrohen, por askënd dhe në asnjë mënyrë nuk i kanë detyruar.



Kastel Novi

Kur kjo është plotësisht kështu, kur z. Rela nuk është shquar me persekutime dhe spijunazhe, atëherë nuk është në asnjë mënyrë e drejtë ai të dënohet me dënimin më të rëndë. Përveç tjerash, në qoftë se jemi për drejtësi dhe të drejtën, nëse kemi pak zemër, duhet pasur parasysh edhe sëmundjen e tij të rëndë dhe të gruas së tij.

Duke i paraqitur të gjitha këto, ju lutem të angazhoheni, që dënimi më i ashpër ndaj z. Rela të zbutet në mënyrë që "të transferoohet në një vend tjetër pranë detit, ku do t'i përgjigjej gjendjes së tij shëndetësore dhe të gruas së tij.

Jam i bindur, duke njohur fisnikërinë tuaj, që të ndërmerrni në kuptimin e lutjes hapa urgjentë, unë ju falënderoj përzemërsisht dhe ju përshëndes me respekt të shkëlqyeshëm".

Pas gjashtë muajsh Rela është transferuar në ujdhesën Çiovo, në Sllatinë, ku do të vazhdojë punën arsimore dhe kulturore. Në shkollën e Sllatinës është emëruar drejtor dhe përsëri përjeton okupimin italian dhe ballafaqohet me dhunën dhe terrorin që ushtronte pushteti fashist. Ky ambient do të përfshihet më vonë në krijimtarinë e tij letrare.



Shoqëria kulturore-letrare "Bashkimi".
Me bashk'themelues si Át Pashko Bardhi

Ambasciata d'Italia
Tirana

Istituto Italiano di Cultura Tirana

OMAGGIO A GIROLAMO DE RADA
NEL BICENTENARIO DELLA NASCITA



1814 – 2014

KAPITULLI III

NË FLAKËN E LUFTËS

TREGIME PËR OKUPACIONIN

Josip Rela vazhdimisht ka qenë i preokupuar me fatin e Arbëneshit dhe të popullit të vet. Vitet e okupacionit italian mësuesi arbënesh i përjetoi rëndë dhe kjo bëri, përveç të tjerash, që Rela të pësojë një metamorfozë sa i përket pikëpamjeve të luftës për çlirim të vendit dhe për jetë të lirë. Ai nuk pajtohet me gjendjen ekzistuese, prandaj vetvetiu, në fillim të organizimit të rezistencës së përgjithshme, merr pjesë aktive në lëvizjen çlirimtare të luftës kundër fashizmit. Si intelektual shquhet me propagandën e organizuar kundër ideologjisë nazifashiste. Organizon mbledhjen e ndihmave materiale për luftëtarët e lirisë. Bashkëpunon me organizatën e studentëve të Splitit dhe merret me shkrime publicistike dhe letrare. Shkruan skica dhe poezi me temën e luftës. Të kësaj faze janë krijimet artistike të përmbledhura në ciklin "Fotografi luftarake të Sllatinës". Poezia e viteve të luftës (1941-1945) është shkruar në gjuhën kroate dhe ka titullin e përbashkët "Flakët e përgjakura" (Krvavi plamenovi). Kjo është poemë e përbërë prej 15 pjesësh të veçanta, por të lidhura tematikisht dhe në aspektin kompozicional bëjnë një tërësi.

Në autobiografinë e vet Rela ka shkruar për kohën e luftës: "Meqë italianët nuk lejojshin të japi mësim në shkollë, aty e bani pianon e gurit", për të cilën u shkrua bukur shumë në "Kronikat e don

Mijos, famullitarit të Sllatinës". Tregimin për okupacionin Rela e ka përfshirë edhe në një reagim, dërguar Redaksisë së gazetës së Splitit "Slobodna Dalmacija": "... Gjatë kohës së kësaj luftës së fundit dhe atë mu në vitin 1942, kam qenë mësues në Sllatinë afër Splitit. Okupatorët s'më kanë lejuar të punoj në shkollë... Si mbeta pa punë, kisha shumë kohë të lirë. Duke ecur nëpër shkëmbinj të Sllatinës kam hetuar se si nën këmbë gurët "cingërojnë". Kjo më shtyri të mbledh gurë të tillë, dhe prej tyre të bëj një piano të gurit. Ajo piano është vjerrë në një spango në tra të zakonshëm. Duke u rënë gurëve... zëri i pianos ka qenë i këndshëm dhe dilte si nga zilet e argjendta. Për atë piano sigurisht dijnë të gjithë sllatinasit më të vjetër ndërsa në kronikat e famullisë së Sllatinës shkruhet edhe për gurët që këndojnë...

Theksoj se ajo piano më ka shpëtuar, nëse jo jetën, atëherë nga internimi. Një të diel u tubuan rreth meje dhe pianos së gurit afër pesëdhjetë vendas. Bisedonim për LNÇ dhe për ndihmën... Na befasuan disi karabinierët me helmeta, me bajoneta në pushkë... e kërkonin mësuesin. Unë fillova t'u flas për pianon e gurit si edhe për atë se fshatarët kanë ardhur të shikojnë atë piano të çuditshme. Pastaj ua ekzekutova disa këngë italiane. Shkuan të mahnitur dhe të kënaqur, të bindur se tubimi nuk ishte me sherr, ndërsa raporti ishte dhënë ashtu... Disa splitas kanë parë atë piano, midis tyre edhe drejtori i Muzeut Arkeologjik të Splitit... i cili me atë rast ka thënë se ky nuk është mendim origjinal, sepse në kishën e Shën Jakovit në Shibenik ekzistonte pagëzimorja... Megjithatë, pagëzimorja... është skulpturë ndërtimore artistike, ...ndërsa ky është gur krejt i thjeshtë, i natyrshëm, i paudhendur, i cili nëse edhe vetëm pak thehet, e ndryshon zërin e vet të këndshëm...".

FJALA E KËNGËS SË POETIT

Josip Rela hapat e parë në letërsi i kishte bërë shumë vjet më parë me poezitë që shprehnin botën emocionale subjektive dhe angazhimin e tij social. Përveç lirikës përshkruese dhe asaj të dashurisë, ku poeti shfaqte ndjenjat intime të kohës së rinisë, në poezinë sociale ka trajtuar motive që lidhen me jetën e bashkatdhetarëve të

vet. Edhe kur ishte larg vendlindjes, heroin lirik të poezisë, njeriun e vegjëlisë së ambientit të arbëneshëve, i cili i kishte lënë mbresa të pashlyeshme, e mirrte nga koha e fëmijërisë dhe nga aktualiteti i jetës së Arbëneshit. Në poezinë "Fatziu", të krijuar më 1919, që ka mbetur në dorëshkrim, poeti i drejtohet njeriut fatkeq, të cilin të tjerët e sollën në gjendje të mjerueshme sociale. Te ai njeri Rela shihte forcën gjigante, prandaj e fton për t'u këndellë me atë fuqi të zjarrtë.

Në rrethanat e vështira të Luftës së Dytë Botërore, jehon fjala e këngës së poetit, fjala e zjarrtë e lirisë:

"Në burgje të lagta
Në gjak, në varje, në plagë,
Në beteja, pushkatime.
Në lot e vajtime..."

I frymëzuar nga ngjarjet e luftës, poeti ka krijuar një tufë poezish, disa skica, një poemë etj., me të cilat hapet një fazë e veçantë e krijimtarisë së tij letrare. Poezia patriotike me motive të luftës artikulonte idetë e shkrimtarit në atë kohë kthesash dramatike.

Pushteti okupues në Dalmaci kishte ndërmarrë një varg masash me të cilat kufizoheshin të drejtat e njeriut dhe rrezikohej jeta e tij. Rela, duke qenë arsimtar, ka përjetuar fatkeqësitë e luftës, tragjeditë njerëzore dhe është ballafaquar me kufizimet që parashihte dokumenti i arsimit për shkollat e atëhershme. Sipas tij parashihej që arsimtarët të edukonin rininë në frymën e ideologjisë fashiste. Të gjithë ata që nuk i zbatonin normat e caktuara, përjashtoheshin nga puna dhe ndaj tyre ndërmerreshin masa të ashpra ndëshkuese. Josip Relës nuk i kishte mbetur tjetër rrugëdalje, pos të inkuadrohej në Lëvizjen Nacional-çlirimtare. Pas kapitullimit të Italisë fashiste, në shtator të vitit 1943, shkollat dhe institucionet e tjera kulturore funksiononin në kushte të regjimit të luftës, por me organizim të ri. Sistemi i mëparshëm arsimor ishte zëvendësuar me sistemin e ri, që udhëhiqej nga Këshillat e autorizuar, ndërsa më vonë nga organet përfaqësuese arsimore.

Gjatë viteve 1942 dhe 1943 Rela ka shkruar disa tregime, shumica e të cilave përfshijnë aspekte sociale të jetës. Tematika e luftës

trajtohet e gërshetuar me motive të tjera poetike. Në fillim përmbledhja ishte titulluar: "Fotografi të luftës", e pastaj "Portrete". Duke lexuar skicat dhe tregimet e Relës, fitohet përshtypja se shkrimtarit më shumë i janë imponuar temat sociale. Portretet e tij janë karakteristike për atë ambient të njohur mirë nga autori, ndërsa ngjarjet të përjetuara më forcë emociaonale. Kemi aty edhe përshkrime të natyrës, të vendbanimeve, paraqitjen e adeteve e zakoneve të një etnikumi, të njerëzve që gjallërojnë secili në mënyrën e vet dhe të gjithë së bashku. Ata vuajnë në jetë, por kanë edhe gëzime. Marrin pjesë në procesione e festa familjare. Rela në mënyrë realiste ka paraqitur jetën e njerëzve me të cilët punon e jeton dhe prore ëndërron ditën kur do të bashkohej me familjen, me arbëneshët e vet të dashur. Prandaj i këndon lirisë:

" Na erdhe
Si qumsht i nanës
Si buka e bardhë,
Si qielli i kaltërt
Si dielli i nxehtë
Si fusha pa skaje
Si mali mbi male
Si hylli që shkëlqen..."

Poeti dëshiron të kthehet sa më parë në vendlindje dhe atje ta vazhdojë jetën e ëndërruar.

Përveç poezisë lirike Rela krijoi edhe poemën "Flakët e përgjakura". Pjesët e saj janë: "E lëshuar" (më parë kishte titullin "Katastrofa"), "Perverziteti i përgjakur", "Dëshpërimi", "Zëri i lirisë", "Okupatorit", "Hakmarrësit", "Okupatori rrëfen" (më parë ka pasur titullin "Përmendorja"), "Kënga e bulkthit", "Tregimi i gjinkallës", "Festimi i zaptuesit", "Përpara", "Lulëzo atdhe!" dhe "Fjala e trimit të panjohur". Për rrethanat e luftës ka shkruar edhe në fejtonin "Arbëneshët e Zarës", një kopje të të cilit ia ka dërguar "Rilindjes", në Prishtinë, ndërsa kopjen tjetër Budil Karel – Jindrichuv Hradecit në Çekosllovaki. Në skicën "Lascia passare".



Shkolla Fillore „Kruno Krstiq“ në Arbënesh


Rela ka përshkruar gjendjen në Sllatinë gjatë luftës. Ai ka shkruar: "Në kohët e sotme të jashtëzakonshme njeriu duhet të ketë letërnjoftimin edhe në shtëpinë e vet, ndërsa "Lascia passare" posa "ta kalosh pragun e shtëpisë. Nuk mund të lëvizësh lirisht as në komunën tënde të vendlindjes. Sllatinat i takojnë komunës së Splitit. Për të siguruar "Lisica passare", d.m.th. "tesera speciale" për Split duhet bërë një "Decsturë" dhe duhet gjetur shkaqe të arsyeshme. Lutjen duhet ta vërtetojnë karabinierët e vendit. Pastaj duhet dërguar "Decsturës" dhe duhet pritur...



Lufta e Dytë Botërore në një katund "jashtë komunikacionesh", është paraqitur në dramën "Zani i fëmiut", ndërsa po kjo luftë, në një qytetzë të Kosmetit, në dramën "Ik, Jak, ik !". Motive të luftës janë

trajtuar edhe në disa poezi të cilat shquhen me notë të theksuar patriotike. Në poezinë "Tregimi i okupatorit", Rela ka shkruar:

"... Me fytyra si dylli, mjekra të rrituna
Të prem' nga uja, t' pa fe, të pa besë,
Të gjakuem në mordje, nuk e pranuan
Ngushëllimin e fesë.
I shtrënguem grup'i parë po çohet
Pa ndjenja, vetëm syt të gjallë u mbesin
Si bagëtija kanë jetue, si bagëtija
Do të vdesin!"



KAPITULLI IV

JETA NË ARBËNESH

KTHIMI NË VENDLINDJE

Në nëntor të vitit 1944, pas çlirimit nga okupatorët fashistë, në Zarë u vendosën organet e reja të pushtetit: Këshilli Nacionalçlirimtar, Këshilli i Qytetit etj. Organizimi i veprimtarisë arsimore në këtë kohë ishte njëra ndër detyrat e shumta për transformimin shoqëror, politik e kulturor. Josip Rela në këtë kohë transferohet dhe caktohet mësues në Preko, në ishullin Uglan. Atje i priu një grupi nxënësish nga Spliti dhe rrethina ku kishte punuar edhe më parë. Atëherë ishte organizuar një kurs për ndihmës mësues. Rela kishte shpresuar shumë se menjëherë do ta kthenin në Zarë dhe posaçërisht në Arbënesh. Shumë vite kishin kaluar dhe malli për vendlindjen ishte shtuar gjithnjë e më shumë. Për kohën e qëndrimit në Preko Rela nuk ka lënë shënime të tjera, prandaj edhe nuk kemi informacion më të gjerë lidhur me veprimtarinë e tij në këtë lokalitet. Në autobiografinë e vet ka shkruar se gjatë asaj faze kohore ka punuar në një ishull të vogël të quajtur Gallovc dhe ka mbajtur kursin për ndihmës mësues. "Ai ishte mësimdhënës dhe shkrimtar" – ka shkruar Ante Bushkuliq. Meqë kishte përvojë të gjatë në punën arsimore, me vendimin e Këshillit Popullor të Qarkut të Zarës, Rela caktohet ushtrues i detyrës së drejtorit të Shkollës Normale në Zarë. Kthimi në vendlindje për shkrimtarin ka pasur rëndësi të madhe,

posaçërisht për krijimtarinë letrare që lidhej me arbëneshët. Përgatitjen e brezit të ri për mësues të ardhshëm e bënte me përkushtim të jashtëzakonshëm. Ishte ky profesioni i tij dhe ideali jetësor. Në mesin e normalistëve kishte edhe nxënës nga Arbëneshi. Puna e Relës në institucionet kulturore, prirja për t'u marrë me përgatitjen e shfaqjeve të ndryshme në teatër dhe krijimtaria e tij letrare, kishte tërhequr vëmendjen e personaliteteve të shquara të jetës kulturore të këtij mjedisi. Prandaj, më 1945 Josip emërohet ushtrues i detyrës së drejtorit të Teatrit Popullor të Zarës, "... i cili u formua nga diletantët e ardhur nga lufta". Më vonë është emëruar drejtor i këtij institucioni kulturor me traditë mjaft të pasur. Shfaqjet e para teatrore kanë zgjuar interesim të madh te shikuesit. Rela është angazhuar, jo vetëm për pasurimin e repertorit të Teatrit, por edhe për zgjedhjen e aktorëve, për skenografinë dhe për realizimin e përgjithshëm të veprave skenike, të shfaqura në teatër. Siç është e njohur, përvoja e tij në fushën e artit skenik, ishte mjaft e hershme. Qysh në dimrin e vitit 1920/21, në lokalet e Bibliotekës së Arbëneshit, Rela kishte përgatitur për t' u shfaqur në skenë veprën dramatike "Lundërza e Jozhës", me përmbajtje nga jeta e fëmijëve. Në këtë shfaqje kanë marrë pjesë shumë arbëneshë si aktorë dhe si shikues. Në rrethana të reja Rela do të japë kontribut të veçantë për gjallërimin e jetës kulturore në qytetin e Zarës, por edhe në mesin e arbëneshëve. Bashkëkohësit e Relës dëshmojnë për një sërë aktivitetesh kulturore të organizuara nga një grup entuziastësh të Arbëneshit, ku ka marrë pjesë aktive edhe vetë Josip Rela.

Më 1946 ka qenë drejtor i Shkollës Normale (të përtërirë), pastaj drejtor i Shtëpisë së Nxënësve të Shkollës Normale, drejtor i Kinemasë së qytetit dhe drejtor i Shkollës Fillore "Voshtarnica" të Zarës. Më 1948 i vdiq e shoqja, Marija.

"Në këtë periodë të shkurtër u shqua edhe në punë jashtëshkollore, ka shkruar Rela. Së bashku me prof. D. Çatllakun, M. Biloglavin e të tjerë, formoi "Shoqatën e shahistëve". Me shokët: Sh. Deshpali, B. Peroviqin, formoi Shoqninë kulturo artistike "Arbëneshi". Bashkëpunon më të gjitha organizatat shoqërore, si në LSPP, Sindikatë, etj. Mirëpo, nuk ka qenë anëtar i LKJ. Tri herë u zgjodh

këshilltar i qytetit dhe i komunës. Për punë të këtillë ministri i arsimit i Kroacisë, me dekretin nr.34967, dt. 30.VI.1949, e lavdon".

Gjatë gjithë jetës Rela është interesuar t'i njohë sa më mirë bashkatdhetarët e vet dhe veçanërisht arbëneshët. Shumë vjet kishin kaluar nën sundimin italian. Migrimi në vendet evropiane, në Amerikë dhe gjetiu kishte lënë pasoja të rënda. Prandaj, zgjimi i vetëdijes kombëtare, ngjallja e dashurisë ndaj gjuhës shqipe, ndaj kulturës kombëtare etj. kishte rëndësi të madhe për ekzistencën e arbëneshëve si grup etnik. "Sipas koncepcionit të vet filozofik – pedagogjik është dashur që së pari njerëzit të binden se ata nuk janë italianë, por shqiptarë (arbëneshë)".[39]



Rela shumë kohë kalonte me bashkëvendësit e vet dhe në forma të ndryshme punonte për zgjimin e vetëdijes kombëtare të tyre. Për këtë arsye, siç ka shkruar Bushkuliq, disa funksionarë politikë seriozisht ia kanë tërhequr vërejtjen, që të mos zhvillojë aktivitete të tilla. Rela, sipas tyre, përhapte nacionalizëm shqiptar. Pra kërkesa për kultivimin e gjuhës së arbëneshëve, të kulturës dhe të traditave shqiptare në përgjithësi, konsiderohej veprimtari që duhej ndaluar. Në këto rrethana Rela për një kohë kishte ndërprerë krijimtarinë letrare. Megjithatë, e shtynte një forcë më e madhe shpirtërore dhe morale, që të vazhdojë veprimtarinë e vet dhe kështu krijoi disa vepra letrare me të cilat, përsëri në qendër të vëmendjes dhe të interesimit ishin arbëneshët dhe historia e tyre e lavdishme. Në këtë kohë kushtet e punës dhe të jetës për shkrimtarin ishin mjaft të vështira, prandaj, me

[39] Ante Bushkuliq (Nga dorëshkrimet).

kërkesën e tij më 1950, kur i mbushi 35 vjet stazh pune, doli në pension. Kohën e lirë në këto rrethana jetësore e ka kaluar duke punuar. Interesohej për punën e shkollës së Arbëneshit, merrej me aktivitete të tjera dhe veçanërisht me krijimtari letrare. Veprimtaria kulturore dhe letrare shënonte rezultate të reja të mirëseardhura për arbëneshët dhe për letërsinë shqiptare.

MISIONI ARSIMOR DHE KULTUROR

Josip Rela, mësues i arbëneshëve, në veprimtarinë shumëvjeçare arsimore ka dhënë kontribut të madh. Për këtë arsye është respektuar nga të gjithë ata që e kanë njohur dhe sidomos nga bashkëvendësit. Ai ka qenë i përzemërt me fëmijët e shkollës së Arbëneshit, me bashkëpunëtorët dhe me prindërit e tyre. Dashurinë prindore ndaj fëmijëve e ka shprehur në mënyra të ndryshme dhe veçanërisht në krijimtarinë poetike për fëmijë. Loja e tyre, gëzimet dhe shqetësimet e fëmijëve, të vrojtuara mirë dhe të përjetuara emocionalisht, janë paraqitur në përmbledhjen "Për fëmi". Botën interesante të fëmijëve, në një spektër të gjerë motivesh, poeti e ka trajtuar me përkushtim poetik, gjithnjë duke pasur parasysh qëllimin edukativ dhe arsimor të letërsisë. Në poezinë "Nini, nuni", si edhe në poezinë popullore shqiptare, me disa vargje të zgjedhura, që janë tipike për këtë lloj të poezisë, shprehet dashuria e çiltërt për krijesën e njomë:

"Kokra e zembres ti m'je,
Palcen te zembres ti ma ke;
Ti dëshirja je e nanës,
E lumnija je e tatës..."
Ti je gjaku gjakut jem...
Ti je qielli je i kjartë,
Ti je fati jem i bardhë!"

Josipi si mësues dhe drejtor i shkollës institucionin arsimor e ka çmuar shumë. Përvoja e gjatë në procesin mësimor, leximi i literaturës

profesionale pedagogjike, i veprave letrare etj., e ka nxitur që vazhdimisht ta pasurojë veprimtarinë arsimore dhe të arrijë rezultate të shënuara në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore. Mirënjohjet e posaçme për punën shembullore në shkollë dëshmojnë përkushtimin e madh që ka treguar Josip Rela në këtë fushë të veprimtarisë së rëndësishme arsimore dhe kulturore. Funksioni kompleks i shkollës bashkëkohore është kuptuar drejt dhe është realizuar në kushtet konkrete të realitetit shoqëror të kohës. Angazhimi i tij arsimor në shkollë është reflektuar në rrjedhat e emancipimit kulturor dhe arsimor të Arbëneshit dhe ka ndikuar në ngritjen e vetëdijes patriotike të bashkatdhetarëve. Dokumentacioni shkollor i sistemuar, vështrimet kritike dhe raportet profesionale shkollore, përkujdesja e posaçme për përfshirjen e nxënësve në shkallët dhe profilet e ndryshme arsimore, bashkëpunimi me prindërit dhe me qytetarët e tjerë për mirëvajtjen e punës arsimore, organizimi i jetës kulturore etj., tregojnë angazhimin e gjithanshëm të Relës për të sendërtuar misionin arsimor në pajtim me vizionin humanist dhe me parimet pedagogjike bashkëkohore.

"MARTESA" NGAZËLLOI ARBËNESHËT

Shumë vjet më parë Josip Rela kishte krijuar veprën dramatike "Lundërza e Jozhës", një idilë me tri akte për rininë. Për fat të keq, teksti i origjinalit i kishte humbur. Me insistimin e Shime Deshpalit, autori veprën e rikrijoi në bazë të kujtesës. Poashtu ishte komponuar muzika dhe meloditë, për ta shfaqur ashtu të plotësuar para publikut vendës. Pas kthimit në vendlindje, në Arbënesh, mbas 25 vjetësh, ishin bërë ndryshime të mëdha: "... në të folun e madje edhe në ndjenjat e Arbëneshëve të tij, që nuk ishin gjindë në kushte të reja të jetës", ka shkruar Rela. Ky ballafaqim i ri me jetën e arbëneshëve e ka nxitur shkrimtarin të krijojë "... në dialektin e vet arbënesh nji dramë të lehtë dhe argëtuese" me titullin "Martesa" dhe me përkushtimin: "Në kujtim të gys të nanés". Kështu lindi ideja për të krijuar një vepër në gjuhën shipe dhe ajo është kristalizuar më mirë në procesin krijues.

"Përmbajtjen e mori nga jeta e vetë Shqiptarëve, në mënyrë që kështu të zgjojë dhe trimnojë Arbëneshët e vet dhe kështu t'i bindi për

nji jetë dhe ardhmëni ma të hareshme e ma të lumtun, e njiherit edhe si pengesë propagandës italiane. Drama u lexue në nji tubim të gjanë të qytetarëve, ku mbërrijti nji sukses jashtëzakonisht të madh. Ndërkaq drama nuk pretendonte me u botue...".

Me rastin e 250-vjetorit të shpërnguljes së arbëneshëve të Zarës është organizuar një manifestim i madh kulturor dhe në kuadër të këtij programi është promovuar edhe vepra "Martesa" e Josip Relës. Studentët e Degës së Albanologjisë, të udhëhequr nga profesori Dr. Vojisllav Dançetoviqi, kishin organizuar një vizitë në Arbënesh. Për këtë ngjarje kulturore është shkruar: "N'ekskurzionin e bamë vjetin e kaluem në Zarë nga studentat e grupit të Albanologjisë takuem edhe Relën, edhe sikur mos ta kishim gati detyrue me na lexue melodramën e vet, të shkrueme në gjuhën shqipe, do të kishte mbetë edhe "Martesa" pa dalë në dritë, sikurse edhe shumë vepra të tjera të shkrueme prej Shqiptarëve në botë. Qëllimi i kësaj vepre, të shkrueme në gjuhën shqipe mbi karakterin e zakonet shqiptare t'Arbëneshëve të Zarës, asht që flaka e ndjenjës kombëtare, jo vetëm të mos shuhet, por përkundrazi... të ndizet gjithnji e ma tepër. Se sa e nevojshme sod që të ketë nji përkrahje të gjithanshme kjo dëshirë e vetë arbëneshëve të Zarës, i vërtetojnë fjalët e vetë autorit të "Martesës" ku ai tregon arsyet që e kanë shty me shkrue këtê vepër lirike në gjuhën shqipe".[40] Me atë rast Rela paraqiti rrethanat në të cilat është krijuar vepra "Martesa": "Kur mbas njizet e pesë vjetëve mungese u ktheva në vendlindje dhe pashë se si te vendasit e mij ishte tue hupë gjuha shqipe, si edhe, se si ata nuk kishin dijtë me u gjetë në kushtet e reja mbas njizet e pesë vjetëve të sundimit fashist, më nxiti me shkrue në dialektin tonë arbënesh për ne, për ta, për bashkëvendasit e mij, dhe kështu lindi "Martesa", e cila me përmbajtjen, humorin e lehtë dhe karakterin populluer do të ringjalli nji shpresë dhe besim në vetvete dhe në t'ardhshmën e tij".[41] "Ky asht me të vërtetë zani i njeriut, i cili e don popullin e vet", kanë pohuar të pranishmit dhe studentët shqiptarë për zbulimin e veprës me interes të madh për letërsinë e kësaj pjese të diasporës shqiptare.

---

[40] Vojisllav Dançetoviq: "Dy fjalë mbi Arbëneshët e Zarës dhe melodramën "Martesa", "Jeta e re", Prishtinë, 1952, nr.2. f.86-87

[41] Po aty, f.87.

Takimi me studentët, dhe më vonë edhe me shkrimtarë e intelektualë të tjerë të Kosovës, autorit i kishte hapur horizont të ri në fushën e letërsisë. Më parë Rela nuk ka pasur kontakte me krijimtarinë letrare dhe me kulturën shqiptare. Në korrik të vitit 1946 ai kishte pasur rastin të marrë pjesë në një koncert, të organizuar nga kori shtetëror i Shqipërisë. Ky ansambël i Tiranës në kuadër të bashkëpunimit kulturor të atëhershëm midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, gjatë ekskursionit për Rijekë dhe Split, ishte ndalur në Zarë. Në atë mbrëmje të paharruar, në sallën e Teatrit të Zarës, arbëneshët dhe bashkë me ta edhe Josip Rela, ishin ngazëllyer nga kënga dhe melosi popullor shqiptar. "Erdhshin me pa katundin e Arbëneshët i pritshin si vllaznit. Në bromje e dhashin në teatër të Zadres nji koncert me sukses fort të madh... Arbëneshët, tue dingue kangët të programit në gy shqip, u knaqshin fort".

Drama është botuar në revistën "Jeta e re", duke sjellë një ambient të ri, atë të Arbëneshit të Zarës, në letërsinë shqiptare. "Ky asht kontakti i parë i Josip Vlladoviq – Relës me "Jetën e re", me Kosovën e Metohinë dhe me punën e tij letrare në gjuhën shqipe". Komunikimi i parë i veprës letrare të Relës me lexuesit shqiptarë t ë Kosovës ka qenë ngjarje e madhe kulturore dhe letrare. Krijuesi arbënesh me veprën e vet tregonte se e adhuron popullin e vet, gjuhën shqipe dhe traditën kulturore shqiptare. Këtu zuri fill edhe dashuria e madhe ndaj arbëneshëve të Zarës dhe ndaj shkrimtarit.

FRYMËZIME TË REJA LETRARE

Gjatë viteve '50 Josip Rela vazhdoi krijimtarinë letrare, duke krijuar poezi, tregime dhe vepra dramatike. Frymëzimet e reja krijuese e nxisin autorin të realizojë disa projekte letrare më të hershme, por edhe të formësojë dhe të kristalizojë ide të reja. Kështu, pas pensionimit, me tërë qenien e vet iu përkushtua letërsisë. Në këtë fazë të krijimtarisë letrare kompletoi përmbledhjen e poezisë "Për të mdhej", "Vjershë në dialekt t'arbënisht", "Proza arbënisht", si edhe veprat dramatike "Kungulli" (dramë në tri akte), "Nita" (dramë në katër akte), "Ludërza e Jozhës" (dramë e ripunuar në tre ndodhina). Poezitë, dra-

mat dhe disa shkrime të tjera, Rela i botoi kryesisht në organet e shtypit dhe të periodikut shqiptar të Kosovës. Redaksitë theksonin faktin se këto krijime letrare vinin "Nga letërsia e arbëneshëve".

Së pari botoi poezitë: "Prindët fëmive", "Zani i t'biruomit", "Ema e vogël", "Dita e re", "Bregu i Sokos", "Ata qish s'arrohet", "Qysh jam unë", "Lishom o nanë", "Kujtou, kujtou, me'e", "Kronit të fikun", "Kujtimet në vjeshtë", "Bota vlon", "E hutueme", "Fjala e kangës sime, "Pjekunija", "Futbolli", "Moti i keq", "Shoferi i ri", "Përgjegje t'eshtnave", "Qershis të preme", "Lules të bregdetit" etj.

Nga proza ka botuar "Nji kujtim me nji pëvetje" dhe "Vepër trimnije". Po ashtu ka botuar artikujt: "Ekipi i futbollit", "Arbëneshët e Zadrës" (fejton historik).

Motivet dhe temat e trajtuara janë të larmishme dhe mjaft të pasura. Rela gjatë këtyre viteve zgjoi interesimin e lexuesve, të shikuesve të veprave skenike dhe të kritikës letrare. Vështrimet e para kritike për krijimtarinë letrare të Josip Relës i kanë shkruar: Ramiz Kelmendi, Vehap Shita, Hasan Mekuli etj. Shkrimtarit i njihen merita të posaçme për kontributin letrar, spikaten veçoritë tematike dhe artistike të veprës së tij letrare dhe shprehet gatishmëria për bashkëpunim kulturor si dhe për botimin e krijimtarisë artistike. "Jeta e re " gati në çdo numër të ri ka botuar krijimet e letërsisë së arbëneshëve dhe e ka afirmuar atë në suaza më të gjera të letërsisë shqiptare.

Pas botimit të dramave "Martesa" dhe "Kungulli", është botuar "Nita" (1954) dhe në shkurt të atij viti, duke pasur parasysh vlerën artistike të saj, shtrohet kërkesa para ansamblit shqiptar të Teatrit Popullor Krahinor të përfshihet në repertorin e vitit si dramë origjinale shqipe. Me atë rast paraqitet problemi i gjuhës së kësaj vepre skenike. Në kuadër të rubrikës "Teatër" të "Jetës së re" Ramiz Kelmendi ka shprehur mendimin se "Nita" është "... drama që ka afirmue plotësisht auktorin e vet dhe ja ka caktue vendin në historinë e letërsisë sonë të re... "Nita" pati fatin e bardhë dhe hyni në repertoarin e parapamë për këte sezonë. Mirëpo, menjiherë mbas këtij vendimi u shtrue përpara nji "problem". Si me e luejtë në sqenë dramën e Reljës, e cila asht shkrue në të folmen e arbëneshëve të Zarës? Kelmendi është i bindur, siç ishin të bindur edhe shumë lexues dhe intelektualë të tjerë, se

"Nita" duhet luejtë ashtu si asht shkrue! E shkrue asht shqip. Madje, me nji shqipe, e cila të kënaqë shumë ma tepër se ajo e disa pjesëve të përkthyeme e të luejtuna deri tash në të njejtën sqenë. Sepse e foluna e "Nitës" t'evokon të folmen e të parëve tanë para disa qind vjet-shash".[42]

Drama "Nita" ishte shfaqur në skenë nga grupi shqiptar i Teatrit Amator të Pejës, e pastaj në skenën e Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë është shfaqur shumë vjet me radhë me sukses të jashtëzakonshëm. Me këtë dramë, të shfaqur pastaj në Festivalin e teatrove amatore në Gjakovë, artistët kanë impresionuar shikuesit shqiptarë. "Nita" është apoteoza e virtyteve më të pastra të popullit të thjeshtë... ku çmohet vetëm fjala, nderi e burrnija...", ka shkruar Vehap Shita në vështrimin për shfaqjen e dramës "Nita".[43]



Shkolla Fillore „Kruno Krstiq“ në Arbënesh.
Mësimi plotësues në gjuhën shqipe (2014)

Në turneun e Teatrit Popullor Krahinor që nga 16 maji deri më 8 qershor të vitit 1955 në qendrat e ndryshme të rretheve dhe të komunave të Kosovës, ansambli shqiptar ka shfaqur me sukses edhe dramën "Nita" të Josip Relës. Në një referat të përgatitur nga komisioni në të cilin bënin pjesë: Esad Mekuli, Zekeria Rexha, Hivzi Sulejmani, Mark Krasniqi, Tajar Hatipi, Vehap Shita dhe Stathi Kos-

[42] Bal Coli /Ramiz Kelmendi/,"Disa fjalë para paraqitjes së dramës "Nita" në Theatrin Populluer të Krahinës","Jeta e re", Prishtinë,1954, nr.6,f.558 dhe 562.

[43] V. Shita, Josip Vlladoviq - Rela: "Nita", "Jeta e re", Prishtinë, 1955, nr.2, f.122.

tari, ku paraqiten të mbërrimet dhe problemet e zhvillimit të letërsisë shqiptare në Jugosllavi, përveç të tjerash, është shkruar: "... Pak ma vonë shfaqet edhe Josip Vladoviq Relja, si shkrimtar i pjekun dramaturg, i cili me melodramën "Martesa" dhe dramën "Kungulli", e sidomos me tragjedinë lirike "Nita" – shënon fillimin e artit të vërtetë dramatik në gjuhën shqipe te na. Shprehja artistike e tekstit të Relës, njoftja shum e mirë e artit të sqenës – ndihmuen shum që ansambli shqiptar i Teatrit amator të Pejës zuni, me dramën "Nita", vendin e parë në festivalin e dytë republikan të teatrove amatore të Sërbis, në maj të vjetit 1955, e me këte dramaturgjija jonë u afirmue edhe në përpjesëtime ma të gjana jugosllave... Në bazë të punës së bame deri tash në lamin e dramës, mund të thuhet se me përjashtim të "Nitës" së Josip Vladoviq – Reljës – na sod nuk kemi ndonji realizim tjetër serjoz dramatik".[44]

Dramat e Relës janë përfshirë vazhdimisht në repertorin e teatrove profesioniste dhe të atyre amatore. Ato edhe sot, kur shumë drama koha i ka larguar nga skena shqipe, janë të pranishme në teatër dhe shikohen me interesim të madh.



Kritika letrare dhe ajo e teatrit i ka vlerësuar veprat e Josip Relës si kontribute të rëndësishme letrare, me të cilat në letërsi është përjetësuar historia dhe aktualiteti i arbëneshve të Zarës dhe i popullit shqiptar në tërësi.

[44] "Mbi të mbërrimet e deritashme dhe disa probleme të letërsis së pakicës kombëtare shqiptare në Jugosllavi", "Jeta e re', Prishtinë, 1955, nr.4, f.259.

KAPITULLI V

RRJEDHA LETRARE

DY VIZITA NË KOSOVË

Josip Rela gjatë viteve '50, pas botimit të disa veprave të mëparshme, u njoh dhe lidhi miqësi me disa shkrimtarë dhe intelektualë të tjerë të Kosovës. Më parë është njohur me Ramiz Kelmendin, Vehap Shitën, Idriz Ajetin dhe me njerëz të tjerë. Takimi i Relës me shqiptarë nga vise të ndryshme etnike shqiptare, dhe sidomos me shkrimtarë të njohur, ka ndikuar në procesin kompleks të krijimtarisë. Bepo kishte dëshirë të madhe të vizitojë Kosovën. Në një letër dërguar Vehap Shitës, më 25 janar 1955, ka shkruar: "Shum vshtirësina ka për t'i kalue për t'u gjie unë atje: Dimni, vjetët e mi, largsia, të hollat, dhe tjerat". Po ashtu në një letër dërguar Grupit amator të Pejës, pas shfaqjes së "Nitës" para publikut në gjuhën e veprës origjinale, Rela, përveç të tjerash, ka shkruar: "Sa i përket asaj se nuk më keni ftue në premierën e "Nitës", mos u turpnoni aspak dhe të mos ju vijë keq fare, sepse unë e di shumë mirë se sa luftojnë për mjete financiare të gjitha teatrot e vendit, e posaçërisht ato amatore, e së këndejmi, natyrisht edhe juaji. Nga ana tjetër, mirrni parasysh edhe largësinë, stinën e vitit e veç asaj edhe moshën time bukur të shkuar, kështu që pa dyshim nuk do të kisha mundur t’ju plotësoj dëshirën edhe sikur të

kishin qenë në ujëra të kënaqshme financiare. Konsideroj pra, si të më kishit ftuar, e unë ju shpreh mirënjohje të sinqerta për dëshirat".[45]

Vizita e parë e Josip Relës në Kosovë është realizuar në korrik të vitit 1955. Ai ishte i ftuar të marrë pjesë në tubimin e letrarëve të Kosovës, për të cilin në revistën "Jeta e re" është shkruar: "Me iniciativën e Kryesis së Këshillit Krahinor të Lidhjes socialiste të popullit punues për Kosovë e Metohi dhe të Redakcis së revistës letrare "Jeta e re" u mbajt në Prishtinë më 8 e 9 korrik të këtij vjeti, mbledhja e parë e punëtorëve dhe dashamirëve të letërsisë së pakicës kombëtare shqiptare të Jugosllavis". Josip Rela dhe Budimir Peroviqi, arbëneshë të Zarës, u njohën me Esad Mekulin, Hasan Mekulin, Petro Janurën dhe me shumë personalitete të jetës arsimore dhe kulturore të Kosovës". Me atë rast vizituan disa qytete, institucione shkollore dhe ambiente turistike të Kosovës. Përshtypja që pati shkrimtari Rela mbeti e paharrueshme dhe e frymëzoi të trajtojë tema të ndryshme, që lidhen me këto vise autoktone shqiptare. Si shkrimtar i afirmuar Rela tregoi interesim të posaçëm për rrjedhat e zhvillimit të letërsisë shqiptare, për publicistikën dhe për veprimtarinë e institucioneve të tjera arsimore dhe kulturore të Kosovës, të Maqedonisë etj. Rela pas kësaj vizite do ta konsiderojë veten si pjesëtar aktiv të kësaj letërsie.

Qëndrimi i fundit i Josip Relës u realizua me rastin e shënimit të 10-vjetorit të botimit të revistës "Jeta e re". Me atë rast ishte i ftuar edhe shkrimtari arbënesh dhe bashkëpunëtori i zellshëm i kësaj reviste letrare. Mbledhja solemne e redaksisë dhe e bashkëpunëtorëve është mbajtur më 9 tetor 1959. Referatin për punën 10-vjeçare të "Jetës së re" dhe për zhvillimin e letërsisë shqiptare, në klubin e intelektualëve në Prishtinë, e lexoi Esad Mekuli. Pas drekës intime në hotelin "Avalla", "në sallën e këshillit populluer të komunës, u mbajt nji takim i ri i redakcis dhe i bashkëpunëtorëve të "Jetës së re" me letrarët jugosllavë, mysafirë në këtë kremtim, në të cilin u zhvilluen biseda spontane në lidhje me problemet e ndryshme të krijimit letrar në përgjithësi". Në vazhdim të programit të kremtimit të këtij përvjetori të rëndësishëm është organizuar mbrëmje letrare. Gjatë ditës së dytë shkrimtarët, pra edhe Josip Rela, "... vizituen përmendoret kulturo – historike të Prish-

[45] Ramiz Kelmendi, "Nga epistolari i Relës", "Rilindja", Prishtinë, 1970, 6.XI, f.13.

tinës dhe të rrethit të saj, Muzeumin krahinuer si dhe disa objekte më të mëdha ekonomike". Një mbrëmje letrare është organizuar në Mitrovicë. Të pranishmit shikuan edhe një shfaqje në Teatrin Popullor Krahinor. Më 11 tetor është organizuar një shetitje nëpër Kosovë (Prizren, Gjakovë, Deçan, Pejë etj.). Kujtimet e paharrueshme nga vizita në Kosovë Rela i ka evokuar me kënaqësi gjatë bisedave me bashkëkohësit. Malli dhe dashuria për vendin dhe për njerëzit janë shprehur edhe në krijimtarinë letrare. Ai ka pasur dëshirë të madhe të vijë në Kosovë edhe ndonjëherë tjetër, por, siç ka shkruar Rela: "... nja mendohet, por tjetra ndodhet..."

FAZA E FUNDIT E KRIJIMTARISË LETRARE

Gjatë viteve të fundit të krijimtarisë letrare Josip Rela krijon në heshtje. Veprimtarinë letrare nuk e ndërpreu deri në fund të vitit 1966. Në "Jetën e re", por edhe në revistat dhe në gazetat e Kosovës e të Maqedonisë, botoi poezitë: "Kujtimi", "Derës së oborrit", "E ku më je", "Ty", "Voglushes", "Liris", "Djaloshi" etj. Po aty botoi edhe dramën për të rinj "Lundërza e Jozhës", dramën "Zani i fëmiut" në tri akte etj. Në "Zanin e rinisë" ka botuar poezitë: "Të due, partizan", "Ndoshta", "Përgjigje e malsorit", "Kangtari i kohës", "Vazës së vetmueme", "E kaluemja", "Tregim i okupatorit" etj. Nga proza botoi rrëfimin "Tregimi i okupatorit". Më 1963 redaksia e "Jetës së re" botoi dramën në tri akte "Zani i fëmiut", ndërsa më 1964 përmbledhjen e poezisë "Vjersha".

Dramat e tjera siç janë: "Ik Jak, ik" (dramë në katër akte), "Dila" (dramë në tri akte), "Fisi i mallkuom" (dramë në katër akte me epilog), "Tallasat e dybëjes" (dramë në pesë akte) janë botuar njëra pas tjetrës, duke rrumbullakësuar kështu krijimtarinë dramaturgjike të Josip Relës. Vepra "Fisi i mallkuom" është paraqitur në konkursin e Bashkësisë Kulturore dhe Arsimore dhe më 12.VI.1966 është shpërblyer me 100 000 dinarë. Pra, juria ka vendosur ta blejë dramën e Josip Relës. Drama e fundit "Vampiri" (dramë në katër ose pesë akte) është e pakryer dhe është gjetur midis dorëshkrimeve. Autori kishte arritur të përfundojë vetëm aktin e parë dhe të fillojë aktin e dytë. Në

këtë vepër trajtohet tema historike e epokës së Ali Pshë Tepelenës. Në aktin e parë përfshihen ngjarje të vitit 1760, ndërsa në aktin e dytë është menduar të zënë vend ato që pasojnë pesë vjet më vonë.

Synimi i tij ishte të përjetësojë në letërsi figurën e lavdishme dhe tragjike të Ali Pashë Tepelenës, të njohur për përpjekjet e tij për pavarësinë e popullit shqiptar dhe për realizimin e idealeve liridashëse. Kjo figurë madhështore dhe lufta e tij ishte bërë e njohur në tërë Evropën.

Kronologjia e botimit të veprave të Josip Relës dhe të dhënat e tjera bibliografike janë përfshirë në vështrimin bibliografik "Josip V. Rela – Bibliografia 1962-1983".[46]

Në vitin 1966, në moshën 71- vjeçare, Josip Relës i është dërguar ftesa për të marrë pjesë në konkursin e Bashkësisë Kulturore Arsimore. Megjithatë, ai nuk paraqiti për konkurs asnjë vepër letrare. Në këtë moshë Rela kishte përjetuar shqetësime të natyrshme, që u reflektuan edhe në procesin e krijimtarisë letrare. Në një letër dërguar Kolë Bitër Shirokës, sekretarit të BKA, në janar të vitit 1966, Rela ka shkruar: "Faleminderës e për faqjen e Rilindjes me të cillin shumë më gëzove! Unë nuk e marr as Rilindjen për të mdhej. Kam shpresë se ke me më gëzue edhe ndonji herë nëse ma dërgojsh Rilindjen kur të baj fjalë për punime të mia, nëse nuk të asht shumë vështirë.

Tekstin e konkursit të rij të Bashksis Kult. arsimore e kam, por "kreni jem asht i zbrazt...". Nuk jam tue punue asgja. Deri sot jam me shëndetje mirë..."

Shkrimtari në Autobio – bibliografinë e vet ka ndriçuar disa aspekte të jetës dhe të krijimtarisë letrare, duke shkruar: "Rela jeton në Zarë / Đure Đakovica 15 / dhe ende punon nga pak. Detyra e tij e përvujtë ka qenë "Mësues", kurse qëllimi i tij letrar e jetësor, si thotë vetë: "përpjekja me ngritë, me fisnikue dhe me përkrye njeriun në vedi dhe rreth vedit. Nuk ka pasë fëmijë. Së dyti është martue më 1962 me Joska Koshta të Antes, amvise. "Si shkrimtar i afirmuar ka shprehur dëshirën të jetë anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Ko-

[46] Tahir Foniqi, "Vepra e Josip V. Relës - Bibliorafia 1962 - 1983", "Rilindja", Prishtinë, 1988, 14.V. f.12 - 13.

sovës, ose me rekomandim të veçantë të jetë anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kroacisë. Për fat të keq, kjo dëshirë nuk i është plotësuar për shkak të pakujdesisë së Kryesisë së Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës.

HUMBJE E MADHE E LETËRSISE SHQIPE

Mbas botimit të dramës "Tallasat e dybjës" më 1966, Josip Rela vazhdoi krijimin e një drame të re me titullin "Vampiri". Si i ka lindur ideja shkrimtarit dhe si është kristalizuar ajo, për të krijuar dramën me temë historike, ku në qendër të vëmendjes të gjindej Ali Pashë Tepelena, nuk mund të themi me siguri. Disa fakte, të paraqitura këtu, ndriçojnë këtë çështje të historisë së krijimit të kësaj vepre. Në korrik të vitit 1955, siç është pohuar më parë, Rela ka bërë vizitën e parë në Kosovë. Pas kthimit në Arbënesh, atij i dërgohej "Rilindja" dhe disa publikime të tjera. Në arkivin e Relës është gjetur edhe faqja zbavitëse e "Rilindjes", (11 Dhetuer 1955). Në faqen 10 ishte botuar një vështrim me titullin "Ali Pasha i Janinës", pa shënim të emrit të autorit. Lexuesi / Josip Rela / gjatë leximit të atij artikulli ka nënvizuar disa pjesë të tekstit, disa emra, data etj. Aty ka lexuar, përveç të tjerash, edhe këtë tekst: "Mënyra e vrasjes së Ali Pashës asht material i mjaftueshëm për hartimin e nji romani në stilin e Aleksandër Dymës – babës e vetë jeta e tij na jep material për hartim dramash ose edhe sqenari për film. Supozojmë se Josip Relës kjo do t'i ketë lënë përshtypje të veçantë dhe me këtë rast mund t'i ketë lindur ideja për krijimin e dramës së fundit, e cila, sikur të ishte përfunduar, do të radhitej ndër dramat më të suksesshme të këtij autori.

Në ekspozicionin e aktit të dytë Rela i ka lënë të shkruara këto fjalë të fundit: "Pesë vjet mbas. Dera përpara fortese të fortë. Nata. Përpara dere kalon atje kanë rojsi. Pranë fortese uji – lumi".

Në përfundim të vitit 1966, derisa pritej krijimi dhe botimi i ndonjë vepre të re, më 30 dhjetor, vdiq Josip Rela. Në një telegram, dërguar nga Budimir Peroviqi, kumtohet lajmi për vdekjen e papritur të Josip Relës. Vdekja e shkrimtarit në Arbënesh, në Kosovë dhe në trojet e tjera etnike shqiptare u përjetua si humbje e madhe e letërsisë

sonë. Në tubimet përkujtimore kushtuar kësaj figure të ndritur të kulturës shqiptare, është shprehur pikëllimi i thellë dhe janë evokuar kujtime lidhur me jetën dhe krijimtarinë e tij letrare. Në artikullin përkujtimor të "Rilindjes" është shkruar: "Humbja e Josip V. Relës", "plakut të letërsisë sonë të re", artistit të fjalës poetike dhe asaj skenike, burrit të Arbëneshëve të Zarës, shkrimtarit që e pasuroi me disa margaritarë letërsinë tonë të re, e goditi rëndë jo vetëm opinionin publik, që pat rastin ta njohë nëpërmjet veprës së tij, qoftë skenike, qoftë poetike, por njëherit, vdekja e pamëshirshme e goditi po ashtu edhe letërsinë tonë, sidomos dramaturgjinë, ku i ndjeri tregoi afinitet të posaçëm. Tragjedia "Nita", me interpretimin e së cilës disa teatra edhe fituan shpërblime madje jashtë caqeve krahinore, është dëshmi e fuqishme talenti i tij në fushën e dramaturgjisë. Për Relën njeri, poet, dramaturg, burrë t'urtë, artist të fjalës, mund të flasin të gjithë ata që kanë pasë rasën ta njohin personalisht si edhe ata që kanë lexue vjershat dhe dramat e tij në faqet e revistës sonë letrare "Jeta e re".[47]

Në shenjë nderimi dhe kujtimi për Relën, kujtimet e tyre i evokuan shkrimtarët: Esad Mekuli, Tajar Hatipi, Ramiz Kelmendi, Vehap Shita etj.

Esad Mekuli: "Humbja e Relës është humbja e parë e madhe që pëson letërsija jonë. Me te filloi dramaturgjija jonë e vërtetë: "Nita" asht tash për tash kulminacioni i dramës sonë. Jo pak të vlefshme janë edhe dramat e tjera të këtij autori. Pos dramës së thjeshtë, ai provoi fuqitë e veta edhe në melodramë, e asht nji humbje e randë për ne që s'u realizue opera e parë në gjuhën shqipe te na, muzikën e së cilës gati e ka pasë krye letrari dhe kompozitori i vlefshëm i Zarës, Shime Deshpali..."

Tajar Hatipi: “Sa e vetëtimtë aq edhe e fortë qe për mue, goditja në çastin kur lexova telegramin: "Mbramë vdiq Rela". Nji grimë ma vonë u përmblodha dhe më doli parasysh ai plaku i bronztë dhe i gjatë i cili në të perënduem të diellit të jetës së vet, na fali të parat drama të mirëfillta tonat – në gjuhën shqipe. Atëherë nisa të shoh me sytë e mendjes mjegullën që hëpërhë mbështolli krijimtarinë artistike të

[47] Masar Stavileci, "Humbje e parë e madhe e letërsisë sonë", "Rilindja", Prishtinë, 1967, 3.I, f.10.

kësaj gjinie letrare tonës, shkrue në zjarrin e elegjisë së mallit t'atij që qe i detyruem me përtri peripetitë e gjuhëve, që foli për historinë e vet të dhimbshme dhe të bashkëkombasve".

Ramiz Kelmendi: "Relën e kam pasë mik të zemrës, mysafir të shtëpisë, në nji farë dore edhe antar të familjes. Në shenjë të dashurisë për veprën e tij të çmueshme në lamin e dramës e të krijimtarisë letrare e artistike në përgjithësi, në shenjë avarije për vetë Relën, në familjen time ndëgjohet tash pesë vjet e sa emni: Nita. Asht ky emni i sime bijë që e due edhe pse ma kujton Relën e m'i kujton ato ditë të paharrueshme të takimit tim të parë me te, si student, në Zarë, kur mbas kushedi sa vjetësh – i ra me ua lexue studentëve shqiptarë të parat fragmente të "Nitës" së tij, me të cilën hyni Rela edhe Zara në letërsinë tonë. Lajmi tragjik mu në natën e Vitit të Ri, telegrami që mora s'andejmi, shkaktoi pikllim të madh në shtëpinë time... Për Relën qajti edhe Nita ime e vogël".

Vehap Shita: "Burrë i vjetër ka qenë Rela i ynë. Plak i letërsisë sonë. Por vallë, a i ka shkue kujt mendja se ka me na lanë kaq shpejt. Jo, kurr! Thue se nuk kemi qenë koshient për moshën e tij, për vjetët e tij. Gjithmonë entuziast e optimist në shkrimet e veta, madje edhe atëherë kur i ka përshkue këto ndonji intonacion i dhimbjes e melankolisë, ndonji ton i mallëngjimit e nostalgjisë, ai gjithmonë ka qenë i ri para syve dhe ndjenjave tona. Nuk kemi mundë me marrë me mend si të vjetër, ani ma si njeri që vdekja e pamëshirshme do të na e rrëmbejë prej gjinit tonë, këte jo se jo. Po pikërisht me burrninë e njomsinë e vet, me pleqninë e risinë e vet, me fjalën e urtë e këshillën atnore, Rela ka qenë i afërt, aq i dashtun për të gjithë ne, bijt dhe kolegët e tij, nxansit e lexuesit e tij. Shkroi Rela për të gjithë e mbi të gjithë. Dijti Rela me prekë aq bukur të gjithë telat e harfës që i ngjall, u jep hov e flakë ndjenjave e ndërgjegjes sonë, dijti me paraqitë me ndiesitë ma të holla popullin dhe njerëzit e vet që dallgët e shtypjes dhe zgjedhës së huej i dëbuen prej votrave të veta. Dijti me na i afrue aq shum këta njerëz, këta vllazen e motra tona, sa ata të gjithë u banë shum t'afërt, shum të njoftun, shum të dashtun, jo vetëm në letërsinë, por edhe në jetën tonë, në të përditshmën tonë".

Josip Rela si shkrimtar është përjetësuar në letërsinë shqiptare. Vepra e tij mbeti trashëgim i çmuar kulturor dhe letrar për të gjithë brezat. Poetët i përkushtuan poezi dhe e lartësuan në piedestalin që e meritoi gjatë jetës dhe krijimtarisë letrare. Në poezinë "Vdekja e poetit", kushtuar Josip Relës, Beqir Musliu përjetëson poetin dhe poezinë në Histori:

"N'pikllim lulet nuk dijnë për tana brigjet e detit
Por – deri në vdekjen e kangës, asht dhe 'i dëshirë:
Me u kthye në kohën e gurit të fortë hir e pa hir –
Me kuptue at verë të lules dhe Vdekjen e Poetit"

Emri dhe vepra e Relës janë prore të pranishme në kulturën shqiptare. Lidhjet me Arbëneshin dhe me arbëneshët janë të përhershme, ndërsa kujtimi për shkrimtarin do të jetë i përjetshëm. Varri i Relës vizitohet me nderime dhe me atë rast në Arbënesh shpeshherë organizohen orë letrare dhe programe kulturore. Në shtator të vitit 1976, disa shkrimtarë të Kosovës vizituan Arbëneshin dhe vunë kurorë mbi varrin e Josip Relës. Në orën letrare krijimet e tyre i lexuan: Rexhep Hoxha, Ramiz Kelmendi, Shime Deshpali, Qerim Ujkani, Miroa i Kikicës / Budimir Peroviqi /, Vehap Shita, Fahredin Gunga etj. Me këtë rast mbrëmje letrare është organizuar edhe në Zagreb. Në shtator të vitit 1980 studentët shqiptarë, anëtarë të Shoqatës Letrare Muzikore "Përpjekja", kanë organizuar një vizitë në Arbënesh. Ata kanë mbajtur një koncert për qytetarët dhe pastaj kanë bërë një vizitë te varreza e Josip Relës. Në gazetën "Përpjekja "është shkruar: "Ashtu të renditur, ecnim nëpër rrugët e varrezës së bukur me drunj të lartë, me rrugë të drejta. Në krye të kolonës, një vashë e një djalë e mbanin kurorën pejanësh. Që nga larg, vërejtëm portretin e poetit, mbështetur për gurin e mermertë të varrit, mbi të cilin gjendej një vaze e në të lule të freskëta. Shqimet tona u shtanguan mbi germat ku shkruante emri i poetit".[48]

Në shenjë nderimi dhe kujtimi për shkrimtarin herë – herë vizitohet Arbëneshi, banesa dhe varreza e Josip Relës.

[48] XH. Z. /Xhelal Zejneli/, "Te varri i Relës", "Përpjekja", Beograd, 1980, nr.2, f.3.






UNIVERSITETI I ZAGREBIT


ASPEKTE TË LETËRSISË
VROJTIME LETRARE DHE ARTISTIKE
VLERËSIME TË LETËRSISË SHQIPTARE
PROCEDIME LETRARE
S I P A S
TE KRIJIMTARISË LE
LETËRSIA SHQIPTARE E SHEKULLIT XX
Kadare
STUDIME LETRARE
LEXIM LETRAR
LEXIM LETRAR
Bibliografi
UNIVERSITETI DHE SHOQËRIA BASHKËKOHORE

PJESA E DYTË



KAPITULLI VI

FILLIMET E KRIJIMTARISË LETRARE

KRIJIMET E PARA POETIKE


Krijimtaria e Josip Relës që nga fillimet letrare, së pari në poezinë lirike dhe më vonë në poezinë epike dhe atë dramatike, dhe deri në përfundimin e saj, shtrihet në pesëdhjetë vjet të aktivitetit letrar 1916-1966. Periodizimi i kësaj krijimtarie përfshin tri faza kryesore. Prodhimi letrar deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore i përket etapës së parë. Shkrimet e viteve të luftës (1941-1945) në aspektin tematik dhe të motiveve të trajtuara, bëjnë etapën e dytë. Në fazën e tretë përfshihet tërë krijimtaria letrare e mëvonshme, pra veprat më të njohura të këtij shkrimtari. Periodizimi i tillë bazohet në veçoritë më karakteristike të krijimtarisë letrare të Josip Relës, por edhe në ecuritë kryesore të zhvillimit të letërsisë shqiptare të shekullit XX.

Krijimet e para poetike të Josip Relës janë ato të kohës së rinisë. Sa ishte nxënës i Normales, ai tregoi afinitet të duhur për shkencat shoqërore dhe për artet e bukura. Plani dhe programi mësimor i shkollës së mesme, ku mësoi Rela, përmbante më shumë lëndë të profileve arsimore dhe kulturore, dhe në këtë bazë edhe më shumë njësi mësimore për gjuhën dhe për letërsinë. Josip Rela shkollën e mesme, siç është e njohur, e kreu në një ambient ku jeta kulturore dhe letrare ishte shumë dinamike dhe e pasur. Zara, si qendër e rëndësishme kulturore me traditë shumë të pasur, ka pasur ndikim të gjith-

anshëm në emancipimin kulturor edhe te arbëneshët. Në Arbënesh zhvillonin aktivitete të shumta grupet dilitante artistike, të cilat shfaqnin pjesë teatrore dhe programe të ndryshme artistike muzikore. Leximorja e Arbëneshit po ashtu tubonte të rinjtë për të organizuar aktivitete kulturore dhe letrare. Në seksionet e dramës bënin pjesë edhe shumë arbëneshë të moshuar dhe të rinj. Në këtë rrjedhë të jetës kulturore, me specifika edhe të jetës arbëneshe, janë afirmuar edhe shoqëritë kulturore dhe artistike. Me veprimtarinë e saj është shquar sidomos Shoqëria "Arbanasi" ("Arbëneshi").

Rela hapat e parë në letërsi i bëri si nxënës i shkollës së mesme. Së pari krijoi disa poezi lirike. Ato nuk janë ruajtur. Poezia më e hershme, e shkruar në gjuhën kroate më 1916, është lirika e dashurisë "Margariti" ("Margaritës"), e cila bashkë me një tufë poezish të tjera lirike është përfshirë në përmbledhjen "Intima". Poezia është mjaft e shkurtër, ka gjithsejtë gjashtë vargje të rimuara dhe ka mbetur e pabotuar. Disa fjalë poeti i ka nënvizuar, për të vënë në dukje më shumë elemente të përmbajtjes, por edhe të funksionit të rimës. Përveç këtij motivi të dashurisë poeti ka trajtuar edhe motivin social. Poezia "Svirepi"("Mizori"), sipas shënimit të autorit, është krijuar më 1919. Heroi lirik i saj është njeriu i vuajtur dhe i shfrytëzuar pa mëshirë nga zotëria që mashtron dhe nga shoqëria në përgjithësi, në të cilën dominon shtypja klasore dhe padrejtësia. Ky hero lirik, i katandisur në mjerimin social, megjithatë kishte force të një gjiganti. Poeti e përkrah shtresën e vegjëlisë dhe akuzon shkaktarët e mjerimit. Poezia nuk është ndarë në strofa dhe si brendi ka një rrëfim që zhvillohet natyrshëm dhe lidhet me gjendjen sociale të kohës. Krijimi poetik i ngjan poezisë sociale të poetit kroat, Silvije Strahimir Kranjçeviqit, autorit të poezisë sociale të gjysmës së parë të shekullit XX. Rela, siç është vlerësuar më parë, është ndikuar edhe nga literatura e lexuar. Më shumë është ndikuar nga letërsia italiane dhe nga letërsia kroate. Krijimtaria popullore e arbëneshëve, edhe pse e ruajtur në mënyrë fragmentare, ka lënë gjurmë të dukshme në krijimtarinë e poetit të ri dhe pa përvojë të duhur letrare. Shfrytëzuesi mizor, sipas poetit, nuk ka mëshirë dhe nuk respekton drejtësinë në raport me shërbëtorin dhe të varfërit. Për këtë arsye, me fuqinë e

zjarrtë atë duhet shkatërruar. Poeti identifikohet me heroin lirik dhe pa nguruar pohon: "oh, i yti jam".



Qyjtut

O Qyjtut i lodhun, jo, mos u prishtnò!
Hreshin e vet prishtë mos e lëshò!
Ndregu! Me dremi reth vellit shigò!
Tokën e vet me dashtnú punò!
Kalu'ka koa e vajtimit,
Kalu'ka koa e gjrulzimit!
Përshesh tokën me duer dhe me nojers:
Kiji vënesht, liq! Mbjellë drith, grun e presh!...
Koha i'asht mà e begat, e agës...
Ç'nuk asht mà si t'ka kenë babës!
Vrita e ditës ndryshe shkëllzen,
Nata e dimit ma bukur nxen'!
Kumigat t' mënijshem na i thyem,
Me gjak e lemerí na i lyem...
N'se shkepit, katundet na i rrxeuen,
Fqejen të bardhë for na e pruem!

Poezinë tjetër "Ku më je" më parë e kishte titullin "Dikur". Në të trajtohet motivi i dashurisë. Është krijuar më 1926. Në këtë poezi poeti shpreh dashurinë dhe mallin e pashuar për të dashurën. Në çaste të vetmisë e fton vajzën e bukur t'i kthehet sa më parë në përqafim.

Përshkrimet që bën poeti janë karakteristike për poezinë erotike, të cilën ai e kultivon në moshën e rinisë. Në kohën kur poezia është përkthyer në gjuhën shqipe dhe është botuar, ka befasuar lexuesit me paraqitjen sensuale të dashurisë:

"O, ku më je –
E bukur,
E butë,
E re!
Që të mbështjelli
Të ngrohtë, të dridhshme, t'ambël;
Të puthi
Në buzë, në faqe, në gji –
E ti,
E hutueme, me za t'ultë,
Tue përkdhelë flokët e zes,
Me thane:
"Me pi, me pi,
E tea jam – ..."[49]



[49] Josip V. Rela: "Ku më je", "Jeta e re", 1963, Prishtinë, nr.3, f.354.

Në poezinë "Përmendorja" Rela trajton temën e luftës, pra luftën e popullit liridashës kundër okupatorit fashist. Është kjo një pamje luftarake e Sllatinës, ku evokohen ngjarje të përjetuara: fashistët pushkatojnë njerëzit e pafajshëm dhe të pambrojtur. Poezia është shkruar më 14.XII.1944, është përkthyer në gjuhën shqipe më vonë dhe është botuar me titullin "Tregim i okupatorit". Si ilustrim kemi veçuar dy strofa të kësaj poezie, me të cilën zgjerohet gama e motiveve si edhe tematika e poezisë në tërësi:

"Nuk u përqafuen. As baba me birin!
Vetë si tjerëve dorën shtrënguen pa fjalë,
Dhe qetësisht, si hijet, ngadal shkuen
Te "muri i bardhë".
Kaq okupatori... Fytyrat e shejta:
Babën, birin... Kurr un' nuk do t'i harroj!
N'krenare zemrën time – përmendoren
Do t'ju ndërtoj!"

PROVA TË KRIJIMTARISË DRAMATIKE

Gjatë kohës së qëndrimit si mësues në Mal të Zi, në Arzë dhe në Priftën, Josip Rela provoi të krijojë dramën "Pengtarët", por nuk arriti ta përfundojë. Ky tekst dramatik, si edhe disa shkrime të tjera, i kanë humbur gjatë tërheqjes së ushtrisë austrohungareze. Përveç kësaj sprove dramaturgjike, në etapën e parë Rela krijoi pjesën teatrale "Lundërza e Jozhës", e cila është shfaqur në skenë nga amatorët e Arbëneshit më 1919. Kjo lojë skenike për rininë, duke u përcjellë me këngë dhe muzikë, ka zgjuar interesimin e shikuesve ndër arbëneshët.

Ngjarjet që zhvillohen në këtë vepër ndodhin në një katund buzë detit, siç është edhe vetë Arbëneshi. Personazhet janë po të atij ambienti dhe njerëz të viseve të tjera. Skena është e thjeshtë dhe tipike, me një skenografi të adaptuar për zhvillimin e lojës dhe të ngjarjeve. Personazhet kryesore janë: Jozhea (peshkatar i vjetër), Ma-

rea (gruaja e Jozhës), mësimdhënësi, Janja (shërbëtorja e shkollës), nxënës, vallëzues, vallëzuese, djem dhe vajza.

Duke paraqitur marrëdhëniet e përditshme dhe punën e njerëzve sipas profesioneve që kanë, virtytet dhe veset e tyre, shpresat dhe dëshpërimet, mentalitetet, sjelljet dhe veprimet e ndryshme etj., krijohet atmosfera tipike e jetës familjare dhe kolektive e kohës dhe e ambientit të caktuar. Pikëpamjet e ndryshme, të shfaqura nga përfaqësues tipikë të brezave të ndryshëm, pastaj veprimet e llojllojshme, paraqesin konfliktin letrar jo aq të ashpër, por të mjaftueshëm për një vepër të këtij lloji. Për shikuesit janë interesante: loja dramatike, kënga dhe muzika, tekstet e këngëve popullore arbëneshe të përcjella brez pas brezi, si edhe poezitë e krijuara nga vetë autori. Një poezi e tillë, e krahasuar me krijimet popullore, paraqet synimin e Relës për të pohuar se edhe arbëneshët e kanë krijimtarinë e vet artistike. Vargjet e një poezie të këtij lloji, të përshtatura nga poeti, janë:

"Këqyrni vajzën, këqyrni çikën,
Sikur molla asht e hijshme,
Sikur dardha asht e shijshme:
Unë e puthi vet' në ballë,
Ajo mue shum më rallë,
Hej, haj, dëfrime!"

Teksti dramatik e ka mjaft të theksuar qëllimin edukativ. Mirënjohja ndaj prindërve, ndaj mësuesit, shokëve dhe shoqeve, spikatet edhe në vargjet poetike të krijuara dhe të kënduara nga kori i nxënësve:

"Arsimtarit ynë të dashtun
Miradijen për gjithmonë,
Nderjen ditës, nderjen natës,
Edhe fatin ja dëshrojmë!"

Nxënësit në aktin e tretë përmes këngës i drejtohen peshkatarit plak:

"Tungjatjeta barba Jozhës:
E t'tannve të shtëpisë,
Lundra e vjetër do t'ringjallet
Mu me forca të rinis!"

Josip Rela dramën "Lundërza e Jozhës" e ka përfunduar me këngën që i kushtohet rinisë, të kënduar nga kori. Kjo poezi është gjithashtu krijim poetik i fazës së parë, i cili gërshetohet me tekstin dramatik të skenës së tretë dhe të fundit:


"Erë e kandshme, er'e e lulesh
Kangë,e butë, fllad pranvere,
Buzëqeshje, gëzim i zemrës,
Dhe peshqeshje dashtunije.
o rini, ti je!
.....
Si orkani dobësit i fshinë,
Si vullkani të drejtat ngren!
Fatin të botës s're,
E dashtuna, ti na bje –
o rini, rini!"[50]

Vlera artistike e kësaj drame është modeste. Autori, duke mos pasur përvojën e duhur letrare, nuk ka arritur të krijojë një vepër që do të plotësonte më mirë kërkesat themelore të krijimit letrar të dramaturgjisë. Megjithatë, drama e Relës e shfaqur në skenë, ka përmbushur dëshirën e publikut të etshëm për argëtim.

Më 1928, kur ishte mësues në Kashtel Novi, afër Splitit, Rela krijoi komedinë dyaktëshe "Sot tetë ditë","e cila u shfaq disa herë me sukses". Në vazhdim të krijimtarisë letrare Rela krijoi edhe komedinë triaktëshe "Provat" "me përmbajtje nga jeta dhe përjetimet e vetë diletantëve në prova".

[50] Josip V. Rela: "Vepra I", "Rilindja", Prishtinë, 1968, f.258.

NAIM FRASHËRI



HISTORI E SKËNDERBEUT

KAPITULLI VII

POEZIA

MOTIVE POETIKE ARBËNESHE

Në poezinë e Josip Relës trajtohen motive të larmishme poetike. Motivet arbëneshe janë karakteristike për këtë ambient dhe si i tillë përfshihet në poezinë shqiptare. Në lirikën e krijuar në faza të ndryshme të krijimtarisë, poeti ka shfaqur ndjenjat subjektive, ka paraqitur meditimet për fenomene të ndryshme shoqërore dhe kujtimet jetësore. Shkrimtari ka kultivuar poezinë përshkruese, atë të dashurisë, poezinë patriotike, sociale, refleksive dhe lloje të tjera lirike. Poezia për fëmijë bën një tufë të veçantë dhe në të shprehet dashuria e poetit ndaj fëmijëve.

Rela nuk e ka bërë klasifikimin e poezisë në mënyrë rigoroze, prandaj shpesh herë në disa krijime të veçanta ka gërshetuar disa motive poetike. Poezinë e ka krijuar në çaste të ndryshme të frymëzimit dhe derisa nuk ka vendosur t'i botojë në përmbledhje të veçanta, as nuk i ka sistemuar në cikle të posaçme. Në gjashtë fletore janë përmbledhur poezitë e krijuara që nga viti 1916 dhe deri në fund të vitit 1966. Shumica e poezive janë shkruar në disa variante, duke i përmirësuar vazhdimisht deri në versionin e fundit. Duke ditur se poezitë i ka të shpërndara dhe shpesh herë të pa përfunduara, poeti më herët nuk e kishte idenë e qartë si do të përgatitej përmbledhja me poezi të zgjedhura.



Universiteti i Zarës në Zarë
Rektori - Prof. dr. sc. dr. h. c. Ante Uglešić

Shumë poezi të botuara në shtypin dhe në periodikun shqiptar të kohës edhe më parë ishin bërë të njohura për publikun lexues. Për të tjerat nuk është ditur se gjinden në dorëshkrimet letrare të Relës. Në fillim të viteve '60 Bepo kishte bërë përpjekje për të botuar një përmbledhje poetike. Më parë i është drejtuar Esad Mekulit, kryeredaktorit të "Jetës së re".



Nadbiskup Vicko Zmajević

Pastaj, për të realizuar këtë synim, Redaksisë së këtij botuesi i është dërguar dorëshkrimi me poezi të zgjedhura me titullin "Dhimbjet e mija". Më 20 gusht 1964 Esad Mekuli i ka shkruar Relës një letër në gjuhën serbokroate, në të cilën e ka e njoftuar për këtë çështje si vijon: "Kopjen e poezive tua ta kthej me lutjen që t'i lexosh me kujdes dhe t'i përmirësosh gabimet eventuale daktilografike.

Unë dorëshkrimin ende nuk e kam lexuar, prandaj nuk e di si do të duket përmbledhja – a do të përfshihen të gjitha por më parë dëshiroj ta kem tekstin plotësisht të pastruar. Njëkohësisht t'i japësh titullin përmbledhjes – kështu, siç e shoh, ajo nuk e ka, rregullo ciklusin sipas të cilit rend radhiten (I, II, III), ta bësh përmbajtjen (shkruaje me dorë në një faqe) dhe shëno dy tri fjalë për SHËNIMI PËR AUTORIN. Shpresoj këtë do ta përmirësosh sa më parë dhe dorëshkrimin ta dërgosh rekomande. Për ndryshimet e mëvonshme eventuale në përmbledhje jo njoftoj.

Shumë të fala shkrimtarëve – pleqve të Arbëneshit – pasi, për fat të keq, nuk keni kurrfarë përtëritje!"

Nën shënimin P.S. Esad Mekuli ka shtuar: "Kur njeriu plaket, i ndodh kështu të harrojë që letrën ta fusë në materialin e dërguar – në poezitë."

Më 24.VIII. Rela i kthen përgjigjen dhe Esadit i shkruan në letrën e bashkangjitur me përmbledhjen poetike: "... dje kam marrë dërgesën – poezitë, dhe ja sot t'i kthej. A s' është shpejt? Unë nuk di se në to mungon diçka.

Pohon se ende nuk i ke lexuar dhe nuk din a do të hynë të gjitha apo jo. Vepro si ta shohësh të arsyeshme. Unë nuk mundem tjetër, përveç të falënderoj përzemërsisht dhe të mbetem borxhli...

Te përmbajtja, edhe nëse ajo zvogëlohet, nuk ka mundësi që faqet t'i përgjigjen faqeve të poezisë, sepse mendoj që faqet e dorëshkrimit nuk u përgjigjen faqeve të përmbledhjes.

Besoj se është e mjaftueshme për "Shënimi për auktorin" dhe se kam plotësuar të gjitha kërkesat. Ju faleminderit për përshëndetjet – pleqve. Dhe me të vërtetë, për fat të keq, përtëritje nuk ka? Nuk ka, i dashuri Esad, dhe çka është më e rëndë, frigohem se më tutje as që do të ketë, sepse poezia profetike "Zani i t'birunit" në f.14...

Ne këndej jemi të bindur se kemi "kënduar si ai para vdekjes së vet. Rinia jonë argëtohet dhe jeton në mënyrën e vet, ndërsa fjala e nënës gjithnjë e më tepër zbehet. Po, të gjitha kushtet dhe shkaqet, të cilat kanë kushtëzuar qe të mbahemi, në pjesën më të madhe po zhduken.

Unë fëmijë nuk kam! Miroa i Kikicës i ka dy, dhe asnjëri nuk kupton as dialektin tonë. Fëmijët e Shime Deshpalit, i ka katër, aspak nuk flasin arbënisht! Prandaj, nuk është simptomatike? Dhe kështu me radhë..."

Bashkangjitur me përmbledhjen poetike Mekulit i është dërguar edhe një letër e shkurtër, që mban datën 3.VIII.1964. Në të ka shkruar: "Sipas propozimit tënd, t'i dërgoj afër tridhjetë poezi me dëshirën që të bësh përpjekje t'i botosh, me çka do të më gëzosh shumë". Në të vërtetë Rela i ka dërguar 35 poezi, të sistemuara në tri cikle:



Maximiljana Barançiq

I. "RRETH VENDLINDJES"

"Prindët femijve" (1951), e botuar në "Jetën e re", 1954, nr.4.

"Tata birit të ritun" (1951), "Jeta e re", 1952, nr.4.

"Derës së oborit", "Jeta e re", 1963, nr.5.

"Vazës së vetueme", "Rilindja", 1964, nr.1828.
"Kronit të fikun", "Jeta e re", 1954, nr.4.
"Bregu i Sokos", "Jeta e re ", 1953, nr.6.

II. "ATDHEU"

"Zani i t'birunit" (1951), "Jeta e re", 1952, nr.5-6.
"O natë", "Jeta e re", 1955, nr.1-2.
"E kaluemja", "Zani i rinis", 1964, nr.6.
"Përgjegjea e Malsorit", "Zani i rinis", 1961, nr.23-24.
"Tregimi i okupatorit", "Jeta e re", 1964, nr.2.
"Fjala e kangës sime", "Jeta e re", 1959, nr.5.
"Djaloshi", "Jeta e re", 1963, nr.1.
"Përgjegje t'eshtnave", "Zani i rinis", 1955, nr.6.
"Fjalët e Zanit t'rinis"
"Liris", "Jeta e re", 1956, nr.2.
"Bota vlon", "Jeta e re", 1959, nr.3.
"Qysh jam unë", "jeta e re", 1955, nr.6.
"Qershis të prem", botuar në "Gëzimi", 1955, nr.2.

III. "DASHTNIJE"

"Ndoshta...", botuar në "Zani i rinis", 1960, nr.7-8.
"Kujtimet në vjeshtë", "Jeta e re", 1955, nr.4.
"Kujtou, kujtou meje", "Jeta e re", 1954, nr.5.
"Pjeshkës së thatë", "Jeta e re", 1959, nr.4.
"Tri vjersha":(E hutuemja, Pjekunija, Dhimbja), botuar në "Jeta e re", 1959, nr.1.
"Kisha me dashtë", "Jeta e re", 1960, nr.5.
"Kujtimi", "Jeta e re", 1960, nr.3.

"Ku më je", "Jeta e re", 1963, nr.3.

"Ty", "Jeta e re", 1964, nr.2.

"Lulea e bregdetit", "Flaka e vllaznimit", 1955, nr.312.

"Thirrja e lules" dhe

"Bukuroshes s'plazhës".

Redaksia e "Jetës së re" pastaj zgjodhi poezitë e Relës dhe i sistemoi në tri cikle:

"Rreth vendlindjes" (6 poezi)

"Atdheu" (6 poezi) dhe

"Gëzimi e dhimbja" (11 poezi).

Në fund u dhanë shënime për autorin, ku nuk është përfshirë tërë teksti i shkruar nga poeti, por është sajuar tekst i veçantë, në të cilin lexuesit informohen shkurtimisht për jetën dhe veprimtarinë letrare të Josip V. Relës. Jashtë përmbledhjes "Vjersha" mbetën 12 poezi të përmbledhjes "Dhimbjet e mija" dhe shumë vjersha të tjera të shpërndara nëpër fletore të veçanta, të cila Rela dëshironte t'i botojë në një vëllim tjetër poetik. Arsyet e mospërfshirjes së shumë poezive të opusit poetik në vëllimin "Vjersha" janë të shumta. Për këto çështje ka shprehur mendimin e vet edhe autori. Disa krijime të hershme poetike nuk kanë qenë të përfunduara, ndërsa shumë të tjera nuk janë shquar me vlerën artistike.

Lirika e Relës është ruajtur në shumë variante. Duke analizuar këto tekste poetike, mund të vërehet se ato janë përsosur vazhdimisht, derisa nuk kanë fituar një formë përfundimtare. Megjithatë, disa poezi kanë mbetur në nivelin e tyre, me vlerë modeste artistike. Ato janë lënë anash. Në disa raste edhe poezi të tëra janë vlerësuar të dështuara dhe si të tilla janë prishur me laps. Poezia lirike e Josip Relës në aspektin e motiveve dhe të ideve është interesante. Si krijimtari origjinale e poetit arbënesh ajo ka zgjuar interesimin e lexuesve dhe të studiuesve të letërsisë shqiptare n; kohën kur është krijuar dhe është botuar.

POEZIA E DASHURISË

Në etapën e parë të krijimtarisë poetike të Josip Relës lirika e dashurisë ka shtrirje më të madhe. Duke shprehur botën subjektive, ndjenjat e dashurisë ndaj vashës së ëndërruar, apo edhe ndaj së dashurës që e shoqëron poetin në çaste të gëzimeve dhe të shqetësimeve jetësore, Rela ka krijuar një realitet të ri artistik, atë të poezisë.

Në kohën e rinisë poeti është dashuruar në një vajzë të bukur e lozonjare, të cilën e quan me emrin Margaritë. Ai dëshiron t'i shfaqë dashurinë dhe t'i dhurojë çdo gjë të çmuar, prandaj kërkon që edhe ajo t'i përgjigjet dashurisë. Asaj i kushton poezinë e parë. Më vonë Rela në shumë poezi të tjera ka trajtuar motivin e dashurisë.

Në kuadër të përmbledhjes poetike "Vjersha" janë botuar poezitë: "Kisha me dashtë", "Kujtimi", "Thirrja e lules", "Ndoshta", "Ku më je", "Ty", "Lulea e bregdetit", "Kujtou, kujtou meje", "Kujtimet në vjeshtë" etj. Poezitë erotike që kanë mbetur në dorëshkrim, ose që janë botuar në gazetat dhe në revistat e kohës, janë: "Sot do t'thoj", "Yllkat, thirmani", "Ema e vogël", "Pa ty...", "Pa nderë...", "E dashtuna", "M'duhesh", "Shfaqja e kinos", "Lules s'ambël", "Kujtimet nëpër lot", "Në sheti", "Dashnores", "Le t'dijsh", "Nëse nuk beson", "Të zgjedhunes", "Bukuroshes s'plazhës", "Në peron" etj. Në ciklin e veçantë "Dashtnije" të përmbledhjes "Dhimbjet e mija" Rela i ka përfshirë poezitë më të realizuara artistikisht.

Në poezinë "Kisha me dashtë" poeti shpreh dëshirën që të dashurën ta ketë gjithnjë afër dhe bashkë me të të prjetojë lumturinë:

"Kisha me dashtë –
M'u bashkua përherë me ty,
Si uji i lumit qi lidhet e përzihet
Me detin e thellë –
Kisha me dashtë!"

Ai e thrret të dashurën, për t'ia falë dashurinë. I ekzaltuar, kërkon ta shohë lulen si "I çelë fletët bul' e lules / E hap' këmishën

t'pëlhurës: /. Ajo nuk e fsheh bukurinë as dashurinë, prandaj flet e gëzuar:

"Jam e bukur, jam e thjesht
Në pranverë si dhe në vjesht'!
.....
Ambëzinat ju ka mbledhë,
Edhe zemrën ju kam çelë".

Ideali estetik i dashurisë është herë – herë i ngjashëm me atë të poezisë popullore. Vasha shquhet me bukurinë fizike, por edhe me virtytet morale. Ajo ka bukurinë e vashës arbëneshe, njomësinë dhe vrullin rinor. Fizionomia morale spikatet me ndjeshmëri të hollë. Në poezinë "Ty" paraqitet dashuria e çiltër dhe e natyrshme midis të rinjve. "Vjershtari" është frymëzuar nga bukuria e vashës së hareshme në çaste të trazimit shpirtëror, prandaj i ndien thellë tronditjet emocionale që ndodhin në qenien e saj. Në strofën e fundit spikatet aspekti moral i realizimit të dashurisë:

"Me dëshira nëse t'flakta
Lules s'bukur e mora erën,
Zemrën t'pastër, dashtninë t'madhe
Nuk ja borra, jo as besën!"

Në dy poezi të tjera: "Bukuroshes s'plazhës" dhe "Shfaqja e kinos" ndjenja e dashurisë është paraqitur e gërshetuar me elemente vizuale dhe me lojën e dashurisë, që nuk ka qenë karakteristike për poezitë e tjera të këtij lloji. Poezia "Në gjum", ose në një version tjetër "Ëndërr", paralelisht me dashurinë ka paraqitur edhe xhelozinë. Ëndrra dhe realiteti herë – herë në poezi konvergjojnë. Një paralelizëm i tillë poezinë e Relës nuk e ka zgjëruar në aspektin e përmbajtjes dhe nuk e ka përsosur në planin artistik. Si e tillë, ajo ka mbetur e thjeshtë dhe e lehtë për të komunikuar me lexuesit.

Kujtimet për dashurinë e përjetuar më parë janë evokuar në disa vjersha, në të cilat motivi i dashurisë gërshetohet me motive të tjera

poetike. Një prirje e tillë është e pranishme në poezitë: "Kujtimet në vjeshtë", "Kujtohu, kujtohu meje", "Kujtimi" etj. Kjo reminishencë si përmbajtje poetike ka sjellë edhe disa dimensione të tjera kuptimore. Kujtimet nga e kaluara ndikojnë në disponimin shpirtëror të poetit dhe i sjellin atij parafytyrimet e bukura, që nuk harrohen kurrë. Rela ka shkruar:

"Kujtimi i ambël qetësinë ma merr
Kaluemjes s'bukur mendjen na shpjer...
.....
Të gjitha të mirat në zemër i kam;
Prej këso kujtimesh un i lumtun jam!"

Poeti e kujton me mallëngjim të dashurën, ndërsa ajo i shfaqet si një siluetë nga larg, në fillim e errët, por që vjen e qartësohet me bukurinë e saj. Kujtimi për dashurinë e kaluar, për shetitjet dhe përqafimet te kroni, për pritjet dhe takimet, për dëfrimet rinore, që nuk kthehen më asnjëherë, e bëjnë poetin të ndjehet i gëzuar dhe i mallëngjyer. Malli i pashuar për të dashurën, për njerëzit e tjerë të dashur, e nxit poetin për të shpalosur ndjenjat, kujtimet, mendimet. Kjo më së miri vërehet në poezinë "Kujtimi":

"Lulet, puthja dhe shetija
Si n'prralla m'jan' dukë:
E shkëlqyeshme bukurija
Kurr prej mendjes s'ka me zhdukë!"

Figuracioni poetik i poezisë së Relës nuk është aq i pasur. Siç shihet, poeti më shumë i ka kushtuar kujdes komunikimit të lehtë dhe të drejpërdrejtë të poezisë me lexuesit. Gjatë etapës së parë të zhbillimit të poezisë shqiptare kjo prirje ka qenë e pranishme edhe te disa poetë të tjerë, siç janë: Esad Mekuli, Aleks Çaçi, Andrea Varfi, Petro Marko, Vehbi Bala, Hivzi Sulejmani etj.

Vashën e dashur poeti e emërton me emra që sugjerojnë bukurinë, njomësinë, freskinë. Ajo është qershi që ëmbëlson, lule e bukur shumëngjyrëshe, mimozë, orhide, mollë, rrush, pjeshkë, lule e breg-

detit, lule e fushës, lule e malit, lule e qytetit, sy i qiellit, pranverë, diell, drenushë, zog i diellit, bijë e hënës, melodi e bukur etj.

Poeti është i përkushtuar ndaj së dashurës dhe jetën e lumtur dëshiron ta kalojë së bashku me të zgjedhurën e fatit të vet. Ai i drejtohet vashës:

"Le t'dijsh, se pa ty
Si pa zemër jam!
Dhe di, se me ty
Unë dy zemra kam!"

Në poezinë "Nëse nuk më beson" trimi, jo vetëm se vajzës i shfaq dashurinë, por edhe i premton besnikërinë. Ai është shqiptar dhe i përmbahet fjalës së dhënë:

"Jo vajzë! Shqiptari besën s'e then kurr!
As fjalën! E unë – Shqiptar jam – dhe burr!

Në një fletore shënimesh Rela për poezinë "Të zgjedhunës" ka shënuar: "E përpunuem". Aty janë përshkruar dy variante paralele, ku shihet përpjekja që ka bërë Rela në procesin e krijimit dhe të përsosjes së poezisë. Poezia "Ema e vogël" ka disa strofa të ripunuara. Djali i ri është dashuruar në vajzën e bukur të kopshtarit. Ajo shquhet me bukuri të rrallë fizike dhe shpirtërore. Sytë e saj depërtues e kanë mahnitur djalin në takimin aq të pritur nën hijen e fikut. Në strofat vijuese poeti nuk e ka idealizuar dashurinë. Është paraqitur dashuria e pa fat e Emës. Ajo në fund është braktisur nga i dashuri dhe është lënë në mëshirën e fatit tragjik. E tronditur shpirtërisht, edhe një herë kërkon t'i kthehet i dashuri:

"Djal i dshtun mos më lisho
Djal i kanda mos më haro!
Përse kunoren ti s'ma ke fal?
Jetën shpirtin ti ma ke marr!"

Varianti i dytë i kësaj poezie më vonë është botuar në revistën "Jeta e re". Ema, nga dëshprimi i thellë që përjeton pas ndarjes nga i dashuri, vdes tragjikisht. Lili, i penduar dhe i pikëllua pa masë për vdekjen e Emës, rënkon dhe fajëson veten. Vargjet e fundit të kësaj poezie:

"Nji djal i ri ner fik po pret
Në dorë krenin e ka pështetë...
"Ema, Ema, s'të kam mashtru...!
Në shpi tatës të kinjesh pru..."! [51]

i përkasin variantit të dytë të poezisë së ripunuar, ku kanë pasuar shumë ndryshime.

Poezinë e dashurisë, si edhe ato me motive të tjera, duhet vlerësuar në kuadrin më të gjerë të opusit letrar të Josip Relës. Kjo krijimtari poetike ka vlerën e saj letrare dhe dokumentare. Në këtë poezi është paraqitur edhe vizioni jetësor i poetit gjatë dy fazave të para të krijimtarisë letrare.

LIRIKA PATRIOTIKE

Motivi patriotik në lirikën e Josip Relës është trajtuar në shumë poezi të krijuara në faza të ndryshme, dhe veçanërisht pas kthimit midis bashkatdhetarëve, "... atëherë kur edhe filloi të shkruajë vjershë në dialekt t'Arbëneshëve të Zadrës". Poeti në përmbledhjet "Pika s'largut", "Vjersha", "Limbjet e mija" etj., që i ka lënë në dorëshkrim, në dy ciklet: "Rreth vendlindjes" dhe "Atdheu", përfshin më shumë poezi patriotike. Në kuadër të përmbledhjes poetike, të dërguar për botim më 1964, i ka ruajtur titujt e këtyre cikleve dhe kështu kanë mbetur edhe në përmbledhjen "Vjersha". Cikli i dytë "Atdheu" përmban edhe këto poezi atdhetare: "Fjala e kangës sime", "Përgjegje t' eshtnave", "Liris", "Tregimi i okupatorit" dhe "Qysh jam unë".

[51] Josip Rela: "Ema e vogël", "Jeta e re", 1953, nr.4, f.268.

Në përmbledhjen "Dhimbjet e mija" poeti kishte zgjedhur për botim edhe më shumë poezi të këtij lloji, disa prej të cilave i kishte botuar më parë në shtypin dhe në periodikun shqiptar. Ato janë radhitur si vijon:

"Zani i t'birunit", botuar në "Jeta e re", 1952, nr.5-6.

"O natë", "Jeta e re", 1955, nr.1-2.

"E kaluemja", "Zani i rinis", 1964, nr.6.

"Përgjegja e Malsorit", "Zani i rinis", 1961, nr.23-24.

"Tregimi i okupatorit", "Jeta e re", 1964, nr.2.

"Fjala e kangës sime", "Jeta e re", 1959, nr.5.

"Djaloshi", "Jeta e re", 1963, nr.1.

"Përgjegje t'eshtnave", "Zani i rinis", 1955, nr.6.

"Fjalët e Zanit rinis"


"Liris", "Jeta e re", 1956, nr.2.

"Bota vlon", "Jeta e re", 1959, nr.3.

"Qysh jam unë", "Jeta e re", 1959, nr.6.

"Qershis të prem", "Gëzimi", 1955, nr.2.

Në disa poezi të tjera të ciklit "Rreth vendlindjes", në të cilat trajtohen motive sociale ose motive të tjera, spikaten ide të theksuara patriotike. Poezitë e tilla, që shquhen me elemente të lirikës së atdhedashurisë, janë: "Nana birit në prehen", "Tata birit të ritun", "Tata bijës pesmdhet vjetsh", "Derës s'oborrit", "Kronit të fikun", "Bregu i Sokos" etj. Në disa poezi të tjera të përmbledhjes "Vjershë në dialekt t'Arbëneshit", në strofa ose në vargje të veçanta, janë gërshetuar segmente të poezisë patriotike. Me këtë përmbajtje dallohen poezitë: "Fjalë të nxeta", "Përgjegje t'vorreve", "Ndjenja e ime", "Nëse nuk beson", "Marshi i rinis", etj.



Zani i t'birrit

I rrëzem jam. Si barka në det i birrun...
Prej gji'anash t'botës me erna i shtypun...
Me gjithfar' emnash t'mbrajtes jam i thirrun,
Prej kërkoje i dashtun as prej këje i lypun...
Gjithfar puniesh kam punua un' si qeni...
Kundet, djersin m'i këthejti vetëm - dheni...
Dheni...? Dheni tom qaxom, nanë tu'sht tu?
Zanin të fjalës jote kush ma ka me pru?
O, nanë, tu më je?
Syt e tua kurr s'i pova...
O nanë, pse m'ke lé?
Prendon jote kurr s'e njova!
O, ti, nanë, s'je si tjerat nana janë?
Prej zembre kur të dbla, zembrën s'ma ke dhanë?
O nanën e vet - gjindja - dyet shum me lutë,
Për t'ja ndjie zembrën dgjorën të brutë?
Këta vrasat un'i peila, por s'i dgjeka:
Ke dhamb si gjarpni, dreq sot e projta
Emnin të dijë e fagon, gjakun të thiesht
E gjynë: Dygindnjizetëpesë vjet s'kam hesht!...
O, nanë, tu më je?
Syt e tua kurr s'i pova...
O, nanë, pse më ke lé?
Prendon jote kurr s'e njova!
Nan', o, nanë! A më ke lé motra e vllazni?
O për fat të keq, nuk janë motra e vllazni,
Kur vllau i tyne kaq mot zanin fo e pret
Kur vllaun e tyne kështu p'e leshojnë me dhelë...

Lirika patriotike e Josip Relës ka veçori ideore dhe estetike të përbashkëta me poezinë shqiptare të këtij lloji, por edhe tipare të veçanta. Në aspektin tematik kjo poezi është e lidhur me vendlindjen. Krijimet e para patriotike në të vërtetë paraqesin dashurinë ndaj vendit ku jetojnë arbëneshët. Lokaliteti Arbënesh në këto poezi fiton atribute të atdheut të dytë, krahas atdheut të parë, Shqipërisë. Ai dallohet nga vendbanimet e tjera dhe është unik. Aty arbëneshët, brez pas brezi, e kanë ruajtur dhe e kanë zhvilluar më tutje vetëdijen kombëtare. Gjatë historisë kjo oazë shqiptare ka rezistuar dhe ka qëndruar e pa epur në baticat dhe zbaticat e kohës, prandaj arbëneshët deri vonë e kanë ruajtur gjuhën shqipe, kulturën shqiptare, doket dhe zakonet e të parëve të tyre.

Rela, si edhe poetët e tjerë që kanë kultivuar poezinë patriotike, në lirikën e tij ka shfaqur ndjenjën e patriotizmit, bindjen se i përket një bashkësie etnike, pra kombit shqiptar. Njëkohësisht ka treguar krenarinë e vet dhe të bashkëvendësve se historikisht i përkasin një vendi, Shqipërisë, atdheut të përbashkët të të gjithë shqiptarëve. Bashkë me idenë patriotike poeti ka shprehur edhe kërkesën e natyrshme për realizimin e drejtësisë sociale, për respektimin e të drejtave kombëtare, të idealit humanist dhe veçanërisht të idealit kombëtar. Midhat Frashëri në veprën "Plagët tona", idealin kombëtar e vlerëson si faktor të rëndësishëm në rrugën e zhvillimit të kombit. "Një popull – ka shkruar Frashëri –nukë rron dot pa ideal, pa një shtytkë, pa një qëllim që e bën të ecënj, të punojë, të përpiqetë dhe të përparojë...

Ky qok që dinë të ndjekin njerëzit e një kombi, bëhëtë idelai i ati kombi, bëhëtë fuqia e tij morale. Pa një fuqi morale, pa një pikë drejtë së cilës duhet të rendin së bashku, njerëzit dhe popujt vdirenë, shuhenë...

Cili duhet të jetë ideali ynë?

Duhet të jetë madhëri dhe nderi i Shqiptarit, njësi dhe bashkim i kombit, lumtëri dhe përparim i përgjithshëm".[52]

Josip Rela çështjen e idealit kombëtar e ka konceptuar si synim që arbëneshët të kultivojnë traditën pozitive, virtytet kombëtare, të

[52] Midhat Frashëri: "Vepra", "Rilindja", Prishtinë, 1996, f.211 dhe 214.

mos asimilohen, ta ruajnë identitetin kombëtar dhe, bashkë me shqiptarët e tjerë në viset e tyre etnike, të realizojnë synimet e tyre shekullore.

Në një letër Rela ka shkruar: "Për çdokend votra e tij është më e dashur dhe më e ngrohtë se të gjitha të tjerat". Në poezitë e veta poeti këtë ndjenjë të dashurisë ndaj vendlindjes, pra edhe ndaj atdheut, e ka shfaqur në mënyrë mjaft transparente. Qysh në fëmijëri nëna e këshillon fëmijën t'i dashurojë njerëzit e vet dhe vendin ku ka lindur, që ai / "Per tambël t'nanës e dashtni / të motrës, të vajzës, për dhé, liri...". Të dijë të luftojë kur të rritet e të bëhet burrë.

Për poetin çdo gjë që i përket vendlindjes dhe mëmëdheut është e dashur dhe e shenjtë. Kroi i fshatit është i bukur dhe, kur ai shterron, e shqetëson çdo njeri. Atij ia këput shpirtin pamja e "kronit të fikun", e "qershisë së prém", e "derës së vjetër të oborrit", pamja e shtëpive të djegura nga armiku.

Fjala e këngës së tij është porosi e madhe e qëndresës, e dashurisë për atdheun. Poezia "Përgjegje t'eshnave" i kushtohet lirisë, atdheut, flamurit të kuq, për mbrojtjen e të cilit derdhet "gjaku jem i kuq". Poeti i drejtohet heroit lirik të kësaj poezie, atij që sakrifikohet për lirinë e atdheut:

"I plagosun shum herë ti erdhe,
Gjakun e vet përse e derdhe?
– Për flamurin t'kuq,
Gjaku jem i kuq!
Për shka ti vdeke? Ç'ka kuj dhune?
- Ty buk, gëzim për t'ri;
Tokës paqë, Atdheut liri".

Shumë poetë shqiptarë lirisë ia kanë kushtuar poezinë më të bukur. Një ndër krijimet më të realizuara artistikisht të Relës është poezia "Liris". Sipas poetit liria agoi "Në burgje të lagta, / Në gjak, në varrje, në plagë, / Në beteja, pushkatime, / Në lot e vajtime, / Në ûjë, n'etje, / Në tym e zjarm, / Në rrenime, n'urrejtje, / Në vorre... /.

Liria në vizionin poetik të poetit erdhi:

"Si qumsht' i nanës,
Si buka e bardhë,
Si qielli i kaltërt,
Si dielli i nxehtë,
Si fusha pa skaje,
Si mali mbi male,
Si hylli që shkëlqen..."

Fati i rëndë i shqiptarëve, pra edhe i arbëneshëve, gjatë luftës kundër fashizmit ka shkaktuar viktima të shumta të njerëzve të pafajshëm. Djaloshi i poezisë me të njëjtin titull, ka mbetur jetim dhe i vetmuar, sepse prindërit e tij qenë vrarë në luftë, ndërsa vëllai ka përjetuar tragjedinë më të madhe në kampin fashist në Aushvic.

Në poezinë "Qysh jam unë" shprehet revolta kundër dhunës dhe padrejtësisë. Poeti, zëri i ndërgjegjes njerëzore, nëpërmjet të përgjithësimit artistik, identifikohet me heroin lirik: ai është "tingëllim i zemrës, dëshir i shpirtit, ...klithmë e gëzimit e atëdheut tonë". Në poemën "Flakët e përgjakura", që përbëhet prej pesëmbëdhjetë këngësh, në këtë tërësi narrative, trajtohet tema e luftës çlirimtare kundër pushtuesit fashist. Ideja patriotike është ide themelore e të gjitha këngëve të kësaj poeme. Ndër to shquhet sidomos kënga "Zani i lirisë", ku ideja patriotike është sendërtuar në plotninë e saj. Në vargjet e fundit poeti thërret bashkatdhetarët e vet të luftojnë për liri:

"Vështirë jetoj
nën thundrrën e pushtuesit!
Mos u dorëzoni?
Luftoni!
Nuk jeni vetëm
Të gjithë jemi me ju
Zaptuesit duhet dërmuar!
Liri, ja vdekje!"

Poezia patriotike e Josip Relës është vlerësuar drejt nga kritika letrare si poezi e një frymëzimi të natyrshëm. Ndikimet letrare të këtij krijuesi janë të ndryshme. Përjetimet jetësore, ngjarjet historike, jeta e arbëneshëve dhe historia e tyre, janë paraqitur me vërtetësi artistike. Në poemën e Relës është evidentuar ndikimi i Vlladimir Nazorit, dhe sidomos i poezisë "Naprijed". Kënga e trembëdhjetë e Relës mban po këtë titull të poezisë revolucinare të poetit të njohur kroat. Në aspektin e përmbajtjes, por edhe të formës artistike, poezia e Relës nuk ka sjellë shumë tipare ideoartistike novatore. Poezia patriotike "Liris" është vlerësuar si një realizim poetik i një niveli të lartë artistik dhe, si e tillë, është përfshirë në programet mësimore të letërsisë dhe në librat e leximit për shkollat shqipe.

POEZIA SOCIALE

Në letërsinë shqiptare tematika sociale është trajtuar në shumë vepra të gjinive të ndryshme. Problematika sociale, duke pasur parasysh kushtet e vështira të jetesës dhe gjendjen e përgjithshme sociale i ka nxitur shkrimtarët t'u qasen fenomeneve të ndryshme shoqërore dhe të trajtojnë në poezinë e tyre motive dhe tema komplekse, që kanë rëndësi të madhe për letërsinë. Letërsia shqiptare e shek. XX në aspektin e përmbajtjes është kryesisht letërsi sociale, në të cilën është trajtuar tematika shoqërore. Angazhimi social dhe qëndrimi i shkrimtarëve ndaj problemeve dhe dukurive shoqërore ka qenë i gjithanshëm. Në këtë rrjedhë të letërsisë është kultivuar edhe lirika sociale.

Gati në të gjitha llojet e poezisë lirike janë të pranishme edhe disa tipare të poezisë sociale. Rrethanat shoqërore në të cilat kanë jetuar shtresat e ndryshme të popullsisë, padrejtësia sociale, pabarazia shoqërore dhe ekonomike, ndasia në të pasur dhe në të varfër, antagonizmat klasore, prejardhja e ndryshme sociale dhe etnike, shfaqja e mentaliteteve të llojllojshme dhe e disponimeve të ndryshme sociale, janë bërë inspirim adekuat për krijimin e poezisë sociale.

Josip Rela, si edhe shumë poetë të tjerë shqiptarë, ka krijuar poezi sociale dhe në këtë mënyrë, duke shpalosur ndjenjat subjektive, ka

paraqitur botën e arbëneshëve, problemet sociale të tyre, virtytet dhe veset dhe njëkohësisht problematikën sociale të mbarë njerëzimit.

Poezitë sociale më të njohura këtij poeti janë: "Bujkut", "Bujku shatit", "Gurbetçi", "Bota vlon", "Vendlindjes", "Faqeziut", "Nana birit në prende", "E ti po shkon", "Zani i të birunit", "Në Kolovare", "Tata birit", "Pa nderë", "Qershisë së prém", "Bregu i Sokos", "Fjalë të nxeta", "Vleftet", "Plaku plakës", "Profetizimi i dervishit", "Djaloshi", "Atyne..." dhe "Qish vien kjo gy".

Spektri i motiveve të këtyre poezive është mjaft i gjerë. Rela, duke pasur parasysh faktin se arbëneshët në të kaluarën janë marrë me bujqësi, por edhe me veprimtari të tjera, ka paraqitur aspekte të jetës sociale të bujkut, të punëtorit, të njerëzve të thjeshtë, që u përkasin shtresave të ndryshme. Në poezinë "Në kujtim të vjetit 1726" poeti evokon të kaluarën e arbëneshëve, ngjarjen e rëndësishme historike të shpërnguljes së bashkatdhetarëve të vet. Përveç këtij dimensioni historik është dhënë edhe një përshkrim i gjendjes sociale:

"*S'ju tremb as udha e larg*
as etja, as uja.
Shum keni pas bés
Para dyqind e njizet e pes.

Kush ju nis? Kush ju çon?
Kush pe shpie ju grmon?
Pasha, begu o Sulltani
Uja, smunda o megdani?"

Në poezinë tjetër të Zef Relës (kështu është nënshkruar poeti I. Sh.) "Nana birit në prende" nëna i drejtohet të birit: "Të vorfunit jepja dorën" dhe i jep udhëzime të tjera morale e të mirësjelljes:

"Me dashni gji punët puno,
Kush nuk munje atiij' di' mo.
Gji puntorve fale nderjen
Vetë të madhit fute "mjerjen!"

Dy poezi sociale i kushtohen bujkut të Arbëneshit. Në poezinë "Bujku" është paraqitur gjendja sociale e këtyre njerëzve të thjeshtë, të cilët, përveç punës së rëndë që i lodhë shumë, ndeshen me vështirësi të shumta të jetës. Portreti fizik i bujkut është realizuar në disa pamje dhe bashkë me të edhe fizionomia e tij morale. Lidhja e bujkut me tokën dhe me veglat e punës paraqitet në poezinë "Bujku shatit". Në këto poezi janë të pranishme edhe disa dimensione të transformimit social të kësaj shtrese vitale të popullsisë. Lufta për ekzistencë, por edhe për mirëqenie shoqërore, është e lidhur me punën e vazhdueshme dhe me plot sakrifica të domosdoshme të jetës.

Bujku është i lodhur nga puna e rëndë dhe i shfrytëzuar pa mëshirë nga punëdhënësi. Megjithatë, buka e zezë dhe e hidhur, që sigurohet me mundime të mëdha, e shpëton bujkun e mjerë nga shfarosja fizike. Në vargjet poetike Rela tregon shqetësimin e thellë për këtë gjendje të pavolitshme të bujkut dhe shpreh urrejtjen ndaj shkaktarëve të mjerimit social:

"Dhe me urrejtje na presin, o zot!
Dhe yndyrën na marrin kot.
O shat, tem shat!
Buka jonë e zez'. e thatë.
Si edhe toka na asht e fort
O shat, tem shat!
Me lagë na dyet me ndjers e lot,
Si edhe dhenin e dje e sot."

Ai identifikohet me bujkun dhe i jep shpresë: "Do t' vijë le' tsimi, zemra m' thotë! / Dhe shfrytzimi do t'mbarot'!" /

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore poeti ka shpresuar se bujqit, si edhe njerëzit e tjerë, do të çliroheshin nga prangat e shfrytëzimit social, nga urrejtja dhe nga poshtërimi. Prandaj shpreh optimizmin jetësor, të bazuar në një vizion të ri, por i cili nuk realizohet ashtu siç ishte proklamuar. Poeti i drejtohet bujkut:

"O bujk i lodhun, jo mos u posht' no!

Krenin e vet poshtë mos e lësho!
Ndrequ! Me kreni rreth vehtit shiqo!
Tokën e vehte me dashtni puno!
Kalu' ka ko' a e vajtimit,
Kalu' ka ko' a e çfrytzimit! "

Motivi i mërgimit është trajtuar në poezitë sociale: "E ti po shkon", "Gurbetçi" etj. Shpërngulja e arbëneshëve nga vendlindja në vende të ndryshme të botës ka lënë pasoja të rënda në jetën e kësaj oaze shqiptare. Numri banorëve shqiptarë, në vend se të shtohej, vazhdimisht është pakësuar. Varfëria i ka shtyre njerëzit të lënë vatrat e veta. Poeti shpreh dëshirën t'i shohë bashkatdhetarët e vet të bashkuar dhe të lumtur në trojet e veta, prandaj kërkon që ata të mos i braktisin familjet arbëneshe. Ai pyet: "E ti po shkon?" dhe sjell argumentet për ç'arsye s'duhet lëshuar vendlindjen:

"Këtu je lé. Këtu fshat
E vëneshtat të vet i ke.
Gurt e çufrat, udhët, gardhnjet,
Kronjet, greblat – gji i nje..."

Gjatë qëndrimit në mërgim arbëneshi ka pësuar shumë. Bashkë me të shpesh herë është katandisur edhe familja. Prandaj, në poezinë "E ti po shkon" në një farë mase është vetëdijesuar dhe u thot të tjerëve ç'duhet bërë:

"*Pse un s'mbeta në oborr...!?*
Tash, kur erdha, jo jo vllô,
E me dash dokush me më vrô;
E me më dhan nuk dijet sâ;
Vendin e vet un nuk e lô...
Arbënesh – ri, mendo –
Dhenin, gjakun, gyn e do."

Portreti i mërgimtarit të poezisë "Gurbetçi" të Josip Relës është i ngjashëm me atë të heroit lirik të poezisë "O vlla me sharrë në krah" të Esad Mekulit. Ky kurbetçi është argati që ka punuar më parë arat e huaja, për të siguruar kafshatën e hidhur të bukës së zezë, është punëtor krahu për punë të rënda dhe për sakrifica të mëdha jetësore. Ai, megjithatë, është i nënçmuar dhe i përbuzur. Si i tillë "Shamje, përbuzje, poshtërsina ka pritë..."

Në poezinë "Bota vlon" shpreh shqetësimin e ligjshëm dhe të papërmbajtur: "Përse tan bota vlon me të shkretë? / Pse s' ka mjerija nji grimë të drejtë." /

Sipas tij pabarazia sociale ka shkatuar ndasi të madhe midis të pasurve dhe të varfërve:

"Dikush tet' herë për dit' han e pi,
Mijat nji pikë uj s' kan' as buk të zi!"
Njerzit shoq me shoq – pse njerz nuk janë?
Pse njani tjetrin shfrytzon e han!"

Derisa në poezinë sociale shqipe të viteve tridhjetë disa poetë kërkonin rrënimin e botës së vjetër dhe krijimin e një bote të re, Rela me përkushtim poetik spikat revoltën e skamnorëve dhe kritikon shkaktarët e mjerimit social. Në strofën e fundit poeti paraqet ashpërsimin edhe më të madh të kundërthënieve, prandaj edhe luftën për jetë a vdekje të vegjëlisë:

"*Gjaku t' untit vlon e vlon...*
Herë – her era shum ushton,
Dhe vërshimi tokën mbulon...
Kudo pushka zjarmin qet:
Plumb i pushkës varron e vret. "

Në poezinë "Zani i të birunit" janë gërshetuar elemente të poezisë patriotike dhe të asaj sociale. Heroi lirik i kësaj vjershe u përket shumë periudhave historike të jetës së arbëneshëve, që nga koha e

shpërnguljes së tyre dhe deri në ditët e sotme. Ai është i vetmuar, pa nënën e dashur, "Si barka n'dete i birun."

Shumica e poezive sociale të Relës kanë mbetur në dorëshkrim. Rrethanat e jetës shoqërore, të jetës së arbëneshëve, në mënyrë realiste janë paraqitur edhe në poezitë e tjera të panjohura nga lexuesit. Ato janë të shkurtëra e me pak vargje, por përfshijnë përmbajtje të pasur. Duke pasur parasysh traditat pozitive gjatë historisë së jetës së arbëneshëve, dhe sidomos vullnetin e tyre për punë, në poezinë "Tata birit" poeti spikat porosinë të cilën prindi i përcjell të birit, për t'u bërë punëtor i zellshëm, sepse në atë mënyrë, jo vetëm që sigurohet ekzistenca e familjes dhe mirëqenia shoqërore, por kultivohen edhe virtytet e mira morale. Puna sipas tij ka rëndësi të madhe, prandaj shpreh mendimin:

"*Deri sot pe uje na ka rue,*
Emnin, erzin e gyn na ka prua! "

Mosha e shtyre dhe gjendja e vështirë sociale e jetësore e plakut të Arbëneshit e shqetëson poetin. Ai ua qan hallin të gjithë skamnorëve të tjerë, të cilët mezi e përballojnë varfërinë dhe pleqërinë. Në poezinë "Bregu i Sokos" evokohen kujtimet nga vizita në vendlindje pas njëzet vjet bredhjesh në mërgim. Sa ndryshime të mëdha kishin ndodhur: gjyshi dhe babai kishin vdekur, njerëzit e tjerë kishin braktisur vatrat. Kishte mbetur vetëm i biri, për të mos u shuar familja. Pas të gjitha këtyre, Bregu i Sokos "… gur e çufër, gardh e shkëmb… faqen ndron", por mbetet i egër dhe i ashpër si gjithmonë.

Një poezi tjetër sociale i kushtohet qershisë, kësaj peme që shumë herë ua shuan urinë skamnorëve. Kujtime të paharrueshme për qershinë që, jo vetëm hijeshonte oborrin e shtëpisë me degët, me kokrrat e kuqe dhe me gjethet plot gjelbërim. "Ti më ke qen' dark' e drekë…", thotë poeti dhe shpreh shqetësimin për pemën e prerë:

"*Mbas shumë vjetësh qe, jam kethy',*
Me të pa dëshrojsha edhe ty …
Kurr ma zemrën s'ma ke me nxe –

Njerëzit – ajnat të kanë pre! "

Motivi social, i gërshetuar edhe me motive të tjera, është trajtuar në poezitë në të cila paraqiten transformimet shoqërore, siç janë: "Dita e re", "Sirena e fabrikës", "Marshi i rinisë", "Në botën e re", "Fjalët e Zanit t'rinis" etj. Josip Rela e ka njohur mirë gjendjen sociale të arbëneshëve dhe botën shpirtërore të tyre. Djaloshi jetim kishte mbetur në rrugë të madhe, pa perspektivë jetësore. Gjendjen e tij e paraqet me vargjet:

"*Pa vlla, pa motër, pa prind' e pa buk*
atëherë djaloshi ka hupë, u zhdukë.
Tmersinat e luftë s' i ka durue…"

Po ai djalosh, si partizan, merr pjesë në luftë dhe kurrë nuk e harron vuajtjen dhe mjerimin social. Ai i përjeton rëndë edhe vuajtjet e njerëzve të tjerë, pra edhe të robërve të luftës. Prandaj, kafshatën e fundit të bukës ua jep të uriturve. Aspekte të transformimeve shoqërore, si edhe në poezitë e shumë poetëve të tjerë, janë përfshirë në këtë cikël poezish të Relës dhe kështu është pasuruar përmbajtja e poezisë në tërësi.

Gjatë etapës së parë të zhvillimit të poezisë së sotme pas luftës ishte bërë e natyrshme që poetët t'i kushtonin poezi: jetës së re, rinisë, fabrikës, shkollës, heronjve, ambulancës së re, përparimit shoqëror etj. Në poezinë "Dita e re" poeti shpreh gëzimin për ndërtimin e jetës së re:

"*Dita e re sot ka ardh,*
Dita e lirë, dita e bardh,
Sot u levëm edhe nji' erë
Me punë, me buk, e me nderë! "

Ndërtimi i fabrikës së re, krijimi i marrëdhënieve të reja, hapja e shkollës së re, arsimimi dhe edukimi i brezit të ri dhe shumë veprimtari të tjera, ngjallin shpresat te njerëzit për jetë dhe për punë të ndershme. Sirena e fabrikës sjell gjallëri në qytet dhe në fshat. Poeti

me këtë poezi ka reaguar në mënyrën e vet kundër Kominformit. Ngjarjet që pasuuan atëherë bënë që të pushojë sirena e fabrikës dhe të acarohen marrëdhëniet shoqërore dhe politike. Në poezinë "Marshi i rinisë" shquhet roli i brezit të ri në shoqëri. Të rinjtë, sipas tij, janë lule të ardhmërisë. Poezia "Në botën e re" sintetizon aspekte të transformimeve të gjithanshme në jetën e re. Bota bashkëkohore gjatë periudhës së pasluftës ka ndryshuar dhe ka përparuar. Poeti me krenari ka afirmuar arritjet e botës së re, i bindur se humanizmi, solidariteti dhe mirëqenia e njerëzimit do të realizohen në mënyrë optimale. Ky iluzion megjithatë nuk është i qëndrueshëm, sepse Rela ka shfaqur edhe qëndrimin kritik ndaj dukurive të ndryshme aktuale të kohës. Realiteti jetësor nuk ishte i tillë, siç paraqitej në një pjesë të poezisë së këtij lloji.

Me rastin e pesëmbëdhjetë vjetorit të revistës "Zani i Rinisë" shkroi poezinë "Fjalët e Zanit t' rinis". Përshtypjet e vizitës në Kosovë poeti i kishte ende të freskëta. Rrjedhat e transformimeve shoqërore për plakun e Zarës ishin dukur shpresëdhënëse. Me fjalët e ngrohta ai përshëndet njerëzit dhe viset shqiptare:

"*O fjalë të mia të freskta,*
shkoni, qyteteve udhëtoni,
dhe vendeve kah t'kaloni
thueni, kallzoni, lajmroni e
njoftoni: koha e re si
zemrat na zgjoi ! "

POEZIA ELEGJIAKE

Në dorëshkrimet e poezisë së Relës shquhet elegjia "Kujtimet nëpër lot". Më vonë e njëjta poezi është titulluar "Kujtimet e vjeshtës". Fjala *elegji,* e shënuar në ballë të tekstit, ka përcaktuar llojin e kësaj poezie lirike. Pikëllimi i thellë për humbjen e së dashurës në këtë poezi është shprehur me tone të theksuara të melankolisë. Elegjia ka trembëdhjetë strofa me nga gjashtë vargje njëmbëdhjetërrokëshe.

Përmbajtja e saj është mjaft e gjerë. Përveç motivit elegjiak në të janë përfshirë edhe aspekte sociale dhe morale të jetës së kaluar. Kujtimet për krijesën e adhuruar e ngushëllojnë poetin. Ajo për të ishte: "zan' e bardhë", "stoli ma e bukur", "zog i diellit", "bi e hanës", "i dashtun hyll" etj. Vdekja e kobshme ka mbuluar me pikëllim edhe shtëpinë, familjen dhe natyrën në tërësi. Me mallëngjim kujton bukurinë e vashës dhe çiltërinë morale të saj. Buzëqeshja, besnikëria, gëzimet dhe dëfrimet mbeten të paharrueshme. Kujtimet e vjeshtës, pra edhe ato të kohës së pleqërisë, i sjellin poetit ngushëllimin dhe ndjenjën e pendimit. Pikëllimi për humbjen e gruas së dashur nuk është vetëm ndjenjë intime. Vaji nuk përmbahet dot dhe shpërthen natyrshëm. Poeti nuk nguron t'u drejtohet njerëzve, të kenë mirëkuptim:

"*Miq, po më pyetni: – pse me vajtue?*
Përse pikëllimin për dit' me shtue
M'i lëshoni dhimbjet. Mos më ngacmoni!
E ju, lotët e mija rrjedhni, pikoni! "

Poezia "Zani i të birunit" po ashtu shpreh pikëllimin e njeriut të vetmuar, larg familjes dhe atdheut. Vdekja e nënës e frymëzon poetin të krijojë poezinë me të cilën shpreh ndjenjat subjektive. Në gjashtë strofa gërshetohen edhe elemente sociale. Refreni i kësaj poezie:

"*O nan, ku më je?*
O nan, pse më ke le?
Syt të tua kur si pava…
Prenden jote kur se njova! "

dëshmon llojin e poezisë dhe spikat dëshirën e heroit lirik për ta parë edhe një herë nënën dhe atdheun. Natyrisht, kjo dëshirë mbetet e parealizueshme.

POEZIA HUMORISTIKE SATIRIKE

Humori dhe satira në poezinë e Josip Relës janë përfshirë në mënyra të ndryshme. Ai ka krijuar poezi të mirëfillta humoristike dhe satirike. Për këto krijime poetike, me rastin e zgjedhjes së tyre për botim, vetë autori afër titujve të tyre ka shënuar fjalët: *humoristike* ose *satirike.* Megjithatë, këto poezi dallohen lehtë nga krijimet e tjera. Poeti me dashamirësi ka vënë në tallje ligësitë, veset, pikëpamjet dhe sjelljet negative të njerëzve. Duke përqeshur bartësit e fenomeneve të tilla, ka synuar t' i përmirësojë dhe t' i fisnikërojë njerëzit. Përveç kësaj, duke kritikuar ashpër dukuritë negative të jetës, në poezitë satirike ka shfaqur qëndrimin kritik dhe dëshirën për t'i eliminuar anët negative të saj. Funksioni utilitarist i këtyre poezive është i dukshëm..

Vjershat humoristike dhe satirike, në të cilat shfaqet kjo prirje e krijimtarisë poetike, janë: "Atyne…", "Djali plak", "Qish vien kjo gy", "Pa nderë", "Plaku plakës", "Faqeziut", "E kaluemja" (Vllazënve), "Njerëz dhe gra", "Bagëtitë jona", "Në mars", "Gicipollat", "Në gjutet", "Plumb – sokolat" etj.

Në poezinë "Atyne…"autori kritikon ata arbëneshë të cilët, pasi kanë humbur shumë virtyte kombëtare dhe sidomos mburrjen se janë shqiptarë, për shkaqe të ndryshme mbahen se janë francezë, kroatë, italianë. Për këtë qëllim në këto vargje ka radhitur një varg faktesh, të njohura edhe për arbëneshët, siç janë:

"*Kokoriza nuk ësht lemza,*
E vërteta nuk ësht renxa.
As "Desh – Pali" me ken – Ërvot"!
Kiki - s' munje m' u thir – Toni
"*Maroviqat*" *janë "Morani"?*
Përse Mark – Ucajt dojn me than
Me fis se jan fijesht Taljan?
– Leshi mbeten gjider-lesh,
Arbëneshi – Arbënesh! "

Njëkohësisht kritikohen të gjithë ata njerëz mendjelehtë, të cilët e harrojnë gjuhën e vet amtare dhe e zëvendësojnë me gjuhë të tjera. Sipas poetit, ai që mohon gjuhën shqipe, arsyetohet para të tjerëve: :

"Me fjal jon kush më ko me prit?
Me vot ku muj un me ket gy? "

Ai përgjigjet me zemërim: "Ti çish nieri do me u thir, / Kështu nuk bje ti në fis t' on… / Pe' nesh biru – shko me tën Zon!" Ata i quan plangprishës dhe i përbuz ashtu siç e meritojnë.

Rela ka dashur të krijojë poezi në të folmen e arbëneshëve të Zarës, gjithnjë për të tërhequr vëmendjen e bashkëvendësve, që ata ta flasin gjuhën dhe të argëtohen.. Në poezinë argëtuese "Plaku plakës" plaku evokon kujtimet nga koha e rinisë, kur ishte i ri dhe i shëndetshëm. Edhe plaka atëherë ishte e re, e bukur dhe e vyeshme. Tani, në moshën e pleqërisë, që të dy kanë ndryshuar shumë dhe janë të bindur se koha e rinisë nuk kthehet më. Vetëm brezi i ri u jep shpresë dhe i gëzon. Dëshira e plakut për t' u kthyer e kaluara mbetet vetëm një iluzion.

Në poezinë "Faqeziu" fshikullohen dukuritë e shëmtuara të njerëzve në fushën e moralit. Në "veprat e zia" të tyre, thotë poeti, pasqyrohet "errzi e njerzia". Kritikohet ashpër patriotizmi i rrejshëm, egoizmi, demagogjia, injoranca, tradhtia, imoraliteti, grykësia dhe të gjitha devijimet e tjera që shfaqen në jetën individuale dhe kolektive. Kjo kritikë e rreptë i drejtohet atij "… çish do me jetua nërmjet nesh, e në gojë vetë i madh je Arbënesh". Porosia morale është përmbledhur në vargjet:

"*Kush mendimin, besën ndron*
Si grotë sh' i ponë,
Kush në prazma renën mbonë
Dhe perdoron,
Kush dashtniën përpara qet
E pagën pret,
Kush vetëvehten e madhson

E tjetrin shonë,

.....

Atë populli nuk e don!

Atë – shoqnia e largon!

Masa – pesha e gërmon! "

Dashuria dhe besnikëria në jetën arbëneshe janë çmuar shumë. Gjithnjë janë respektuar normat zakonore dhe morale, të cilat e kanë forcuar familjen shqiptare. Tendencat e shthurjes morale në dashuri dhe në marrëdhëniet martesore kritikohen në poezinë "Njerëz e gra". Në të shprehet bindja se fisnikëria e synuar në jetë nuk realizohet gjithherë ashtu siç dëshiron njeriu.

Në poezitë e tjera humoristike dhe satirike: "Në mars", "Gicipollat", "Në gjutet", "Plumb – sokolat" etj., që sajojnë një cikël të veçantë, në formë të përrallës popullore paraqitet udhëtimi i magjinuar, qëndrimi dhe peripecitë e njerëzve në Mars. Ata u përkasin kontinenteve të ndryshme dhe dallohen midis tyre me shumë tipare karakteristike. Përfaqësuesit e Azisë, të Amerikës, të Australisë, të Afrikës dhe të Evropës, me sjelljet, mentalitetet dhe me veprimet e ndryshme befasojnë lexuesit. Megjithatë, ata realizojnë udhëtimin fantastik. Në këtë përrallë, ka pohuar Rela, përfshihen ngjarje të lashta dhe të sotme, të cilat rrëfehen edhe arbënisht. Në një cikël poezish, ku trajtohen motive të ndryshme, gjithashtu janë të pranishme edhe disa tipare kryesore të poezisë humoristike satirike.

POEZIA PËR FËMIJË

Në përmbledhjen e poezive në dorëshkrim "Për fëmi" Rela ka përfshirë këto krijime poetike që u kushtohen fëmijëve: "Shoferi", "Në bejleg", "Shiu", "Loja", "Në Kolovare", "Pulumbardi e ciciloku", "Moti i keq", "Futboll", "Gishtat të dorës", "Bagëtit jona", "Shi ne Shumbri" dhe "Pranvera". Poezitë, bazuar në shënimet e autorit, janë krijuar që nga viti 1951 dhe deri në maj të vitit 1959. Poezi për fëmijë autori ka krijuar edhe në intervale të tjera kohore. Në këtë tufë

poezish, duke pasur parasysh dedikimin e tyre, bëjnë pjesë edhe këto vjersha: "Nana birit në prendë", "Tata bis pesmdhet vjetësh", "Prindët fëmijve", "Voglushes", "Në Mars", "Plumb – sokolat", "Nini, Nuni" etj.

Josip Rela ka shfaqur dashuri të madhe ndaj fëmijëve. Ai nuk ka pasur fëmijë, megjithatë, si mësues dhe si njeri shumë vjet i ka kaluar në punë të vazhdueshme për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve. Ndjenja e dashurisë ndaj tyre prore është rritur, prandaj nuk ka ngurruar ta thotë haptazi se me fëmijët dhe me të rinjtë ka punuar më së shumti. Kujtimet nga koha e fëmijërisë atij i kanë mbetur të gjalla gjatë tërë jetës.

Në një intervistë, në pyetjen se "Cila vjershë e juaj ju pëlqen ma shumë dhe pse? ", është përgjigjur: "Nana birit në prehën" dhe ka vazhduar: "Kjo vjershë më pëlqen m'a shum prej të gjithash. Përse? Kjo asht e para bulë, e para bulë e kopshtit të vogël tem, e cila lulzoi në gjuhën t' ambël amënore…

Dhe në qoftë se asht e thatë, e lakuriqe, ma e kanda ma shum se tjerat dhe pse nëpër fjalë të sajë më duket, dhe sot me e ndigue tingullin të zanit të butë të nanës sime; më duket të ja ndijë shpirtin të saj bujar…më duket sikur t' isha tue ndejë në prehën të butë dhe të nxehtë të sajë dhe tue ndigue mësimet e moçme – të cilat më hijshin në zemër tue m' i mbyll sytë hieja e gjumit…

Qe, pse më pëlqen ma shum se të tjerat" [53]

Në aspektin e përmbajtjes keto poezi përfshijnë motive të ndryshme. Pos lojës së fëmijëve, përshkrimeve të natyrës, aktiviteteve të tjera., Rela ka shpalosur botën e pasur emocionale të vocrrakëve. Lojërat popullore të kultivuara në Arbënesh e kanë frymëzuar poetin të krijojë poezi origjinale për fëmijë. Krijimet e tilla kanë ngjallur kërshërinë e fëmijëve, për t'i mësuar ato në shkollë ose në procesin e lojës. Poezia "Loja" në këtë aspekt dëshmon këtë prirje të poetit. Ajo hapet me vargjet:

[53] Josip V. Relja: "Nana birit në prehën", "Zani i Rinisë", Prishtinë, 1955, nr.3, f.4.

"*Ajna luom në kinkiz*
Ajna, ajna nër murriz!
Lojën të bukur e godisim,
Me nji gozhdë ne dhe e nisim…
Kush i pari? Prit le t' pam
Vizës gurin kush afron…
Ajna çesim: Njaj, dy, tre!…:

Strofa e fundit zakonisht sjell poentën morale, të shtruar si kërkesë edukative nga pedagogu shembullor: "Lujni, lujni, ju fëmia, / Lujni, lujni si vllazni, / Pak pushoni. Bukën 'ani / Tue lue mos u ra'ni!" /. Në këtë funksion edukativ duhet vlerësur poezinë e Relës. Ky poet, siç ka vënë re Rexhep Qosja, "Porsi iluministët tanë më të vonshëm…u drejtohet fëmijëve me ato këshilla të përsëritura sa e sa herë që të duan prindërit: babain, nënën, motrën, vëllain dhe të gjitha këto dashuri të tyre i lidh me atdhedashurinë".[54]

Gjatë lojës fëmijët janë të prirur të imagjinojnë situata të ndryshme. Ata janë aktorë të mrekullueshëm dhe kanë aftësi të madhe vrojtuese. Njohja e psikologjisë së tyre është me interes të veçantë edhe për të rriturit, sepse në këtë mënyrë mësohet edhe ajo që në shikim të parë, duket e jashtëzakonshme. Fëmija në proces të lojës shfaq dëshirat e veta dhe me kërshëri përcjell reagimet e të tjerëve rreth tij. Në poezitë "Shoferi", "Në bejleg", "Shiu" etj., fëmijët paraqiten mjaft aktivë dhe me veprimet e veta të befasojnë këndshëm. Ata imitojnë të rriturit, duke i dhënë rëndësi të posaçme rolit të tyre. Shoferi trevjeçar, me një "auto fring – frig" ngarkon dhe shkarkon gur e rërë, dërrasa e drunj, i bart njerëzit në drejtime të ndryshme, udhëton në qytet dhe kthehet pa "defekt". Në duel "besa – besë", si në përralla, ndeshën fëmijët në Arbënesh. Armët e tyre janë "pushka" dhe "shpata". Rregullat e lojës janë mjaft rigoroze, sa edhe duelet e tyre. Dramaciteti i lojës arrihet shkallë – shkallë, duke u krijuar kështu atmosfera autentike plot hare. Tre fëmijë "si vllazni, gji të veshun, bu-

[54] Rexhep Qosja, Josip Vlladoviq – Rela (Parathanje), Josip V. Rela, vepra II, Rilindja, Prishtinë 1971, f.31.

kuri", në kuadër të natyrës arbëneshe, poetit i kanë lënë përshtypje te veçantë. Moti i mirë dhe moti i keq, fenomenet e tjera të natyrës, të stinëve të vitit në përgjithësi, përshkruhen nga një afërsi e mjaftueshme, prandaj nga fëmijët perceptohen pa vështirësi. Keqësimi i motit në vjeshtë ose në dimër, ngrysja e natyrës, ushtima e erës së fortë, luhatjet e bimëve, ikja e shpezëve, vetëtima, krisma e rrufesë, përplasja e dritareve dhe e dyerve të shtëpisë etj. në shumë poezi përshkruhen me mjeshtri artistike.

Me rastin e organizimit të festave të fëmijëve, të garave të futbollit, të vrapimeve, të gjuajtjes së peshave etj., këndohen këngë të bukura, recitohen poezi, luhen valle popullore, shfaqen pjesë të dramatizuara. "Pulimbardi e ciciloku" është një dramatizim i gërshetuar me këngë të fëmijëve. Pulëbardha dhe sorra, secila në mënyrën e vet, "flasin" për fëmijët. E para i adhuron të vegjlit, ndërsa e dyta i përqesh. Pulëbardha, zogu i verës, "Fluturon aj per mi nesh, …tuj kërkua, Thojn se jemi Arbënesh!". Fëmijët në vazhdim këndojnë këngën "Zogu i verës". Shetitja e fëmijëve në Kolovare (në plazhin afër Arbëneshit), noti, vrapimi, loja dhe hareja e fëmijëve, paraqiten në poezinë "Në Kolovare". Poeti përjeton gëzimet dhe shqetësimet e fëmijëve. Ai i lavdëron dhe i qorton si një prind i dashur:

"Zogjtë të vogli, lonje shtatin!
Kush diell kapen nuk merr shtratin!
Por, mendoni de nji ‘ erë,
Edhe ju se jeni – njer! "

Loja e futbollit adhurohet nga fëmijët. Krahas zhvillimit fizik dhe psikik në këtë lojë arrihet edhe edukimi moral. Poeti spikat të gjitha këto tipare, për të zhvilluar ndjenjën e dashurisë ndaj vendlindjes dhe ndaj kombit. Futbollistët e vegjël: Pietri, Poli, Zefi etj., luajnë me top së bashku me fëmijët e tjerë dhe janë të gëzuar. Por, shqetësimi vjen i papritur. Thyerja e xhamit të dritares, prishja e këpucëve, shkyerja e këmishës etj., mjaftojnë për t’u ndërprerë loja. Rela konstaton: "Edhe kjo lodër ka nji bisht".

Të ngjashme me poezitë popullore janë krijuar vjershat: "Gishtat e dorës", "Bagetit jona" dhe "Nini, Nuni". Poezia "Pranvera"

shquhet me përshkrimin e bukur të natyrës. Poeti i fton fëmijët të sodisin natyrën pranverore: lindjen e diellit, gjelbërimin e livadheve, fluturimin e zogjve, zbukurimin e kopshtijeve. Disa poezi të tjera me motive të ndryshme po ashtu zgjojnë interesimin e lexuesve të vegjël. Këto janë: "Shi, shi në Shumbëri", "Çish munje e çish nuk munje!", "Këngallës", "Në kodër" dhe "Dëshira". Shën Mëri është fshati ku, sipas traditës arbëneshe, festohet Shën Mëria. Tetë vargje të poezisë me këtë motiv popullor Rela i ka përfshirë në përmbledhjen e poezisë për fëmijë.

Shpezët në vjershat e tilla janë paraqitur si krijesa shumë të dashura për fëmijët. Pulëbardha, bilbili, dallëndyshja, pëllumbi etj., adhurohen nga të gjithë, prandaj spikaten karakteristikat e veçanta. Gjinkalla gjatë verës lëshon zërin gumëzhitës dhe me këtë zë dallohet nga gjallesat e tjera. Adhurimi ndaj natyrës është shprehur në këto vargje të poezisë "Natyrës":

"*Ty kodër, malit, pronit, dillit*
Qi botën e nxen, zogut e qillit,
Mrekullisë s' agimit e muzgut,
Lules, bletës, fluturës, bylbylit,
Fushës e gurit, ujit e dyllit
Tneglës, bretkocës, bollës, ujkut–
O, me i numrue n' krye s' i dal,
As për admirim nuk kam mjaft fjalë".

Poezia tjetër "Për melodi të Bramsit" është ninullë. Pranë titullit të saj autori ka shënuar falën *përkthim.* Krahasuar me vjershën origjinale "Nini, Nuni", fitohet përshtypja se teksti është përshtatur me ninullën e poezisë popullore shqiptare.

POEZIA NË GJUHËN KROATE

Josip Rela krijimtarinë poetike e ka filluar në gjuhën serbokroate. Përmbledhja e parë (dorëshkrim) është "Intima" dhe përfshin poezitë e krijuara që nga viti 1916 dhe deri më 1944. Në të bëjnë pjesë: "Margariti", "Svirepi", "Oh, gdje si mi, gdje" dhe "Spomenik". Përmbledhja e dytë mban titullin "Stihovi" (1951-1956). Këtu bëjnë pjesë: "Nekad", "Onda", "Sada", "Okupatoru", "Oj seljace i radnice" (Parodi), "Krik iz dna", "Na peronu" (Susret), "Trofej heroja", "Izlet", "Krvavi plamenovi" (Poemë me 14 pjesë të veçanta), "Miseli veseloj", "Olimp", "Glas etera", "Nase more", "O◊ajnik", "Zrnca", "Zadru", "Griblja", "Tebi", "Pokolenja" dhe "Majka Rakiqa".

Disa poezi, të krijuara më parë në gjuhën shqipe, Rela i ka përkthyer në gjuhën serbokroate. Ato janë: "Slobodi", "Tebi", "Usahloj breskvi", "Zelja", "Triptikon" (1. Zanesenost, 2. Zrelost, 3. Bol). Disa prej tyre janë botuar në "Zadarska revija", "Glas Zadra", etj. Me këtë rast, si ilustrim të përkthimit të poezisë, kemi zgjedhur vjershën "Slobodi", të cilën e përshkruajmë krahas poezisë "Liris":

"Në burgje të lagta,
Në gjak, në varje, në plagë,
Në beteja, pushkatime,
Në lot e vajtime,
Në uje, n' etje,
Në tym e zjarm,
Në rrënime, n' urrejtje,
Në vorre-
Ti, e bardha,Ti e dlira
Agove!
Na erdhe
Si qumsht' i nanës,

U zatvorima vlaznim
u krvi, u ranama,
vjesanjima, strijeljanjima,
u placu i suzama,
u mrznji, u grobovima,
u gladu, u zedi
Ti nam cista, Ti nam bijela,
Okicena,
Ti nam, željo zeljkovana,
Zarudi!
jest, Ti nam dodje
ko majćino mljeko,

Si buka e bardhë,	*ko hljeb bio,*
Si qielli i kaltërt,	*ko vedro nebo,*
Si dielli i nxehtë,	*ko sunce toplo*
Si fusha pa skaje,	*kao zvijezda sjajna,*
Si mali mbi male,	*kao sreca bajna.*
Si hylli që shkëlqen ...	*Da, ti nam se rodi,*
Na linde-Ti,	*Ti, isto ljubav sijes,*
Që dashunin mbjellë,	*srca grijes,*
Dhe dritën na sjell…	*zdravlje cijelis,*
Të duem, shum të duem!	*svijetlo svijetlis*
Të duem,	*i odmor nam dijelis.*
Në prag të shtëpisë të duem,	*Volimo Te u pragu, u krovu*
Në kulm, në votër,	*i ognjisto svome,*
N' uj', në det,	*volimo u polju, u kamenu,*
Në fush' e male,	*u vodi, u moru.*
Të duem, sepse-	*Volimo Te jer Ti nas volis*
Ti na vllaznon,	*Volimo Te, jer nas sjedinjujes.*
Ti zemrat na i bashkon!	*O, draga, vidim Te*
O, e kandshme,	*u oku drage svoje,*
Në Ty synin e vajzës semen e shijoj,	*u posmjehu majke moje.*
Buzëqeshjen e nanaës shiqoj,	*Vidim u junastvu oca svoga*
Në Ty burrnin e babës përjetoj,	*i u cojstvu djedova mojih.*

Dhe nderin e gjysheve mbaj,
Me ty kënaqsin e zemrës e shprehi,
Krenarin atëdheut ja ngrehi,
Me Ty t' vështirat leht' i duroj
Dhe fatin e bardhë gjith botës uroj! "

S Tobom srcu
zadovoljstva nizem,
s Tobom domovini
Bonos dizem. "

Për çështjen e botimit të poezisë Rela ka shkruar në Autobio – bibliografinë e vet: "E përditshmja "Glas Zadra" botoi me rasën e 10 vjetorit të çlirimit vjershën "Zarës", me rasën e 90 vjetorit të Shkollës normale të Zarës vjershën "Sokolimet", e në numrin e vjetit të ri, më 1958, vjershën "Biseda e Baba dimrit me fëmijt", kurgja tjetër. Punimet e ti në serbokroatisht janë mbyllë (ose shkapërderdhë) nëpër sirtarë e ormane… Gazeta jugosllave "Borba", "Vjesnik", "Politika", "Knjizevne novine" botuan recensione dhe shënime të rastit mbi veprat e Vlladoviq – Relës" [55]

Në aspektin e përmbajtjes këto poezi janë të ngjashme me ato në gjuhën shqipe. Megjithatë, meqenëse janë të pabotuara, është e rëndësishme analiza letrare e tyre. Në poezinë "Olimp" trajtohet motivi social dhe paraqitet rënia morale e atyre njerëzve që kalojnë jetë të shthurur nëpër kafene dhe në lokale të natës. Mjerimi social i njeriut të vuajtur është pasqyruar në poezinë "Očajnik". "Glas etera" është poezi e poetit të angazhuar në luftën propagandistike kundër BRSS pas Informbyrosë.

Me rastin e përvjetorit të çlirimit të Zarës plaku i Arbëneshit, më 20 nëntor të vitit 1954, në mbrëmjen festive, ka lexuar poezinë "Zadru". Poeti ka evokuar të kaluarën e qytetit dhe njëkohësisht, në mënyrë afirmative, ka paraqitur aktualitetin e asaj kohe. Poezia "Pokolenja" i është kushtuar Shkollës Normale të

[55] Josip V. Rela, Vepra I, (vepra e cituar) faqe 548 dhe 550

DANI GOSPE LORETSKE 2014

1726 - 2014

Barska - Zadarska nadbiskupija

Generalni pokrovitelj Grad Zadar



BEATA VIRGO
LAURETANA
ORA PRO NOBIS

05.05.2014. 17:00h dvorana GKZD - Arbanasi (zgrada u kojoj se nalazi i sjedište DZA)

Hrvatske povjestice (Zadarski Arbanasi i prijatelji)
Zadarska povjesnica -**Tomislav Marijan Bilosnić**, književnik
Svećenici i župnici iz mjesta Crno i Dračevac kroz
povijesne dokumente - **Mario Vidaić** iz Udruge glagoljaša Zadar
Crtice iz glagoljaške povijesti Bokanjca - **Željko Kolić**, dipl. inž. arh.
Arbanaški učitelji i Preparandija u Arbanasima
- **Željko Perović**, dipl. inž. građ.
Arbanaška prezimena-stara ilirička oznaka rodova - **Dario Tikulin**,
voditelj Čehuljice za glagoljsku knjigu Zmajevich DZA
Trio "Fontana"

08.05.2014. 17:00h dvorana GKZD - Arbanasi (zgrada u kojoj se nalazi i sjedište DZA)

Prvi hrvatski prijevod Drame "Nita"
autor: Josip Vladović Relja, arbanaški i hrvatski književnik
Marina Raspović Prekpalaj (prevoditelj)
Isak Shema (Profesor sa Sveučilišta u Prištini)
Igor Radeka (Profesor sa Sveučilišta u Zadru)
voditelj **Šenol Selimović**
glumci: **Ivana Begović** i **Vinko Radovčić**
Mješovita klapa "Kolajna", voditelj **Renato Perović**

10.5.2014. BLAGDAN GOSPE LORETSKE
18:00 sati Svečana Sv. Misa, predvodi Mons. **Juraj Jezerinac**
sa tradicionalnom procesijom Gospinim kipom kroz Arbanase

13.05.2014. 17:00h dvorana GKZD - Arbanasi (zgrada u kojoj se nalazi i sjedište DZA)

Knjižica **"Šime Relja - Glazba koja život znači"**
autor: **Dina Bušić**
oktet "Pieta" - voditelj **Šime Relja**
gosti: Klapa "Niko"

3.6.2014.-15.6.2014. 17:00h GKZD - Arbanasi (zgrada u kojoj se nalazi i sjedište DZA)

"U SJENI GOSPE" izložba fotografija
tradicionalne procesije s kipom Gospe Loretske kroz Arbanase,
snimljene tijekom posljednjih 45 godina pod pokroviteljstvom
DRUŠTVA ZADARSKIH ARBANASA.
Trio Fontana


Hvaljen Isus i Marija!

Predsjednik DZA
Enio Grdović



Arbënesh, (2014)

Zarës, në të cilën janë shkolluar disa breza të normalistëve, prandaj me mburrje i ruajnë kujtimet nga koha e kaluar në këtë institucion të rëndësishëm arsimor.



Josip Rela e ka njohur shumë mirë gjuhën serbokroate si edhe mjeshtërinë e vargënimit. Botimi i këtij vëllimi të poezive do ta afirmonte poetin, ndërsa lexuesve do t'u mundësohej komunikimi me një pjesë të pa njohur të poezisë së Josip Relës. Kjo

ishte edhe dëshira e poeti të Arbëneshit, e cila deri më sot nuk është realizuar.

Përurimi i veprave më 10 shkurt 2o15, me rastin e 75-vjetorit të lindjes dhe të 55-vjetorit të veprimtarisë sime arsimore, kulturore dhe shkencore.



Programi

12.00-12.20

Prof. Dr. Sedat Kuçi, Dekan i Fakultetit të Filologjisë
Akademik Pajazit Nushi, Rektor i Kolegjit Iliria

"Kroi i fshatit tone"(Palokë Kurti)
Interpretojnë: Sanije Matoshi, Mezozoprano
Pranvera Hoxha, piano

12.30-12.50

Përurimi i botimit "Identitete letrare I"
Prof. Dr. Hysen Matoshi,
Drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës
Prof. Dr. Bashkim Kuçuku, Fakulteti i Filologjisë dhe
Historisë i Universitetit të Tiranës

"Lulebora"(Simon Gjoni)
Interpretojnë: Sanije Matoshi, Mezozoprano
Pranvera Hoxha, piano

13.00-13.20

Përurimi i botimit "Kultura letrare bashkëkohore"
Prof. Dr. Osman Gashi,
Kryesues i Degës së Letërsisë Shqipe, Fakulteti i Filologjisë
Prof. Dr. Shygri Galica, Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës.

KAPITULLI VIII

PROZA

PROZA TREGIMTARE

Josip Rela është poet, prozator dhe dramaturg. Përveç poezisë dhe veprave dramatike, ka krijuar skica dhe tregime. Përmbajtja e tyre është e ndryshme dhe përfshin kryesisht aspekte të jetës së arbëneshëve. Njëkohësisht ka trajtuar tematikën universale, e cila është e përhapur në prozën moderne. Prirja e shkrimtarit për të rrëfyer në mënyrë interesante për ngjarjet historike dhe të aktualitetit, disa prej të cilave i ka përjetuar edhe vetë, i ka dhënë mundësi të krijojë tregime nga të cilat lexuesi do ta njohë më mirë botën shqiptare dhe realitetin jetësor në tërësi.

Në tri fletore tregimesh autori ka përmbledhur të gjitha prozat në gjuhën shqipe dhe ato në gjuhën serbokroate. Nga përmbledhja "Proza" arbënisht më vonë janë botuar tregimet: "Ty të kan thir në drekë...", "Trimb ma gaxo emnin", "Edhe mo zembra e eçët", "Çish kan dash fashistat" dhe "Karabushi i kuq". Në gjuhën shqipe janë krijuar edhe këto tregime: "Dy paravesha", "Pogaça" (Prifti me brisk në kishë), "Nji kujtim me nji pëvetje" ose "Merima", "Paraveshi i dytë" etj.

TRAJTIMI I TEMËS SOCIALE

Josip Rela, si edhe në poezi, në prozën tregimtare ka trajtuar tematikën sociale. Edhe pse vëllimi i prozës nuk është i madh, megjithatë në të ka shtruar probleme të ndryshme të jetës së arbëneshëve dhe më gjerë. Shtresimet sociale i ka paraqitur me vërtetësi historike. Megjithatë, në planin artistik nuk ka arritur nivelin e dëshiruar, as të zhvillojë rrëfimin për ngjarjet komplekse dhe të zbërthejë deri në detaje fenomenet më të rëndësishme jetësore.

Jeta e mësuesisë shkrimtarit i ka lënë mbresa të pashlyeshme. Personazhi i tregimit "Ty të kan thir në drekë...", Pero, është mësues i sëmurë mentalisht dhe në gjendje shumë të vështirë sociale. Pas shumë përpjekjesh për t'i ndihmuar, për fat të keq, shumë vjet mbetet në rrugë të madhe dhe pa ndihmën e askujt. Fati deshi që Pero të përmirësohet nga shëndeti dhe të kthehet midis miqve dhe vëllezërve, "i veshun me robe të rea... I ruom... I leuom. Në nji 'er prap u ban njer". Njerëzit i afrohen të gëzuar, e ftojnë me përzemërsi në shtëpi, por ai nuk u përgjigjet dhe nuk flet asnjë fjalë. Një ditë e thërrasin në drekë, por ai nuk hante dhe nuk pinte asgjë. Për habi të të gjithëve, "... e kapë anën të jaketës të re, e shtin në piat me lang, e thon: ...Ty të kan thir në drekë, e jo mua! Me nji 'erë u çua, e i lishoj me gojë te 'apët..."

Në tregimin "Trimb, ma gaxo emnin" ka shkruar për një ngjarje që ka ndodhur në ambientin e Arbëneshit. Shkrimtari rrëfen për jetën e njerëzve të thjeshtë dhe për gatishmërinë e tyre që, në rast nevoje, duke bërë vepra të mira, të sakrifikohen pa u hamendur. Në pranverën e pritur me padurim, njerëzit zakonisht punojnë dhe shetisin të gëzuar. Ata janë solidarë dhe mjaft modestë. Banori i Arbëneshit, Shime Rela, shpëton nga rreziku mjekun vendas dhe të birin e tij, të cilët kishin dalë të shetisnin me karrocë. Shime, duke rrezikuar jetën e vet, më në fund kishte ndalur kuajt dhe karrocën dhe kështu kishte evituar tragjedinë e njerëzve të pafajshëm. Ai nuk pranon të marrë shpërblimin e merituar për këtë veprim të domosdoshëm, sepse këtë e konsideron obligim qytetar, të ndihmojë çdokend që gjindet në rrezik.

Në disa pjesë të tregimit autori ka bërë përshkrimin e natyrës dhe ka paraqitur atmosferën e përgjithshme që ka sjellë pranvera. Për të dëshmuar këtë prirje të këtij prozatori, sjellim këtu një fragment të shkurtër, që na kujton ambientin autentik të Arbëneshit:

"Notja e pranverës – nji bukuri! Dieli, syni i qiellit, i çoj rezet nëpër gjutet, katunde, kopeshtinj, vënesht e fusha. Bori e lulet i çoven krenjt e dorët çiellit tu e dash me than: "Nxej, o dielli jonë, nxej. Nxej e neve të vogji, të vorfun! ...

Zogjët tu e këçyvë pe rembit në remb, tue e këndua frutolvën ko tre – katër, këndojnë, luoen, çeshen, ra'en, pe lisit në lis e pe gardit në gard. E ata gëzon prenverës, notjes e diellit t'ambël.

Arbëneshët janë me çef e me gëzim në zembër..."[56]

Tregimi "Karabushi i kuq" shquhet ndër prozat më interesante dhe të realizuara artistikisht. Tema sociale është trajtuar me invencion dhe me përkushtim krijues. Duke njohur të kaluarën dhe aspektet e jetës bashkëkohore, autori ka synuar të rrëfejë për të gjitha këto nga këndi i shikimit të brezave të ndryshëm. Lexuesit që e njohin mirë organizimin e jetës së arbëneshëve, pas leximit të këtij tregimi, mësojnë edhe më shumë për veçoritë e karakterit të personazheve të këtij ambienti. Në atmosferën tipike dhe gazmore të punës dhe të lojës, shpaloset bota shpirtërore e këtyre njerëzve të dashur dhe bujarë. Rela ka shkruar:

"Te na në Arbënesh ësht zakon me dimue me dridhë karabusha njani tjetrit, ashtu se, kur dridhen karabushat mbidhet gji kojshia. Dhetë deri pesëmdhet mashkuj – femna, dikush në bank, dikush në grumbull të karabushave, dikush për tokë dridhin mas darke karabusha: shëoqin lëpushkën pe karabushit... Karabushat të vogji e të krymbuom i qesin me njonë. Karabushave të mëdhenj i lëshijnë ko dy – tri kashtë kollomboçit për me u tho. Lëpushkën e përdorujnë për shtrat. E "mustaqet" i shtien me nj'onë, për nërkrysë.

Kështu, tue punua, gaxojnë ndodhinat të rea te katundin, kuvendojnë. Ata të sillet e kanë gynë të ambël e të shpejt, tregojnë pralla,

[56] Josip Rela: Vepra II, Vepra e cituar, f.207

tash – të morshima, tash për me u qeshë... Dikurë e nisin kangë e këndojnë..." [57]

Ata punojnë, këndojnë dhe luajnë. Loja "Flutoroj shkurta" është interesante për të gjithë: për fëmijët, për të rinjtë dhe për pleqtë. Sejcili tregon aftësitë e veta dhe të gjithë së bashku, me humorin karakteristik të arbëneshëve, krijojnë atmosferën e hareshme që nuk harrohet.

Rela, duke kujtuar ato mbrëmje të hareshme, ka shkruar: "U gjetsha e un nji 'erë në shoqni, tu e dridhë karabusha. U qeshesha, u gëzojsha atë mbomje ashtu, se nuk e 'arroj kurr..."

Loja zhvillohet në mënyrën tradicionale dhe spontanisht.

"Ndodhet ashtu tue punua, tu e lua, tu e këndua, e tu u qeshë e gjetën dikush karabushin të jashtzakonshëm, at' erë e gaxon shoqnisë: "Shigoni, shigoni këtë! ... Si brini i kaut! ... Ase: Kqyrni, kqyrni si janë për pjek keta dy... Si Ivci e Tozha! ... Do me thanë si dy të sillët shum do' en, ose janë të marun, ose... I silli, ashtu e gaxon shpirtin mo të' ollë, e shtrinë në shoqni e ngazin mo të madh! ..."

Në këtë prozë nuk ka personazh të mirëfilltë, rreth të cilit zhbillohet rrëfimi. Personazhi është grupi i njerëzve, me tiparet e përbashkëta dhe individuale, është vetë arbëneshi i dashur, mikpritës, gjaknxehtë, guximtar dhe gazmor. Ai është njeriu i mirë, që shquhet me virtyte të larta, por edhe me të meta të pashmangshme përballë situatave të ndryshme jetësore. Arbëneshi, ka pohuar Rela, është gjithherë arbënesh.

TRAJTIMI I TEMËS SË LUFTËS

Tema e luftës në prozën e Josip Relës është trajtuar në tregimet: "Edhe mo zembra e eçët...", "Çish kan dash fashistat", "Fotografi nga Sllatina" etj. Kjo temë në tërë veprën e këtij shkrimtari është shtjelluar me përkushtim të veçantë. Qëndrimi kundër luftës shpehet në forma të ndryshme. Rela është shkrimtar humanist dhe çdo herë ka akuzuar

[57] Nga dorëshkrimet e Josip Relës

bartësit e luftës pushtuese. Në prozën e tij ka paraqitur pasojat e mëdha të dy luftërave botërore.

Shumë ngjarje të luftës i ka përjetuar edhe vetë në vendlindje ose në vise të ndryshme. I ndjekur dhe i burgosur është ballafaquar me forma të ndryshme të diskriminimit. Pamjet rrënqethëse të luftërave shkatrrimtare e kanë tronditur shkrimtarin dhe e kanë frymëzuar të trajtojë motive dhe tema interesante. Në aspektin ideor ai ka çjerrë maskën e luftënxitësve dhe të kriminelëve në kohë të luftës dhe të paqes. Reagimet e tij ndaj luftës së padrejtë janë motivuar në planin artistik. Ai ka afirmuar luftën çlirimtare. Duke çmuar lirinë e popujve të mbarë botës, ka stigmatizuar paktet luftarake, sidomos paktin fashist Berlin – Romë – Tokio.

Në tregimin "Çish kan dash fashistat" ka veçuar "tre emna të mershim: Hitler – Musolini – Mikado", si përfaqësues të tri shteteve fashiste të kohës, të cilët: "... janë bashkua me shti ner vete gji jetën. Bashkuo jan me i bo gji nacionat rob, për me shfrutat e dhenin e jetën. Jetës me jau marr ndjersin, lotët e gjakun, e pe dhenit me i marr mineralat, drutë, mishin e bukën. Gji jeta u dyente me punua për ata. Ata kenjen zotat, ata urdhnonjen, ata patnjen gjithçish, e të gji tjert punonjen për zota të vet! Gjermant e morën për vete emnin: Ybermenç, sh' do me thanë: sipër njerit, sipër tjersh. Ata sipër të gjive, e tjert nër ta! Bukur e kan mendua?"

Popujt liridashës janë ngritur në luftën çlirimtare kundër fashizmit dhe kanë fituar. Luftën e drejtë, sipas Relës, e bëjnë të gjithë ata "... çish e dojn lirin. Gji ata të sillët mo dojshin me dekë se me kenë rob".

Në tregimet e veta Rela herë – herë gërsheton elemente të shkrimit publicistik shkencor. Qëllimi ka qenë që lexuesit t'i sqarohen çështjet e shtruara dhe kjo të ketë një efekt pozitiv. Autori ka qenë i pakënqur me qëndrimin e papranueshëm ndaj disa dukurive negative, të shfaqura gjatë kohës së luftës në mesin e arbëneshëve. Gjatë Luftës së Parë Botërore, por edhe gjatë viteve 1941-1945, disa arbëneshë ishin proitalianë dhe kjo i sillte dëm të madh çështjes së luftës çlirimtare, pra edhe vetë arbëneshëve.

Proza tjetër "Edhe mo zembra e eçët" po ashtu trjaton temën e luftës. Ngjarja vendoset në kohën e sundimit italian në Zarë. Personazhi i këtij tregimi, Bejoa i Çeperit, përjeton tmerret e torturave fashiste italiane. Ai, siç thotë autori, "ka kenë djal 20 vjetësh. I mir, i but, i ndershëm, i vorfun. Kur e mbaronte me punua ata pak dhe të vet, punonte t'uajve. Kurkush, nuk është kjo në të, kurkuj s'i ko ken kanda me vot në të diela në shoqni, me këndua, me u përbi, ma kur nuk u dente, as nuk bante mbrapshtia..."

Megjithatë, fashistët dëshironin që edhe Bejoa të jetë fashist. Prandaj, ata e fajsojnë: "Përse nuk do me shit emnin e fisin. Përse folën arbënisht..." Për këtë arsye e thërrasin në Fashjo dhe e torturojnë me metodat më mizore. Shumë njerëz të tjerë ishin vrarë e masakruar pa procedurë të gjykimit. Bejon e detyrojnë me dhunë të pijë vaj të ricinusit jashtë çdo mase. Për habi të fashistëve, ai në mënyrë stoike përballon të pijë aq shumë "vojdericë" dhe në fund u drejtohet: "– Mbushni, mbushni! Zembra mo fort e eçët...!" Edhe në këtë tregim, siç shihet, Rela ka spikatur të gjitha tiparet pozitive të arbëneshit, siç janë: guximi, besnikëria, qëndresa, atdhedashuria etj.

RRËFIMI I KUJTIMEVE

Në një titull të përbashkët "Kujtime" Rela ka përmbledhur disa tregime me tema të ndryshme. Këto janë proza të pa botuara: "Paraveshi i mikut" dhe "Paraveshi i dytë". Kujtimet nga koha e rinisë, kur ai ishte absolvent i Shkollës Normale të Zarës, përfshijnë të dhëna autobiografike. Rrëfimi për babain dhe për mikun e tij zgjerohet, duke përfshirë edhe ngjarje të tjera të paharrueshme. Ambienti është po ai i Arbëneshit, ku përveç të tjerash, ishin përhapur edhe bestytni të ndryshme. Mësyshi, sipas besimit popullor, sillte sëmundje të pashërueshme ose mortin. Personazhit të këtij tregimi i ndodh, jo vetëm të sëmuret nga syri i keq, por edhe "të vdesë". Megjithatë, ai zgjohet nga kjo ëndërr e keqe. Por kjo dhunti e mësyshit kalon te ai vetë. Në këtë mënyrë provon që me këtë veprim, duke parë me sy të keq tjetrin, t'i shkaktojë atë gjendje që kishte përjetuar vetë.

"Paraveshi i dytë" është tregim i shkurtër dhe i papërfunduar. Në brendinë e kësaj proze përfshihen kujtime nga koha e qëndrimit të Josip Relës në viset shqiptare të Malit të Zi, në rrethin e Gusisë, që nga viti 1916 deri më 1918. Ngjarja përjetohet nga vetë autori, i cili rrëfen në vetën e tretë. Personazhi i tregimit është Vukana, pronare e një kafeneje të Gusisë. "Vukana, ka shkruar Rela, ka qenë nusea njizet e disa vjetësh, e bukur, e pllot por jo tepër. Bash kjo bukuri e saj, kjo mënyrë e ambël e saj gjithmonë me qeshje në buzë, i ka lidhë shum mushterija, e ashtu edhe neve. Burri i ka kenë i internuom në logor... Plaku vjetër 72 vjet rinte në nji qoshe pinte duhanin me nji kamish të gjatë pa fjalë..." Për ta përfituar gruan e re komandanti i rrethit premton lirimin e bashkëshortit të Vukanës dhe për këtë qëllim, lutjen e posaçme ua dërgon organeve përgjegjëse. Duke mos ditur asgjë për këtë lojë, pëson ai që nuk kishte kurrfarë faji. Konflikti letrar nuk zhvillohet deri në fund. Ai ndërpritet shpejt dhe me këtë edhe rrëfimi për ngjarjet vijuese. Rela ka shkruar: "Pa e dijtë për këthough lodër, u gjetëm un e shoku tem faj i silli ma ngjeti paraveshin të nxetë tue ipë giatë. U ullëm, dhe lypëshim çajin. Vukana erdhi dhe me buzëqeshje na luti me pritë sa nji dekik deri të gatitet çaji".

Proza tjetër "Pogaça" ("Prifti me brisk në kishë") përfshin ngjarje që zhvillohen gjatë kohës së shërbimit të Relës në bregdetin e Dalmacisë. "Katundi i bukur në të sillin kam kenë msuos, ka shkruar Rela, për 'apet buzë detit. Shtëpiat grumbullohen në nji grup, ashtu si të ishte qytet i vogël. Rreth nji grykë detit, ... u mbledhën shtëpiat të zbardhuna me gelqere e me bojna. Derat e balkojt shigojnë në port ashtu se kur vjen te porta 'erë me vapor në këthough katund ta nep nji figur t' ilustratave. Vendasit i thojnë katundit të vet prej dashtnije: "Pariz i vogël".

Banorët e këtij lokaliteti ishin lundërtarë. Shumë vjet më parë katundi kishte pasur 1 200 banorë dhe ishte zhvilluar me hov të madh. Pas Luftës së Dytë Botërore, kur punën e lundërtarëve e kryenin anijet e ndryshme, katundi ishte varfëruar shumë. Numri i popullsisë ishte zvogluar në 600 banorë. Shumë fshatarë braktisnin vendlindjen dhe vendoseshin në qytetet e tjera.

Personazhi i këtij tregimi është Milea, një fshatar i varfër, "njeri katërdhet vjetësh, banua ko në nji kasollë jasht katundit. U riti – si i gjetuni – në katund, te nji familie e mirë dhe e shpirteshme, të sillen e ka ndegjua deri u rritë. Erdhi i gjatë e i thatë... Grueja – nji femën vocrrake – me ndim të Zotit, i pruni fëmi si tallas mbas tallasit: Në tetë vjet – tetë zogj".

Kjo familje hiqte të zitë e ullirit për sigurimin e ushqimit. Shkrimtari ka paraqitur gjendjen sociale të saj, por edhe të fshatarëve të tjerë. Kremtimi i festës së Pashkëve në aspektin kompozicional në këtë tregim zë vend më të madh. Shkrimtari përshkruan atmosferën e përgjithshme në fshat dhe procesionin kishtar. Mile dhe e shoqja për festë bëjnë përgatitjet e duhura. Derisa familjet e tjera më të pasura çojnë në kishë për t'u bekuar pogaçet më të mira, familja e Miles memzi gatuan një pogaçë të elbtë dhe për të parën herë ia dorëzon priftit për ta bekuar. Tregimi është përfunduar më fjalinë: "Kur më t'ambla Pashkët s'i ka kallue Milea me famile se atë vjet..."

Proza "Nji kujtim me ni pëvetje", me titullin e mëparshëm "Merima", është shkruar më 1954. Edhe në këtë tregim, të ripunuar dhe të botuar po atë vit, shpalosen kujtimet e kohës kur Rela ishte mësues në Vuthaj, më 1917. Pas sqarimit të rrethanave, që e shtyen mësuesin të shkojë për të punuar në Mal të Zi, shkrimtari sjell shumë të dhëna për arritjen në Vuthaj, për katundin dhe për takimin e parë me fshatarët:

"Zanafill ka vjeshta e vjetës 1917. Dita – te na thonjen – si ambra. Dielli u kapë mirë qiellit kur, me paçefsi, dhe me nji grimë merje mas krashë, për buzë Visitorit, u nisa në Vuthaj. Visitori, mali i egër, me viollca të verdhë, dhe me bisha të helmuom, tue u çua thik, mshenë në vete dhe ndonji koçak... Po vshtirsie i kapërceva ata tre – katërmdhjetë kilometra, dhe u gjeta në Vuthaj, në katund tem, ku m'u kâ dashë me dhanë msim nxansave të mi të rij.

Ndermjet kopshtinjesh, të lëshuom pô kujdsi, nô gjashtë – shtatë shtëpia. Tjerat të shpero' uma ndënkenden nëper mal. Kurku me u pô nji shpirt i gjôll. Me sy kërkova shtëpinë e silla u dyente me kenë shkulla, pse mendova, u dyente me njothe ndërtesa e silla asht e përcaktuom për shkullë, por kot s' mujta me qillua..."

Takimi i parë i mësuesit me fshatarët dhe me nxënësit, biseda me njerëzit e këtij ambienti etj., është paraqitur me vërtetësi historike. Në ato kushte të vështira të jetës, siç i përjetuan shqiptarët e Plavës dhe të Gusisë, kur bëhej luftë për ekzistencë, nuk ishte punë e lehtë organizimi i punës së shkollës në gjuhën shqipe. Ndërtesa që ishte caktuar për lokal shkollor, nuk i plotësonte as kushtet minimale. "Kasolla, ka shruar Rela, nô kater metra e gjatë dhe taman ôq e gjan. Për me 'ipë brenda m'u dashë me u përkullë mjaft mirë për mos me kapë me ballë pragun të naltë. Dera pâ dorxë as pô dry. Poshtë dhent e pësiprit të 'apun deri në kulm. Muret të ndytë. Në mur të jugut' apsina gjashtedhet – shtatëdhet centimetra e naltë, dhe njizet – e pesë – tridhet centimetra e gjan. U desht me kenë – dritësorea, dhe – kurgj tjetër! As banqe, as tryesë, as drasa e zezë, as... Për të vërtet, këtu s' kô mujtë as m'u vendua kurgjô pe kësish teshash të shkullës. Zembra m'u shtërgua, dhe u pëveta: Këtu më dyet me dhanë msim"?

Fëmijët ishin të shpërndarë dhe në fillim nuk tregonin interes-simin e duhur për të vijuar shkollën. Rela ka përshkruar hollësisht vështirësitë që dilnin në punën me nxënësit, me prindërit dhe me faktorët e tjerë përgjegjës për mirëvajtjen e mësimit në shkollë.

Mosmarrëveshjet me nxënësit, dyshimet se ndoshta mësuesi ishte "kaur", pra i krishterë, prandaj insistonte t'i pagëzojë fëmijët etj., bënë që përkohësisht të ndërpritej puna mësimore. Nxënësit ishin shpërndarë dhe nuk vinin në shkollë. Kjo e shqetësoi mësuesin dhe nuk dinte arsyet dhe as pengesat që ndikuan të pezullohej mësimi.

Personazh tjetër i këtij tregimi, përveç mësuesit, është Merima, nxënëse, e cila ia sqaron mësuesit arsyet e ndërprerjes së mësimit. Portreti i vajzës së bukur është realizuar me shkathtësinë e një piktori të talentuar: "Nji krye i engjullit! Flokët t' arit me dredha – dredha: syte, as qielli mô i blert s'ka mujtë me kenë: buzët – dy çershia te pi-ekun, e nërmjed sosh dy vargje dhambësh si gurt e çmuoshëm: fëtyra, qumësht e gjak të përziem... Gji piktort të dyrnjajes kinjen dëshirua me pikturua këthough krye..."[58]

Merima gjashtëmbëdhjetë vjeçare fiton simpatinë e mësuesit, e

[58] Josip Rela: "Nji kujtim me ni pëvetje", "Jeta e Re", Prishtinë, 1954, nr.5, fq.447.

mahnit me bukurinë fizike, por edhe me mirësjellejen. Babai i saj ishte vrarë herët. Në familjen e Merimes, pos nënës jetonte edhe gjyshja e shtyer në moshë. Në dialogun e zhvilluar me këtë vajzë, të cilën autori do ta kujtojë me mall për shumë vjet, ndriçohen rrethanat që kishin shkaktuar aq shumë vështirësi gjatë qëndrimit të Relës si mësues midis bashkatdhetarëve të dashur. Biseda me të për viset e Dalmacisë, si edhe për çështje të tjera të jetës në atë ambient, e zgjeron përmbajtjen dhe e spikat karakterin arsimor të tregimit "Nji kujtim me ni pëvetje".

Merima tërheq vëmendjen e lexuesit si personazh letrar me fizionaminë fizike dhe morale të saj. Ajo ishte e urtë, e zgjuar dhe e sinqertë, ishte "si frutula, si drenusha". Në rrethana të jetës patriarkale shqiptare, ajo nuk arrin të realizojë dashurinë ndaj Zefit. Pasi shërohet nga sëmundja e rëndë, ndahet nga shkolla dhe më vonë martohet me një burrë të moshuar.

Kujtimi për Merimen e dashur mbetet i paharruar. Autori i drejtohet i mallëngjyer: "Merima, në je e gjollë, dhe në diktoshë për këtë rrëfim jem, a u ke me kujtua Zefit? Zefit, të sillit, kur kujto'et te'e edhe sot – e – këtë ditë i shtërgo'et zembra?...

Më fal Merima, le të mbarimi të pëves nji pëvetje:

– A i ke martua e ti bijat të veta ashtu, si të kanë martua ty?..."

SKICAT TREGIMTARE

Përmbledhja e skicave tregimtare të Relës "Crtice", të shkruara në gjuhën serbokroate gjatë viteve 1942 dhe 1943, ka mbetur në dorëshkrim, prandaj nuk është e njohur nga lexuesit dhe as nga studiuesit shkencorë. Disa skica janë portrete dhe përfshihen në kuadër të prozës "Fografi nga Sllatina". Ngjarjet zhvillohen në kohën e okupacionit të Dalmacisë nga Italia. Në prozën "Don Mijo" në mënyrë realiste është dhënë portreti i një prifti të Sllatinës së bregdetit dalmatin, ku Rela kishte qenë mësues. Ai ishte një burrë pesëdhjetetetë vjeçar. Gjatë shtatëmbëdhjetë vjetësh kishte ushtruar shërbimet kishtare dhe me punën e palodhshme ishte bërë simbol i udhëheqësit

shpirtëror të atij rrethi. Ai kujdesej për mirëqenien fizike dhe shpirtërore të besimtarëve të devotshëm. Me pjesëmarrjen e tij në të gjitha procesionet fetare, në gazmendet, kurorëzimet, pagëzimet, varrimet dhe kudo tjetër, i kishte bërë njerëzit për vete dhe i kishte lidhur për kishën. Te ai bëheshin gati të gjitha lutjet, ankesat, kontratat, rekomandimet dhe njëherit shqyrtoheshin çështjet e ndryshme me interes për bashkëvendësit. Don Mijo ka një biografi interesante. Shpalimi i saj bëhet në disa figura – skica tregimtare.

Në skicën "Mali Mijo" paraqitet fëmijëria e tij. Shkollën fillore e kishte kryer në gjuhën italiane. Si fëmijë ishte ngucakeq. Për ta edukuar dërgohet në vende të ndryshme. Megjithatë, ai nuk përmirësohet dhe sjell probleme të shumta në shtëpi dhe në rrethin shoqëror. Me kalimin e kohës, pas shumë vjetësh, ai bëhet një prift shembullor Gjorgji dhe Bakani janë personazhe të skicës tjetër, të cilët i njeh gjithkush. Ata janë kusherinj dhe shumë vite i kanë kaluar së bashku. Janë punëtorë të zellshëm, punojnë dhe fitojnë shumë para në mënyra të ndryshme. Pas konfliktit që ndodh për shkak të mosmarrëveshjeve, Gjorgji ankohet te karabinierët italianë. Italianët mezi prisnin një konflikt të këtillë, për t'i ngarkuar njerëzit me faj edhe më të rëndë. Edhe në këtë rast ndërhyn Don Mijo dhe i pajton këta njerëz në mes veti.



Në tregimin "Liscia pasare" paraqitet gjendja e popullsisë së Sllatinës dhe të Splitit gjatë sundimit italian. Çdo njeri, sipas ligjit, duhej të posedonte letërnjoftimin e vet. Pa të nuk dilej nga pragu i shtëpisë. Kjo pengonte organizimin e të gjitha aktiviteteve dhe tregtinë.



Ernest Koliqi, Martin Camaj dhe Krist Maloki

Don Mijo edhe këtu është ndërmjetësues i jashtëzakonshëm. Ai dërgon lutjet dhe ankesat e ndryshme dhe me durim shumë të madh siguron lejet e qarkullimit për besimtarët dhe për njerëzit e tjerë. Don Mijo s'ka si mos të jetë i pranishëm kudo dhe në çdo kohë me njerëzit e rrethit të vet. Në skicën "Tremuntana", nga dialogu që zhvillon ai me mësuesin dhe me njerëzit e tjerë, të cilët në treg kryenin obligimet e ndryshme, tipizohet më mirë si personazh letrar.



Në skicat "Remeta" dhe "Kata", krahas personazheve të tjera, Don Mijo shquhet me tipare të karakterit kompleks. Parimi i tij humanitar, se në çdo situatë duhet të ketë mirëkuptim për veprimet e të tjerëve dhe t'u ndihmohet atyre çdo herë, zbatohet me vullnetin e mirë dhe në frymën e kodeksit religjioz.

Në tregimin "Babice" trajtohet tema sociale. Interesimi i autorit është të paraqesë marrëdhëniet në familje. Qëndrimi i njëanshëm i nënës ndaj fëmijëve shpesh herë sjell probleme të shumta, të cilat e vështirësojnë jetën edhe ashtu të rënduar nga ndikimi i faktorëve të shumtë. Rela për të gjitha këto ngjarje rrëfen rrjedhshëm dhe pa shtrëngesa ideologjike. Pavarësisht nga pikëpamjet e veta, të shprehura publikidht në forma të ndryshme, në këto krijime epike në mënyrë realiste ndjek zhvillimin e ngjarjeve që kanë ndodhur. Ato i paraqet bindshëm, me të gjitha shkaqet dhe pasojat e tyre, ashtu siç janë manifestuar në jetën reale. Duke bërë përgjithësimin artistik arrin të sintetizojë njohuritë e domosdoshme për çështjet më të rëndësishme. Si shembull tipik të kësaj prirjeje duhet veçuar prozën "Procesija".

Krahas problemeve jetësore të të rriturve, Rela edhe në këto skica ka përfshirë aspekte të jetës së fëmijëve. Nga të gjitha këto proza të shkurtra shquhet tregimi "Rokica". Djaloshi pesëmbëdhjetë vjeçar vuan nga të metat fizike dhe kjo, përveç të tjerash, ka ndikuar të jetë i mbyllur dhe i pa përmbajtur. Jetën e kalon në mënyrën e vet, pa marrë parasysh kërkesat e prindërve apo të rrethit më të gjerë.

Përshkrimet e bukura të natyrës në prozën "Nedeljno jutro" lexuesit i lënë përshtypje të veçantë. Në ambientin e fshatit, kur pranvera ndryshon pamjen e natyrës, njerëzit pushojnë, shëtisin dhe falënderojnë perëndinë që u ka falë begatinë në ara dhe në kopshtije. Don Mijo në kishë lutet për mirëqenien e njerëzve besimtarë, por edhe për ata që janë rebeluar, të cilët jo vetëm që nuk marrin pjesë në procesionet fetare, por haptazi shajnë zotin dhe priftin. Mallkimet e tyre s'kanë të ndalur.

Në tregimin "Počasna straža" shkruan për disa ngjarje që kanë ndodhur në prag të luftës. Konfrontimet në bazë të përkatësisë politike dhe ideologjike kanë ndikuar në qëndrimin që kanë mbajtur grupet e ndryshme. Disa kanë simpatizuar Maçekun, ndërsa të tjerët kanë

përqafuar orientim tjetër politik. Të gjitha këto kanë pasur jehonë në popullsinë e trazuar dhe të brengosur për ardhmërinë.

"Blutava časkanja" është prozë më e gjatë. Përveç parathënies në të përfshihen dymbëdhjetë pjesë të ndara me numra romakë. Rela në këtë tregim ka trajtuar një temë sociale, të pranishme edhe në shkrimet e mëhershme. Krijimi i familjes, martesa dhe marrëdhëniet familjare, që janë aq të rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë, janë në fokusin e interesimit letrar të shkrimtarit. Çështjet e shtruara Rela i zbërthen si të ishte sociolog në kuptimin e plotë të fjalës. Ai deklarohet për martesën, për familjen e shëndoshë, e cila do të ketë fëmijë dhe ardhmëri. Rela ka thënë: "Fëmijët janë gëzimi, prehja dhe jeta e prindërve". Për të afirmuar këtë qëndrim, ka shtruar pyetjen: "Shikoni, meqenëse unë jam martuar, përse të mos martoheni edhe ju?"

Rela në këtë tekst letrar ka shtruar çështjen e krijimit të veprës letrare dhe rëndësinë e kritikës. Ai ka shkruar: "Sot gjithkush shkruan. Dikush është për këtë, ndërsa dikush tjetër jo. Kritika dikë me të drejtë e lavdëron, ndërsa dikë tjetër me të drejtë e qorton... Edhe unë mendoj të shkruaj, pra të botoj librin. Prandaj, nuk mendoj aspak të marr parasysh kritikën e paqëndrueshme. Në vend të kritikës, lexues të dashur, (nëse do të ketë ndonjë) do të bazohem vetëm në ju... Çka më duhet mua kritika, edhe nëse është ajo e cila, me të drejtë më qorton, kur unë e shes librin, që ka lexuesit e zellshëm, të cilët e blejnë. Ose çfarë dobie kam nga kritika, "edhe pa para, e lavdëron librin tim, nëse ju lexues të mirë, nuk doni ta bleni. Prandaj edhe ju, miqtë e mi të mos mbështeteni në kritikën "e paqëndrueshme", por blenie atë libër, nëse dëshironi edhe në kundërshtim me kritikën".[59]

Proza e Relës, e krijuar në gjuhën serbokroate, nuk ka komunikuar me lexuesit. Ajo nuk është përkthyer në gjuhën shqipe dhe nuk është botuar, prandaj edhe nuk është vlerësuar nga kritika letrare. Kjo krijimtari letrare ka mbetur në dorëshkrimet e këtij autori, si dëshmi artistike për kohën dhe për njerëzit, për angazhimet e Josip Relës si shkrimtar dhe si njeri. Studimi i saj ka rëndësi të posaçme për letërsinë dhe për shkencën e letërsisë.

[59] Nga dorëshkrimet e Josiop Relës

KAPITULLI IX

DRAMA

KRIJIMTARIA DRAMATIKE

Vepra letrare e Josip Relës është mjaft e gjerë dhe përfshin gjini dhe lloje të ndryshme letrare. Interesimet e gjera të këtij krijuesi, pasuria tematike dhe gjuhësore, mënyra e trajtimit të motiveve dhe të temave, kanë tërhequr lexuesit e shumtë dhe sidomos shikuesit e veprave dramatike të shfaqura në skenë. Siç është vlerësuar nga kritika letrare, Rela megjithatë nuk ka arritur nivel të dëshiruar në të gjitha krijimet artistike. Në letërsinë bashkëkohore shqiptare ai mbetet një ndër dramaturgët më të afirmuar dhe më të dashur. Kontributi i tij dhënë zhvillimit të dramaturgjisë sonë është mjaft i madh.

Në aspektin tematik në veprën letrare Rela ka trajtuar tema të ndryshme. Gurrat tematike të krijimtarisë së tij janë: e kaluara historike, luftat botërore dhe jeta aktuale e pasluftës. Jeta e arbëneshëve të Zarës, si edhe ajo e popullit shqiptar gjatë të gjitha këtyre periudhave historike shoqërore, nuk ka qenë e lehtë. Vështirësitë që ka sjellë jeta i ka përjetuar edhe vetë shkrimtari. Të gjitha këto janë paraqitur me realizëm edhe në krijimtarinë letrare. Merita e Relës është ajo se prore është përpjekur që me vërtetësi t'i paraqesë baticat dhe zbaticat e jetës së vështirë të arbëneshëve, të shqiptarëve në përgjithësi, por edhe të njerëzimit. Vepra letrare, siç është realizuar nga ky shkrimtar, ofron

shumë mundësi që të kuptohen drejt aspektet e ndryshme të jetës komplekse dhe sidomos plasaritjet që kanë cenuar ekzistencën kombëtare në periudha të caktuara dhe kritike, pra të njihen mirë ndryshimet që kanë ndodhur në jetën e arbëneshëve dhe më gjerë, në viset e tjera shqiptare.

Në aspektin tematik disa nga veprat e Relës trajtojnë tema nga historia e arbëneshëve dhe e popullit shqiptar në tërësi. Shkrimtari me invecion të rrallë ka hulumtuar dhe i ka gjetur temat mjaft karakteristike për t'i trajtuar në veprat letrare. Ka mjaftuar për Relën, për shembull, të ketë disa informata themelore dhe, në bazë të tyre, pas studimit të hollësishëm, të thurë ngjarjet dhe të organizojë subjektin e veprës letrare. Të bën përshtypje të posaçme prirja e këtij krijuesi për të gjetur momentet më dramatike në jetën e njerëzve, dhe veçanërisht në jetën shoqërore.

Kronologjia e krijimit dhe e botimit të veprave dramatike të Josip Relës paraqet aspekte me interes shkencor, që lidhen me çështje të historisë së krijimit të tyre dhe të komunikimit me lexuesit dhe me shikuesit e këtyre veprave skenike. Shkrimtari ka pohuar se gjatë vitit shkollor 1917/18, kur qëndroi në Prift (Arzë) dhe në Triebsh, "Aty e mendoi dhe provoi me e shkrue dramën "Pengtarët". Kjo dramë nuk është përfunduar dhe, për fat të keq, nuk është ruajtur. Pjesën teatrale për të rinjtë "Jožinov kaik" ("Lundërza e Jozhës"), "të cilën pjesë e realizuen në skenë amatorët arbëneshë (studentët) më 1919". Në Kashtel Novi, afër Splitit, në vitin 1932, Rela krijoi komedinë "Sot tetë ditë", "... e cila u shfaq disa herë me sukses, por kurrë nuk u botue". Komedia tjetër "Probe" ("Provat") është krijuar më vonë. Ajo është një komedi eksperimentale në tri pamje, një "prelud" që i paraprin veprimtarisë së mëvonshme.

Këto vepra skenike janë shkruar në gjuhën serbokroate dhe nuk kanë komunikuar me lexuesit shqiptarë të viseve të tjera. Më 1968 shkrimtari Ramiz Kelmendi i ka përkthyer në gjuhën shqipe dhe i ka përmbledhur në botimin "Vepra I" të Josip Relës. Mbas Luftës së Dytë Botërore, në të folmen e arbëneshëve të Zarës, i krijoi dhe i botoi gati të gjitha dramat e tjera. Revista "Jeta e re" me botimin e poezive dhe sidomos të dramave e afirmoi shkrimtarin Josip Rela në letërsinë

shqiptare. Nga veprat dramatike në gjuhën shqipe së pari është krijuar melodrama "Martesa". Me rastin e 225 vjetorit të shpërnguljes së arbëneshëve në rrethinë të Zarës, teksti dramatik ishte përfunduar. Bashkëvendësit e Relës për këtë vepër kishin dëgjuar shumë kohë para botimit. Me përkujdesjen e autorit, më parë kishin filluar përgatitjet për ta shfaqur në skenë, por kjo dëshirë për shumë shkaqe nuk u realizua. Më 1951 studentët e Albanologjisë të Universitetit të



Fakulteti Filologjik i Beogradit (Dega e Albanologjisë)

Beogradit, së bashku me profesorin Vijisllav Dançetoviq, patën vizituar Arbëneshin dhe më atë rast janë takuar me Josip Relën. Për këtë takim të përzemërt Dançetoviqi ka shkruar: "... edhe sikur mos ta kishim gati detyrue me na e lexue melodramën e vet, të shkrueme në gjuhën shqipe, do të kishte mbetë edhe "Martesa" pa dalë në dritë, sikurse edhe shum vepra tjera të shkrueme prej Shqiptarëve në botë... "Martesa" asht mendue dhe shkrue si libreto për opera, të cilën po e komponon kompozitori Arbënesh Deshpali. Por n'insistimin tonë, Josip Vlladoviq – Relja na e dha që ky dorëshkrim të botohet si vepër e parë e shkrueme në dijalektin shqip t' arbëneshëve të Zarës".[60]

Vepra "Martesa" është botuar në "Jetën e re" më 1952 dhe ka zgjuar interesim të madh te lexuesit shqiptarë. Në këtë vazhdë, po në këtë revistë, janë botuar në vazhdime këto vepra dramatike të Relës:

[60] Vojisllav Dançetoviq: "Dy fjalë mbi Arbëneshët e Zarës dhe melodramën "Maresa". "Jeta e re", Prishtinë, 1952, nr.5, f.86 – 87

"Kungulli" – dramë në tri akte, "Nita" – dramë në katër akte, "Lundërza e Jozhës" – lojë për rini në tri akte më kangë e muzikë, "Zani i fëmiut" – dramë në tri akte, "Dila" – dramë në tri akte, "Ik, Jak, Ik!" – dramë në katër akte, "Fisi i mallkuom" – dramë në katër akte me epilog, "Tallasat e dybëjes" – dramë në pesë akte, "Sot tetë ditë" – komedi dhe vepra "Në liri" – dramë me dy figura dhe tri akte.



Përurimi i veprës *Vrojtime letrare dhe artistike* (1995)

Në kuadër të Bibliotekës së vogël të "Jetës së re", që nga viti 1962-1967 disa vepra dramatike janë botuar në vëllime të veçanta. Merita e posaçme i takon shkrimtarit Ramiz Kelmendi, i cili më 1968 në Redaksinë e botimeve "Rilindja", mblodhi, redaktoi, përktheu disa prej tyre në gjuhën shqipe dhe i botoi në një vëllim të përbashkët të gjitha veprat dramatike të Josip Relës, të këtij shkrimtari të adhuruar.

Më 1973 drama "Nita" është botuar në Tiranë, e përshtatur në gjuhën letrare shqipe nga Sami Çabej. Gjatë viteve të mëvonshme disa vepra të opusit letrar të Relës janë ribotuar dhe janë shfaqur në skenat e teatrove profesioniste dhe amatore.

Tipologjia e dramaturgjisë së Relës spikat analogjitë që shfaqen në kuadër të gjinisë letrare të dramës dhe të llojeve kryesore të saj. Janë evidente ngjashmëritë e këtij opusi letrar me krijime artistike të letërsisë shqiptare dhe të asaj botërore.

Rela ka krijuar forma të llojllojshme dramatike, siç janë: komedia, loja teatrore, melodrama, drama, tragjedia etj. Mbarështrimi i lëndës po ashtu ka sjellë ndryshime në strukturën kompozicionale. Vepra skenike e Relës rëndom ka disa akte dhe në kuadër të tyre shumë pamje. Në disa vepra përfshihen figurat dhe epilogjet. Pjesët muzikore, këngët dhe përmbajtjet e tjera të këtij lloji, janë në funksion të vlerës së përgjithshme artistike.

Në shkencën e letërsisë çështjet e zhvillimit të poezisë dramatike janë studiuar me përkushtim mjaft të madh. Drama është përkufizuar si njëra ndër gjinitë themelore letrare. Letërsia dramatike përfshin llojet dramatike në të cilat janë të pranishme elementet e komedisë, të tragjedisë, të dramës dhe elemente të përziera, varësisht nga temat e trajtuara dhe nga mënyra e trajtimit të tyre letrar. Tri parimet e unitetit: të veprimit, të kohës dhe të vendit, janë ruajtur që nga koha e Aristotelit. Veçoritë e poezisë dramatike janë ndryshuar dhe janë plotësuar, varësisht nga ecuritë e zhvillimit të poezisë dramatike. Me dialogët, që janë mjete themelore të shprehjes artistike, pra me bisedat e njerëzve midis tyre për çështje të ndryshme, me monologët dhe me format e tjera të paraqitjes së përmbajtjes e të veprimit dramatik, komunikohet me lexuesit, me shikuesit dhe me dëgjuesit. Duke pasur parasysh rëndësinë e shfaqjes së veprave dramatike para auditorit të gjerë dhe raportin e dramës me teatrin, Gëte ka pohuar: "Drama jeton në skenë". Teksti i shkruar dramatik, si i tillë, dhe përshtatshmëria e tij për t'u shfaqur në skenë, paraqet veçorinë specifike të dramës. Tipizimi i personazheve, vërtetësia artistike e paraqitjes së ngjarjeve, realizimi kompozicional i veprës etj., janë çështje të cilave shkrimtari u kushton vëmendjen e duhur. Para krijuesit të veprës dramatike shtrohen kërkesa të posaçme, për t'u zbatuar ligjshmëritë e artit skenik. Vepra dramatike është unike me tekstin, që ka vlerë artistike, dhe me realizimin skenik. Përveç fjalës, si mjet i shprehjes artistike, në dramë shfrytëzohen edhe mjetet e artit teatral. Për realizimin e suksesshën të veprës në skenë, rëndësi të veçantë kanë: regjia, loja e aktorëve, dekori, muzika, efektet e dritës, efektet akustike, skenografia, kostumografia, didaskaliet etj. Situatat dramatike kushtëzohen nga tërësia e veprës dhe e sajojnë atë të motivuar artistikisht.

Gjatë zhvillimit historik poezia dramatike ka evoluar dhe gjithnjë është pasuruar. Në aspektin terminologjik, në kuptimin më të gjerë, dramaturgjia përfshin artin dramatik dhe atë skenik. Në studimet e sotme shkencore, për këtë arsye, ndriçohen aspektet relevante të dramaturgjisë botërore në tërësi, të një epoke, të një populli, dhe të dramaturgjisë së një shkrimtari. Në kuadër më të gjerë të drejtimeve letrare, në njërën anë, janë krijuar shumë vepra me tipare të dramës tradicionale dhe, në anën tjetër, krijime dramatike me veçori të dramës moderne. Në letërsinë shqiptare janë krijuar vepra dramatike të këtyre dy sensibiliteteve dhe të llojeve letrare. Derisa në letërsinë botërore janë krijuar aq shumë lloje dhe nënlloje të poezisë dramatike, në letërsinë shqiptare janë kultivuar tipat më karakteristikë të dramës tradicionale dhe të asaj moderne.

Dramaturgjia e Josip Relës, e shtrirë në disa etapa të krijimtarisë letrare, me veçoritë e përgjithshme ideoartistike, i përket poezisë dramatike tradicionale dhe përfshihet në letërsinë shqiptare të dy periudhave letrare. Drama shqipe deri në gjysmën e viteve gjashtëdhjetë, kur përfundon krijimtaria letrare e Josip Relës, duke pasur parasysh kushtet e përgjithshme të zhvillimit të letërsisë shqiptare në tërësi, jo vetëm që nuk është zhvilluar krahas me poezinë dhe me prozën, por edhe nuk është studiuar sa duhet. Deri në këtë fazë drama moderne nuk është kultivuar, prandaj edhe nuk është njohur si lloj i tillë me një sensibilitet të ri. Në repertorin e teatrove shqiptare, në bazë të kriterit ideologjik, shpesh herë janë zgjedhur për t'u shfaqur në skenë vepra dramatike të autorëve shqiptarë dhe të huaj, që u janë përgjigjur kërkesave të kohës. Në fund të viteve gjashtëdhjetë, Anton Pashku krijoi dramën "Sinkopa", me të cilën hapet rruga e zhvillimit të dramës moderne shqipe.

Josip Rela ka dhënë kontribut të madh letrar për zhvillimin dhe afirmimin e dramës së një tradite letrare, që ishte konsoliduar në përmasa mjaft të gjera. Si shkrimtar diapazonesh të gjera kuptimore, ka kultivuar komedinë, melodramën, dramën historike, dramën me temën sociale, dramën e aksionit, dramën psikologjike, tragjedinë etj. Në saje të përvojës së pasur dramaturgjike, njëkohësisht ka gërshetuar elemente të llojeve të ndryshme dramatike dhe ka sintetizuar idetë

themelore universale. Nga tërësia e veprës së tij del e qartë porosia e caktuar humanitare. Mesazhi i veprës ka edhe vlerë informative dhe paraqet kuptimin e përgjithshëm të krijimit artistik. Veprimi dramatik, që përmban konfliktin letrar, zhvillohet në disa faza kompozicionale, siç janë: ekspozicioni, thurja, kulminacioni, peripecia dhe zgjidhja. Autori u është përmbajtur këtyre ecurive të organizimit të subjektit dhe vetë zhvillimit të veprimit. Rela është njohës i mirë i këtyre parimeve në aspektin teorik dhe të praktikës krijuese. Personazhet e veprës dramatike në skenë paraqiten në marrëdhënie të caktuara midis tyre dhe, në bisedën që zhvillojnë, me veprimet e tyre krijojnë situata të shumta dramatike. Duke shfaqur pikëpamjet e veta dhe duke vepruar në kuadër të zhvillimit të ngjarjeve, realizohen si karaktere. Rela shquhet ndër dramaturgët më të njohur të etapës së parë të zhvillimit të letërsisë shqiptare. Ai është njohës i mirë i ligjshmërive të krijimit të dramës dhe të shfaqjes së saj në skenë.

KOMEDITË E RELËS

Veprat e para të Josip Relës janë komeditë: "Lundërza e Jozhës", "Sot tetë ditë" dhe "Provat". Këto janë krijuar në etapën e parë të veprimtarisë letrare, kur autori si mësues në viset e Dalmacisë, organizonte shfaqjen në skenë të pjesëve të ndryshme dramatike, merrte pjesë si aktor, apo edhe krijonte tekstet e para në lëmin e komedisë në gjuhën serbokroate. Qëllimi i autorit ishte i qartë: të ngjallej jeta kulturore dhe të argëtohej masa e shikuesve. Në këto komedi janë trajtuar tema të llojllojshme dhe në këtë mënyrë janë përqeshur disa veti negative të njerëzve dhe dukuri të rrethit më të gjerë shoqëror. Autori nuk kishte pretendime më të mëdha letrare, sepse ende nuk kishte fituar përvojën e duhur dhe mjeshtërinë artistike. Konflikti i komedive zë fill dhe zhvillohet nga situatat komike. Në aspektin e përmbajtjes trajtohen tema të rëndomta, shtrohen probleme aktuale dhe mjaft interesante. Mënyra e shtjellimit të tyre nuk është novatore, megjithatë zgjon interesimin e lexuesve dhe të shikuesve. Gjuha e komedisë është e kuptueshme, e pasur me shprehje popullore dhe me leksik të pasur, që i përgjigjet veprës skenike.

Rela ka synuar që nëpërmjet elementeve komike të arrijë efekte artistike. "Komikja ose karakteri komik i ngjarjeve paraqiten në mënyra të ndryshme në jetë e prandaj pasqyrohen në forma të ndryshme edhe në art... situatat qesharake, absurde por të ndreqshme shkrimtari i vesh me petkun e humorit".[61]

Njoftimet e para për komedinë "Lundërza e Jozhës" i ka dhënë vetë autori, ndërsa më vonë edhe bashkëkohësit e Relës: Niko Karuc[61] dhe Josip Peroviqi. Në autobio – bibliografinë e vet Rela ka shkruar: "Në Zarë e shkroi të parën pjesë teatrale për të rinjtë "Lundërza e Jozhës, të cilën e realizuan në skenë amatorët arbëneshë (studentë) më 1919, në shtëpinë e të vllait të ish regjentit mbretnor, Ivan Peroviqit (arbënesh) dhe në Vinjerc"

Në një letër të Josip Peroviqit, i cili si aktor kishte luajtur një rol të veçantë të kësaj komedie, janë dhënë sqarime lidhur me organizimin e shfaqjes. Niko Karuc, njohës i mirë i traditës kulturore dhe politike të arbëneshëve, ka shkruar: "Në dimrin e vitit 1920/21 në lokalet e dikurshme të Leximores kroate është shfaqur për karneval pjesa teatrore "Lundërza e Jozhës" me këngë dhe me përcjellje të instrumenteve muzikore. Tekstin kroat e ka hartuar mësuesi Josip Vlladoviq – Relja; pjesën muzikore e ka komponuar dhe e ka ushtruar Shime Deshpali. Përmbajtja ka qenë nga jeta e fëmijëve në Vinjerc. Sipas letrës së Josip Peroviqit të 1.XII.1967 – i cili ka luajtur rolin dhe ka kënduar rolin kryesor në shfaqje, kanë marrë pjesë shumë njerëz nga Arbëneshi".[62]

Përmbajtja e komedisë përfshin ngjarjet që zhvillohen në një katund buzë detit. Në skenë recitohen shumë poezi dhe këndohen këngë të ndryshme. Peshkatari i vjetër, Jozhea, dhe vehtjet e tjera, siç janë: Marea (gruaja e Jozhës), Mësimdhansi, Janja (shërbëtorja e shkollës), pesë nxanës, vallëzues e vallëzuese dhe djem e vajza. Skena është interesante: "Kur perdja ngrihet ne sqenë, ende mbretnon terri. Ndihen të lehunat e qejve, të pallunat e lopave, blegrimet e deleve, këndimet e gjelave dhe cicrrimet e zogjëve... Nënvizohet vallëzimi i

[61] Fjalor shpjegues i termave të letërsisë, Tiranë, 1972, f.115

[62] Niko Karuc:"Prilozi iz novije prošlosti zadarskih arbanasa", "Z.revija", Zadar,1968, nr.3, f.247.

"zanave', dhe ndihet melodia e kandshme. Kur plasë agimi, "zanat" tresin..."

Plaku Jozhea shumë vjet i ka kaluar së bashku me lundërzën dhe është i dashur nga të gjithë njerëzit. Në kohën e pleqërisë është shumë i shqetësuar shpirtërisht. Kujton të kaluarën, kohën e rinisë, argëtimet... Një disharmoni midis asaj që ka përjetuar dikur dhe asaj që përjeton tani i moshuar. Jeta ka ndryshuar, por edhe njerëzit. Plaku kërkon qetësinë dhe prehjen në kujtimet e dashura.

Mosmarrëveshjet me gruan, me rrethin ku jeton dhe sidomos me fëmijët, krijojnë situata komike. Kjo i nxit shikuesit të qeshin dhe të argëtohen. Jozhea ruan me xhelozi lundërzën dhe qenin. "Lundërza teme! Po, u plak nji grimë, flet peshkatari, por gjithmonë asht e re, edhe nëse nuk asht e ngjyem me bojna të bukura, edhe nëse asht e blert, prej barnash të detit, gjithnji e due shum, gjithnji e adhuroj, gjithnji për dit i këndoj ".(Këndon):

"Lundër, lundër, lundëro
I blert temi zabel-o
Mbane, shpjere, rueje
Jozhen plakun peshkatar".

Konflikti i komedisë buron nga situatat komike që shfaqen në bisedat dhe në veprimet e Jozhës dhe të nxënësve. Fëmijët shpesh herë ia marrin barkën peshkatarit dhe luajnë me të. Autori spikat rolin edukativ të mësuesit dhe të shkollës në përgjithësi. Ballafaqimi i të vjetrës me të renë qet në pah komiken dhe porosinë morale. Në këtë komedi gërshetohen përmbajtje nga poezia popullore dhe në këtë mënyrë evokohet arti poetik i arbëneshëve. Vargjet e poezisë "Këndon zogu, zog mullinja" zgjojnë dashurinë e tyre ndaj vendlindjes, ndërsa jehona e saj prej s' "largut" krijon atmosferën gazmore.

Në aktin e tretë mësimdhënësi arrin t'i pajtojë plakun dhe nxënësit dhe kështu, kënga dhe hareja të gjithë i bashkon në jetë. Autori spikat rolin e rinisë për ardhmërinë:

"Lundra e vjetër do t'ringjallet

Mu me forca të rinis!"

Me këto vargje, por edhe me këngët e tjera zgjerohet përmbajtja e veprës. Kori i nxënësve, së bashku me njerëzit e tjerë, këndon himnin e rinisë dhe e përfundon me vargjet:

"Fatin, të botës s're
E dashtuna, ti na bje-
O, rini, rini! "

Vepra dramatike "Lundërza e Jozhës, me gjithë përpjekjet e autorit, nuk ka shënuar nivelin e duhur artistik. Në kohën kur është krijuar komedia, ky zhanër i poezisë dramatike nuk ishte zhvilluar sa duhet, prandaj edhe s'ishte afirmuar në përmasa më të gjera të letërsisë.

Komedia "Sot tetë ditë", krahasuar me veprën e mëparshme, në aspektin kompozicional është realizuar si një komedi e situatave komike. Autori ka ndjekur gjurmët e komediografit kroat, Marin Dërzhiqit. Në të tri aktet e komedisë, dhe në kuadër të tyre në shumë skena, në një paralelizëm situatash, që nga fillimi dhe deri në fund, ka organizuar subjektin dramatik në mënyrë të rrjedhshme. Tetë vehtjet, siç i quan autori bartësit e veprimit dramatik, janë të moshës madhore, që nga 25 deri në 48 vjet. Ato janë: dy çiftet bashkëshortorë (Marko Dobriqi me të shoqen, Ursullën dhe Bare Gërgiqi me të shoqen, Zllatën), pastaj Dragani (i biri i Markos), Marija (e bija e Bare Gërgiqit), Ivani (shërbëtori) dhe Mara (shërbyesja). Ekspozicioni është mjaft i thjeshtë, ndërsa skena po ashtu shumë modeste: një dhomë e thjeshtë për pritje.

Situatat komike burojnë nga mosmarrëveshjet që shfaqen midis këtyre dy familjeve, dy të rinjve të dashuruar dhe të shërbëtorëve. Të gjithë këta luajnë rolin e tyre dhe vazhdimisht konfliktin letrar e mbajnë në nivelin e duhur. Në komedi nuk zhvillohen ngjarje të mirëfillta, siç veprohet në komedinë e karaktereve. Në vend të tyre, njëra pas tjetrës, radhiten situatat komike.Intriga, me të cilën realizohet thurja në veprën dramatike, bazohet në konfliktin jo edhe aq të ashpër, që shfaqet midis familjeve lidhur me dashurinë e dy të

rinjve. Ngarkesat e tjera sociale dhe morale të familjeve patriarkale, që shkaktojnë divergjenca të shumta, në këtë bazë përfshijnë në ndërlikime edhe personazhet e tjera. Rënia morale dhe sjelljet triviale të gruas manifestohen në situata të veçanta komike, gjithnjë për të theksuar karakterin humoristik të tekstit letrar. Shërbëtori dhe shërbyesja, duke vepruar në ambientet tipike, si edhe në veprat e komediografëve të tjerë shqiptarë dhe të letërsisë botërore, tregojnë aftësitë e tyre, zgjuarsinë dhe shkathtësinë, për të realizuar dëshirat e tyre, por edhe dashurinë.

Vepra "Sot tetë ditë" përfundon me një hepiend. Pas tetë ditësh organizohet dasma e përbashkët, si edhe martesa e Ivanit me Marën. Kjo komedi e situatës i shquan mirë komiken dhe intrigën, që kushtëzohen nga mosmarrëveshjet e njëpasnjëshme, nga moskuptimi dhe nga pakujdesia. Në këtë vepër skenike janë paraqitur mirë mentalitetet e ndryshme të njerëzve, shprehitë negative, veset dhe djallëzitë njerëzore. Njëkohësisht spikaten virtytet e larta morale dhe idetë e qëndrueshme dhe aq të domosdoshme për përsosjen e individit dhe të shoqërisë njerëzore.

Komedia "Provat" ka një histori interesante të krijimit. Gjatë periudhës dymbëdhjetë vjeçare, kur ishte drejtor dhe arsimtar i shkollës në Kashtel Novi, Rela ka qenë mjaft aktiv në jetën kulturore të atij mjedisi. Shkolla kishte shumë nxënës dhe bashkëpunonte me qarqet intelektuale dhe të rinisë. Rela udhëzonte grupet amatore për të përgatitur shfaqjet teatrore dhe asistonte në provat e tyre, duke qenë herë regjisor dhe herë aktor. Atij i interesonte, përveç të tjerash, drama dhe teatri dhe bënte përpjekje të vazhdueshme për të dhënë kontributin e vet arsimor dhe kulturor në atë lokalitet të rivierës së Dalmacisë. Për krijimin e kësaj vepre Rela ka shkruar: "Ma vonë shkroi edhe komedinë në tri akte "Provat", me përmbajtje nga jeta dhe përjetimet e vetë diletantëve në prova. Kjo komedi ndikoi aq pa fat, sa që krejt seksioni u shpartallue". Komedia nuk është botuar sa ishte gjallë autori.

Në ekspozicionin e kësaj vepre paraqitet edhe përmbajtja që zhvillohet në tri tablo dhe në shumë pamje. Koha është e tanishmja, ndërsa skena është e rëndomtë dhe e parregulluar. Vehtjet janë ato që

marrin pjesë në provat për organizimin e një pjese teatrore. Regjisori ka rolin kryesor, prandaj nëpërmjet tij paraqitet vetë shkrimtari. Në bazë të një skenari të pa definuar plotësisht, zgjedh aktorët, secilit i cakton rolin adekuat, jep udhëzimet për të realizuar koncepcionin e vet të regjisë, përshtat tekstin e hartuar, kujdeset për skenografinë, për kostumografin dhe për çdo gjë tjetër. Aktorët: Protagonisti (Personi i dyshimtë), Primadona – Mara, Dona II – Jugana, Dona III – Madama, Dona IV – Gruaja, Dona V – Jevga, I pari njeri i martuem – Stojani, I dyti njeri i martuem – Shërbëtori, Nji djalosh – Dhandri fisnik, Vicko – Shërbyes dhe Sufleri, jo vetëm që përgatisin rolet e tyre, por manifestojnë prirje më të ndryshme dhe shfaqin pikëpamjet e veta lidhur me ecurinë dhe suksesin e provave. Rela ka shfaqur bindjen e vet se, angazhimi që bëhet për realizimin e shfaqjes në skenë të një vepre dramatike kërkon talent dhe përkushtim të jashtëzakonshëm në punë. Situatat komike në të cilat ndodhen të gjithë pjesëmarrësit në prova, deri në kohën kur çohet perdja, për të filluar shfaqja e komedisë, janë të llojllojshme. Nga fjala e regjisorit kuptohet mirë se sa e vështirë dhe me përgjegjësi është puna e aktorëve, e regjisorit dhe të gjithë personave të tjerë, të angazhuar në teatër. Provat dramaturgjike të Josip Relës do të vazhdojnë në një proces të gjatë të krijimtarisë për shumë vjet me radhë, deri në vdekjen e shkrimtarit.

MELODRAMA "MARTESA"

Mbas një çerek shekulli të qëndrimit larg vendlindjes Rela është kthyer në Arbënesh dhe e ka kuptuar më mirë se çfarë ndryshimesh kishin ndodhur në jetën e bashkatdhetarëve të vet. Malli i pashuar dhe dashuria ndaj vendlindjes e nxisin edhe më shumë për të punuar gjithnjë për arsimimin e brezit të ri dhe për të ngjallur jetën kulturore. Si krijues i afirmuar, me poezinë e krijuar më parë dhe me komeditë e shfaqura, i lind ideja, e cila më vonë është kristalizuar plotësisht, që veprat e tjera letrare t'i krijojë në gjuhën e gjallë të arbëneshëve. Nga dorëshkrimet e Relës mësojmë se veprën e re dramatike "Martesa" kishte filluar ta krijojë që nga gjysma e dytë e viteve dyzet. Veprën e krijuar në disa fragmente, ua lexonte bashkëpunëtorëve të vet dhe

kishte dëshirë të dijë vlerësimin e tyre për veprën dhe sidomos për gjuhën e përdorur. Në tetor të vitit 1950 vepra ishte e përfunduar dhe ishte bërë e njohur në mesin e arbëneshëve. Para se të botohej, më 1952, me këtë vepër letrare ishin njoftuar edhe disa qarqe letrare dhe shkencore.

"Martesa", *e luajtuna në katër ndolina*, është krijuar me synimin e autorit që te arbëneshët të ngjallet ndjenja patriotike. Para se te jepeshin elementet e para të ekspozicionit, Rela ka shkruar: "Në kujtim të gys së nanës" Nga ky tekst dramatik, që është shfaqur në skenë, arbëneshët kanë mësuar se çfarë ka qenë dikur dhe çfarë është aktualisht e folmja e tyre. "Puna ndodhet në Arbënesh rreth 1890". Është kjo koha e fëmijërisë së autorit, prandaj edhe gjuha që është përdorur atëherë. "Martesa" është vepra e parë e botuar në gjuhën shqipe të arbëneshëve dhe, si e tillë, ka vlerën letrare dhe gjuhësore. Teksti është i shkurtër dhe me rastin e shfaqjes në skenë plotësohet me interpretimet muzikore. Këngët dhe muzika përshtaten sipas kërkesave të regjisë dhe të teatrit në veçanti. Si zhanër letrar i përket dramës, ndërsa në aspektin e mënyrës së organizimit të subjektit ka veçori të melodramës. Ky lloj letrar dramatik gërsheton tekstin me elementet muzikore vokale dhe instrumentale, me ato të vallëzimit dhe të baletit. Melodrama shpesh herë shndërrohet në vepër operistike dhe shfaqet në skenë.

Në këtë vepër Rela ka trajtuar temën sociale dhe në kuadër të saj ka përfshirë përmbajtje më të gjerë. Poezitë e krijuara, të përshtatura dhe poezitë popullore të Arbëneshit, i japin veprës një kolorit të pasur artistik. Koncepti i autorit për krijimin e melodramës në kuptimin pozitiv është mjaft i thjeshtë. Vehtet, si i quan personat që luajnë rolet, "punojn" dhe në ndodhinat e në "pouma" veprojnë dhe shfaqin pikëpamjet dhe botën shpirtërore të tyre. Qysh në fillim të veprës është dhënë fizionomia fizike dhe morale e përfaqësuesve të dy familjeve, të cilat i lidh në mes veti martesa e dy të rinjve, siç janë Vana dhe Pimi.

Prindërit e Vanës, si edhe tërë familja, dëshirojnë ta martojnë vajzën me Makun, djalin e një pasaniku. Në këtë mënyrë do të sigurohej pozita e favorshme shoqërore dhe ekonomike. Vana, e dashu-

ruar në Pimin, i cili është punëtor i varfër, dëshiron ta realizojë dashurinë e sinqertë. E frikësuar se ndoshta prindërit do ta fejojnë dhe pastaj do ta martojnë pa pëlqimin e saj, largohet nga shtëpia dhe kurorëzohet me të dashurin e saj. Çifti bashkëshortor, pas të gjitha këtyre ngjarjeve, sipas traditës, kërkon bekimin nga prindërit e Vanës. Martesa me pëlqimin e dy familjeve sjell gëzim të madh. Me këngë e valle të dasmorëve, të djemve, të vajzave dhe të fëmijëve, përfundon edhe pamja e tetë e ndodhimit të fundit. Kori e bën edhe më solemne ceremoninë e martesës dhe këndon këngën "Lulzon lulja":

"*Lulzon lulja me shpi të bukur*
Lulzon lulja në prende të nanës,
Lulzon lulja për sy të tatës
Kur lulzue thojti tatës
Kur lulzue thojti nanës:
Çilli derat tat i dashtun
Nek poj diellin e birbillin,
Nek poj të lemin e kaptimin,
Nek poj djalin e pakzimin.
I çill derat tat i dashtun,
Iku lulja me birbillin,
Iku vajza me djalloçin! "

Në aspektin kompozicional vepra "Martesa" ka të gjitha fazat e mbarështrimit të përmbajtjes, të cilat lidhen natyrshëm midis tyre. Në bazë të kujtesës, por edhe të njohurive që kishte për të kaluarën e arbëneshëve, pastaj duke u bazuar edhe në realitetin jetësor të kohës kur është krijuar vepra, autori ka përfshirë të dhëna të vlefshme për dasmën arbëneshe. Dimensioni kohor është relativizuar, ndërsa konflikti letrar dhe ndërlikimet e caktuara për këtë zhanër dramatik janë adekuate. Prania e pjesëve muzikore dhe e valleve është në harmoni me tërësinë e kësaj vepre artistike. Melodrama e shfaqur në skenë përcjell te shikuesit mesazhin më të plotë për jetën aktuale të arbëneshëve dhe për ardhmërinë e tyre.

Çështjeve të realizimit skenik, skenografisë, kostumografisë, zgjedhjes së formave përcjellëse muzikore etj., autori u ka kushtuar kujdes të veçantë. Rela i ka njohur mirë njerëzit, psikologjinë e tyre dhe ambientet ku janë zhvilluar ngjarjet. Krahas shqetësimeve njerëzore dhe reagimeve të ashpra, është spikatur mirësia, besnikëria, dashuria, mirëkuptimi dhe optimizmi jetësor. Motivimi në planin artistik i ecurisë së organizimit të subjektit, tipizimi i karaktereve dhe shpalimi i botës shpirtërore, janë në funksion të vlerës letrare.

Babai i Vanës, punëtor i pasur, shquhet me tiparet e fshatarit konservator. Nëna e saj është mjaft ambicioze. Ajo kërkon që dhëndri medoemos të jetë i pasur. Me përkushtim krijues autori ka paraqitur fizionominë fizike dhe morale të Vanës dhe të Pimit. Ata njihen më herët dhe së pari njëri tjetrit i kanë shfaqur simpatinë, ndërsa më vonë edhe dashurinë. Ndjenja e dashurisë së sinqertë shprehet nga vajza e re dhe e bukur edhe në këtë monolog të shkurtër: "Zembra m'ko me plas! Sh' u ndoli pe' mee? Si ma mori zembren? Si ma shpovi paqin? Fjalët te vlajt si më vravën".



Vehap Shita

Me rastin e botimit të parë të veprës "Martesa" Aleksandër Stipçeviqi, studiues i njohur shkencor nga Arbëneshi, ka shkruar një vështrim interesant dhe ka vënë në spikamë disa veçori të melodramës, rëndësinë e saj për kulturën shqiptare dhe disa aspekte të gjuhës së përdorur: "Për këtë melodramë opinioni ka dëgjuar më herët se ajo të jetë botuar. Qysh vitin e kaluar, nën udhëheqjen e vetë autorit, kanë

filluar ushtrimet për përgatitjen e saj, kështu që për të është ditur dhe është biseduar qysh moti në katundin tonë. Plani i parashikuar për shfaqjen e kësaj melodrame në skenë ka mbetur i parealizuar për arsye të ndryshme. Subjekti i "Martesës", siç shohim, nuk paraqet diçka të re në letërsi. Ajo që për ne arbëneshët është risi, është ajo fryma jonë tipike arbëneshe, të cilën autori në disa vende e ka fiksuar në mënyrë të shkëlqyeshme. Këtë e ka arritur më së miri në aktin e fundit në të cilin me mjeshtri janë përfshirë shprehje dhe një këngë popullore e dasmës, e vetmja që është ruajtur në popullin tonë. Ato shprehje të vjetra të cilat sot gjithnjë e më tepër po humben, të cilat ne të rinjtë në kohën e fëmijërisë i kemi dëgjuar nga gjyshet tona, ngjallin te ne dashurinë ndaj së kaluarës sonë, dashurinë të cilën ne qysh moti, nën ndikimin e rrethanave të ndryshme, e kemi humbur".

Vepra dramatike "Martesa", me veçoritë ideoartistike të një zhanri specifik letrar, shënon një fazë të re të krijimtarisë letrare të Josip Relës. Kjo kthesë e veprimtarisë në gjuhën shqipe ka qenë vendimtare për afirmimin e këtij shkrimtari në letërsinë shqiptare. Me veprat letrare të plakut të Arbëneshit, të Shime Deshpalit etj. shtohet edhe një rrjedhë e letërsisë sonë bashkëkohore.



Foto: Laura Hasani

KAPITULLI X

TRAJTIMI I TEMËS HISTORIKE

DRAMA “NITA”

Tematika historike në veprën e Relës ka shtrirje më të madhe, sidomos në dramat "Nita" dhe "Vampiri". Në të parën trajtohet tema historike e shpërnguljes së arbëneshëve nga atdheu i parë në Arbënesh të Zarës. Në këtë dramë gërshetohen elemente të përmbajtjes historike me ato të jetës sociale – shoqërore. Përfshihen ngjarjet midis viteve 1726-1729 dhe më vonë. Në dramën tjetër "Vampiri", që është e papërfunduar, autori merret me ngjarjet e kohës së Ali Pashë Tepelenës. Ideja e Relës ishte të krijojë një dramë interesante, ku posaçërisht do të paraqitej jeta dhe veprimtaria e Ali Pashë Tepelenës dhe epoka e tij. Aspekte të tjera të jetës së arbëneshëve janë paraqitur në krijimet e tjera dramatike, siç janë: "Kungulli", "Martesa", "Fisi i mallkuom", "Dila", etj. Autori temat e trajtuara në këto vepra i ka marrë nga e kaluara, që nga viti 1880 e këndej, dhe është përpjekur të paraqesë ngjarje dhe pamje të jetës, ashtu siç kanë ndodhur ato në të vërtetë. Shquhet posaçërisht prirja realiste për ta rikonstruktuar në planin artistik, në rrjedhat kryesore, jetën e kaluar. Mjaft mirë janë dhënë oshilimet e jetës shpirtërore dhe familjare, dramat e jetës individuale dhe kolektive, mentaliteti dhe psikologjia e bashkëvendasve dhe e njerëzve të tjerë. Në dy vepra të tjera: "Zani i fëmiut" dhe "Ik, Jak, ik" trajtohet tema e Luftës së Dytë Botërore. Drama e dytë më parë e kishte titullin "Nana". Në këto vepra letrare autori paraqet atmosferën

që ka dominuar gjatë atyre viteve të luftës në Arbënesh, por edhe më gjerë. Në dramën "Ik, Jak, ik" zgjerohet rrethi tematik, por edhe hapësira ku zhvillohen ngjarjet. Teksti dramatik përfshin aspekte të jetës dhe rrethanat ekzistuese në Kosovë, por edhe në viset e tjera.

Tematika aktuale e pasluftës është trajtuar me sukses në disa krijime dramatike të mëvonshme. Vepra "Në liri" shtjellon ngjarje të periudhës midis viteve 1948-1950. Ngjarjet zhvillohen në hapësirë më të gjerë: në ish Jugosllavi, në Bullgari, në Turqi dhe në vise të tjera. Në këto vepra gjithnjë është i pranishëm edhe arbëneshi, me vizionin e tij jetësor dhe me të gjitha tiparet me të cilat shquhet karakteri i tij.

Kjo shtrirje tematike mjaft e madhe në veprën dramatike të Relës është kushtëzuar nga interesimi i vetë autorit, që të kultivojë llojet karakteristike të poezisë dramatike: dramën, melodramën, komedinë, etj. Më dendur Rela ka trajtuar temën historike, temën e luftës dhe temën e jetës aktuale të pasluftës. Megjithatë, ky shkrimtar ka krijuar edhe dramën psikologjike. Temat e trajtuara nuk janë të ngjajshme dhe nuk përsëriten.

Larmia tematike, si edhe veçoritë e tjera ideoestetike, krijimtarinë dramatike të Josip Relës e bëjnë mjaft tërheqëse për lexuesit dhe shikuesit. Rela është treguar mjeshtër i mirë i krijimit të veprës dramatike. Mjeshtëria e tij letrare vërehet në shumë aspekte: në aspektin e zgjedhjes së temave, të organizimit të subjektit të veprës letrare, në prirjen realiste të tipizimit të personazheve dhe të ambienteve letrare, në ngritjen e konflikteve letrare, në fushëm e kompozicionit etj. Dramat më të realizuara artistikisht, siç janë "Nita", "Fisi i mall-kuom", "Ik, Jak, ik" etj., janë shumë të përshtatshme për t'u shfaqur në skenë. Posaçërisht i është kushtuar kujdes i madh përshtatshmërisë së shfaqjes në skenë të këtyre veprave. Rela ka dhënë elemente të shumta të skenografisë, të kostumeve etj., si edhe sqarime të tjera plotësuese për përgatitjen e këtyre pjesëve dramatike për t'u shfaqur më mirë në skenat e teatrove. Që nga vitet '50 dramat e tij janë shfaqur në skenat e teatrove tona pa ndërprerje.

Prirja e këtij dramaturgu për humor, për t'i kondensuar ngjarjet e paraqitura, për të paraqitur mendimin e vet lidhur me çështjet e shtruara, organizimi i suksesshëm i dialogjeve, si dhe fryma e për-

gjithshme realiste, e pranishme në krijimet letrare, janë veçori të tjera ideoartistike të krijimtarisë së tij letrare.

Në një vepër të vetme letrare autori përfshin shumë fakte dhe të dhëna të tjera dhe të gjitha janë të lidhura mirë në tërësinë kompozicionale. Shkrimtari arrin të realizojë ecurinë kompozicionale në etapat kryesore: ekspozicioni (paraqitja, prologu), thurja, kulminacioni, peripecia dhe shthurja. Respektohen dhe në shumicën e rasteve gjejnë zbatimin e tyre njësitë themelore të veprimit, të vendit dhe të kohës. Në këtë aspekt Rela përfill shumicën e elementeve të dramës klasike realiste, por nuk ngurron të përdorë edhe ato elemente funksionale të llojeve dramatike moderne. Të veçojmë, bie fjala, tiparet e dramës psikologjike dhe ato të dramës së karaktereve.

Galeria e tërë e personazheve të veprave dramtike të Relës është tipizuar në mënyrë realiste. Nëpërmjet tipizimit realist të personazheve dhe të ambienteve letrare, është paraqitur drama e arbëneshëve të Zarës dhe e popullit shqiptar gjatë periudhave të ndryshme historike dhe veçanërisht në rrethana të jetës aktuale pas Luftës së Dytë Botërore. Personazhet janë imagjinuar ose janë marrë nga historia jonë kombëtare.

Ndër dramat me temën historike, më të realizuara artistikisht të Josip Relës, shquhet "Nita". Kjo vepër është vlerësuar lart dhe konsiderohet ndër krijimet më të mira artistike të këtij lloji në letërsinë e sotme shqiptare.

Në këtë dramë katëraktëshe është trajtuar tema historike e shpërnguljes së arbëneshëve, në ato kushte të rënda historike dhe shoqërore të sundimit të egër feudal turk, gjatë viteve njëzet dhe tridhjetë të shekullit XVIII. Rreth kësaj teme historike Rela ka shkruar edhe një fejton me titullin "Arbëneshët e Zarës", ku është përpjekur të ndriçojë me vërtetësi shkaqet dhe pasojat e shpërnguljes dhe aspektet e tjera të jetës së kaluar të arbëneshëve në Dalmaci.

Ai ka shkruar: "S'ka dyshim se ata kanë ikur përnjimend nga atdheu i tyre. Kanë ikur nga votrat, fushat e veta, pronat e veta, kurse rrethanat i kanë shpurë në Zarë – pa vullnetin e tyre.

Pse kanë ikur? Ja disa shkaqe:

1) Vendlindja e tyre ka qenë njëfarë trekëndshi kufitar; në të vërtetë, veriu i Shqipërisë gjendej ndërmjet Turqisë, Malit të Zi, dhe Dalmacisë së Venedikut, madje pikërisht në anën e majtë të malit Rumia. Mali Rumia gjendet ndërmjet Deti Adriatik dhe Liqenit të Shkodrës. Edhe sot e kësaj dite atje gjenden, pranë Liqenit të Shkodrës, fshatrat Brisku, Shestani dhe Livari, nga të cilat kanë ikur arbëneshët. Vetë ky fakt, se kanë qenë në këtë trekëndësh kufitar, për atë kohë sillte pasiguri: sulmet dhe plaçkitjet nga njëra anë cytnin hakmarrjen e anës tjetër, qoftë edhe kundër popullsisë së pafajshme.

2) Vetë "haraçi" zyrtar turk ka qenë i rëndë dhe i padurueshëm. Mirëpo, "mileti" nuk mundte që, posë haraçit zyrtar, të mbrohej dhe nga kapadahitë turq: agallarët, bejlerët dhe pashallarët. Dihet për marrjen e vocrrakëve si jeniçerë, dhunimet dhe marrjen e vajzave për hareme, marrjen e krenëve më të mira të bagëtisë etj.

3) Perandoria turke luftonte asokohe me Persinë. Lufta nuk i shkonte mirë, ndaj mblodhi dhe mori njerëz për ushtri kudo, vetëm për të kënaqur nevojat në luftën kundër persianëve. S'do mend se këta njerëz janë marrë pa mëshirë dhe egërsisht.

4) Pikërisht në atë kohë përhapej sëmundja e rrezikshme, kolera, që vinte nga Lindja dhe i kanosej Perëndimit.

5) Pa pikë dyshimi, rolin e vet e ka lojtur edhe feja. Të gjithë këta arbëneshë kanë qenë të krishterë – katolikë, kështu që pos të gjitha halleve, po qe se jua mirrte mendja të evitojnë së paku ndonjërin nga ata, detyroheshin të ndërrojnë edhe fenë e vet, duke pranuar atë islame.

Për shkasin e drejtpërdrejtë, që i ka shtrënguar të ndahen nga votrat e tyre, t'i lënë të gjitha këto dhe të ikin, nuk dihet të thuash asgjë. Është e sigurtë, ndërkaq, se do të ketë ekzistuar ndonjë shkak i fuqishëm dhe i drejtpërdrejtë, i cili ka shtrënguar të marrin këtë hap më drastik, të lënë kulmet e veta dhe të ikin në drejtim të panjohur.

Autori i këtyne rreshtave, në dramën e vet "Nita", e cila bën fjalë për këtë ikje të arbëneshëve, si shkas për largimin nga trojet e veta paraqet frikën nga hakmarrja e turqve, për shkak të vrasjes së shërbëtorëve të bejlerëve, të cilët, me kërkesën e beut, rrëmbejnë vashën Nita, të cilën e shpëtojnë djelmoshat, duke mbytur rrëmbyesit.

Ky është rrëfim arbitrar i dramaturgut, por është afër mendsh se pikërisht ky i afrohet më së shumti së vërtetës së pamohueshme".[63]

Drama është krijuar në fillim të viteve pesëdhjetë dhe është botuar në vazhdime në katër numrat e revistës letrare "Jeta e re" të vitit 1954. Deri atëherë në Kosovë, përveç "Martesës" dhe "Kungullit" të Josip Relës, ishin botuar këto tekte dramatike: "Çarshafi" – vepër e Hasan Vokshit, "Bija e pengueme" e Tajar Hatipit, ndërsa në Shqipëri: "Prefekti", "Cani Hoxhë" dhe "Prefekti" të Besimi Levonjës, "Don Gjoni", "Halili dhe Hajria", dhe "Toka jonë" të Kolë Jakovës etj. Në krahasim me poezinë dhe me prozën, drama si krijimtari mjaft komplekse dhe e vështirë, në këtë fazë ka pasur zhvillim më të ngadalshëm dhe të kufizuar.

Ekspozicioni i dramës është mjaft interesant dhe paraqitet me invencion të rrallë:

NITA

– dramë me katër ndodhina –

Punojnë vetët:

PRENK VUKA		vjet 44
NITA, e bia		vjet 17
ZEFI I UCIT		vjet 21
GJON i SKENDERIT		vjet 60
MARK I UCIT		vjet 62
JAK PERAJ	pleqët – gjukuosat	vjet 58
DASH I PALIT		vjet 52
LUK KAPETANI		vjet 48
ITHA, e shoqja e Gjonit		vjet 52
CANA, bia e Markut		vjet 18
ROZA, bia e Nik Lukës		vjet 17
PAL I JAK PERAJ		vjet 22
NIK I DASH PALIT	djelmët	vjet 23

[63] Josip Rela: Vepra II, Rilindja, Prishtinë, 1971, f.259–260.

MIMQI I GJONËS vjet 24
PRIFTI vjet 42
GJOV. KRISTOFOLI, Guv.i Arbënesh.vjet 46
Njerëz, gro, djelm, vajza, fëmi

Puna ndodhet
I ndodhim në Brisk 1726
II ndodhim në Arbënesh 1729
III ndodhim në Arbënesh tre muoj mas
IV ndodhim në Arbënesh dy muoj mas

NDODHIMI I PARË

Udhë-kryq në Brisk (në kra'inë të Shkodrës) Në nji onë shpia në mur të thotë, me derë në miecë. Pe onash të derës ko nji balku i vogël i ngusht. Pran shpie jarea për bakti me derë të qilët. Para shpie obori i rethuom me mur të vogël. Në tjetrën onë edhe nji shpi si kjo. Mas kësosh poen tjerat të derdhuna për në mal. Nërmjet sosh donjana mo e madhe e mo e bukur. Në fund moli.

Kaptimi i diellit nërmjed marcit e prillit. Ndien si blerojnë dhent, donji tinglim i këmonze të bereve. Donji'erë ndiet bërlykimi i lopës. Si puna shkon përpara gji mo mangut ndien zanjet të baktive, e nata shtriet.

Kur skena qilet ndien diku larg pesë - gjashtë krisma të kuburës.

Menjëherë pas botimit të dramës "Nita" Theatri Populluer Krahinuer ka paraparë shfaqjen e kësaj vepre në skenë. "Me premierën e kësaj pjese theatrale, ka shkruar Bal Coli / Ramiz Kelmendi /, ky ansambël do të shënojë të dytën dramë origjinale në listën e repertoarit të vet kombëtar... të dyja këto drama i kunorizoi me të tretën – "Nitën", e cila asht, të thuesh, sinteza e mbarë veprimtarisë së tij dramaturgjike deri sod... Ma në fund, "Nita" pati fatin e bardhë dhe

hyni në repertoarin e parapamë për këtë sezonë. Mirëpo, menjiherë mbas këtij vendimi u shtrue përpara nji "problem": si me e luejtë në sqenë dramën e Reljës, e cila asht shkrue në të folmën e Arbëneshëve të Zarës?". Në vazhdim të këtij reagimi Kelmendi kundërshton dilemën e shfaqur për realizimin në skenë të "Nitës" dhe sjell një fragment të dramës, për të argumentuar se ky tekst dramatik pa pengesa mund të shfaqej në skenën e teatrit. "Mendimi im e i shum të tjerëve, shkruan Kelmendi, me të cilët kam bisedue, asht, që "Nita" duhet luejtë ashtu si asht shkrue! E shkrue asht shqip. Madje me nji shqipe, e cila të kënaqë shum ma tepër se ajo e disa pjesëve të përkthyeme e të luejtuna deri tash në të njajtën sqenë. Sepse e foluna e "Nitës" t'evokon të folmen e të parëve tanë para disa qind vjet-shash".[64]

Çështjen e shfaqjes në skenë të dramave të Relës e ka shtruar edhe Vehap Shita. Ai ka shkruar: "Për "Nitën" e Relës asht folë shum herë dhe asht shkrue në shtyp se paraqet nji prej të mbërrimeve të para me vleftë serioze letrare artistike të dramaturgjisë sonë që po vjen tue shtrue themelet e veta. Dari vonë, edhe "Nita" si edhe dy dramat e tjera të Relës "Martesa" dhe "Kungulli" patën ngelë disi në harresë, si mos me pasë qenë fare, për të vetmën arsye se shumkush prej atyne që duhet t'u jepte jetë këtyne në sqenën e vet rrudhshin krahët tue mejtue se dramat e Relës nuk mund të luhen për shkak të dialektit t'Arbëneshëve të Zarës që, âsht "i pakuptueshëm" për publikun tonë. Por, ajo që ndodhi në Festivalin krahinuer të teatrave amaterë në Gjakovë, i përgënjeshtroi të gjitha".

Në festivalin e tretë krahinor të teatrove amatore, që është mbajtur në Gjakovë, që nga 22 deri më 26 dhjetor të vitit 1954, Theatri i Pejës, ka shkruar Vehap Shita, është paraqitur me shfaqjen e dramës "Nita". "Me çfarë duertrokitjesh frenetike e përshëndeti p.sh. publiku i Gjakovës mbarimin e aktit të parë të dramës "Nita" n'interpretim t'ansamblit shqiptar të Theatrit amater të Pejës! Me këtë rasë thuese dallohej në fytytrën e secilit shiques se si po e përjetonte

[64] Bal Coli: Disa fjalë para paraqitjes së dramës "Nita" në Theatrin Populluer të Krahinës, "Jeta e re", Prishtinë, 1954, nr.6, f.561.

fatin tragjik të nji popull që, i shtrënguem prej terorit e dhunimeve të pushtuesit

turk, u detyrue me lanë plang e shtëpi dhe me marrë "dynjanë në sy" për me gjetë strehim".[65]

Drama "Nita" për herë të parë, si premierë e pestë e vitit 1955, është shfaqur në Teatrin Populluer të Prishtinës të dielën më 18 mars. Vepra e Relës entuziazmoi lexuesit dhe shikuesit dhe mbeti gjithnjë aktuale për t'u shfaqur në të gjitha skenat profesioniste dhe amatore. Në gazetën "Rilindja" të datës 24 mars Vehap Shita shkroi një vështrim shumë interesant për dramën dhe për shfaqjen e saj të parë në Prishtinë. Këtë vepër autori e quan tragjedi lirike. Shita ka shkruar për përmbajtjen e veprës dhe ka dhënë këtë vlerësim për veçoritë artistike të saj:

"Megjithëse plot me elemente romantike, "Nita" e Relës asht dramë realiste, e teksti i pasun me nji varg figurash të bukura artistike e ban veçanërisht magjepse. Por, ajo që "Nitën" e ngrit në radhët e krijimeve ma serjozë t'artit dramatik, asht akti i parë. Fjala, gjesti, muzika e kanga piklluese dhe çdo imtësi tjetër, janë aq të natyrshme, bindëse dhe reljefe, e ngjarja aq trondotëse dhe intenzive, sa që ato që zhvillohen ma vonë mbeten nën hijen e tij... thurja letrare e "Nitës", poezija në të shprehun dhe lirizmi me të cilin ajo asht e pasun e frymëzojnë njeriun dhe e nxisin me krijue nji çfaqje të madhe theatrale".[66]

Regjinë e kesaj premiere e ka bërë Abdurrahman Shala, ndërsa rolet kryesore i kanë luajtur artistët më të njohur të Theatrit Populluer të Prishtinës. "Nitën, këtë lule virgjine të nji dashunije romantiko – lirike, vajzën e re, të caktueme si prej fatit me vuejtë dhe me ra viktimë e zakoneve mbrapanike dhe paragjykimeve të kota, e interpretoi Mysherefe Preka me nji përjetim të thellë e plot akcente të nji loje të natyrshme..." Rolet e tjera i kanë luajtur: Shani Pallaska, Xhevat Qena, Leze Spaçi, Shaban Gashi, Katerina Josipi, Malo Gami, Masar

[65] V. Shita: Josip Vlladoviq – Rela, "Nita", "Jeta e re", Prishtinë, 1955, nr.1 – 2, f.122.

[66] V. Shita: Dëshmi e përparimit t'artit theatral amater, "Rilindja", Prishtinë, 1955, 6 kallnuer.

Kadiu, Shaban Domi, Rexhep Kabashi, Mikel Balaj, Ahmet Qirezi etj. Muzika përcjellëse ishte ajo e Rexhep Mullajit.



Abdurrahman Shala

Këto fakte historike dhe të tjera, të përfshira në aktin e parë të kësaj drame, i ka zgjedhur dhe i ka paraqitur në kuadër të përmbajtjes më të gjerë të dramës, duke dhënë kështu frymëmarrjen e kohës. Fshatarët e varfër shqiptarë kanë lënë trojet e tyre të para dhe marrin në sy rrugën e shpërnguljes dhe të shpëtimit. Kjo shkakton pikëllim të thellë te njerëzit, por edhe dramën tronditëse familjare dhe shoqërore. Zefi, i dashuri i Nitës, për shkaqe objektive detyrohet të mbetet në vendlindje dhe të përjetojë çaste të rënda të jetës. Pamjet e paraqitura në këtë akt janë tronditëse dhe në mënyrë të qartë, përveç të tjerash, spikatin idenë patriotike. Zefi, personazh i realizuar mirë në këtë dramë, pohon: "Trimat vdesin në luftë".



Katerina Josipi

Në vazhdim të dramës, në tri aktet e tjera, ku ngjarjet zhvillohen në Abënesh të Zarës, autori përfshin aspekte të tjera të jetës shoqërore aktuale të arbëneshëve disa vite pas shpërnguljes, dhe në këtë mënyrë zgjeron dhe thellon paraqitjen realiste të kundërthënieve shoqërore. Çështja e ruajtjes së traditës, e normave morale pozitive, dhe bashkë me të edhe kërkesa për zhdukjen e zakoneve të vjetra, që ishin bërë pengesë për jetën e re, bëjnë bazën e konfliktit të veprës dramatike. Me të drejtë autori ka insistuar që bashkëvendasit e tij të jenë gjithmonë krenarë për të kaluarën e tyre heroike dhe të lavdishme, të kultivojnë edhe më tutje dhe të përcjellin brez pas brezi virtytet pozitive: besën, trimërinë, dashurinë ndaj atdheut, urtësinë, normat morale që fisnikërojnë njerëzimin etj. Në të njëjtën kohë ai ngrit zërin që të zhduken nga jeta arbëneshe të gjitha ato dukuri negative dhe ato norma morale që ndikonin negativisht në emancipimin progresiv të shoqërisë. Në një plan mjaft të gjerë të vjetrës i kundërvihet e reja. Në ato kushte të vështira historike, sociale dhe politike, e reja depërtonte me vështirësi të mëdha. Ballafaqimi i dy kohëve, i dy botërave dhe i dy kahjeve në jetën si edhe në gjyqin e pleqëve, ku duhej të vendosej fati i Nitës dhe i Zefit, por edhe i brezave të mëvonshëm, nxjerr në shesh me mprehtësi dhe dramacitet antagonizmat e ashpra shoqërore. Kjo bën që konflikti letrar të hyjë në faza të reja të ashpërsimit më të madh dhe të ndikojë në mënyrë funksionale në tipizimin e personazheve, siç janë: Nita, Zefi, Prenk Vuka, Marku, Luk Kapetani, Prifti, Itha, Mimqi, Cana, Roza etj.

Nita, sipas zakonit të vjetër, për t'i mbetur besnike të dashurit të saj, Zefit, qe shpallur mashkull. Ajo bie viktimë e atyre kodeve të vjetra që edhe më tutje ruheshin nga pleqtë konservatorë dhe nga disa priftërinj fanatikë të kishës katolike. Meqë e vjetra me gjithë vrazhdësinë e vet kishte lënë vragë të thella në jetën e njerëzve, ndikon pashmangshëm edhe në vdekjen tragjike të Nitës. Duke mos gjetur shpëtim, ajo bën vetëvrasje dhe kjo është protesta më e ashpër që ngrihet kundër padrejtësisë dhe mykut shekullor. Ideja progresive dhe humanitare, që i hap shtigje së resë në përgjithësi, triumfon. Ajo në mënyrë të plotë thadrohet nëpërmjet veprimeve të personazheve pozitivë dhe sidomos nëpërmjet të fjalëve të Luk Kapetanit në gjyqin e pleqve. Argumentet e fuqishme që sjell Luk Kapetani dhe qëndrimi

i masës së gjerë kundër së vjetrës, detyrojnë pleqtë dhe priftin, që edhe kundër bindjes së tyre, të tërhiqen dhe të mposhten. Kërkesa e Nitës që t'i këthehet Zefit, pranohet para të gjithë njerëzve të pranishëm, por atëherë ishte shumë vonë. Kjo vajzë, siç thotë Rela, "... me nienja mâ të holla, pa dijtë se e ka lirue fajit L. Kapetani, dhe tue kuptue se vendasit kanë me e bâ të panderë, u vra. Po, u vra, por jo në binë. Vetëvrasja jasht bine nuk âsht aq e bindes. Por kur Zefi don përtëvërtetë me u vra (në binë), atëherë besimi caktohet. – Prapë sjellja e Zefit si njeri qi e bjerr arsyen kishte me mujtë me ba në publikë nji efekt të papritun...".

Zefi, në anën tjetër, edhe pse i pikëlluar pa masë nga lajmi i vdekjes tragjike të Nitës, gjen ngushëllimin te njerëzit që kishin përqafuar të renë në jetë dhe sidomos te Prenk Vuka. Autori i dramës "Nita" ka shikuar mundësinë që Zefi të hakmerrej kundër shkaktarëve të kësaj tragjedie. Rela ka shkruar: "Por, ku, dhe në kën? Në Prenkën, në pleq, në priftin? Prej tjetrës anë unë nuk gjej të faj as Nitën as Zefin. Jo, ata s'janë të faj! Fajtuer janë rezhimet, zakonat, rrethanat, shoqatat, kobi dhe nuk dij kush edhe por ata jo. Dhe nuk i kam dënue "unë" por këtu përpara të njehun! (Kush kishte me qenë i dënuem Zefi ma se Nita ndoshta kishte me u dashtë me e ndrrue emnin dramës?)".

Rela ka analizuar mirë veprimet e Zefit. Siç është e njohur nga drama, Zefi nuk bën vetëvrasje. Por ai ka qenë në atë gjendje emocionale, ta humbë arsyen dhe të bëjë vetëvrasje. Rela nuk pajtohet as me këtë rrethanë. Ai lidhur me këtë ka shkruar: "... me dënue Zefin me bjerrjen e arsyes… nuk ma merr mendja me u bashkue me këtë sugjerim. Megjithëse vetëvrasje e Zefit (e cila nuk zbatohet) mundet me u kritikue, gjithnji asht vetëvrasje ma e natyralisht se bjerrja e arsyes, sepse Zefi, djali i shëndosh, i fort, i cili ka sprovue shum të këqija, të cilit iu forcue karakteri... Këtyne nuk u mirret mendja ashtu lehtë si atyne që e kanë shpirtin të lëngueshëm dhe shumë të ndieshëm... Për të vërtetë ma mirë kishte me qenë kur të kishte me mujt me ba hakmarrjen "… Se shqiptarët nuk kanë gjithaq zakon me ba vetvrasje, sidomos për grue, dashtni...".

Në një letër dërguar Vehap Shitës, menjëherë pas shfaqjes së dramës, "Nita" edhe njëherë është shtruar çështja e përfundimit tragjik

të kësaj vepre dhe bashkë me të edhe disa aspekte të tjera të rëndësishme të procesit krijues. "Nitën" në kërkesë të Theatrit të Prishtinës, ka shkruar Rela, e kam përshtatue në gjuhën letrare... dhe kam pasë dëshirë me të porositë Ty me ja dhanë korrigjimin të fundit, por drejtori i theatrit u murre vesh me z. S. Rizën për këtë, ashtu se nuk deshta me thye këshillimin e tyne.

Shka takon sugjerimit yt për ndrimin e fundit të Nitës mujë të thom se ky – si edhe shumë piesë tjera – munden të kritikohen, dhe se me njiherë më kanë sugjerue me ndryshue fundin por në mënyrë ç'u duhente me dënue Zefin ma shum se Nitën (për shembull me bjerrjen e arsyes)...

Mue më duket se zbutja e ngjarjes mbas fjalësh të Lukë Kapetanit nuk guxon me ndërrue vendimin e protagonistit për arsye të thiesht: kurrkush s'ka pasë kohë me ja pru në dije zbutsimin (mendimin progresiv) e Lukës, dhe s'dytit: Ma efekt për shikuesa ka tragedia e saj bash për këtë. Ndoshta kishte me qenë ma në vend kur kishte me mujtë Zefi me marrë gjakmarrjen, por në kën? – Gjithnji në këte pikëpamje e pata ba nji ndryshim të vogël".

Në dramën "Nita" Rela ka shprehur dashurinë e madhe që ka pasur ndaj njerëzve, ndaj bashkëvendësve të vet, ndaj popullit shqiptar. Vepra është krijuar në çaste të frymëzimit të fuqishëm, prej këndej rrjedh edhe prania e mjaft elementeve të lirizmit të theksuar. Ndjenjat dhe idetë gërshetohen shumë mirë dhe sugjerojnë përmbajtje edhe më të pasur, domethënie më të gjerë dhe kuptimplote. Çdo detaj është dhënë në kuadër të tërësisë kompozicionale dhe ka funksion dhe efekt të caktuar në veprën letrare dramatike.

Kritka letrare e ka vlerësuar lart veprën "Nita", duke shquar veçoritë ideoartisike të kësaj drame të realizuar artistikisht. Në studimet historike letrare dhe në vështrimet kritike për këtë vepër, por edhe për aspekte të tjera të krijimtarisë letrare të Relës, autorët, siç ajnë: Rexhep Qosja, Ramiz Kelmendi, Vehap Shita, Ali D. Jasiqi, Nasho Jorgaqi, Aleksandar Stipçeviqi, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Sami Çabej, Esad Mekuli, Hasan Mekuli,etj., kanë dhënë vlerësime mjaft interesante.

Rexhep Qosja ka shfaqur mendimin vlerësues shumë afirmativ, duke shquar dramën "Nita" ndër veprat më të mira të dramaturgjisë shqiptare të kohës. Në veprën "Shkrimtarë dhe periudha" ka shkruar: "E shikuar prej një lagësie të duhur historike – qoftë edhe në kontekstin e tërë dramaturgjisë shipe – "Nita" e Relës mund të radhitet ndër dramat e suksesshme historike te ne deritani. Rela e ka provuar me të një prirje që në dramat e pastajme nuk do të jetë në gjendje ta dëshmojë, megjithë punën e pareshtur dhe përvojën e shtuar krijuese. Në të vërtetë, të gjitha fuqitë krijuese sikur janë derdhur në këtë vepër dhe as më parë, e as më vonë ai nuk është ngritur deri tek niveli i saj artistik".[67]


Sami Çabej në parathënien e botimit të "Nitës", të përshtatur në shqipen letrare, ka shprehur mendimin se: "Vepra që e bën plakun e Zarës më të njohur, sikur edhe e vetme të qe, është drama me katër akte "Nita". Kjo dramë, shkruar me pathos e forcë dramatike, është jehonë e fatit të rëndë të malësorëve të Veriut pas pushtimit të Shqipërisë nga turqit.

Autori, jo vetëm që njeh mirë epokën në të cilën vendos ngjarjet, por njeh mirë dhe depërton në shpirtin e këtyre njerëzve të thjeshtë, bujarë e trima, të cilët asnjëherë nuk iu nënshtruan armikut të egër... Autori ka merita në thurjen e skenave të gjalla, në mprehjen e dialogut, në dinamikën dhe harmoninë e veprimeve, në paraqitjen e tablove masive. Zakonisht çdo personazh ecën në profilin e vet, vizatohet në profilin e vet, në këtë ansambël të gjerë, spikat harmonia e figurave, e ndjenjave dhe e mendimeve e, përmes tyre, gjithmonë në rritje, ashpërsohen kontradiktat që e kanë zanafillën në botën social – psikologjike të këtyre njerëzve, në përputhje me frymën e kohës...

Nita është figura më e realizuar e dramës. Njomështia dhe freskia e ndjenjave, shpirti delikat dhe njëkohësisht i fuqishëm, dashuria e saj e pamasë për Zefin, babanë, shokët e shoqet, trimëria dhe besnikëria ndaj fjalës së dhënë, gëzimi i jetës, shpirti i sakrificës,

[67] Rexhep Qosja: Josip Vlladoviç – Rela, "Shkrimtarë dhe periudha", Prishtinë, 1975, f.220.

gjithë këto e të tjera tipare të botës së saj janë mishërim i gjallë i vetive të femrës shqiptare".[68]



Fotografia që i dërguan amatorët pejanë Relës më 1955
(Nga interpretimi i "Nitës")

Josip Rela ka merita të veçanta si autor i dramës "Nita", por edhe i veprave të tjera letrare. Trajtimi i temave të rëndësishme, përfshirja e problemeve të mëdha, zgjidhja e tyre me ndjenjë të hollë mase dhe në pajtim me synimet shekullore të masave të gjera, dramaciteti i brendshëm, tablotë e jetës shoqërore, familjare dhe individuale, paraqitja e botës së pasur emocionale të njerëzve, pra të personazheve letrare, spikatja e ideve progresive, tipizimi i personazheve dhe i ambienteve letrare në pajtim me kushtet dhe rrethanat ekzistuese, stili, gjuha e përdorur etj., janë tipare që e bëjnë veprën dramatike të ketë vlerë të lartë ideore dhe estetike. Në këtë aspekt veprat dramatike të Josip Relës, me të gjitha veçoritë e përmbajtjes dhe të formës artistike, paraqesin kontribut të çmuar në zhvillimin e dramaturgjisë sonë.

[68] Sami Çabej: Parathënie, në librin Josip Rela: "Nita", "Naim Frashëri", Tiranë, 1973, f.4 dhe 7.

HISTORIA E LAVDISHME E ALI PASHË TEPELENËS

Josip Rela e ka trajtuar temën historike edhe në dramën "Vampiri", në të cilën evokon historinë e lavdishme dhe tragjike të Ali Pashë Tepelenës. Këtë dramë autori ka filluar ta krijojë si një projekt serioz, në katër ose në pesë akte. Akti i parë i mbeti në dorëshkrim, ndërsa aktet e tjera nuk arriti t'i krijojë, prandaj nuk jemi në gjendje të supozojmë asgjë tjetër për përmbajtjen e tyre. Në dorëshkrimet e Relës nuk është gjetur material tjetër dhe as shënime të veçanta.

Si i lindi autorit ideja dhe si u kristalizua ajo pastaj, për ta krijuar këtë vepër dramatike, e cila, sikur të ishte përfunduar, do të radhitej ndër dramat më të suksesshme të Josip Relës?

Në shumë vepra historike dhe artistike, si edhe në shkrime të tjera të llojllojshme, janë paraqitur aspekte të ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë së Ali Pahë Tepelenës si njeri dhe burrë shteti. Ali Pashë Tepelena (1740-1822) ka qenë sundimtar feudal i Shqipërisë Jugore. "Lindi në Tepelenë në një familje feudalësh ushtarakë dhe u dallua shumë shpejt për aftësitë e tij dhe për energjinë me të cilën ndoqi planet e veta ambicioze për t'u bërë sundimtar i vetëm i vendit duke përdorur gjithë mjetet, dhunën, dinakërinë, po aq sa edhe lidhjet familjare me feudalët e tjerë vendas".[69] Kështu fillon shkrimi enciklopedik për këtë figurë të madhe të historisë shqiptare. Të dhënat e tjera ndoshta i ka njohur edhe Josip Rela. Ai në të vërtetë është mbështetur vetëm në të dhënat elementare të historisë së këtij personaliteti të shquar. Bashkë me dorëshkrimet e Relës është gjetur një artikull në faqen zbavitëse të "Rilindjes", në të cilën janë nënvizuar shumë fakte historike të biografisë së Ali Pashë Tepelenës.

Në fillim të këtij artikulli është shkruar: "Njeri që trazoi gati gjithë Evropën, njeri që e ngifshin gjithë sundimtarët e kohës së tij, njeri i madh e romantik, por edhe i pabesë, primitiv dhe të gjitha këto bashkë ishte Ali Pasha i Janinës ose Ali Pashë Tepelena". Në vazhdim Rela ka nënvizuar disa pjesë interesante të tekstit, siç janë: "kusar të maleve...

---

[69] Ali Pashë Tepelena, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985, f.1085.




Ali Pashë Tepelena, Vasiliqia, Bajroni 1809.
Kompozim Rakip Shabani

Nana e tij ishte helmuese... Motrën e kishte aq të egër, sa nuk flente në jastëk të mbushun me lesh, si të tjerët, por e mbushte me flokë të viktimave të vllaut të saj. Ali – pashë Tepelena ishte gjakatar?... Po përmendim vetëm mbylljen e motrës së tij... Gjyshin ia kishin mbytë Venedikasit në Korfuz në vjetin 1716 dhe i ati kishte ra si viktimë e avanturave të tij trathtare prej disa shokëve. Për këte, ai si jetim, andronte hakmarrje... Me trup ishte i vogël, por i madh e i fuqishëm. Gjithmonë ecte me nji varg koburesh në brez. Vishej si sulltan... Mbante nji harem grash dhe nji për fëmijë... Nji dervish i kishte thanë se ka zaptue Korfuzin dhe se ka me jetue 120 vjet... Mbas dy vjet lufte të pa preme, trathtisht e nxuerrën prej fortese dhe ma në fund me 5 fruer të vjetit 1822 ia prenë kryet".[70]

Supozojmë se Josip Rela për të krijaur dramën është nisur nga këto fakte. Në aktin e parë në subjektin e dramës këto të dhëna përfshihen si pjesë e përmbajtjes.

[70] Ali Pasha i Janinës, "Rilndja", Prishtinë, 1955, 11 Dhetuer, f.10.



Rela ndoshta e ka lexuar një dramë tri aktëshe të shkrimtarit Kostandin Kotte : « Shpërblimi i gjaksisë ».[71] Kjo vepër ka 108 faqe dhe shquhet me vërtetësinë historike të trajtimit të temës dhe të ngjarjeve. Personazhet e kësaj vepre janë : Ali Pasha Tepelena, Hankoja (e ëma), Emineja (e shoqja), Shanishaja (e motra), Ali Pasha Gjirokastra (i shoqi i Shanishasë, sundimtar i Gjirokastrës), Selman Beu (sundimtar i Delvinës), Selim Pashai, Stavroja, Seid Agai, Beqoja, Meteja, Lameja, Fatimeja, Merusheja, Kadiu, Një zë, Një zë i dytë, Një zë i tretë, Zëre, Trima.



Nga Arbëneshi i hershëm

[71] Kstandin Kote: "Shpërblimi i gjakësisë", Zara, 1929.

Autori sigurisht ka pasur mundësi të shfrytëzojë materiale të ndryshme historike, të shkruara në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera.

Në romanin e Sabri Godos "Ali Pashë Tepelena", në kapitujt ku paraqitet fëmijëria dhe koha e rinisë e Ali Pashait, është paraqitur fizionomia fizike dhe morale e Ali Pashait, e prindërve të Aliut: e Veliut dhe e Hankos, e Eminesë (gruas së tij), e Shanishasë (motrës së Aliut) dhe e personazheve të tjera. Godo, përveç të tjerash, ka shkruar:

"Në 14 vjeç, Aliut i vdiq i jati dhe ai filloi të merrej me kusari, se s'kishte ç'të bënte. Vidhte ndonjë kec, apo ndonjë plaçkë të vogël jashtë Tepelenës. Hankua thoshte se djalit nuk i duhej shkollë tjetër. Falë zotësive që tregoi, pa mbaruar të shtatëmbëdhjetat, ai kishte formuar një çetë, ku merrnin pjesë shumë përkrahës të shtëpisë. E ëma i tha se kardhiqotët e harmovitët qenë pasuruar duke ngushtuar pronat e Veliut. Djali tani duhej t'u binte atyre dhe kështu s'bënte tjetër veç t'u merrte natën ato që i kishin grabitur të jatit ditën. Aliu ra me çetën e tij në stane e në kryqet e rrugëve dhe bëri plaçkë të mirë. Në asnjë pritë nuk e futën në dorë. Atëherë ai kujtoi se ishte koha të kërkonte trashëgimin e të jatit e ta zgjeronte ca më tepër".[72]

Për fat të keq këtë material historik dhe letrar kaq të pasur Josip Rela nuk ka pasur mundësi ta njohë në këtë masë. Sido që të jetë, në bazë të informacionit mjaft të gjerë, Rela i është qasur krijimit të një vepre me temë historike, duke na lënë në dorëshkrim 12 faqe të aktit të parë, të realizuar me sukses të posaçëm.

Personat e kësaj drame të Relës janë: Zina (nana), Hajrija (e bija), Ali (i biri), Hana (grueja e Alit), Zogu (oficeri), Gabi (zezaku), Omi (dervishi), Omeri (rojtar), Beni (rojtar), Kalorësi etj. Në role episodike luajnë edhe lajmëtarë, vallëzues, ushtarë, lypës, diplomatë dhe shërbëtorë.

Ngjarja zhvillohet rreth vitit 1760. Skena ku shfaqen ngjarjet është mjaft karakteristike. Në skenat e para paraqiten Zina, Hajrija dhe Aliu. Zina, e ëma e Aliut, së bashku me vajzën dhe të birin, pas tragjedive të njëpasnjëshme, lufton për ekzistencë. Aliu ende ishte i ri,

[72] Sabri Godo: "Ali Pashë Tepelena", "Rilindja", Prishtinë, 1972, f.14.

ndërsa Hajrija në moshën më të bukur të vajzërisë. Zina u rrëfen atyre për jetën dhe tragjedinë e të shoqit, Veli beut: "Baba ka kenë i detyruem me u mba maleve... padrejtësija, ligji, ligji i padrejtë dhe me miqët e kanë përdhunua me shkua në mal, dhe me jetue në këto shkretina..."

Aliu zotohet për hakmarrje: "E unë po ju thom se të gjithë të cilët e ngritën shpatën mbi krye të babës do ta ndiejnë dorën, e cila u ka me ju marrë hakun...".



Pavle Deshpali

Në episodin vijues Aliu në një shpellë zbulon arin e mëshehur nga babai, bën plane për kthimin e pronave të plaçkitura nga të tjerët dhe për zotërime të reja. Hajrija dashurohet në Kalorësin, të cilin e takon papritmas dhe pas pak çastesh përjeton tragjedinë e vrasjes së të dashurit nga Aliu i rreptë. Ajo i lutet të vëllait me ngashërim, ta lejojë t'i marrë për kujtim flokët e Kalorësit të dashur. Plani i Aliut për mëshehjen e gjurmëve të vrasjes dhe kërcnimi i tij, që të mos flitej më për viktimën, detyron nënën dhe motrën të heshtin dhe të përqendrohen rreth realizimit të qëllimit të tyre të përbashkët. Zina e shpreh këtë me fjalët: "Për rrnimin ma të mirë tonë. Për jetesën ma të bukur t'Aliut, për fat bardhë jot e për lumtuni të zemrës seme...".

Në skenën e dymbëdhjetë dhe të trembëdhjetë paraqitet ndeshja e Aliut me disa lypës, të cilët më në fund i kërcënohen dhe e sulmojnë. Aliu i fuqishëm dhe i zhdërvjelltë, me ndihmën e Zogut (oficer), i shpartallon dhe i detyron të ikin. Në skenën e katërmbëdhjetë zhvillohet dialogu midis Aliu dhe Zogut. Të pranishme janë edhe Zina e Hajrija. "Zogu (shiqon Zinën, por shum ndalet tue shique në Hajrijen...).

Pasi hapet akti i dytë, Josip Rela arrin të tregojë kohën e zhbillimit të ngjarjes dhe elementet e skenës: "Pesë vjet mbas. Dera përpara fortese të fortë. Nata. Përpara dere kalon atje kanë rojsi. Pranë fortese uji – lumi".



Teatri i Operës dhe Baletit Koncert

Duke analizuar këtë fragment të dramës, vlerësojmë se autori ka ndjekur kronologjinë e zhvillimit të ngjarjeve historike. Kjo ecuri kompozicionale, në aktet vijuese dhe deri në përfundimin e dramës, do t'i mundësonte krijuesit të realizojë artistikisht një vepër interesante, me përmbajtje të gjerë dhe të pasur. Dialogët, monologu, si edhe mjetet e tjera shprehëse të dramës, do të shtonin dramacitetin e zhvillimit të ngjarjeve dhe me të gjitha këto do të arriheshin efektet e duhura artistike.

KAPITULLI XI

DRAMA ME TEMËN E LUFTËS

AKUZË KUNDËR LUFTËS

Temën e luftës Josip Rela e ka trajtuar në shumë krijime artistike. Ajo ka qenë burim i pashtershëm ku ka gjetur motivet dhe temat e ndryshme. Në dramat "Zëni i fëmiut" dhe "Ik, Jak, ik" ka ngritur zërin kundër luftës, pra kundër fashizmit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Shkrimtari ka mallkuar luftën pushtuese kudo që ka ndodhur. Ai e ka ndjerë veten të sigurtë dhe të shkathtë për t'i trajtuar këto tema komplekse të luftës, duke i gërshetuar ato me aspekte të jetës sociale.

Drama "Zani i fëmiut" është krijuar në fillim të viteve '60 dhe së pari është botuar në revistën "Jeta e re" në vitin 1963. Kjo dramë tri aktesh ka zgjuar interesimin e lexuesve dhe të shikuesve të shumtë. Ngjarjet zhvillohen në një katund larg nyjeve të komunikacionit. Ky lokalitet më shumë i përngjan vetë Arbëneshit, sepse është ambient ku jeton popullsia shqiptare e asaj ane dhe aty shprehen të gjitha kundërthëniet e shfaqura gjatë luftës. Është koha e pushtimit italian dhe e dhunës së egër ndaj banorëve të pafajshëm, të cilët dëshirojnë të jetojnë të lirë dhe me nder. Ata njëkohësisht i bëjnë rezistencë pushtuesit në forma më të ndryshme, dhe njëherit u kundërvihen edhe bashkëpunëtorëve të karabinierëve italianë.

Vehtjet e kësaj drame janë: Kitoa - tregtar, Lina - e shoqja e Kitos, Oficiali (italian), Sheboa - rrogtari, Gema - rrogtare, Marea, Nica, Rina, Tona, Krabinierat, Partizani, Nji plak, gra, fëmijë.

Akti i parë përfshin ngjarje të ndryshme gjatë luftës, të cilat edhe autori mund t'i ketë përjetuar në mënyrën e vet, prandaj i ka paraqitur me vërtetësi historike dhe i ka motivuar në planin artistik. Skena është e zakonshme dhe është fiksuar me mjaft elemente plotësuese: "Pjaca e nji katundit. Pe anash shtëpija. Përdhes të nji shtëpie, butiga e Kitos. Okupacioni. Nëpër hapsinë ndonjierë përbi donji fëmi, gruo ose ushtar italian. Visavi shtëpie ku rri Kitoa - shtëpia ku banon oficjali".

Jeta e njerëzve në kohë të luftës është paraqitur me realizëm. Ballafaqimi me luftën gjatë kohës së krizës së thellë, siç është e kuptueshme, qet në shesh ndryshime të mëdha dhe dramatike. Njerëzit vriten, përdhunohen, plaçkiten dhe masakrohen pa mëshirë. Vuajtja dhe mjerimi shoqëror kaplon shtresat e varfëra të popullsisë, godet pa mëshirë gratë dhe fëmijët. Njerëzit luftojnë për ekzistencë dhe bëjnë çmos për të siguruar kafshatën e bukës. Edhe në këto rrethana tragjike, përfitojnë nga vetë lufta tregtarët dhe njerëzit e korruptuar. Autori ka çjerrë maskën e këtyre njerëzve gjakpirës, të rënë moralisht dhe në çdo aspekt tjetër njerëzor. Nica, një grua e varfër, që bën përpjekje t'i shpëtojë fëmijët nga uria, i drejtohet Kitos: "Nuk dishroj me ju ofendit, zotni Kito, por kamatet, intereset të tua, na mjelin gjakun e na pijnë paqin të shpirtit...".

Kitoa është një personazh negativ, me të cilin lidhen gati të gjitha ngjarjet e dramës. Ai ka grumbulluar shumë pasuri dhe para dhe ka plaçkitur pa mëshirë njerëzit e thjeshtë. Duke shitur sa më shtrenjtë artikujt ushqimorë, duke përfituar nga kamata për paratë e huazuara dhe duke keqpërdorur njerëzit që ka në shërbim, shkakton shumë fatkeqësi dhe tragjedi njerëzore. Ai bashkëpunon në mënyrë perfide me pushtuesit fashistë dhe kështu përfiton pasuri më shumë se asnjëherë më parë.

Në dramën "Zani i fëmiut" autori paraqet aspekte të ndryshme të jetës sociale. Ashpërsia e luftës i qet në shesh edhe ato fakte jetësore dhe ato marrëdhënie të cilat, në kushte të tjera të jetës, nuk hetohen lehtë. Fatet njerëzore janë të ndryshme dhe në vitet e mbrapshta të luftës pushtuese, krimet shtohen si asnjëherë më parë.

Fillet e shthurjes morale në familjen e Kitos janë të hershme dhe me pasoja të rënda për tërë mjedisin shoqëror. Veprimet e tij kriminale shkatërrojnë jo vetëm familjen e tij, por edhe shumë familje të tjera. Lina, një grua e cila nuk respekton normat morale elementare, duke shkuar me oficialin italian, braktis të shoqin dhe fëmijën e saj ferishte. Gema, rrogtare, keqtrajtohet në mënyrë shtazarake nga patroni i saj. Ajo mbetet me barrë dhe si e tillë braktiset nga Kitoa. E shtyre me dhunë dhe e mashtruar, më në fund ajo detyrohet të martohet me Shebon, për ta ruajtur dhe rritur fëmijën e vet. Për ta shfrytëzuar edhe Maren, burrin e saj, Kiton, me dredhi e çon në ushtri. Në mënyrë perfide ky njeri mashtron dhe plaçkit edhe bashkëvendësit e tjerë, gra dhe burra, vetëm e vetëm për të shfryrë urrejtjen që ka ndaj njerëzve të pafajshëm dhe për të kënaqur tekat e veta të një krimineli ordinar.

Veprimet e paskrupullta të Kitos si edhe krimet e paramenduara mirë, e shtyjnë Marën të hakmerret dhe ta vrasë këtë "qen njeri". Këtë vrasje në çastin kritik e eviton vaji i fëmijës tremuajshe, pra zëri i tij i papritur. Mara heq nga dora thikën dhe largohet. Kitoa asaj i drejton revolen për ta vrarë në vend, por atë e pengon partizani, i cili hyn në dhomë në këtë çast kritik dhe e çarmatos këtë vrasës faqezi.

Ishte koha kur fashistët italianë kishin braktisur vendin dhe partizanët kishin marrë përsipër qeverisjen edhe të këtij mjedisi. Nga fundi i dramës mbetet të kuptohet se kriminelët si Kitoa dënohen me drejtësi dhe ashpërsi nga gjyqi i popullit.

Prirja e autorit, që në mënyrë realiste të paraqesë fizionominë fizike dhe morale të gruas, ka bërë efektet e duhura dhe ka zgjeruar përmbajtjen e dramës. Derisa Lina, që i përket një shtrese të pasurish, insiston me ngulmë të ndjekë jetën mondane, Nica, Gema, Rina, Marea etj., duke u ballafaquar me probleme të ekzistencës njerëzore, qëndrojnë të paepura, për të ruajtur medoemos fëmijët, familjet e tyre dhe dinjitetin njerëzor. Ato, si të tilla, janë shumë të lidhura me familjen dhe me përkushtim të madh kryejnë obligimet e shumta, shpesh herë duke zëvendësuar edhe meshkujt në punët e shtëpisë.

Në aspektin kompozicional Rela ka ndjekë ecurinë e kompletimit të fazave të natyrshme të zhvillimit të ngjarjeve. Porosia morale

spikatet me forcë emocionale deri në përfundimin e dramës. Rela ka synuar gjithnjë të ngadhënjejë e mira mbi të keqën dhe të përsoset jeta njerëzore.

Autori ka përdorur gjuhën e folur ndër arbëneshët e Zarës. Për të individualizuar personazhet, ka përfshirë shumë fjalë të huaja, sidomos të italishtes. Në "Fjalorthin", që është dhënë si shtesë në fund të dramës, shumë fjalë janë shpjeguar, duke u dhënë trajtat sinonimike, emërore dhe foljore.

DRAMA "IK, JAK, IK"

Ndër dramat më të suksesshme me temën e luftës konsiderohet vepra "Ik, Jak, ik", e cila i përket fazës së fundit të krijimtarisë së Josip Relës. Derisa në dramën e mëparshme ka trajtuar ngjarjet që kanë mundur të ndodhin, apo që kanë ndodhur në vendlindjen e shkrimtarit gjatë luftës së fundit, në këtë vepër të mëvonshme ngjarjet janë vendosur në një qytezë të Kosovës. Si ngjarjet e luftës, po ashtu edhe personat, siç i quan personazhet, janë të imagjinuara. Gjatë vizitave në Kosovë Rela kishte njohur më mirë gjendjen aktuale dhe të kaluarën e Kosovës. Përshtypjet e udhëtimit nëpër vise të ndryshme, në qytete, në katunde dhe në vendet e njohura historike, i kishin lënë përshtypje të jashtëzakonshme. Po ashtu autori ka njohur më mirë gjendjen sociale dhe pozitën politike të Kosovës. Zgjedhja e temës së luftës për Relën, për ta trajtuar në një vepër skenike, ka qenë orientim me efekt të caktuar. Në këtë mënyrë dëshmohej pjesëmarrja e shqiptarëve të Kosovës në Luftën e Dytë Botërore kundër fashizmit. Në fillim drama kishte titullin "Nana". Në një intervistë për këtë dramë të re Rela ka pohuar: "Krejt çka kisha mundë tash me ju thanë për te asht mallkimi i luftës dhe zani kundër ringjalljes s'asaj kulshedre t'egër... lufta nuk mund të kufizohet. S'asht e randësishme se ku janë pushkatue me mija njerëz, ku janë rrënue qytetet, ku janë çmendë nanat. Por nuk asht e thanun se ngjarja nuk asht e lidhun me Arbëneshët e mij aq sa edhe me njerëzit e meridianeve të ndryshme gjatë

luftës. "Nanën" jam tue shkrue në gjuhën letrare shqipe dhe do t'ia ofroj Teatrit krahinor në Prishtinë deri në fund të këtij viti".[73]

Siç është e njohur, për të arsyetuar masat diskriminuese ndaj popullsisë shqiptare, mohohej kontributi i popullit shqiptar në Luftën Nacional Çlirimtare dhe ai "akuzohej për bashkëpunim të hapur me fashistët". Prandaj, në këtë vepër dramaturgjike, si edhe në shumë krijime të tjera artistike, motivet dhe temat e luftës kundër fashizmit janë trajtuarr në gjerësi mjaft të madhe.

Ekspozicioni i dramës është mjaft konkret dhe funksional. Personat e kësaj drame, që ka katër akte me shtatë figura, janë: Gjoni (baba), Drita (e shoqja), Antoni (biri), Lulea (bija), Jaku (biri), Zaimi (miku i Antonit), Ademi (axha), Prifti, Kola (miku i Jakut), Oficeri (gjerman), Dy-tre ushtarë, Njerëz, Gra.

Skena paraqet ambientin qytetar të nji familjeje intelektuale: "Dhoma e pritjes në shtëpi qytetare. Tryesa me karika. Biblioteka. Nëpër tryes sende msimit. Okupacioni. Kur perdja ngrihet", në figurën e parë janë të pranishëm Gjoni dhe e shoqja, Drita.

Rela ka qenë shkrimtar i talentuar dhe gjithnjë është përpjekur që zhvillimin e ngjarjes ta fillojë dhe ta vazhdojë në mënyrë të natyrshme. Rrëfimet dhe dialogët në tekstin dramatik janë të drejtpërdrejta dhe të rrjedhshme. Çështjet e mëdha i ka vendosur në plan të parë dhe pas tyre, me invencin të rrallë janë paraqitur edhe problemet e tjera, që sajojnë përmbajtjen e veprës si tërësi të plotë kompozicionale.

Që në fillim tensioni dramatik i zhvillimit të ngjarjes është mjaft i lartë. Çifti bashkëshortor, si edhe tërë familja, ballafaqohet me probleme ekzistenciale të jetës së rrezikuar gjatë viteve të luftës. Ushtria gjermane kishte vendosur ta dëbojë me dhunë nga shtëpia këtë familje dhe ky vendim synohej të ekzekutohej sa më shpejt. Edhe pas konsultimeve me të shoqen, Gjoni nuk pranon të largohet nga shtëpia. Këtu zë fill konflikti letrar dhe zhvillohet edhe në aktet vijuese të veprës. Drita është e frikësuar dhe në një mënyrë kërkon që tërë familja të largohet nga shtëpia. Ajo dëshiron ta shpëtojë burrin, fëmijët dhe vetveten. Arsyetimi i saj është shumë i thjeshtë dhe bindës. Ajo i

[73] Nehat Islami: "Nji za mallkon luftën", "Rilindja", Prishtinë, 1964, 24.V., f. 12.

drejtohet Gjonit: "Ti edhe vet e din secila ushtri në luftë asht e egër, e pa mëshirë, aq e ma tepër asht kjo... Unë jam e mendimit me u hiek dreqneve prej syve dhe me dal prej shtëpisë...".

Gjoni, megjithatë shpreh mendimin e vet dhe merr vendim të prerë, që në asnjë mënyrë mos ta lëshojë shtëpinë. Ai me rreptësi dhe me zë të lartë thotë: "Shtëpija asht e imja! Dhe due me pa kush ka me më qitë të gjallë jashtë sajë!

Shtëpija asht e imja! Për qejf të kurrkujt s'dal prej sajë! E ty, Drita, të lutem, mbaroje mos diskuto ma!"

Ndërhyrja e të tjerëve, si e Ademit dhe e Zaimit, për ta shqyrtuar çështjen me përgjegjësi, nuk bëjnë efekt. Ademi shpreh qëndrimin e vet lidhur me situatën kritike: "Më fal, Gjon, por qëndrimi jot kundra anmikut të egër e të pamëshirshëm s'ka vend. Kundërshtimin qe besa, duhet me ja ba, dhe do t'ja bajmë, por jo këtu, as jo kështu Gjon!"

Shqyrtohet edhe propozimi i Zaimit, por edhe ai rrefuzohet me ashpërsi. Duke përcjellë porosinë e babait të vet, që është bashkëpunëtor i oficierëve gjermanë, Zaimi i drejtohet Gjonit: "Për këte, baba po ta bje në dije se, ndoshta, kishte me mujtë me shtye, me anulue urdhnin, kur zotnija u kishte me deklarue si ndihmës, ose përkrahës i armatës...".

Pas të gjitha këtyre sfidave të tmerrshme, Gjoni, si edhe tërë familja, vendos të mos braktisë shtëpinë dhe të qëndrojë i patundur në rezistencën e hapur kundër fashizmit.

Gjoni nuk përfill as urdhërin e ushtarëve gjermanë. Në çastin kritik ai vritet në mënyrë mizore dhe kjo vrasje sjell pikëllim të madh në familje, por edhe në mbarë popullsinë që luftonte kundër fashizmit, për liri dhe për pavarësinë e Kosovës.

Shëmbëlltyra morale dhe njerëzore e Gjonit spikatet në fjalën e Dritës me rastin e varrimit: "Të falem nderjes për secilën fjalë, të cilën ma ke drejtue gjatë bashkimit tonë. Faleminderes mirsis të shpirtit jot e butsis s'zemrës sate, me të cila më përcjellë gjithmonë si në mendafsh. Të falenderohem Gjon, msimit yt të rregullt dhe udhëheqësis s'drejtë qi ma ngule në zemër".

Gjatë viteve të luftës edhe djemtë e Gjonit, si edhe luftëtarët e tjerë, marrin pjesë në lëvizjen çlirimtare, në luftë kundër fashizmit. Antoni, pas akcioneve të njëpasnjëshme, burgoset dhe pastaj internohet në Gjermani, ndërsa Jaku, së bashku me shokët e vet vazhdon rezistencën dhe ndërmerr aksionet të ndryshme kundër pushtuesve. Në luftë shquhen sidomos Ademi dhe Kola.

Kjo gjendje e tendosur e luftës, përveç viktimave të shumta në popullsinë e pafajshme, ka lënë pasoja shumë të rënda për tërë vendin. Në këtë luftë pëson edhe Drita. Ajo e ballafaquar me rrezikun e vrasjes së të birit, Jakut, përjeton një tronditje të thellë emocionale dhe kjo shkakton humbjen e vetëdijes. Ajo "(thellohet në mendime, çohet, shkon prapë kadal pa u ndije, me krye të ulun, tue fol diçka qi nuk kuptonte, atëherë ndalet diku në mjedis të shqenës, dhe sikur të ndiente diçka e çon kokën dhe i ngulë sytë në mbulesën e përballë. Mbulesa çelet: Shifet vagoni me njerëz. Ndihen zanjet: - Ujë, ujë! Nget te tryesa, e merr bakallin për me dhanë njerëzve uje. Ndien zanin e Antonit: - Lamtumirë, nanë - e mbulesa mbyllet)".

Në skenën e fundit të aktit të tretë marrin pjesë Jaku dhe e ama, Drita. Jaku kthehet nga Lufta, "(i veshun partizan, e shef nanën, nget përpara sajë, e përqafon)". Drita nuk e njeh të birin. Ajo mendueshëm dhe e habitur arrin te thotë: "Ik, Jak, ik! ..." dhe rrëzohet për tokë. Jaku (kadal ulet te nana, butë e plot ndiesi): Oh, nanë, nanë e dashtun!"

Si asnjëherë më parë, Rela në këtë dramë me temën e luftës ka artikuluar disa të vërteta të rëndësishme për jetën e popullsisë shqiptare të Kosovës. Lufta kundër pushtuesve gjermanë, e paraqitur në plan të gjerë, por edhe rezistenca që bën një familje, siç është kjo e Gjonit, shpreh idenë liridashëse të popullit shqiptar gjatë historisë. Kjo luftë kuptohet mirë dhe përjetohet edhe si rezistencë kundër regjimeve të tjera antipopullore, pra edhe kundër dhunës, vrasjeve, burgosjeve, maltretimeve, masakrave dhe gjenocidit serb në Kosovë. Shpërngulja me dhunë nga trojet e veta, largimi nga vatra, djegia e shtëpive, plaçkitja dhe rrënimi i fshatrave dhe i qyteteve, bënë që të forcohet bindja e shqiptarëve se vetëm lufta për liri dhe pavarësi siguron pavarësinë kombëtare dhe jetën e lirë e të ndershme.




Personazhet e dramës "Ik, Jak, ik" janë realizuar si karaktere, me një fizionomi fizike dhe morale të menduar mirë. Gjoni është njeri me një formim solid intelektual. Ai njeh historinë e popullit të vet dhe njëkohësisht i din mirë edhe synimet e tij shekullore. Figura e tij shquhet me tipare pozitive në familje dhe në mjedisin shoqëror. Ai e njeh traditën kombëtare shqiptare, i respekton normat morale familjare dhe shoqërore dhe është i vendosur të qëndrojë përballë stuhive të kohës dhe të luftës. Urtësia, edukata dhe veprimet e tij janë si rezultat i një stabiliteti psikik dhe moral. Korrektësia në familje, ndaj së shoqes, ndaj fëmijëve dhe ndaj rrethit më të gjerë, e shquajnë si shembull të guximit dhe të krenarisë, që medoemos duhet ndjekur edhe në vitet e luftës. Prandaj, orientimin e tij jetësor e ndjekin: Drita, Antoni, Jaku, Lulja dhe njerëzit e tjerë. Ai flijohet për një ideal të lartë njerëzor dhe kombëtar. Drita po ashtu personifikon gruan e urtë dhe të dashur, nënën shembullore që sakrifikon çdo gjë për bashkëshortin, për fëmijët, por edhe për çështjen e madhe të lirisë së popullit. Bota e

pasur emocionale e saj është paraqitur në mënyrë të gjithanshme dhe kjo spikat më mirë tiparet e larta pozitive njerëzore. Drita i përngjan Lules së romanit të Hivzi Sulemanit "Fëmijët e lumit tim." Fëmijët e Gjonit nga prindërit kanë fituar edukatën e shëndoshë, por edhe tipare të tjera të formimit intelektual. Ata përfaqësojnë brezin e ri, i cili do të angazhohet në mënyrë aktive në luftën çlirimtare, por edhe në proceset e tjera të emancipimit arsimor, kulturor dhe shoqëror.

Kjo vepër dramatike e Josip, duke pasur parasysh vlerën ideore dhe artistike të saj, vite me radhë është shfaqur në skenat e teatrove dhe ka zgjuar interesimin e shikuesve. Drama është vlerësuar lart edhe nga kritika letrare si kontribut i rëndësishëm dhënë dramaturgjisë shqiptare. Autorit i janë njohur merita të posaçme si shkrimtar. "Karakteristike për këtë moment të ri të krijimtarisë së tij, ka shkruar Rexhep Qosja, është drama e shpërblyer me çmimin e tretë në konkursin e Bashkësisë kulturo - arsimore të Kosovës në vitin 1964 "Ik, Jak, ik!" Me këtë vepër Rela ka synuar edhe një kthesë në prosedeun e tij krijues. Derisa në dramat e para i është përmbajtur qetësisë narrative të dramës sociale, sociale - politike, apo historike, në këtë dramë i është kthyer analizës vertikale të personazheve të veta. Drama në fjalë në të vërtetë është një përpjekje e Relës që të krijojë dramën psikologjike, në të cilën do të shprehë tragjiken e njeriut në vorbullën e luftës".[74]

Fragmente të tëra të dramës "Ik, Jak, ik, si edhe drama "Nita", janë përfshirë në programe dhe në tekste shkollore, ndërsa vepra si tërësi në lekturën e obligueshme për nxënësit e shkollave të mesme dhe për studentët e albanologjisë në studimet universitare.

[74] Rexhep Qosja: “Shkrimtarë dhe periudha”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1975, f. 225.



Një kënd i dhomës së punës së Josip Relës

KAPITULLI XII

TRAJTIMI I TEMËS SOCIALE

DRAMA JETËSORE ARBËNESHE

Tematika sociale në dramaturgjinë e Relës është trajtuar në disa vepra që nga fillimi i viteve '50 dhe ka vazhduar deri në përfundim të krijimtarisë letrare. Pas "Martesës" drama "Kungulli" është vepra e dytë që është botuar në vazhdime në tre numra të revistës "Jeta e re" të vitit l953. Kjo është dramë, siç ka pohuar autori "prej jetimit të Arbëneshit, në dialekt të Arbëneshit në tre ndodhima... Puna ndodhet n' Arbënesh reth 1880".

Arbëneshët në fund të shekullit XIX, në kohën kur popullsia shqiptare e këtij lokaliteti merrej kryesisht me bujqësi dhe me veprimtari të tjera të domosdoshme, edhe më tutje kishin ruajtur gjuhën, mënyrën e jetesës, zakonet e të parëve të tyre, tiparet karakteristike kombëtare dhe mentalitetin tipik arbënesh. Në këto vise ishte e pranishme ushtria hungareze, prandaj edhe pasojat e pushtimit të huaj kishin lënë pasoja të rënda. Shfrytëzimi feudal, por edhe çrregullimet e tjera sociale, vështirësonin jetën e fshatarëve të varfër. Banorët e kësaj oaze shqiptare ende mbaheshin kompakt midis tyre dhe kultivonin marrëdhënie të mira familjare dhe shoqërore. Plasaritjet e llojllojshme në planin më të gjerë të këtij etnikumi do të shfaqen më vonë dhe do të ashpërsohen në mënyrë serioze në rrethana të shtrirjes së propagandës politike austro-hungareze, italiane, kroate etj. "Gjysma e

dytë e shekullit 19-të, kanë shkruar Aleksandër Stipçeviqi dhe Zeqirja Neziri, arbëreshët i gjen midis dy zjarreve të forta dhe diametralisht të kundërta: si në aspektin politik e kulturor, po ashtu edhe në aspektin kombëtar. Ky, duhet të ketë qenë faktori kryesor, që ka ndikuar, në masë të madhe, të rritet kohëzgjatja e ruajtjes së traditës- prejardhja shqiptare."[75]

Josip Rela me këtë vepër ka dashur t'u tregojë bashkëvendësve, lexuesve dhe shikuesve, si kanë jetuar arbëneshët dhe çfarë kanë qenë marrëdhëniet shoqërore të asaj kohe. Të gjitha këto të vërteta jetësore, të përmbledhura me shkathtësi artistike në këtë vepër skenike, i ka komunikuar në të folmen e arbëneshëve dhe me një stil autentik e gjuhë të hershme.

Personazhet kryesore të veprës janë: Joki - punëtor (bujqësor), Tica - gruoja, Lulea - e bija, Tini - i biri, Ara - e bija, Tonka - vejusha, Toni - i biri, Rina - mikesha e Lules etj. "Vetet punojnë" dhe realizohen si personazhe karaktristike, me tipare të përgjithshme dhe individuale. Individualizimi i personazheve bëhet në bazë të veprimeve, të veçorive specifike të sjelljes, në bazë të pikëpamjeve të shfaqura dhe të gjuhës së përdorur, që është praktikë e njohur krijuese e Relës.

Subjekti i kësaj drame tri aktëshe është i thjeshtë. Familja e varfër e Jokos është shtrënguar të punojë dhe të luftojë për ekzistencë. Nga të ardhurat bujqësore Jokoa është i detyruar t'i japë një pjesë të caktuar oborrtarit të pasur. Tica, e shoqja e Jokos, për këtë obligim të rëndë ndaj pasanikut, ankohet e hidhëruar: "Ju, me zotni juoj po na mbytni ashtu, se s'po mujm me marr frym! ... Fëmit jon s'guxojn me prek nji kumbull, nji fik, nji kokër rush... Të zit dyen me vot me flet po darkë... e me angër kunguj të grest... e me bir faqen e nderjen... Ju, ju e zotnit juoj jeni faj për gji nevojat jona! Jo vet se na pini gjakun... Jo vet se na ani e mishin e eshnat... Ajnat po shpirt e po mëshirë! Si ujqët çitën në ne me na pi edhe këta pak gjak."

Në ato rrethana të vështira Jokoa, sipas traditës arbëneshe, i kushton kujdes të madh edukatës së fëmijëve. Ata i udhëzon të pu-

[75] Zeqirija Neziri & Aleksandër Stipçeviqi: “Historia dhe bibliografia e arbëreshëve të Zarës”, Shkup, 1997, f. 32.

nojnë me nderë, të jenë të matur, ta duan njëri tjetrin, të mos marrin pemë dhe gjera të huaja dhe ta ruajnë dinjitetin e familjes.

Konflikti letrar i dramës është i zakonshëm dhe ka karakter social. Pasi humbet kungulli, lindin dyshimet se atë e ka marrë dikush në rrethana të panjohura. Më në fund zbulohet se atë e kishte marrë pa lejen e askujt dhe e kishte ngrënë djali i tyre i uritur.

Në kuadër më të gjerë të organizimit të subjektit, autori ka përfshirë edhe disa ngjarje dhe veprime të personazheve, të cilat shtojnë dramacitetin e brendshëm të veprës dhe e ashpërsojnë konfliktin letrar. Të kujtojmë konfliktin me ushtarët hungarezë për të mbrojtur nderin e vashave arbëneshe, zënkat dhe mosmarrëveshjet me oborrtarin lidhur me kompensimet e të korrave bujqësore etj. Këto sprova të jetës së vështirë forcojnë edhe më tepër karakterin e arbëneshëve dhe i nxisin ata të qëndrojnë me nderë ndër kundërshtime. Në këtë mënyrë autori ka spikatur porosinë morale të veprës. Kitoa është fshatar i ndershëm, i guximshëm dhe i dashur. Të tillë dëshiron t'i ketë edhe fëmijët e vet. "Mua me interesojn sendët e punët të shpies jon... E, për mua thojn se jam i urtë! ... Përse nuk shigojm rreth vetit? Përse nuk shigojm mu shlirua pe nevojash, sh'po na mbysin, mu shlirua pe detyrash; me u shpërbie pe ajnash, dosha me than, pe zotnive, e me ken zot pe toke të vet", pohon Kitoa.

Ai porosit njerëzit të jenë të afërt midis tyre, të kenë mirëkuptim sa më të madh dhe të ndihmojnë njëri tjetrin. Arbëneshët brez pas brezi kanë respektuar normat morale. Martesat më parë i kanë bërë gjithnjë në rrethin më të gjerë të arbëneshëve. Duke përfillur dashurinë midis të rinjve, edhe prindërit e Lules, Jokoa dhe Tica, dhe e ëma e Tonit, Tonka, japin pëlqimin për fejesën dhe për martesën e Tonit me Lulen.

Drama përfundon me gëzimin e përgjithshëm. Atmosfera e tillë e jetës familjare, që përjetohet me forcë emocionale, spikat fuqishëm idenë themelore të veprës letrare. Në këtë mënyrë është realizuar edhe synimi i Josip Relës, për të ngjallur dashurinë ndaj popullit, ndaj gjuhës dhe ndaj atdheut të ri- Arbëneshit.

Rela ishte i bindur se me dramën "Kungulli", në krahasim me veprat e mëparshme dramatike, kishte arritur një nivel më të lartë

artistik. Në një letër dërguar Abdurrahman Shalës, regjisor i Teatrit Popullor Krahinor të Prishtinës, ka shkruar: "Po Ju dërgoj po ashtu edhe "Kungullin", dramë në 3 akte, të cilën do të Ju rekomandoja, sepse trajton jetën e bashkëvendasëve tanë, e sipas mendimit tim në çdo pikëpamje ia kalon "Sot tetë ditëve".

Kritika letrare ka vlerësuar se veprat e mëvonshme dramatike të këtij shkrimtari kanë vlerë më të lartë artistike. Drama "Kungulli" bën pjesë në opusin dramatik të Relës me vlerën modeste artistike. Megjithatë, ajo është shumë interesante dhe ndihmon për ta njohur më mirë jetën e arbëneshëve në tërësi.

DRAMA "DILA"

Jeta familjare dhe shoqërore në dramat e Relës edhe në fazën e fundit të krijimtarisë letrare bën temën qendrore. Autori me invencion të rrallë ka zgjedhur për t'i trajtuar në veprat letrare disa tema karakteristike, të pa trajtuara më parë në opusin e vet krijues. Edhe mënyra e shtjellimit të problematikës së gjerë sociale tërheq vëmendjen e lexuesve dhe të studiuesve letrarë.

Drama tri aktëshe "Dila", ('APET T'IJES), ka për subjekt ngjarjet që lidhen me Dilen, me një figurë të vajzës shqiptare të cilën dhuna e ushtruar mbi të dhe degradimi i plotë moral, e shtyen ta vrasë me paramendim dhunuesin, Pietrin. Gjatë procesit të gjykimit të Diles për këtë vrasje të kryer, shpalosen plagët e pashërueshme dhe përjetimet e kësaj vajze të bukur dhe fatkeqe. Vuajtjet dhe më në fund edhe tragjedia e Diles, shkaktojnë indinjatë të thellë dhe të arsyeshme te bashkëvendësit dhe te gjykuesit. Ata më në fund kuptojnë drejt veprimin e Diles dhe me ashpërsi gjykojnë shkaktarin e vërtetë të kësaj drame njerëzore, me pasoja shumë të rënda edhe për Lotin, fëmijën e lindur jashtë kurorës bashkëshortore të Diles.

Ngjarja zhvillohet në kohën midis dy luftërave botërore në katundin afër Zarës. Autori, siç është e njohur, si edhe në këtë dramë, është bazuar në ngjarjet që kanë ndodhur dhe me vërtetësi historike i

ka paraqitur faktet dhe të dhënat e tjera të jetës individuale, familjare dhe shoqërore.

Personazhet e kësaj vepre, siç ka pohuar autori, janë imagjinuar. Personat janë: Mati- bujk, Vana- e shoqja, Pietri- i biri, Lena- nusja e re, Dila- vajzë e vorfun, Simoni- kumbara i Pietrit, Daloa- kumbara i Lenës, Gjykuesi, Prokurori, Mprojsi dhe të tjerë.

Në aktin e parë është paraqitur dasma e dy të rinjve: Pietrit dhe Lenës. Ceremonia e këtij gazmendi familjar organizohet sipas traditës së pasur arbëneshe. Këngët, vallet, veshjet, urimet dhe tërë dekori i larmishëm, krijojnë atmosferën e gëzimit dhe të haresë. Lexuesit dhe shikuesit të kësaj vepre skenike të gjitha këto i bëjnë përshtypje të jashtëzakonshme. Këndimi i këngëve : "Këndon zogu", dhe "Në dashtni", si edhe vallëzimi, shtojnë disponimin e dasmorëve. Pra, "Të gji'janë kënaqun. Ndien atje-kanë të qeshunat e gëzimet ".

Në skenën e gjashtë atmosferën gazmore të dasmës papritmas e ndërpret vallëzuesja, e cila më parë ka vallëzuar me maskën në fytyrë. Në çastin kritik "Vallëzuesja, në nji botë e qet mbulesën. Ajo është gjysëm lakuriq, dhe fillon me vallëzue. Vallëzimi i saj është i pikllluem, me shenja vendosmenije, sikur të kjonte, dhe donte me 'iqe pe zembre pikëllimin.

Vallëzimi në fillim është i butë e masanden gj'i mo i nxe'të..Të gji' janë të zanun tue shigue vallëzuesjen, sila afro'et tue vallëzue të rijve. Kur mbaron kërcimi, plasën nji aplauz frenetik)". Dila, në çastin kritik, kur gëzimi dhe hareja kishin arritur kulmin e vet, me revole e vret Pietrin dhe kështu hakmerret për të gjitha të këqiat që i kishte shkaktuar ai.

Tre muaj pas vrasjes, në procesin e gjykimit, Dila rrëfen dramën tronditëse që i ka ndodhur. Në fillim ajo vetëm hesht dhe nuk u përgjigjet pyetjeve të gjykuesve, por më vonë, e trazuar emocionalisht, shpalon përjetimet e hidhura dhe tragjedinë e saj, që gati është e pabesueshme për të tjerët. Kjo pjesë e rrëfimit paraqet nivel të mirë të organizimit të subjektit dramatik. Në këtë rrjedhë drama me temën sociale fiton veçori të dramës psikologjike. Personazhi kryesor, Dila, realizohet në shumë aspekte, dhe veçanërisht në aspektin psikologjik, duke u paraqitur fizionomia e plotë fizike dhe morale e saj.

Keqtrajtimet, që kishte përjetuar gjatë viteve të kaluara, Diles i kishin hapur plagë të pashërueshme. Atë e kishin goditur rëndë posaçërisht fjalët e Pietrit: "Ik prej meje, e banu kurvë e gjithkujt...

Pe kësi momenti diç ësht ndrua në mua, ka rrëfyer Dila. Edhe nëse kanë shum tjera ndodhija shum mo të randa, mo brutale e mo të kqija se kjo, ndoshta bash kjo pikë e ko mbushi gotin me 'elm. Pe ksi momenti't jam dhanë m'as mendimit, si do të ja pagoj për të gjitha bashkë, dhe si do të e mbaroj met... Kur ka plasë zani, m'as diso ditesh, se po kunoret me njanën pe si jashtit, edhe mo fort me ko forcua në vendimin, me ja marrë jetën, por s'kam dijtë si... ".[76]

Dila sqaron në hollësi veprimin e vet dhe e konsideron të ligjshëm aktin e vrasjes. Në këtë mënyrë ajo ua ka bërë me dije edhe vajzave e grave të tjera, të cilat kanë përjetuar ose do të përjetojnë dhunime poshtërime të tilla morale, të qëndrojnë dhe të gjykojnë dhunuesit e shumëfishtë.

Fjalia e fundit, me të cilën përfundon dama: " E Dila ko ro për tokë", paraqet një zgjidhje adekuate si fazë kompozicionale të dramës. Diles nuk i shqiptohet dënimi për vrasje, ajo zyrtarisht nuk lirohet nga akuza dhe më në fund nuk dënohet. Ajo ka rënë për tokë, pa vetëdije. Ndoshta është goditur nga tendosja e jashtëzakonshme e emocionale dhe ka vdekur, ndoshta ka shpëtuar nga vdekja dhe jeton e vrarë shpirtërisht, për të mos u shëruar kurrë më. Figura tragjike e gruas shqiptare është paraqitur në mënyrë realiste. Rrëfimi i Diles është përjetësuar si histori e njërës nga ato figura të dashura njerëzore, që mbahen të paharruara në kujtesën e shumë brezave të ardhshëm.

FISI I MALLKUAR

Me dramën "Fisi i mallkuom" Josip Rela ka synuar ta zgjerojë dhe ta thellojë analizën e problematikës sociale dhe morale në mjedisin shoqëror të arbëneshëve. Kësaj radhe ka qitur në shesh plasaritjet serioze morale në familje, por edhe më gjerë në shoqëri. Drama në fillim është titulluar "'Umbja" dhe ka katër akte si edhe epilogun.

[76] Josip Rela: "Dy drama", "Jeta e re", Prishtinë, 1965, f. 60

"Puna ndodhet në katund afër gjutetit. Koha: Fillimi i shekullit njizet.Themeli i ngjarjes është i vërtetë. Emnat janë të imagjinuom".

Personat janë: Bori- bujk, Tona- gruaja e Borit, Tini- i biri, Dari- bujku, Lila- gruaja e Darit, Postijeri dhe të tjerë. Personazhet janë realizuar në bazë të veprimeve të tyre. Subjekti i dramës nuk është i gjerë dhe është organizuar me invencion dramatik. Ambienti ku zhvillohen ngjarjet nga autori është i njohur mirë, si edhe mentaliteti i njerëzve të atij mjedisi shoqëror. Derisa në veprat e mëparshme Rela ka paraqitur aspekte të jetës me ndërlikime të pashmangshme të kohës, që lidheshin me luftën e ashpër për çlirim social dhe kombëtar, në dramën "Fisi i mallkuom", duke u nisur nga ngjarjet që kanë ndodhur, ka dhënë dimensione të cilat paraqesin devijime serioze të jetës familjare dhe shoqërore. Në kuadër të arbëneshëve të ndershëm, të zellshëm e punëtorë, të orientuar kah përparimi i përgjithshëm në kohën dhe në hapësirën e caktuar, të rrethuar nga popullsi të tjera dhe të rrezikuar nga asimilimi dhe shthurja morale, gjallëron fisi i mallkuar, në jetën e të cilit ndodhin rënie morale dhe tragjedi të rënda individuale dhe familjare. Autori ka hulumtuar shkaqet dhe pasojat tragjike jetësore.

Konflikti dramatik ka shtrirje adekuate dhe përfshin personazhet kryesore të veprës. Lila, që nga fillimi dhe deri në përfundim të veprës, ka qenë në qendër të vëmendjes së shkrimtarit. Ajo është grua e re (27-vjeçare), që shquhet me bukurinë fizike dhe me sjelljen e lirë, prandaj edhe të jashtëzakonshme për mjedisin e vet familjar dhe shoqëror. Ajo ankohet dhe akuzon burrin e vet, Darin: "Po, u thonte (kishte me u thanë) se e kam mashkullin, burrin e vet. Por vetëm: U "thonte"! Ky mashkull, ky burr "jem" është vetëm me emën mashkull. Po thom vetëm me emën, e jo me forcë, me akta të mashkullit! Ky mashkull ma lezën (ndezën) dëshirin mas mashkullit, por nuk munje me ma plotësua, as me ma shue epshin te korpit tem! Këso soje mashkullit femna nuk munje me dashunua, dhe nuk munje me u afrue. Ajo e mënin...".

Jeta e çrregulluar intime e shtyn Lilën të afrohet më shumë me meshkuj të tjerë. Këtë veprim ajo e arsyeton në shumë mënyra. E degraduar në aspektin moral dhe e mallkuar si një grua e lirë, bën

përpjekje të gjejë shpëtimin dhe të sigurojë një jetë të mirë. Ajo më në fund argëtohet me Tinin (djaloshin 16 vjeçar). Duke kullotur bagëtinë, ajo afrohet me këtë djalë të ri, dashurohet si asnjëherë më parë dhe me kalimin e viteve, pasi kishte mbetur me barrë, vendos të martohet.

Marrëdhëniet në fisin e mallkuar ashpërsohen gjithnjë e më shumë. Si shkaktare e të gjitha konflikteve dhe e tragjedive të njëpasnjëshme akuzohet Lila. Nga xhelozia Dari vret Tonën. Pas vdekjes së Tonës dhe të Darit, Bori bën çmos të martohet me Lilën. Tini më në fund pranon të martohet me Lilën, për ta shpëtuar kështu edhe fëmijën e vet.

Në aktin e katërt është paraqitur dilema e Borit dhe pastaj vendimi i tij për ta vrarë Lilën. Më parë ai refuzon martesën e Tinit me një grua tridhjetë vjeçare. Ai i drejtohet Tinit: "Ty nuk të lëshoj me u martua me Lilën, a ke ndije! E shtijem se përtëvërtetë është e shtatzanun me ty, un, un do të e marr në vete e Lilën e fëmiun jot nër zembër të soj!... ti mos mendo për kurrgj. Un do të flas met. E si do të flas"! Bori, si përfaqësues tipik i fisit të mallkuar, vret edhe Lilën. Në një monolog interesant është paraqitur fizionomia fizike dhe morale e këtij krimineli:

"Bori (vjen pe si jashtit i murmë. Dorat, faqet e robet i janë të përgjakuna. Tue u afrua shtëpis, folën): Tash është notje naj grapë (grabë?) në mjec (mjedis) udhe, si mica e coftë...Tash e gjie ata çish ko kërkua... Mirë. Un e kam birr (bjerrë) zembrën e shpresën... Ajo e ka birr krenin (kryet) e shpirtin... Un e kam miritue burkun, asoj i dyet vorri. Un keq, ajo edhe mo keq... Thanë ko: Fëmiun të tjetërkuj, fëmiun te Tinit për vete... Shpjere me vete në vorr... Mush me ja dhanë dreqit si nji falje të bukur...".

Epilogu i dramës 'Fisi i mallkuom' në aspektin e përmbajtjes, por edhe të idesë themelore, që sendërtohet shkallë-shkallë, sintetizon shkaqet dhe pasojat e shthurjes morale. Tini mbetet i vetmuar. Ai është i pikëlluar dhe i dëshpëruar në jetë. Si dëshmitar i të gjitha rrjedhave tragjike jetësore, i një mallkimi të fisit njerëzor, pohon me dhimbje: "Po... Me mua, e pe meje ka zanë... Nana, o nana!... Daroa... dreq njerit... Tata?... Përse, tate, përse?... E Lila e dashtun?... Lila bujare!... E me mua po mbaron! Të gji kanë tretë, kanë 'umbë... Unë

vetë kam mbetë... Un, un i faji... Un mekatori!... Fyelli jem!... Shenji i gëzimit, shenji i dashnije... teme të mallkum!!...O...A e gjiej doku ‘arresën... E paqin”?

Ai braktis vendin e vet dhe fisin e mallkuar, për të mos u kthyer kurrë më. Megjithatë, shpresa për përtëritjen e fisit ka mbetur e gjallë.


VIZIONI I LIRISË

Në dramën “Në liri” po ashtu trajtohet tema sociale aq e preferuar nga ky dramaturg i njohur shqiptar. Në dy figura dhe në tri akte është mbarështruar lëndë mjaft e pasur, janë ngritur shumë probleme sociale dhe është sendërtuar ideja themelore e veprës, e cila përfshihet në vizionin e lirisë. Ngjarjet e kësaj drame janë zhvilluar në periudhën kohore midis viteve 1948-1950 në vise të ndryshme të Ballkanit: figura e parë në Jugosllavi, akti I diku në Itali, akti II diku në Turqi, akti III diku në Bullgari, figura e dytë në Jugosllavi.

Autori edhe pas Luftës së Dytë Botërore ka përcjellë me interesim të vazhdueshëm ngjarjet shoqërore dhe politike dhe ka analizuar si janë reflektuar të gjitha ato te bashkatdhetarët e vet. Që nga viti 1948, si edhe më parë, ndiqeshin, burgoseshin dhe internoheshin të gjithë ata njerëz që binin ndesh me politikën zyrtare të kohës. Këto ngjarje ishin shumë mirë të njohura nga shkrimtari, sepse në këtë plan edhe ndaj tij ishin bërë kërcënime serioze.

Personazhet e kësaj vepre dramatike janë: Mili Karanjol, Venka Drapni- e fejuara e Milit, Toni Frashen- miku i Milit, Gjon Kailo, Marica- e shoqja e Gjokos, Prifti, Koçi, Loli, Zhika, karabinierë, agjentë, zyrtarë, fëmijë etj. Shumica e këtyre personazheve janë arbëneshë. Ngjarjet janë paraqitur nga këndi i një retrospektive. Në figurën e parë, pas bredhjeve, vuajtjeve dhe peripecive të shumta, kur është kthyer në vendlindje, Mili rrëfen para personit zyrtar të hetuesisë: “...Oh, edhe unë shumë herë e pyeta vetëvehten: pse e lëshova tokën e vet, shtëpinë e vet dhe vorret e pleqvet të vet?... Edhe unë kam qenë antifashist me zemër dhe me shpirt...Edhe unë e prita shlirimin me gëzim të madh, dhe me zemër të hapët... Por, atëherë s’kam dijtë shum punë qi i dijë tash... S’kam dijtë me çfarë dhe me sa

vështirësina asht dashtë me luftue... Nuk kam mujtë me i kuptue mundimet dhe pësimet të cilat janë dashtë me i kapërcye për me na qenë toka e pamvarun, ashtu se këto vështirësina dal-kadal ma forcovën me e ndryshue mendimin, dhe shum punë qi erdhën mbas shlirimit m'u dukën të huaeja dhe t'idhëta... "



Mbas luftës Mili dhe e fejuara e tij, Venka, si edhe shumë njerëz të tjerë, nuk shfaqnin entuziazmin e tyre ndaj sistemit të ri shoqëror dhe politik, nuk përfillnin aksionet për punë vullnetare, konfe-

rencat e shpeshta etj. Dukuritë burokratike, padrejtësitë shoqërore, kushtet e vështira sociale, kërcënimet dhe maltretimet ndaj njerëzve kishin shkaktuar pezmatim dhe urrejtje të madhe. Prandaj, ata vendosin të ikin nga vendlindja dhe të migrojnë në Itali.



Ibrahim Kodra: *Paqe në Kosovë*

Atje, jo vetëm që nuk gjejnë shpëtimin dhe paqen e ëndërruar, por në kampet italiane përjetojnë vuajtjen dhe poshtërimin moral të


padurueshëm. Të ballafaquar me degradimin moral, me vështirësitë dhe rreziqet e shumta, të goditur edhe nga uria, detyrohen të merren me shitjen e drogës dhe me veprimtari të palejueshme. Më në fund Venka ndahet nga Mili dhe pas të gjitha travajeve jetësore, shtrëngohen ta lëshojnë kampin dhe të ikin dhe të vendosen në një kamp tjetër në Bullgari.



Përurimi i botimeve Identike letrare dhe Kultura bashkëkohore, Prishtinë më 10.02. 2015

Nga Bullgaria organizohen grupe terroriste, për t'u hedhur në aksione diversante në Jugosllavi. Në këtë kohë, siç dihet, ishin prishur marrëdhëniet e Jugosllavisë me Bashkimin Sovjetik dhe në këtë bazë edhe me shtetet e kampit të Varshavës. Ky mobilizim i grupeve nga jashtë kishte përfshirë edhe Milin. Në këtë mënyrë ai depërton në Jugosllavi dhe, në vend se të angazhohet për realizimin e detyrave sekrete, dorëzohet në organet kompetente dhe arrin të lirohet nga çdo akuzë tjetër. Venka në situatën kritike, për të mbrojtur nderin, vret shefin e sigurimit bullgar dhe me shumë rreziqe kalon kufirin dhe u dorëzohet gjithashtu zyrtarëve, me shpresë se do ta lirojnë. Pra, që të dy bashkohen përsëri dhe janë të lirë, "n'atëdhe të vet...dhe në liri të vërtetë...".

Duke trajtuar këtë temë sociale mjaft komplekse autori ka synuar ta shtrojë edhe problemin e mërgimit, që ishte bërë plagë e madhe me pasoja shumë të rënda për arbëneshët. Si moto të veprës "Në liri" ka zgjedhur katër vargje të poezisë së Aleksa Shantiqit "Rrini këtu".



Vizioni i lirisë në krijimtarinë letrare të Josip Relës, prandaj edhe në këtë krijim dramatik, është mjaft i gjerë. Ndjenja e çlirimit social, e pavarësisë kombëtare, e lirisë së qenies njerëzore në përgjithësi, e dashurisë, është gërshetuar në planin më të gjerë të jetës së lirë. Përjetimi i kësaj ndjenje sublime gjithherë mbetet për t'u dëshiruar. Hapësira e lirisë duhet pushtuar gjithnjë e më shumë. Vizioni i lirisë prandaj është gjithmonë i hapur. Për individin dhe për kolektivvitetin njerëzor synimi i lirisë është i përjetshëm.


ISAK SHEMA
VROJTIME
LETRARE
DHE
ARTISTIKE
HEJZA
RILINDJA

KAPITULLI XIII

DRAMA PSIKOLOGJIKE

ZËRI I NDËRGJEGJJES

Çështja e ndërgjegjes njerëzore dhe trajtimi i saj si temë letrare ka qenë dhe ka mbetur në fokusin e interesimeve krijuese të shumë shkrimtarëve. Në shqyrtimet dhe në studimet psikologjike ndërgjegjja është definuar si "tërësi e integruar dijenish, ndjenjash e vlerash morale të individit, që ka përmasa të motivit shoqëror dhe personal. N. është rregullatore e sjelljeve të individit, të vlerësimit të sjelljeve të veta dhe të të tjerëve nga kriteri i kësaj tërësie dijenish, ndjenjash e vlerash morale. N. shfaqet në vlerësimin e detyrës, të përgjegjësisë së njeriut ndaj saj dhe ndaj realizimit të duhur. Realizimi dhe mosrealizimi i saj përkon drejtpërdrejt me ndjenjën e kënaqësisë, të gëzimit, të krenarisë, gjegj. të fajit, të pendimit, etj'.[77]

Reflektimi dhe vlerësimi në mënyrë kritike lidhur me veprimet, ngjarjet, pasojat, dhe sidomos përqendrimi i të menduarit për çështjet ekzistenciale të jetës njerëzore, ngrit nivelin e ndërgjegjshmërisë së njeriut. Shkrimtari Josip Rela në krijimtarinë dramatika ka synuar ta përfshijë edhe botën psikologjike të njerëzve dhe të analizojë si arti-

[77] Dr. Pajazit Nushi: "Fjalori i psikologjisë", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1987, f. 172-173

kulohet zëri i ndërgjegjes në rrethana të ndryshme dhe të ndërlikuara jetësore.

Në dramën "Tallasat e dybëjes" (Ndërgjegja) autori ka trajtuar temën sociale dhe është përqendruar t'u komunikojë lexuesve dhe shikuesve të kësaj vepre skenike të vërtetat jetësore nga këndi i shpalimeve të psikologjisë së karaktereve tipike. Vepra, si e tillë, e botuar më 1966, ka zgjuar interesimin e veçantë dhe është vlerësuar lart nga kritika letrare.

Personazhet më të realizuara artistikisht janë: Gjergji i Gjurelekës- drejtor i bankës, Marea- e shoqja, Toni- i biri, oficjal, Nota- e bija, Rea- e shoqja e Parezhit, Dali i Bigarelës, Mina, Marku, Drita, etj. Koha dhe vendi i zhvillimit të ngjarjeve nuk është përcaktuar. Megjithatë, nga përmbajtja e dramës kuptohet se kemi të bëjmë gjithnjë me ambientin tipik të arbëneshëve, ndërsa ngjarjet kanë ndodhur mbas Luftës së Dytë Botërore. Kjo dramë psikologjike ka pesë akte: akti i parë (bonaca- qetësia), akti i dytë (Marea), akti i tretë (tre rrefula-tri rrahje të erës së papritur në det), akti i katërt- Fortunali (era e madhe, e fortë, e rrezikshme (në det), akti i pestë- mas ciklonit (tajfunit në det).

Subjekti i dramës është organizuar në pajtim me këtë paraqitje globale të zhvillimit të ngjarjeve. Çifti bashkëshortor, Gjergji dhe Marea, dhe tërë familja kalojnë jetë të qetë dhe të lumtur. Shumë vite më parë kishin përjetuar jetën e rëndë sociale, varfërinë dhe vështirësitë e tjera. Fëmijët e tyre ishin të lumtur dhe kishin realizuar dëshirat e tyre si edhe ëndërrat e prindërve, të cilët kalonin jetën në harmoni dhe me dashuri. Kjo qetësi dhe harmoni familjare shprehet veçanërisht te Marea, gruaja që ka një botë të pasur emocionale dhe stabilitet psikologjik. Pas arritjes së letrës së vonuar në adresë të Gjergjit, ngjarjet vijuese marrin një rrjedhë tjetër. Erërat shqetësojnë detin, pra atmosfera familjare çrregullohet jashtë çdo parashikimi.

Rojsi- Dali i Bigarelës, një dëshmitar në gjykimin e organizuar me rastin e vrasjes së Lilit, i kishte shkruar Gjergjit: "Në gjyq je deklarue se kasirin, Lilin e Shpinelit, e ka vro Ogu i Parezhit, dhe deklarata e jote e ko gjukua 20 vjet burg. Kështu i ke lye gënjye të gji' në

gjyq, por mua jo! Un e di' se Lilin nuk e ke vro Ogu i Parezhit, dhe paret nuk i ko ai.

Nëse nuk m'i çoshe 100 000 dinar deri të marten, të merkuren shkoj në polici dhe aty do të flas ata çish dij!"

Me rastin e rishqyrtimit të procesit të gjykimit për vrasjen e mëhershme lind dyshimi për keqpërdorimin e të hollave të plaçkitura. Kjo e shqetëson pa masë Gjergjin. Marea nuk kishte pasur dijeni për këto veprime të mëshehta të bashkëshortit të vet. Ajo me të drejtë dyshon në Gjergjin, sepse ai kishte fituar pasuri të madhe dhe shumë të holla, pra kishte shfrytëzuar një burim të panjohur mjetesh. Kjo bën të zgjohet ndërgjegjja e fjetur e gruas dhe e shtyn të hulumtojë shkaqet dhe pasojat e vrasjes, por edhe veprimet amorale të Gjergjit. Për këtë arsye viziton familjen e varfër të Lilit, si edhe atë të Dali Bigarelës. Atje njihet me fakte të reja lidhur me vrasjen dhe e vret ndërgjegjja për të gjitha këto krime që bëhen në fshehtësi të madhe. Marrëdhëniet me Gjegjin janë tendosur gjithnjë e më shumë dhe kjo e shtyn deri te vetëflijimi: "E ajo, e zeza, so e mbyti vetën në dybëje e ndërgjegje"!

Tallazet e jetës dhe të ndërgjegjjes njerëzore përplasen njëra mbi tjetrën. Zëri i ndërgjegjjes artikulohet në mënyrë të qartë dhe kjo, pas lirimit të gruas, e nxit edhe Gjergjin të mendojë thellë dhe me përgjegjësi për veprimet e veta. Gjergji, pasi merr lajmin për vrasjen edhe të Dalit, i vrarë nga ndërgjegjja, pohon: "O, so i faj jam un! O, sa i faj!... mua po më ngryset përpara sysh!...sepse kam thanë, në gjyq kam thanë: "Unë e kam po"... E aj ko kenë i gjukuom! O, lule e zembres seme! Po she, so keq kam bo un Parezhit!? Kush mua ma ndyen"!


Mbas tajfunit të furishëm, pra të tendosjes së jashtëzakonshme psikologjike, zëri i ndërgjegjes i nxit këto personazhe të pendohen dhe pas dënimit të merituar, të gjejnë shpëtimin.

Përveç dialogëve të mprehta dhe paraqitjes së situatave dramatike, Rela ka përdorur edhe monologët funksionale, të cilat mundësojnë paraqitjen e motivuar të psikologjisë së personazheve. Të kujtojmë dialogët e shumta që zhvillon Marea, në të cilat shprehen shqetësimet, synimet, dëshirat intime, friga, pasiguria dhe më në fund edhe proceset e ndërgjegjësimit. Rela ka provuar të kultivojë me sukses të

veçantë edhe prosedeun e dramës moderne, pra edhe të dramës psikologjike.

Në aspektin kompozicional në dramë janë funksionale të gjitha fazat e organizimit të subjektit. Ndërlikimet, intrigat dhe konfliktet letrare janë paraqitur në kuadër të veprimeve të personazheve. Marea është realizuar si personazh kryesor. Autori është treguar jo vetëm njohës i mirë i tipareve individuale dhe të përgjithshme psikologjike të personazheve, por edhe i ka spikatur ato me ndjenjë mase dhe në funksion të realizimit të idesë themelore të veprës artistke.

Vepra dramatike 'Tallaset e dybëjes' shquhet ndër krijimet më të suksesshme të dramaturgjisë shqiptare. Veçoritë stilistike dhe gjuhësore të saj e bëjnë që të dallohet nga të gjitha veprat e tjera të këtij lloji, si vepër shumë e përshtatshme për t'u shfaqur në skenë.



Në Panairin e Librit 2015 në Prishtinë është përuruar libri i Shime Deshpalit *Vepra letrare- Poezi dhe prozë*

KAPITULLI XIV

DRAMA JETON NË SKENË

SHFAQJE TEATRORE QË NUK HARROHEN

Veprat dramatike të Josip Relës janë shfaqur në skenë që nga vitet njëzet dhe vazhdojnë të jenë aktuale edhe sot e kësaj dite. Derisa shume krijime dramaturgjike i ka larguar vetë koha nga teatri, disa nga veprat e këtij autori janë gjithnjë atraktive për t'u shfaqur në skenat e teatrit shqiptar. Këtu qëndron edhe vlera e artit dramaturgjik të Relës dhe rëndësia e mesazhit artistik dhe humanist të kësaj vepre.

Gjatë viteve pesëdhjetë, kur repertori i Teatrit Popullor Krahinor ishte i ngushtë dhe kur ky institucion nuk siguronte dot vepra skenike origjinale shqipe për t'i shfaqur në skenë, veprat e Relës e plotësuan këtë kërkesë të ngutshme dhe e pasuruan jetën tonë kulturore dhe artistike. Artistët shqiptarë me dëshirë të madhe iu qasën veprës së Relës dhe e realizuan atë me sukses të veçantë si shfaqje origjinale. Me këtë fond dramash entuziazmuan shikuesit e shumtë, duke u sjellë atyre përjetimin estetik që dhuron arti skenik dhe teatri në përgjithësi. Kështu u ndryshua fizionomia e repertorit të teatrit dhe të dramës shqipe në veçanti.

Kronologjia e shfaqjes së dramave të Relës nuk është kompletuar asnjëherë, megjithatë në shkrimet e deritanishme për dramën dhe teatrin shihet se këto vepra kanë qenë të pranishme në teatër gjatë gjysmës së dytë të shekullit që po përfundon. Edhe në fillim të

mileniumit të ri për këto vepra do të jetë i gjallë interesimi i teatrove profesioniste dhe të atyre amatore, për t'u dhënë jetë atyre dramave dhe komedive që kanë vlerë të qëndrueshme artistike. Teatri Popullor Krahinor, që u përtërit në Prishtinë më 1948, si premierë të parë pat zgjedhur një tekst dramatik të përkthyer nga letërsia jugosllave (veprën dramatike "Personi i dyshimtë"), të shfaqur më 1 maj të vitit 1949.

Melodrama "Martesa" është vepra e parë e Relës, e botuar në Kosovë, prandaj edhe vepra e parë që ka komunikuar me lexuesit shqiptarë të këtij mjedisi. Në një letër dërguar Esad Mekulit autori i "Martesës" falënderohet për botimin e këtij teksti dramatik dhe kështu zë fill ideja për shfaqjen e saj në skenën e tetatrit tonë. Më vonë, më 27 VIII 1952, shkrimtari i drejtohet Z. Abdurrahman Shalës, regjisor, për të përgatitur veprën për teatër. "Martesa", "... për të cilën po interesoheni – ka shkruar Rela - gjer më tani ka përjetuar peripeci të ndryshme, ndërsa më e vogla është ajo se për punë disa mosmarrëveshjesh, kompozitori i mëparshëm ka hequr dorë nga komponimi muzikor. Është e vërtetë se i ishte përveshur komponimit një kompozitor tjetër, por ky komponim, harmonizim dhe instrumentalizim po zgjat shumë kohë, prandaj t'i dërgojmë notat e këngëve shkurt për arsye se kompozitori nuk pranon t'i ndajë veç këngët nga komponimet tjera. Vetë "Martesa" është e shkurtë për kah koha, por sipas mendimit tonë – së bashku me uvertyrat për çdo akt dhe me interpretimet muzikore – ajo do të jetë mjaft e gjatë për një mbrëmje. Të gjitha këngët në të janë në frymën popullore pos në aktin IV ajo e dasmës "Këndon zogu"...

Sipas dëshirës së kompozitorit është futur në mbarim të aktit II edhe një romansë për Vanën, ndërsa në aktin IV është zgjeruar dueti Vana dhe Pimi. Së bashku me letrën po ju dërgoj, në qoftë se ju hyn në punë. Në origjinalin tonë ato do të ekzistojnë.

Në rast se vendosni që ta çfaçni "Martesën" pa notat e këngëve, Ju lutem të më njoftoni, sepse atëherë do të ju dërgonim skicat e kostumeve të atëherëshme me ngjyra origjinale së bashku me shpjegimet.

Sa i përket Skenderit, nuk është e domosdoshme që ai, i cili e interpreton këtë, të jetë 5 vjeçar. Rolin e tij do të mund ta interpretonte

edhe ndonjë vashëz 14 vjeçare, me kusht që të mos bjerë në sy përkah shtati".



Me Shime Deshpalin

Ndër dramat e Relës, të shfaqura në skenë, më së shumti ka pasur sukses "Nita". "Martesa" dhe "Kungulli", "... patën ngelë në harresë për të vetmen arsye se shumë kush prej atyre që duhet t'u jepte jetë në skenën e vet rrudhshin krahët tue mendue se dramat e tij nuk mund të luhen për shkak të dialektit t'Arbëneshve që asht "i pa kuptueshëm" për publikun tonë". Megjithatë, kjo pengesë nuk ishte për të qenë, sepse shfaqja e "Nitës" si premierë e pestë e Teatrit Popullor në Prishtinë më 1955, hoqi dilemën që ishte e pranishme dhe dëshmoi se kjo vepër komunikon me publikun artdashës për mrekulli. Në Festivalin krahinor të teatrove amatore të Gjakovës, të organizuar po në dhjetor të vitit 1954, "Nita" kishte korrur sukses të jashtëzakonshëm, duke u shquar si vepra më e mirë e realizuar në atë manifestim kulturor. Regjisori, Kristë Berisha, arriti ta konceptojë dhe ta përshtatë mirë veprën në skenë. "Fjala, gjesti, kanga pikëlluese dhe çdo imtësi në skenë, ishin këtu aq të natyrshme, aq bindëse dhe relieve, e ngjarja aq tronditëse e prekëse", përvetësuan publikun, duke krijuar një atmosferë të këndshme dhe përjetim të rrallë artistik, që nuk harrohet kurrë. "Nita" zuri vendin e parë në këtë festval dhe kështu hapi rrugën

për suksese të mëtejshme në garat e tjera teatrore.

Nitën e dramës më të njohur arbëneshe, "... këtë lule virgjine të nji dashunije romantiko – lirike vajzë të re, "të caktueme prej fatit" me vuejtë dhe me ra viktimë e zakoneve prapanike dhe paragjykimeve të kota – e interpretoi për mrekulli Emine Shabi, tue theksue me vibracione të natyrshme të gjitha nuancimet e gjendjes psikologjike dhe përjetimeve të vrullshme që e kaplojnë fytyrën virgjinisht të pastër e suptile dhe heroikisht të vendosur e djaloshare të Nitës". Rolet e tjera i kanë luajtur artistët: Ramiz Loxha (Prenk Vuka), Xhevat Xhikolli (Zefi), Viktor Gashi (Mimçi), Jusuf Kelmendi (Lukë Kapetani) etj. Skenografinë e ka bërë Shahin Kryeziu. Në shkrimet kritike të Vehap Shitës dhe të autorëve të tjerë është shquar posaçërisht vlera e dramaturgjisë së Relës dhe sidomos përshtatshmëria e saj për t'u shfaqur në skenë.

Josip Rela, me letrat që i ka shkruar lidhur me shfaqjen e dramave të veta, ka ndriçuar disa çështje kryesore dhe në mënyrë të tërthortë ka ndihmuar që veprat skenike të shfaqen me sukses. Ndonjëherë ai ka ndryshuar dhe ka plotësuar tekstin e dramës, duke e përsosur atë në pajtim me vizionin dramaturgjik aktual. Kështu, skena e XII e aktit të fundit të Nitës është ndryshuar dukshëm. Në vazhdim do të japim dy fragmente, për të krahasuar tekstin autorial dhe për të parë më mirë efektet artistike në procesin e realizimit skenik:

I. POUMA XII

Të parët e Zefi

ZEFI (tue ipë, me athëti të madhe): Ma vravët!... Ja pivët gjakun të pastër, ju gjaksorët!... A jeni nginj? Në mos ju jo mjaft... e ashtu kërkon... mo s'kam! (e iqën kuburën): Tuk ju ja edhe gjaku tem! (E çon kuburen).

PRENKA (ja kapën shpejt dorën, ja çon përmi krenit - në ta krisi kubura): Jo! Jo, biro!... Mjaft gjak ko... As dytë! (E merr në prazma, në ta Zefit bje kubura pe dore): Kështu i bashkojmë të limbët... mas Nite!... (Mas pauze): Ajna tash... me pa... ti – nusen jote... e un... Nitën teme!

ZEFI (tue votë me Prenkën): Nita!... Nita! (Mas sish kodalë shkojnë e tjerët. – Deri ata shkojnë, perda kadalë ulet).(Mbarimi)

II. SHQENA E XII

Të përparshëm e Zefi

ZEFI (tue hi kadal, me athëti të madhe): U derdhë gjaku i pastër... U fikë syni i thiesht... Zemëra fisnike e mbaroi tingllimin të butë... Nita, jeme... (Me vrull); Ku, në ken kam me marrë gjakun?

Ku, kuj më duhet me ja prej shpirtin? (Me dymendje): Oh, si do të jetoj ma pa marrë hakmarrje? Pa hakmarrje!... (si pa arsye): E ju, pleq, a jeni ngi?... Në mos iu asht mjaftë... dhe ashtu kërkend ma s'kam gjak! (E çon kuburen..)... (E hieken kuburen): Qe, tuk ju asht... edhe nji Prenka.....

ZEFI (Si pa arsye tu e shkue me Prenken): Nita... Shum të nderon me falte të përzemërta...

"Nita" është shfaqur në skenë vazhdimisht dhe gjithnjë ka zgjuar interesimin e lexuesve dhe të shikuesve të shumtë. Ajo është paraqitur edhe në skenat e qendrave të tjera kulturore jashtë Kosovës, pra edhe jashtë territorit gjuhësor të shqipes. Grupi teatror entuziast i Pejës këtë dramë e ka shfaqur në Novi Sad. "Nita" është shfaqur në Shkup edhe në ambiente të tjera, duke shpalosur në skenë një pjesë të historisë tragjike të popullsisë shqiptare të Arbëneshit.

Gjatë viteve '50 drama "Nita", krahasuar me veprat e tjera dramatike, të shfaqura në skenat teatrore të Kosovës, siç janë: "Nuk martohem me para" dhe "Parajsi i humbun" të Murteza Pezës, "Halit Gashi" dhe "Malësorët" të Xhemil Dodës, "Kryet e hudrës", "Lugati" dhe "Peripetitë e kohës" të Kristë Berishës, "Bashkëshortët" e Muharrem Qenës, "Hakmarrja" e Jusuf Kelmendit etj., shquhet ndër realizimet më të mira skenike. Bashkë me komedinë "Miu në gjep" të Hivzi Sulejmanit, ajo ka entuziazmuar për një kohë të gjatë nxënësit, studentët, arsimtarët dhe publikun e gjerë të shikuesve.

Kjo dramë shumë e dashur për publikun artdashës, "... dramë me temën historike të shpërnguljes së arbëneshëve nga shpatijet e

Rumisë dhe nga brigjet e Liqenit të Shkodrës – ka shkruar Aleksandër Stipçeviqi, është vepra dramatike më e popullarizuar në Kosmet. Për të pohojnë se në kuptimin e plotë të fjalës ka trazuar ndjenjat kombëtare të shqiptarëve. Është luajtur në të gjitha qendrat e mëdha të Kosmetit, ndërsa përgatitet premiera edhe ne Shkup".

E përgatitur nga Teatri i Kombësive, po ashtu u prit me gëzim të madh nga shikuesit shqiptarë të mbarë Maqedonisë. Në këtë vazhdë të zhvillimit të jetës teatrore, kjo dramë pastaj është shfaqur edhe në Kumanovë.



Hrvatsko narodno kazalište Zadar

Në vështrimet kritike kushtuar "Nitës" janë vënë në dukje veçoritë artistike të veprës si tekst dramatik dhe si vepër që jeton në skenë. Vepra "Nita", ka shkruar Miodrag Drugovac, "... asht nji dramë e dashunisë, në të cilën tingëllon nji tingull i hollë melodramatik. Kjo asht në të vërtetë nji dramë romantike e dashunisë së dy të rinjëve. Por edhe ma tepër se kaq, kjo asht dramë me peripeti të dashunisë, konfliktet me të cilat autori ka dijtë të paraqesë njiherit edhe nji kohë të largët, nji ambient të panjohtun në relacionet tona, vitalitetin dhe moralin e nji populli e njiherit edhe kushtet e vështira që i janë kërcnue këtij populli ta çpronësojnë e zhdukin, t'i bajnë të pamundshëm emancipimin e tij".

"Nita" ka brendi dhe formë dramatike shumë interesante për t'u shfaqur si vepër operistike dhe si vepër filmike. Në një intervistë me Josip Relën, shprehet dëshira që "Nita" të dalë para shikuesve dhe dëgjuesve si vepër operistike.

Në pyetjen: "Kam ndëgjue se disa prej kompozitorëve tanë janë shprehë në mënyrë tejet të favorshme për mundësinë e kompozmit të një opere në bazë të tekstit të "Nitës", Rela është përgjigjur:

"- Po, koha asht që edhe ne këtu të fillojmë me operën tonë. Kisha me qenë shumë i kënaqun po t'ia fillonte kush punës. Tekembramja kemi mjaft kompozitorë të zellshëm dhe të talentuem".

Ndërsa në pyetjen tjetër "- Sikur t'ekranizohej "Nita" a kishte me mbetë prap asisoj si e kemi pa në skenë"?, ka pohuar: "Mvaret prej njerëzve të cilët kishin me realizue këtë gja. Unë mendoj se nji regjisor, si asht Abdurrahman Shala, plotësisht kishte me ja arritë qëllimit".



Promovimi i veprës „Nita" në Arbënesh (2014)

Edhe disa drama të tjera të Relës janë shfaqur me sukses në skenat shqiptare të teatrit. Me këto drama ansamblet e ndryshme kanë marrë pjesë në festivale, duke konkuruar për vendet e para. Kështu trupa e Teatrit të Pejës për këtë qëllim më 1966 ka përgatitur dramën "Dila", ndërsa më 1967 ka vënë në skenë veprën "Tallaset e dybëjes".

Kronika e jetës teatrore e Kosovës, e paraqitur në gazetat dhe në

revistat shqipe të kohës, ka përfshirë shumë fakte interesante për praninë e veprave të tilla në skenat shqipe. Kjo dëshmon vazhdimësinë e jetës së dramave në teatër. Sa është i rëndësishëm botimi i dramës, prandaj edhe komunikimi me lexuesit, aq e madhe është edhe jehona e fuqishme e dramave të realizuara me sukses në skenë.

Drama dhe teatri janë dy nocione të lidhura ngushtë dhe përcjellin te lexuesit dhe te shikuesit mesazhin aq të domosdoshëm të artit. Teksti dhe shfaqja paraqesin një tërësi dhe përshtatshmëri që e kërkon arti skenik. Ndarjet në akte, pamje etj., janë të jashtme dhe mundësojnë që më lehtë të organizohet zhvillimi i ngjarjeve të paraqitura në dramë. Vepra dramatike përbëhet nga shumë situata dramatike, që janë të lidhura në mënyrë funksionale. Vetjet në dramë janë në raport aktiv midis tyre dhe gjatë bisedave dhe veprimeve krijojnë situata dramatike. Dialogët dhe monologët mundësojnë organizimin e subjektit dhe zhvillimin e ngjarjeve në një dinamikë të caktuar që i përgjigjet veprës si tërësi kompozicionale. Këto veçori të dramës dhe të teatrit shkrimtari i ka njohur mjaft mirë dhe është përpjekur që me rastin e shfaqjes së veprës dramatike të spikaten si duhet.

Dramaturgjia e Josip Relës tash më i përket traditës sonë letrare. Kanë kaluar shumë vite dhe gjithnjë ajo është e pranishme me petkun e saj tradicional. Megjithatë, siç është vlerësuar në kritikën tonë letrare, mesazhi "... që vjen prej traditës është i vlefshëm edhe për shekullin e ri". Dramat e Çelës do ta vazhdojnë jetën e tyre në skenë dhe do të jenë prore të pranishme në jetën kulturore shqiptare.

SKENOGRAFIA FUNKSIONALE

Skena e teatrit ku shfaqen veprat dramatike, si edhe përgatitja e saj për çdo pjesë teatrale, ka funksion të posaçëm. Në atë pjesë të ngritur të sallës së teatrit vendoset tërësia e dekoreve, për t'u shfaqur sa më mirë vepra skenike. Edhe nënndarjet e një akti, sipas funksionit të skenës, përshtaten në mënyrë adekuate. Për të gjitha këto kërkohet mjeshtëria e krijuesit të dramës, por edhe e realizuesit të shfaqjes së saj.



Funtôna

Kërkesat e teatrit në planin e skenografisë janë mjaft të mëdha, për këtë arsye skenografisë i kushtohet vëmendje e veçantë. Teatri shqiptar në fushën e skenografisë ka krijuar një traditë mjaft të pasur.

Dramaturgët shqiptarë kanë dhënë kontributin e vet të madh, duke e pasuruar këtë traditë dhe duke e rinovuar skenën e teatrit shqiptar me elemente moderne të skenografisë.

Josip Rela i ka njohur mirë kërkesat e skenës dhe ka qenë mjeshtër i zellshëm i përgatitjes së saj. Në çdo vepër dramatike, të krijuar më herët, por edhe në ato të mëvonshmet, ai ka sjellë udhëzimet e plota për skenografinë, e cila, si e tillë, do t'i përgjigjej dramës së shfaqur në skenë. Nga teksti dramatik dhe posaçërisht nga ekspo-

zicioni i saj, pra nga përshkrimi i saktë dhe i detajuar i skenës, varet shumë suksesi i shfaqjes në tërësi. Vepra dramatike përbëhet nga situatat dramatike. Veprimi i aktorëve në skenën funksionale krijon atmosferën e favorshme, interesimin e shikuesve dhe ndikon fuqishëm në përjetimin estetik.

Si pikënisje për formimin e skenës autori shpesh herë ka marrë pamjen e Fontanës së Arbëneshit. Kështu, për ndodhimin e parë të "Martesës" janë dhënë këto elemente të skenës:

"Udha në Pus të Madh. Poet "Stolli i Zonjës", "mocira" me pipa; mo larg gardnjet afër udhe për pus.

Afër pusit plepi i madh.

Kaptimi i diellit. Puntort kthejn pe fushash. Vajzat, njana- dy shkojn me "kaba" në sjetulla në Pus të Madh për uj. Ato flasin, sullacaten, qeshen. Tjerat kthejn me uj e shkojn mo shpejt".

Ndodhimi i dytë ka si skenë oborrin e shtëpisë tipike arbëneshe. Ndodhimi i tretë zhvillohet në dhomën karakteristike, të mobiluar sipas shijes së bashëvendasve. Udha para shtëpisë bëhet skenë e ndodhimit të katërt. Kjo skenë është e përshtatshme për festën e dasmës arbëneshe, me gjithë dekorin dhe veshjet e bukura plot kolorit autentik.

Koha e zhvillimit të ngjarjeve: në mengjes, në mesditë, në mbrëmje përcakton rekuizitat e duhura të ndriçimit por edhe aspektin vizuel të skenës.

Për dramën "Kungulli" janë dhënë pamjet e skenave tipike të Arbëneshit të vitit 1880: "Kuzhina me komi (votër). Në komi zjarmi i mi zjarmit broncini (tenxhere). Rreth zjarmit drasa në coka (shkamb) për me rit. Pran kominit dru. Në kantu (kand) mas dere mokna. Pran murit tryesa e plak. Në tryes sendet të kuzhinës. Mi tryes (Polica) me pjata, terina, çikra etj. N'on pe police nji birë në mur me "Slik" të Zonjës, e para soje lumini (kandili i vojit). Dera e balkunit bje në obor.- Shpia asht në njon pe kuzhine. Ajo nuk poet. E në shpi ipet pe oborit.

Kaptimi i dielit të shtundes të verës".

Ndodhimi i dytë zhvillohet në konoba (pijetore). Kjo skenë ka vetëm karakteristika të përgjithshme dhe rekuizita të zakonshme.

Elementet e skenografisë së dramës "Nita" janë mjaft funksionnale dhe intersante. Përshkrimi i skenës së ndodhimit të parë është dhënë më parë. Është ky ambienti tipik i Briskut, pra një udhëkryq i fshatit të arbëneshëve para shpërnguljes. Akti i dytë shfaqet në skenën tipike të Arbëneshit. "Funtona, uji buzë detit i mblluom me kupol në kolona goditun 1546. Në mjedis të Funtonës uji i rrethuom me kunore 80 cm e nalt. Në fund janë sigjet të gurit. Mi sigjesh rasa e gurit me shkrim. Përpara Funtone pritja për borka".

Skena e ndodhimit të tretë është një udhë-kryq "naj bregdetit të verit", ndërsa ajo e aktit të katërt është përsëri Funtona, "por jo e zbukuruom...- Puna në këtë ndodhim zhvillohet në shenj të randësisë të rrebët".

Vendi i zhvillimit të ngjarjeve për dramën "Zani i fëmiut" është përcaktuar pa detajime: kështu akti i parë shfaqet në një pjacë afër katundit, akti i dytë në një hapësirë para kishës dha akti i tretë në një dhomë të pritjes.

Për dramën "Dila" janë paraqitur dy ambiente të skenës. Akti i parë: darzma-vrasja, ndodhin në një shtëpi përdhese. "Pe onash derat (dyert). Gijatë dhome tryesat në formë të potkovës-darzmort. Në mjec (mjedis), e visun në bredhë, me kunore në krye, nusja e re, Lena dhe pran soje djali i ri, Pietri, i vishun në zi. Pe onash kumbara i Pietrit, Simoa, e pe one të nuses kumbara i soj, Daloa. Mo larg darzmort. Nëpër tryes, përpara darzmorve, nëpër pijata 'aje (gjellat e pije) gota, shishë, etj. Nërmjed shishesh vazna me lule. Gjisili darzmor e ko në prauma nji tubëz lulesh, shenji i darzmorit...' Akti i dytë, Gjyqi, zhbillohet në një lokal të gjykatës. Autori, përveç rekuizitave e mobiljeve, jep edhe pozitën ku janë vendosur aktorët.

Skena idilike e fshatit është paraqitur në dramën "Fisi i mall-kuom": "Kullosë. Diku-diku gardhi, voesa ose dardha e egër. Shtëpiza e fushës, për të u 'she pe shiut. Nodje e verës së 'erët. Dokurë ndien zanjet e bagëtisë të silat kullosin".

Skenat e dramës "Në liri" janë të shumëllojshme dhe shquhen me karakteristika të posaçme, varësisht se në cilin vend janë zhvilluar

ngjarjet. Derisa në aktin e parë është paraqitur “Logori i konqentramentit “ të Italisë dhe në aktin e dytë një dhomë e vogël me orendi orientale, në aktin e tretë janë paraqitur elemente të skenografisë së një ”llogori... për rrokje dhe kapërcim t'’migrantëve. Përbahet prej tri dhomash, me derë e dritësore. Dhoma e parë asht e caktuem për “vajzë të llogorit”. Kjo dhomë asht pa mur prej anës së publikut. Brenda shifet shtrati, dolapi, tryesa etj. Në dhomë tjera nuk shifet. Përpara shtëpie nji bank pranë murit. Bina ashtu asht në dy hise: Dhoma, dhe përpara shtëpie vendi i rrafsh.- Atje larg shifen malet...”.

Dhoma e fjetjes, shtrati i martesës dhe orenditë karakteristike janë sugjeruar për aktin e parë të dramës psikologjike “Tallasat e dybëjes”. Për aktin vijues janë parashikuar dhoma e pritjes, orendi dhe portrete të prindërve.

Dhoma qytetare e pritjes, e pajisur me mobile dhe me bibliotekë, në dramën “Ik, Jak, ik’ të krijon një përshtypje të veçantë. Mbi tavolina janë shpërndarë tekste shkollore dhe pajisje të tjera për mësim. Për aktin e dytë është fiksuar ambienti i një shtëpie të vjetër, në periferi të qytetit, ndërsa akti i katërt shfaqet në një dhomë me mbulesa të zeza, që i përgjigjet plotësisht atmosferës së pikëllimit të thellë familjar.


“Nji pijes e seciles anë të shqenës mundet me u çelë. Kur çelet pjesa e përballë shifet vagoni i trenit ngarkese. Në dritare të vagonit gjinden hekrat. Mbas hakurash duken shum koka të njerëzve të cilët shtrijnë duert tue lypë: -Ujë, ujë! Kur çelet mbulesa e djathët, shifet pushkatimi i njerëzve. Ndihet urdhni i oficerit, atëherë krisma- rafali i mitralozit...-Kur çelet ana e majtas, shifen varrjet me njerëz të varrun... Këto mbulese-kurtinë janë ndamas prej mbulesash të përgjithshme, dhe janë ndermjed plafonit e podit

Sqena e ndolimit të pare të shqenës. Mbulesat çelen kadal, por kur i hjeken Drita sytë, mbyllen shpejtë.


Në shqenë djathtas shtrati i modest, e në shtratkukëlla. Majtas tryesa me nji çini, nji bukall me ujë dhe nji grimë bukë të thatë misri. Pranë tryese nji karrike e nji bank i vogjel”.




Kostume të arbëneshëve të Zarës 1890



Sqena e ndolimit të parë



Sqena e ndolimit të dytë e të katërt



Sqena e ndolimit të tretë

Për t'i saktësuar elementet kryesore të skenografisë, autori ka bashkangjitur vizatimet dhe skicat, ashtu si duken në të vërtetë vendet ku zhvillohen ngjarjet. Ai po ashtu ka dhënë edhe skicimet e duhura për veshjet tipike arbëneshe. Fontana si skenë më tipike është paraqitur nga pozicioni natyror që ka buzë detit, me pamjen e saj komplete dhe të mrekullueshme.



Musa Ramadani

1. Ramadani, Musa. *Fjala ne skene*. Prishtine: Rilindja, 1980
2. **Jump up** ^ Ramadani,M. *Teatri dhe kritika*. Prishtine: Rilindja, 1.9.1981
3. **Jump up** ^ Shita, Vehap. *Skena Shqipetare*.Prishtine: Jeta e Re, 1963
4. **Jump up** ^ Sokoli, Qemal. *Zhvillimi i Teatrit Kombetar te Kosoves*. Pristina: *Litografia*, 2006, Pg.98
5. ^ Jump up to: [a] [b] Sokoli, Qemal. *Zhvillimi i Teatrit Kombetar te Kosoves*. Pristina: *Litografia*, 2006, Pg.97
6. **Jump up** ^ Sokoli, Qemal. *Zhvillimi i Teatrit Kombetar te Kosoves*. Pristina: *Litografia*, 2006, Pg.95 and 96
7. **Jump up** ^ Musliu. B. *Teatrot dhe komunikimi i tij*. Prishtine: Fjala, 15.9.1985



"Lulebora" (Simon Gjoni)
Interpretojnë: Sanije Matoshi, Mezosoprano dhe
Pranvera Hoxha, piano

KAPITULLI XV

VEÇORITË STILISTIKE DHE GJUHËSORE

KARAKTERISTIKAT E STILIT

Analiza e veprës letrare në veçanti, por edhe e tërë opusit krijues të një shkrimtari, përfshin edhe vrojtimet stilistike dhe gjuhësore. Çdo individualitet krijues shquhet me stilin e tij, me atë veçanti të veprave të krijuara, pra me mënyrën e të shprehurit dhe me gjuhën e përdorur. "Idetë e veprës janë jashtë njeriut, stili është vetë njeriu", ka thënë G. Bifoni. Në aspektin teorik stili është përcaktuar "... si veçanti e veprave të artit, e autorëve ose e ekzekutimit të veprave. Mënyra dalluese ose karakteristike e shprehjes në art... del nga tërësia e mjeteve të përdorura për të mishëruar përmbajtjen në një formë të caktuar dhe sipas kërkesave ideoartistike të një epoke, vendi, drejtimi, gjinie arti...".[78]

Prirjet stilistike të shkrimtarëve janë të ndryshme dhe kushtëzohen nga shumë faktorë. Karakteristikat e stilit të një vepre ose të një opusi letrar, lidhen me shtjellimin e mjeteve dhe të trajtave gjuhësore. Këto bëjnë një tërësi të lidhur organikisht. Pra, stili "...është veçantia e një tërësie gjuhësore të organizuar në një mënyrë, që ia jep ligjërimit gjuhësore të organizuar në një mënyrë, që ia jep ligjërimit këtë

[78] Xhevat Lloshi: "Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe", "Rilindja", Prishtinë, 1988, f. 14.

veçanti në realizimin e përmbajtjes, duke synuar përshtatjen me kushtet dhe me qëllimet e komunikimit... stili është veçantia që lind në këtë veçanti në realizimin e përmbajtjes, ... stili është veçantia që lind në një modelim gjuhësor, është përbërësja gjuhësore e strukturimit, e mishërimit, e shtjellimit të përmbajtjes, që e bën këtë të shfaqet në një mënyrë të dallueshme, karakteristike. Në stil kemi dialektikën e së veçantës me të përgjithshmen, të traditës kulturore të modelimit me fillesën krijuese e individuale".[79]

Vepra letrare e Relës shquhet me karakteristika të veçanta stilistike. Duke pasur parasysh të dhënat se ai ka krijuar gjatë disa periudhave kohore dhe ka kultivuar artin letrar të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare, vlerësojmë se edhe këto veçori stilistike janë të larmishme. Te ky autor janë të pranishme prirjet stilistike të sentimentalizmit, të romantizmit dhe të realizmit. Me kalimin e kohës në krijimtarinë e tij kemi evoluimin e tipareve stilistike, pasurimin dhe përsosjen e vazhdueshme të cilësisë së ligjërimit poetik.

Në poezi, në prozën tregimtare dhe në krijimet dramatike të fazës së parë, në aspektin e stilit autori më shumë i ka kushtuar vëmendjen karakterit utilitarist të letërsisë. Dëshira e tij ishte, përveç të tjerash, të argëtojë bashkatdhetarët e vet. Ai ka krijuar i frymëzuar nga jeta dhe në mënyrë origjinale ka shfaqur ndjenjat subjektive, mendimet dhe pikëpamjet për realitetin shoqëror dhe historik.

Gjatë fazave vijuese të krijimtarisë artisti atë realitet jetësor e ka transponuar në planin artistik në mënyrë më të suksesshme. Mënyra e shtjellimit të motiveve dhe të temave është më e pasur dhe më e larmishme. Poezia e tij për kah vëllimi nuk ka shtrirje të madhe. Megjithatë, ajo përmban forma të shumëllojte poetike. Poezitë më të mira shquhen me prirjen origjinale stilistike, me pasurinë e shprehjes poetike, me figuracionin e pasur dhe me larminë e vargjeve, të strofave dhe të metrit. Poezia, përveç vargut të lirë, përfshin edhe lloje të tjera të vargëzimit, trajta specifike të organizimit të vargut dhe të vjershës në tërësi. Poeti ka shfrytëzuar edhe formën e ligjërimit të poezisë popullore dhe të letërsisë së shkruar. Krijimi i varianteve të shumta të vjershave, ripunimi, rikrijimi dhe përsosja e vazhdueshme,

[79] Po aty, f. 9-10.

në aspektin stilistik paraqet synimin e qartë për përsosjen e poezisë. Sa ka arritur poeti ta realizojë këtë qëllim? Poenta e theksuar morale dhe tendenca e hapur moralizuese e ka dëmtuar artin poetik dhe është shprehur edhe në rrafshin stilistik. Duke mos qenë konsekuent në parimin krijues, shpesh herë ka lënë anash dhe nuk i ka respektuar rregullat e vargëzimit. Prandaj, krahas ngritjes së nivelit artistik të poezisë, janë shfaqur edhe rënie drastike dhe të palejueshme. Për këtë arsye shumë poezi nuk janë botuar kurrë dhe, si të tilla, pa vlerën e duhur artistike, kanë mbetur në dorëshkrime.

Në artin poetik të Relës janë kultivuar figura të ndryshme stilistike. Poeti më shumë u është qasur figurave tradicionale, siç janë: krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, alegoria, eufemizmi, ironia dhe epiteti. Njëkohësisht ka përdorur edhe figurat e intonacionit dhe të përsëritjes. Refreni është i pranishëm në shumë poezi. Nga figurat e diksionit më shumë janë të pranishme pyetjet retorike, heshtja dhe pasthirrma. Shkallëzimi si figurë e konstruksionit po ashtu ndeshet në shumë krijime poetike.

Në prozën tregimtare shkrimtari ka përdorur disa nivele të rrëfimit. Ai ka kultivuar prozën tradicionale realiste, por ka provuar edhe prosedeun modern. Format tregimtare janë të larmishme, çka tregon diapazonin e gjerë të prirjeve krijuese. Rrëfimi i mbarështruar mirë prozën e tij e bën mjaft interesante. Për fat të keq proza e Relës, si për kah sasia dhe po ashtu për kah cilësia, nuk ka arritur nivelin e duhur artistik.

Krijimtaria dramatike e Josip Relës sintetizon të gjitha veçoritë stilistike të rrëfimit artistik. Dialogët dhe monologët si forma të shprehjes letrare, që ndikojnë në zhvillimin e veprimeve dramatike, janë mjaft funksionale. Autori në veprat e kësaj gjinie më të vështirë letrare ka treguar aftësitë krijuese dhe ka artikuluar prirjen origjinale stilistike. Ai, që nga ekspozicioni i veprës dramatik dhe deri në fazën kompozicionale të fundit, me lehtësi dhe me invencion të rrallë e krijon veprën si tërësi artistike.

Prosedeu i dramave dhe i komedive të Relës është mjaft interesant. Në etapën e parë dramaturgu është mbështetur në përvojën tradicionale të dramës klasike, ndërsa më vonë në atë të krijimtarisë

bashkëkohore dhe realiste. Krijimi i dramës me temën historike, me temën e luftës, me temën sociale dhe i dramës psikologjike, i ka dhënë mundësi të madhe që, varësisht nga tematika e trajtuar, të akceptojë veçoritë e duhura stilistike dhe gjuhësore. Duke shfrytëzuar përvojën dramaturgjike shumë të pasur të disa autorëve më të njohur, që nga Shekspiri dhe deri te dramaturgjia bashkëkohore, ka gërshetuar format specifike më të larmishme e funksionale. Veprat e tij dramatike janë shfaqur vite me radhë në skenat shqipe dhe janë aktuale edhe në rrethanat e sotme të ndryshimeve shumë të mëdha, kur shumë drama vetvetiu janë hequr nga skenat e teatrit. Me dramat më të realizuara artistikisht, siç janë: "Nita", "Fisi i mallkuom", "Tallasat e dybëjes" etj., si edhe me veprat t tjera letrare, shkrimtari i Arbëneshit ka zënë vendin e merituar në historinë e letërsisë shqiptare.

GJUHA – MJET I SHPREHJES GJUHËSORE DHE LETRARE

Gjuha është mjeti kryesor i shprehjes dhe i komunikimit midis njerëzve. Funksioni i gjuhës në këtë proces të formësimit dhe të shprehjes së mendimeve është i pazëvendësueshëm. "Për të plotësuar rolin e vet gjuha ka një sistem mjetesh (tinguj, fjalë, trajta) dhe rregullash për ndërtimin e fjalëve, togfjalëshave e fjalive. Megjithatë komunikimi nuk bëhet me këto mjete ose rregulla të marra veçan, por me ndërthurjen e tyre në përputhje me pasqyrimin e realitetit, me vijueshmërinë logjike, me rrethanat e komunikimit dhe me veprimin e përbashkët të këtyre anëve sipas mënyrave të përvijuara historikisht nga populli shqiptar. Komunikimi kërkon organizimin tërësor të lëndës gjuhësore. Ky është organizimi parësor gjuhësor, i domosdoshëm për të bërë komunikimin dhe ai e përcakton strukturën e gjuhës e zhvillimin e saj".

Gjuha shqipe me dialektet dhe të folmet e saj është monumenti më madhështor që ka ngritur populli shqiptar gjatë historisë. Ajo është zhvilluar, është pasuruar dhe sot, si asnjëherë më parë, ka mundësi e

mjete shumë të pasura shprehëse. Gjuha e sotme shqipe është gjuhë letrare me normë të njësuar. Si gjuhë e artit letrar ajo i plotëson të gjitha synimet e sotme të ligjërimit bashkëkohor. Gjuha zhvillohet dhe pasurohet në rrjedha të vazhdueshme historike, shoqërore dhe kulturore.

Letërsia është art i fjalës, prandaj gjuha e letërsisë artistike, varësisht nga funksioni konkret i formave gjuhësore, përfshin të gjitha ligjërimet. Vepra letrare, duke pasur gjuhën si mjet themelor të shprehjes artistike, është krijim gjuhësor dhe artistik.

Shkrimtarët në procesin kompleks të krijimtarisë letrare përdorin tërë pasurinë gjuhësore, të gjitha mënyrat dhe tipat e ligjërimit. Në letërsinë shqiptare të traditës, dhe sidomos në letërsinë bashkëkohore, janë shfrytëzuar të gjitha gurrat e shqipes dhe sidomos gjuha letrare. Lënda e pasur e letërsisë ka përfshirë dialektet dhe të folmet e të gjitha viseve shqiptare, pra edhe ato të ngulimeve shqiptare në vende të ndryshme të botës. Kjo pasuri e pashtershme gjuhësore është në funksion të kulturës shqiptare.

Në krijimtarinë letrare të Josip Relës dhe në atë të krijuesve të tjerë arbëneshë të kësaj oaze shqiptare, edhe pse në kushte shumë specifike, si gjuhë e letërsisë është përdorur e folmja e shqiptarëve të Zarës. Në këtë mënyrë, nëpërmjet artit letrar në letërsinë shqiptare është përfshirë edhe një ambient tjetër autentik shqiptar dhe një rrjedhë komplementare e letërsisë.

Gjuha e arbëneshëve të Zarës është studiuar shkencërisht nga disa gjuhëtarë shqiptarë dhe të huaj, siç janë: Idriz Ajeti, Eqrem Çabej, Kruno Kërstiq, Franc Mikloshiq, Tullio Erber, Carlo Tagliavini, Gustav Weigand, Norbert Jokli, P.Skok, H.Bariq, Agnija Vasiljevna Desnickaja, etj. Në studimet dhe në vështrimet gjuhësore lidhur me të folmen gege të arbëneshëve të Zarës janë ndriçuar aspekte të zhvillimit historik dhe të sistemit gjuhësor në tërësi. Në planin më të gjerë kjo e folme është studiuar në raport me të folmet e tjera dhe me dialektet e gjuhës shqipe. Në kuadër të studimit monografik "Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës"[80]

[80] Idriz Ajeti: "Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës", Vepra I, ASHA e Kosovës, Prishtinë, 1997.

janë studiuar çështjet shkencore që lidhen me tingujt dhe trajtat gjuhësore. Sistemi i të folmes së Arbëneshit ka mjaft karakteristika të veçanta. Është ndriçuar çështja e lakimit të emrave, e kategorive të tjera gramatikore, siç janë: përemrat dhe foljet, trajtat e sistemit foljor: prezenti, imperfekti, aoristi etj. Lënda gjuhësore është klasifikuar, për këtë qëllim janë shfrytëzuar fragmente nga rrëfimet e arbëneshëve: Josip Rela, Budimir Peroviq, Zef Marshani dhe Simë Malaj (nga Shestani).

Autori ka bërë transkribimin fonetik të teksteve dhe për herë të parë këtu janë bërë përpjekje, që në këto tekste të zgjedhura të shënohet kuantiteti i vokaleve. Kualiteti i vokaleve nuk është shënuar "... sepse nga kuantiteti pa ndonjë vështirësi mund të përcaktohet edhe lloji i vokaleve, meqë dihet se vokalet e gjata njëkohësisht janë edhe të mbyllëta, ndërsa të shkurtat të çelëta".

Josip Rela e ka njohur mirë të folmën e vendlindjes së vet, e ka folur gjuhën e nënës dhe është përpjekur ta përdorë me përkushtim sa më të madh në krijimtarinë letrare si gjuhë të letërsisë. Tekstet letrare të krijuara para Luftës së Dytë Botërore i ka shkruar në gjuhën serbokroate. Vepra e parë e krijuar në gjuhën shqipe, pra në të folmen e arbëneshëve, është melodrama "Martesa". Rela nuk e ka njohur mirë gjuhën e shkruar shqipe që përdorej në Shqipëri, në Kosovë, apo në viset e tjera shqiptare.

Cila është gjuha e shkrimeve të Josip Relës?

Kjo është e folmja e arbëneshëve e folur gjatë shekujve dhe më vonë e shkruar si gjuhë e kësaj kolonie shqiptare. Dr.Kruno Kërstiqi ka botuar fjalorin e kësaj të folme dhe bashkë me të ka ribotuar edhe studimin "Arbëneshët e Zarës". Në vështrimin "Arbanaški govor Arbana" ka dhënë shumë sqarime të duhura për fjalorin, për mënyrën hartimit të tij dhe për mbledhjen e fjalëve dhe të shprehjeve gjuhësore. "E folmja arbëneshe, ka shkruar ky autor, e cila i përket dialektit gegë, ka rrjedhë nga gjuha me të cilën është folur në atdheun e hershëm të arbëneshëve në fillim të shekullit 18, ka ruajtur disa tipre arkaike (edhe disa karakteristika të dialektit të toskërishtes), por gjatë jetesës së izoluar ka përjetuar ndryshime të rëndësishme, diçka nga tendencat e zhvillimit vetanak (por edhe të proceseve degjeneratve), diçka edhe

nga ndikimet e huaja gjuhësore: të gjuhës serbe e kroate (shtokaviane) të rrethit e të brendisë së Kotarit, të folmes çakaviane të rrethinave të afërta dhe të ishujve, si edhe të gjuhëve romane (venedikase-italiane të qytetit të Zarës, më së shumti nga koha e okupimit venedikas dhe të okupimit të mëparshëm italian)."

Përveç gurrës së hershme gjuhësore në këtë të folme janë përdorur edhe shumë fjalë të huaja me origjinë romane, sllave, të gjuhëve të tjera, si edhe terma të fushave të ndryshme. Shkrimtarët shqiptarë të këtij mjedisi dhe punonjës shkencorë, siç janë: Josip Rela, Shime Deshpali, Kruno Kërstiqi, Aleksandër Stipçeviqi, Budimir Peroviqi, Gjani i Rarit etj., në veprat letrare dhe në shkrimet e tjera të tyre kanë përfshirë edhe fjalë të gjuhës letrare shqipe.

Me rastin e botimit të tregimit "Nji kujtim me nji pëvetje" Josip Rela në një shënim ka shkruar: "Në këto tregim janë të nënvizuoma fjalët të maruna prej fjalorit të S. Dobroshit, përse Arbëneshët të Zadrës nuk i përdorojnë. Në vend të këtyne përdorojnë letisht (italian), ose shkenish (serbo-kroat), të sillat autori i ko eliminua". Fjalët e nënvizuara janë: helmuom, kujdsi, ndërtes, vshtirsie, përcaktuom, kot, kuptova, ndytë, teshash, premtoj, rrjedhën, tregtari, xansat, kalovi, dredha-dredha, vargje, çëmuoshëm, dyrnjajës, kësri, tregova, pelqye, dhoma, majtas, ngushëllimit, sulmojshin, lëmua, vazhdoj, e lezetshëme, e lakmueshëme, e kthjelltë, mjekimit etj.

Në tekstet letrare të Josip Relës, të botuara gjatë viteve '50, por edhe më vonë, janë përdorur shumë fjalë të panjohura nga lexuesit shqiptarë. Për këtë arsye autori vazhdimisht ka hartuar fjalorthin shpjegues. Shumë fjalë autori i ka veçuar dhe ka kërkuar shpjegimet adekuate në gjuhën e shkruar dhe të përdorur në Kosovë. Në një shënim të botuar në revistën "Jeta e re" është pohuar se nuk njihet mirë gjuha e shkrimeve të Relës: "Redaksija s'i ka ba asnji ndryshim dorëshkrimit të "Martesës" të dërguem nga auktori mbasi nuk e njef djalektin e atjeshëm". Duke shfrytëzuar këtë material leksikor, veprat letrare të arbëneshëve kanë komunikuar më lehtë me lexuesit.

Në një letër, dërguar Esad Mekulit më 11.X.1952, lidhur me çështjet e gjuhës Rela ka shkruar: "Sipas këshillës Suaj, do të përpiqemi që të gjitha punimeve tona t'u shtojmë fjalorin e fjalëve më pak

të njohura, por kjo zgjedhje nuk mund të jetë e plotë, për arsye se ne nuk dimë cilat nga fjalët tona janë atje më pak të njohura, me qenë se nuk kemi fjalorë, pos të Dr. Bariqit, vëllimi I.

Neve këtej nuk e dimë plotsisht as ortografinë, as drejtshkrimin, as gramatikën... Të shumtën i përmbahemi fonetikës, ndërsa do të dëshironim të përvetësojmë mënyrën e të shkruarit letrar...

Ndërkaq, në qoftë se ia arrijmë të krijojmë një lidhje dhe kontakt më të fortë me vëllezërit tanë të atjeshëm për kah gjaku dhe gjuha, do t'i dalim hakut së paku ndërgjegjes sonë...".

Rela ka qenë i gatshëm të bëjë ndryshime dhe plotësime në veprat e veta, apo ato gjuhësisht të përshtaten. Ai i ka shkruar Abdurrahman Shalës: "...në qoftë se dëshironi, Ju mundeni me rastin e adaptimit sipas gjuhës së rrethit Tuaj, edhe ta zgjëroni, por do të Ju lutesha që të mos e ndryshoni frymën e ngjarjes, sepse ngjarja në "Martesën" është pasqyrim besnik i nji pjese të jetës së fshatit tonë.

P.S. Në "Martesën", të botuar në "Jeta e re" kanë shpëtuar mjaft gabime shtypi, të cilat diku-diku edhe ndërrojnë kuptimin, por mund ta evitoni edhe vetë...'.

Për gjuhën e dramës "Nita" autori ka shkruar në një letër, dërguar Kristë Berishës. Në fillim ka shtruar çështjen e gjuhës së përdorur dhe ka shprehur gatishmërinë që të bëhen përmirësime gjuhësore, në ato vende ku publiku "... nuk do të mund t'i kuptonte dhe t'i mirrte vesh, t'i adaptoni, ose sipas të folmes Suaj lokale, ose sipas gjuhës letrare. Ka, por vende në "Nitën", të cilat janë të pakuptueshme edhe për mua vetë për shkak të gabimeve të shtypit... Pos këtyre gabimeve materiale ekziston edhe një mori më të vogla, sa të shtypit aq edhe të miat (posaçërisht ortografike por edhe gramatikore), prandaj do të dëshiroja që provat Tuaja t'i korrigjoni, e po qe për çfarëdo arësye nuk i kuptoni, atëherë m'i shënoni në letër, e unë do të Ju shpjegoj.

Sa i përket të folmes apo akcentit, besoj se këtu nuk do hasni në vështirësi të mëdha, sepse qoftë e folmja apo akcenti i dialektit tonë nuk ndryshon shumë nga i Juaji. Nuk e njoh të folmen e Rugovës, ndaj në këtë pikëpamje nuk mund të Ju them asgjë, por në qoftë se atje ka qenë shoku Ramiz Kelmendi dhe po qe se Ju ka thënë se bukur

shumë ja keni qëlluar të folmes sonë, atëherë do të jetë mirë, sepse vërtet shoku R. Kelmendi e njeh mjaft mirë të folmen tonë. Rregulla të posaçme për theksimin e të folmes sonë nuk ka (apo më mirë: nuk janë të fiksuara me ndonjë gramatikë etj.) Diftongun "ua" – ("uo" në fjalë e theksojmë njësoj sikurse e theksoni Ju atje "ue". Ne nuk shqiptojmë pothuaj asgjë nëpër hundë (nazale). Secila "o" e jonë, që është krijuar nga (e gjatë) p.sh. k o l i k a l i, e shqiptojmë "o" të gjatë, të hapur, e cila megjithatë i ngjanë ngapak "a"- së, njësoj si të mbanim gojën për "a", e të shqiptojmë "o". –Ndër ne ka tretur tingulli "h". Vokali para të cilit ka qenë "h", është bërë pak më i gjatë. P.sh. "koa-koha".

Më parë Rela të gjitha letrat i ka shkruar në gjuhën kroate-serbe. Më 14.12. 1954 i ka dërguar një letër gjuhëtarit, Selman Rizës. Përsëri është shtruar çështja e gjuhës së përdorur në dramën "Nita". Ai ka shkruar: "Sa më takon përshtatimi i "Nitës" në gjuhën letrare të gegënishtjes jam i mendimit, se megjithë atë qi kam me shique me përshtatue sa ma mirë, gjithnji i ka me mbetë në "Nitën" shpirti i dialektit tonë. Përse? Thjeshtësisht sepse nuk jam i zoti dhe nuk sundoj me gegënishtjen letrare.

Kam me shique me i ndreqë gabimet ortografike, dhe me i "përlthye" shprehjet të panjoftuna t'arbënishtjes në gegënishtjen ashtu që kanë me mujtë si ansambli i theatrit ma lehtë me dhanë dhe publiku me marrë vesh... "Nita "nuk pretendon me qenë nji vepër mendjemprehtë, por nji dramë e lehtë e modeste të cilën duhet t'e marrin vesh ndigjuesat me lehtësi. Besoj se në këtë mnyrë ka me pasë sukses ma të madh te populli, tue diskutue dhe komentue përmbajtjen e sajë, ka me ardhë vetë - pa sugjerim t'askujë- deri në konkluzione të veçanta.

Këta dëshiron "Nita" – dhe unë me te...".

Rela ka përcjellë me interesim të veçantë përgatitjen e veprave dramatike për t'u shfaqur në skenë. Në letrën e datës 11.XII.1954, dërguar Teatrit Krahinor të Prishtinës, ka shkruar: "Ndonse nuk jam në kontakt me dialektin e gjallë letrar gegë, pos me të lexuar, do të përpiqem të plotësoj, sa Tuajën, aq edhe dëshirën e S. Rizës, megjithëse jam i bindur, se- adaptuar nga unë- "Nita" në dialektin letrar

gegë do të ketë shumë mungesa, kështu që nuk do të mund të konsiderohet si vepër e pastër dhe e përpunuar në dialektin gegë. Do të përpiqem që në "Nitën" të korigjoj, si gabimet ortografike, ashtu dhe shprehjet tona, të cilat për publikun e atjeshëm të gjërë nuk janë – sipas mendimit tim – të njohura dhe në këtë mënyrë të bëj që tekstin ta kuptojë edhe publiku njësoj si dëgjuesit dhe kolektivi teatral ashtu edhe interpretuesit. Njëherit "Nita" në një adaptim kësodore do të mbajë megjithatë frymën e origjinalit si dhe një nostalgji për arbëneshët e Zarës, e në të njëjtën kohë edhe si një përshëndetje të tyre vëllezërve bashkatdhetarëve në Kosmet.

Këtu përnjëherë po theksoj, se këtej e kam të pamundshme ta jap të rrahet në maqinë, sepse nuk kam mundësi, për arësye se nuk ekziston askush që do të dinte të rrahi në maqinë s h q i p t a r ç e, e sikur ta rrahin ata që nuk e njohin gjuhën do të bënin përsëri një mori gabimesh. Këtë e di nga përvoja. – Sa i përket kostumeve, nuk mund të Ju ndihmoj, për arësye se nuk i njohim vetë. Mirëpo, mendoj se kostumet në kohën kur zhvillohet ngjarja kanë qenë thjesht popullore nga viset e anës së Tivarit e të Shkodrës, por pak më të lashta, por njësoj do t'u përshtatej çdo veshje popullore shqiptare e vjetër. Këtu do të duhej pasur parasysh të spikaturit e veshjes dhe të ngjyrave. Posa adaptimi dhe kopjimi të jetë gati, do të Ju dërgoj Teatrit Tuaj, që Ju pastaj të dispononi me te. Bashkë me kopjen do të Ju dërgoj fotografinë (kartolinën) e t'ashtuquaturës "Fontanë", ku zhvillohet akti II dhe IV ".

Gatishmëria e Relës për të shkruar veprat e veta gegërishten e përbashkët shihet në letrën tjetër, dërguar Selman Rizës. Aty ka pohuar: "Letra e Jote, më duket se, përmbanë lavdime aq të mdhaja dhe të pamerituem të cilat gati-gati më përgjasin përgëdheljes... Gjithnji - në qetësi të vullnetit dhe sugjerimit Yt - me këto po Ta premtoj se do të sprovoj dhe të mundohem me shkrue ndonji punë në gegënishtën të përbashktë (dhe në qoftë se jam dhe këtu mjaftë i dorëhollë me fjalë).

Shka përket "me pru tek tuk ndonji tjetërsim redaktimi në tekstin... " për të vërtetë nuk ka droje se do të pezmatohem, masema për arsye qi tash "Nita" gjindet në duert e redaktorit, ashtu se ky,

redaktori asht i zoti i saj, dhe ai mujë t'e pickonje njetash këte, njetash atje... Lirisht i kjoft "!

Duke korigjuar tekstin e dramës "Zani i fëmiut" Rela ndesh shumë fjalë të huaja, të përdorura pa asnjë arsye. Lidhur me këtë i ka shkruar Tajar Hatipit: "Kam fillue me korigue "Zanin e fëmiut" në arbënishtjen, me ngjyrë të kuqe, por "crvenilo" (meriqepi i kuq, si u duhente me thanë në shqipen) dhe si nuk ka qenë letra e mirë (si shpuzë) ngjyra u shtri nëpër letër ashtu, se s'mujta me i dalë në krue. Dashtë m'asht me u dhanë me kopjue...Mendoj se gjithnji ju kame mbri në kohë. Prej Esadit nuk mora letrën, por e unë vetë jam i mendimit se asht ma mirë me shkrue ne stërndialekt t'arbeneshve.

Disa fjalë "Zanin e fëmiut", të cilat Arbëneshët i kanë marrë prej shkenishtje (kështu i thonë serbokroatishtes gjithë arbëneshët e Zarës në të folmen e tyre- R.K.) ose prej "letishtje" (italjan) poashtu dhe italishes i thonë "letishte" – R.K.) dhe i përdurojnë thijesht kroatçe ose italian s'deshta me i përdurue unë në dramën, por kam marrë prej shqipeje fjalët shqipe dhe i kam shti ndër thojza, për shembull tregtar – trgovc, rrebte – trogo, dënimet – kaznat, lezet – dragost e shum tjera. Fjalë tjera të cilat edhe nëse janë shkenish ose letisht por e kanë marrë formën arbënisht i kam përdurue per shembull: gërzat e tjera..."

Rela ishte i shqetësuar shumë, atij i dukej se shumë shpejt po prishet arbënishtja. Në letrën,dërguar Jakup Cerajës më 27 maj 1964, ka shkruar: "Unë marr prej shtypit shqipe "Jetën e re" e "Zanin e rinis"... Shqiptart e Zadrës vehtit i thojnë "arbënesh" dhe flasin "arbënisht", por kjo arbenishtja asht mjaftë e prishun dhe e perzieshem me shkenishtjen e letishtjen, por gjithnji, vendasit tonë dijnë prej kah rrjedhin dhe krenohen këte...".

Vepra letrare e Josip Relës ka vlerë të qëndrueshme artistike dhe rëndësi të madhe gjuhësore dhe kulturore. Ajo është kontribut me vlerë historike dhe dëshmi autentike për gjuhën e arbëneshëve të Zarës.

SHPJEGIMI I FJALËVE

Shkrimtari krijon veprën letrare dhe në procesin kompleks të krijimtarisë ka parasysh lexuesit. Kontakti me lexuesit për krijuesin ka rëndësi të madhe sepse, me formimin e trekëdëshit shkrimtari – vepra letrare – lexuesi, arrihet një qëllim i lartë për jetën e fenomenit artistik letrar. Në qoftë se gjuha e veprës letrare është funksionale dhe e kuptueshme për lexuesit, atëherë shkrimtari është i sigurtë për realizimin e komunikimit të veprës në shkallën e duhur.

Josip Rela në krijimtarinë letrare ka përdorur të folmen e arbëneshëve. Leksiku i kësaj të folme ka qenë i njohur nga shkrimtari dhe në të janë përfshirë shumë arkaizma dhe fjalë të gjuhëve të huaja. Rela ka qenë i bindur se lexuesit shqiptarë të Kosovës nuk e njohin një pjesë të mirë të këtij leksiku specifik, prandaj ka shprehur dëshirën dhe ka treguar gatishmërinë të shpjegojë fjalët e panjohura. Për disa drama, siç janë: "Martesa", "Kungulli", etj., është shtuar fjalorthi shpjegues. Në vazhdim sjellim këtu fjalorin shpjegues të melodramës "Martesa":

a di si t'o = a din si t'âsht, a din si qëndron puna.

afër mee ri = rrin afër meje.

ajme! = kuku për mue! Vallë!

ajna = oh kqyr këndej (ko); eja të shkojmë, le të shkojmë.

an = ani, qoftë.

ashtu po ri puna = ashtu po qëndron puna ashtu âsht...

benkoe = bekoje; fale.

bëkont në mua = mundesh me u mbështet në mue.

bën mota të ironies = thot fjalë ironike, ban me krye ironikisht.

bënjes bé = baj bé, të përbetohem.

bllunj = nji lloj shpendi (bllunj – përdoret si një fjalë fyese): shaptore-ja.

puldu = shkë-a.

boçat = birilat, topa druni, gogël në lojw birili (serbisht- kuglana).
brom = prom, dje mbrama.
bromje = mbramje.
bullini (bulini) = topi, gogla e parë në lojë brili.
bullari = gjarpën i shkurtër dhe i trashë në ngjyrë si në të kuqe.
da = po, sikur, mos; da ko ken diku tjetër – po t' ishte qenë diku në nji vend tjetër.
diq = dishka nji gja.
dit, me dit = me dijtë, dijtun.
djeverushat = vajzat që përcjellin nusen në darsëm.
djol = djal-i, djalosh-i; djol- djolli; djolli i kanda – djal i kandshëm.
doen = dahen.
dogja = dishka.
dojn – dajnë, shkepin.
donje – dojshe, doje.
donjesh – (e donjesh un- e dojsha unë) – dojshem.
dor – dorë-a; dort- duert.
drecnjet (dreçnjet) – dreqit, dreqnit.
dridh = (i dridh) – i dlirë, i pastër.
drydhet = dridhet, tundet.
dundofile (- ille) = trandofille.
dyet = duhet; dyet me sua mendësh- duhet me mësue(me e këthye në mend), të mendojë.
eq kan = eja kha, eja këndej, eja këtu.
e ballkunit- e balkonit, e ballkunit, e çardakut.
edle (edhe) = edhe.
e ka gusurua = e ka grabitë.
e morta = budallicë- ca, e trentë, e marrë.

e në ka vot = e në çoftë shkue.
e nje? = e njoh? e njeh?
e njo = e njoh, e dij.
er = herë
ergel = krenar.
esht = asht-i.
ësht = asht; ësht hamarat = asht dashunue.
faculleta = shami.
faq = faqe.
fer = ferr, xhehnem.
flet = (me flet = me flejtë).
folen = flasin, flitet.
fullet = dru (nji lloj peme që rritet afër detit) – me emën italisht.
gaxua (me gaxua = me kallxue) = me kallxue, me tregue.
gji = gjithë; gji jeta = gjith bota.
gjider = gjithëherë, gjithmonë.
gjoja = gja, asgja, kurrgja.
gjoll = gjallë.
gjuvegija = dhandërri.
i mort = i trembët, i marrun, i çmendun.
i munduoshin (i mundushim) = i lodhun.
jo = jo: a jo? A nuk âsht?
kaba-i = buril, kënatë droni (për ujë), bucelë.
kadna = kadune, kadën, zonjë.
kampanjeli = kumbonare, kulla e kumbunës pranë kishës.
kantu = kand, qoshe.
kapac me mbo (kapac me m'bo) = me qenë i zot me më bo, me qenë në gjendje me të ba.
aptimin = perëndimin – kalimin.

karig = karrigë, karrikëll, fron, shkamb.
kente = kishte, do t'ishte.
këngalla = këngallë, cinzër.
kjon = kjan, kan, qan.
ko (ka dal) = ka dalë = ka.
komb = tregu i barishteve.
kush të suo = kush të mësoj, kush të mësovi, nga kush e mësove?
lakuricit = lakuriçit, laperit, lakurksit.
leqit = (me u leqit) = me u rrëfye) = me u shpallë, me rrëfye, me nunosë.
litiratat = fotografit.
lo (m'u lo = me luejtë) = luejtë.
ma = por.
mal (l-i) = i madh.
malnje = male.
ma ndyeni = ma falni.
mbet = prit, ndalu; me mbet gjoll = me mbetë gjallë, me jetue.
mbërsye (mbë, mbi, në, nër = sy) = mos me lëshue nga syni, me dashtë.
lua me u lua = me luejtë = luejtë.
mbarua, me mbarua = me mbarue.
mbre = mpreh
mee = meje.
mendulla = bajame, bajam, badem.
miqikirku = mën përgdhelës, i vogël si gishti i madh.
mjat = mjaft, boll.
mo = ma; m'o = m' âsht, (m' osht, m'o Kosova).
mbillën boçat = mbledhin topat e drunit, goglat.
mocira = grumbull gurësh.

mot = shej; bën me krye mot = ban shenj me krye.
ndur = sulmuen, vërsulën, mësyen, ku u ndur = ku u vërsul.
nyeni = falni (fajin).
nek = po të, në qoftë se; nuk e ndiej = le të ndëgjojë; nek e po, le të shkojë; nek të kenje = ashtu qoftë.
neka = qoftë, kjoftë, le të jetë!
në njon = me nji anë (në nj'onë).
notje = nate-a; ndije = nadje.
noto = ato, n'ato.
mu gaxomu = eja më kallxo, kallxoma.
nuk kam fijue = nuk kam gabue
nuk m'a i kanda = nuk më kanda, nuk m'a don zemra.
nuk u ko me thir = nuk ke me u thirrë.
nji atër = nji të mirë
nji bot = nji herë.
oj ko ndigua? = a ka ndigjue? A ka ndie? Në qoftë se ka ndie.
oq i... = aq i.
ordhi = erdhi, ardhi
paj = pajë, qejz.
par = para, mâ përpara.
pariqua (me pariqua = me përgatitë) = përgatitë; me pariqua lulle = me përgatitë lule.
pa vot = pa vojtë, pa shkue.
pe = pej, prej, nga.
pe (p'e) kalkanit = po e llogaritë; po e njeh.
pijeshku = ipeshkv, episkop, bishkup.
pipa = akaqe, sallgam, bagrem.
pon = pa: po merje = pa frigë, pa tmerë.
poet = shifet, duket.

pom = shoh, sheh, shiqon.
pomti == lojë, rradha në lojë.
po rugatje = po tallet, po qeshet, po ban hajgare.
pou = pau, pa.
pouma = pamje, sqenë.
prehs ka = po ngutem, s'kam nge.
priq (mos e priq = mos fol e zgjat)
prshut = kofshë, but, koshë.
rgja = myk, e keqe, e ndytë.
rixikua = guxue; ka rixikua = si ke gulue.
se = që; se ke than = që ke thanë.
si Ma shpuvi paqin = si ma muer paqën.
s'ko por = s'ka por.
so = sa; so vjet të ko?
sullucat (me u sullcat = me u qeshë, me u tallë) = qeshë, tallë.
svatat = krushqit, darsmort.
syt i birsha = syt i qorrofsha.
sh = ç'; që; sh' mo në zembër = shka m' âsht në zemër, ç'kam në yemër.
she = fsheh, msh'fe.
sho (me sho = me sha = sha, shajtë.
sholak (shollak) = shollzë, meste.
shot = shat-i.
shpu = marrë; më ka shpu = më ka marrë; e ka shpu = e ka marrë.
shtillat = shigjetat.
shton = kalon.
shtypën në der me shkop = trokitën në derë me shtagë, shkop.
sh'u ndolli (ndodhi) pe mee? = ç'u ba (ndodh) prej meje?
tem = i em; i im; vllo tem = vllaun i em.

tren = ças, dekik.

u çitem = un, shtrihem.

uojve = uejve (ujnave).

vet ty të poj = vetëm ty të shoh.

vlojn = vllaun, vllan.

vlo (vllo) = vlla.

vllizu = lëvizu, lëkundu, hiqu.

vlojn = vllaun, vllan.

zonja e lyeme = Zonja e lume; zonja e lyme nek ta ndyejnë = Zonja e lume le ta fali!

Fjalorthi i vjelur nga kjo vepër është përpiluar nga Vojisllav Dançetoviqi dhe është mbarështruar në botimin e parë në revistën "Jeta e re" më 1952.

Gjuhën e veprës së Josip Relës në aspektin morfologjik dhe sintaksor më së miri e analizojmë nga ky fragment i zgjedhur i dramës "Kungulli":

NDODHIMI I PARË

Kuzhina me komi (votër). Në komi e mi zjarmit broncini. Rreth zjarmit drasa në coka për me rit. Pranë kominit rozga dru. Në kantu mas dere mokna. Pran murit tryesa e plak. Në tryes sendet të kuzhinës. Mi tryese "polica" me pjata, terina, çirka etj. N'on pe police nji birë në mur me "Slik" të Zonjës, e para soje lumini. Dera e balkuni bje në obor. – Shpia ësht në njon pe kuzhine. Ajo nuk poet. E në shpi ipet pe oborit.

Kaptimi i diellit të shtundës të verës.

POUMA E I

Tica, Lulea e Ara

ARA: *(E shporko, tu e kjo)*: Nane dai buk...!

TICA *(Tue e shigua zjarmin)*: Prit pak, Ara e nanës! Tash ko

me ardh tata, ater dërkujm. *(Lules)* A ke pru uj, Lule?
LULEA *(Tu i shti në vend sendët)*: Kam, nane.
ARA *(Si nalt)*: Hm,... daj buk!
TICA *(Me lugë te drusë tendën në bronci)*: Prit edhe pak, zogu i nanës! Po pon se po ziet darka.... (Lules): Lule, e ku'sht Tini?
LULEA: Par e kam po naj Macaranit.
ARA (Si nalt): Dai buk, nane...
LULEA (Arës): Kush ko po vajzën, ashtu të madhe, me kjo? Prit, ne të lôj, e pak të krej, ater me ken e bukur.
TICA: Loje, Lule, loje! Po she se ësht si dosa... Si e ko me tata shigua kur të vijnë pe fushash...
ARA: (Lules): Tri'er sot më ke lô. Nuk dua me më lô vishe...
LULEA: E përse shprokate ashtu? Me ardh cigani... munte me mendue se je bija e ti...
TICA:... E me të shti në thas!...
ARA: E, da. – Ju doni me më tremb...
LULEA: Nuk kemi për çish me të tremb... Kur cigani e pon fëmiun te shporko, mendon se ësht i ti, - e shtje në meq e, e mer me vete.
ARA: Shko, shko, ti po me renë.
LULEA: Nuk do me më zan besë? Ater...

POUMA E II

Ata e Tini

TINI (Ipën në kuzhin): Nane, po vjen tata...
TICA: E për s'ke dal para si...?
TINI: Edhe ësht larg. (Pa kujdes)... Tash – shkoj. –
TICA: Shko, biro, shko! I ko me ken kanda.
TINI (afrojet moknës): E çish po zien nane?
ARA (Frk): Lakna e kumpira. Un nuk dua lakna...
LULEA: Esht, esht Ara. Ty të japim gji kumpira. A je e

kuntent?
LULEA (E lôn Arën): Kështu me ie e kanda.
TICA: Tini? E çish to ty? Pse s'po del para tate?
TINI (I shtrënguom):... Kurgj. Nuk mô kurgj... (Shigon jasht): Tek ësht tata; po vjen... (Mblidhet rreth mokne si me u dash me u she).
ARA: Ko ardh tata! Ko ardh! Lishomu, Lule, nek shkoj naj tatën.
LULEA: Prit, Ara, prit! Shkojm bashk. – I dimojm me zhgarkua.
ZANI I TATËS: Çprsh, çprsh... dura, drenuli tw mart.
ARA: Tek ësht, ajna, Lule, ajna! (Shkojn Lulea e Ara)
POUMA E III
Tica e Tini
TINI (Si da s'ko vend... si da po do mu she nër mokën)
TICA (Shigon Tinin, ater si da s'po mer vesht kurgj): Tini, ama "shuplaçën"!
TINI (E mer shuplaçën e ja shtrin nanës).
ZANI I TATES. E ku'sht Tini (Tinit i bje shuplaça për tok).
TICA: E çish esht pe tee sot, Tini?
TINI (Si i kapun)... Kurgj... Çish ësht pe mee? Kurgj... (e çon shuplaçën).
TICA (Tue e mar shuplaqën): E si kurgj? Si të ko rô shuplaça... si da to dora e padrikës...
POUMA E IV
Ata, Ara, Lulea e Joki, masandej Kovi
ARA (Tu e nga në kuzhin) Nane! Nane! Tata ko pru diq pe fushash... e Tinin nuk i ko me dhan...
JOKI (Tu e ip): I japim e Tinit, i japim. E, ati të parit... Tash

keni me po!...
LULEA: Gji diten ko ken sot i mir, për ta e meriton.
TICA: E mua, për çud, me baet se ësht i smund... Pak par ja kam lyp shuplaqën... e ajo i rojti pe dore... si...
KOVI: (Pe si jashtit): Lal'Jako?!
JOKI: E, e! Kush ësht?
KOVI (Në der të kuzhinës): Lal' Joko, tuk ju kam pru sakicën...
JOKI: Aferim, Kovi, aferim! Lishoje aty mas dere.
KOVI (E lishon sakicën): E mirë... si zjarm! Kjo, sakica juoj...
JOKI: Avërte?
KOVI: Besa, si shpat! – Faleminderës, lal' Joko!
JOKI: Kurgjo, Kovi kurgjo. Përshëndete tatën.
KOVI: Se jeni shëndosh! Faleminderës! (Shkon)
JOKI (mbas si): Në iu dasht edhe do nji 'er, dini ku e keni me gjetë...
KOVI (Pe si jashtit): Natën e mir!"

Fjalorthi i dramës 'Tallasat e dybëjes ' është mjaft interesat dhe paraqet përpjekjet e autorit për ta pasuruar gjuhën e veprës letrare, por edhe për të individualizur personazhet letrare. Në këtë fjalorth janë përfshirë këto fjalë:

apena – at qsa, porsa
amor (me bo)- me ba dashuni
aprofitua (me) – me pasë dobi
afan (në) – i, e mekun
adria – për mbas, me vu mendjen
aberja – me thirrë ndim
bonaca (në det0 – qetësia (në det)
balkuni – dritësore
birr (me) – bjerrë

bardë – barghë
bote (nji) – nji herë
bacilat (me) – me pasë pasë kujdesë
butiga – duqani
qeleshte – kaltërt
qaro – këthiellтë
cikloni – tajfuni (në det)
cukur – sheqer
dybëje – ndërgjegjes
deknjesh – dotë kisha me vdekë
dô (me) – me nda
duoma (të) – të ndanuma
dingò – ndigjo
dishgrocia – pafati
deshperimi – dëshprimi
drilë – dlire
de (i) – i dejun
thonte (u) – u kishte me thanë
ezhempio – shembull
fletë (me) – me fijetë
fisho-fisho – pa lëvizje
foji – gazeta
fortunali – era e madhe e fortë e rezikshme (në det)
gy, gyja – gjuhë, gjuha
gjider – gjithmonë
gjisila – secila
ipë (me) – me hy
jeta – bota, populli
jovit (me) – me lajmerue


korpi – trupi
kreni – kryet
kuverta – zarfi
kanda – qejfë
kinje – do të kishe
kjô (me) – me qajtë
koshijenca – ndërgjegja
kuja – kuçka
kashtigua – dënua
kente – kishte me qenë
kajiqi - lundërza
kartolin – lundreza
kamare – dhoma
ledë – lehtë
leze – (me) – me ndezë
lume – lumtë
likari – mjeku
likari – ilaç
mi – mbi
mô – ma
mborja – marrë-ja
montura – kostumi
mareta (në det) – lëvizjet e tallasave (në det)
mrshilë – mbyllë
mbidhë (me) – me mbledhë
morenda – silla
merja – friga
noshtu – atill
ngritë – ftoftë
ndie – ndigjue

nô – nja
nderta – drejta
dretash – drejtash
ndalë (me) – me fikë
ngljuç – bulsshi
ndurë (me u) – me sulmue
ormari – dollapi
oficja – zyre
ò – ose
ôq – aq
obeçat – premtue
përbi – kalue
përpi – kaperdi
pè – prej, nga
piquna – piekuna
prende – prehën
piani – kati
patnje – kishe me pasë
prititën – kërcnohet
punj – grusht
pô (me) – me pa
pariçua (me) – me gatue
presha – ngutja
rifiutat – refuzue
rre (me) – me rejtë
rua – ruejtë
refuli – rrahje e erës të paprit (në det)
ragjun – e drejta
razabrait – ngushllue

stupci – lisi
sonat – në mëngjes
svidok – dëshmitar
svidoçit – me dëshmue
skurpula – ndërgjegje
sentiment – ndiesi
sherio – serioz
shtôti – shteti
shtati – korpi
sholda – pare
shporkat – lye, përlye
shpu – marrë
shtraca – lecka
shtedit – me kursye
shempliqe – thieshtë
shkafeti – syrtani
trevit – ndodhë, ndeshë
trembë – frigue
‘undi – hunda
ura – ora, sahat
vishe – veshe
votë (me) – shkue
vrijojnë – rrjedhin
vijtë – arijtë
voje – vullnet
vero – cakte
valor – vlefte
voshteria – drekore
vlizet – lëvizet
zabavit – argetue

zdrypë – zbritë

Shpjegimet e fjalëve janë shumë të nevojshme për të kuptuar përmbajtjen e teksteve letrare. Në krijimet letrare që kanë mbetur në dorëshkrim gjithashtu janë dhënë shënimet e duhura të fjalëve të ndryshme, të cilat lexuesit nuk i kanë njohur.



PËFUNDIMI

Njohja e jetës dhe studimi i gjithanshëm i krijimtarisë letrare të shkrimtarëve shqiptarë është synim i studimeve tona historike letrare. Në studimet monografike kushtuar autorëve të njohur, të prirë edhe nga ky qëllim, ndriçohen aspekte të ndryshme të aktivitetit njerëzor dhe të krijimtarisë letrare të personaliteteve eminente të letërsisë, të cilat me veprat e tyre artistike kanë zënë vend të merituar në historinë e letërsisë.

"Duke mësuar jetën e një autori, mund të kuptosh më mirë veprat e tij"- ka shkruar Fan S. Noli. Në studimin monografik "Jeta dhe krijimtaria letrare e Josip Relës", duke njohur më mirë jetën e shkrimtarit (Pjesa I) dhe duke studiuar krijimtarinë e tij letrare (Pjesa II), është synuar të zgjerohen dhe të thellohen njohuritë shkencore historike letrare për opusin krijues të shkrimtarit dhe për çështje të tjera të letërsisë dhe të kulturës shqiptare në tërësi.

Çdo krijues letrar në krijimtarinë e tij paraqet vetveten. Të dhënat biografike për shkrimtarin Josip Rela janë të shumta dhe mjaft interesante. Ato janë gjetur të shpërndara në materiale të ndryshme arkivore, në dorëshkrimet e autorit, në shtypin dhe në periodikun e kohës dhe në "Autobiobliografinë" e tij. Në kujtimet e bashkëkohësve, si edhe në tërë veprën letrare, janë të pranishme dëshmi interesante dhe me vlerë për këtë studim. Duke hulumtuar në arkivin e shkrimtarit, në dorëshkrimet letrare, në studimet e vështrimet e deritanishme kushtuar këtij shkrimtari, si edhe në tekstet e llojllojshme, janë sistemuar përmbajtjet e duhura dhe është kompletuar jetëshkrimi i Josip Relës (1895-1966). Në planin më të gjerë në këtë mënyrë është njohur më mirë epoka në të cilën ka jetuar dhe ka krijuar shkrimtari,

por janë parë historikisht edhe baticat dhe zbaticat në jetën e arbëneshëve.

Josip Rela në tërë krijimtarinë letrare ka kultivuar poezinë lirike, prozën tregimtare dhe gjininë dramatike. Ai ka lënë edhe shkrime të tjera, me të cilat është zgjeruar interesimi i këtij intelektuali arbënesh dhe është shtrirë edhe në fusha të tjera të diturisë. Ai ka treguar njohuri të gjithanshme për jetën, për shkencat shoqërore dhe për letërsinë. Tërë jetën ia ka kushtuar arsimit, edukimit, artit letrar dhe teatrit. Në veprimtarinë e gjithmbarshme ka synuar të sendërtojë idealin jetësor, idealin e lirisë njerëzore, arsimimin, mirëqenien sociale, përsosjen shpirtërore ngritjen morale dhe përmirësimin e njerëzimit.



"Letërsia është mendimi që bashkohet me dritën", ka pohuar një mendimtar i njohur. Në krijimtarinë letrare të Relës janë shprehur ndjenjat subjektive, si edhe mendimet për botën njerëzore. Shkrimtari, në rrjedhat e jetës dhe të krijimtarisë së vazhdueshme dhe të pasur letrare, ka shfaqur pikëpamjet e veta mjaft interesante. Ato janë artikuluar në mënyrë origjinale dhe shumë specifike. Në krahasim me shkrimtarët e tjerë të viseve të tjera, Rela shquhet si individualitet letrar i Arbëneshit. Modestia, sinqeriteti dhe vullneti i njeriut të mirë, të bën përshtypje të veçantë dhe të nxitë të meditosh më thellë për problemet e jetës dhe të artit.

Josip Rela e ka filluar krijimtarinë letrare që nga viti i largët 1916 dhe e ka vazhduar deri në fund të vitit 1966, kur edhe vdiq në moshën 71 vjeçare. Një kohë të gjatë ka krijuar larg rrjedhave të letërsisë dhe të kulturës shqiptare, pa kontaktet aq të domosdoshme me jetën kulturore dhe letrare shqiptare. Kjo është shprehur dukshëm dhe ka ndikuar në krijimtarinë letrare.

Plaku i Arbëneshit, siç e kanë quajtur poetin, është shkrimtari më i njohur i arbëneshëve të Zarës dhe njëri ndër dramaturgët më të shquar të letërsisë shqiptare. Fëmijërinë dhe rininë e ka kaluar në vendlindje, ku mori mësimet e para dhe pastaj iu përkushtua misionit arsimor. Shumë vite kaloi në viset e ndryshme të Dalmacisë, në Vutha etj., dhe më në fund është kthyer përgjithmonë midis bashkatdhetarëve të vet, për të punuar si mësues, udhëheqës i institucioneve arsimore dhe kulturore dhe për të vazhduar krijimtarinë letrare. Puna në teatër dhe angazhimi për përgatitjen e shfaqjeve skenike, e kanë nxitur dhe e kanë frymëzuar të krijojë veprat dramatike.

Rruga jetësore dhe e krijimtarisë letrare ka qenë shumë specifike. Vetëm pas disa dekadave të krijimtarisë së vazhdueshme letrare, ishte vetëdijesuar se më në fund është afirmuar si shkrimtar dhe është pranuar si shkrimtar shqiptar.

Krijimtaria letrare e Josip Relës përfshin tri etapa kryesore dhe sipas këtij periodizimi inkuadrohet në rrjedhat e përgjithshme të zhvillimit të letërsisë shqiptare. Në etapën e parë përfshihet një pjesë e krijimtarisë poetike, e prozës tregimtare dhe e dramaturgjisë së krijuar deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore. Poezia e krijuar gjatë viteve të luftës (1941-1945) bën fazën e dytë. Në fazën e tretë përfshihet krijimtaria e tij letrare e mëvonshme, e shkruar kryesisht në gjuhën shqipe, që paraqet nivelin më të lartë artistik të arritur nga ky shkrimtar. Kjo është vepra më e rëndësishme letrare, që megjithatë ka nivele të ndryshme artistike, por edhe vlera të qëndrueshme estetike.

Poezia, sa i përket trajtimit të motiveve dhe formave poetike, është mjaft e pasur dhe e larmishme. Poeti ka kultivuar poezinë e dashurisë, lirikën patriotike, poezinë sociale, poezinë elegjiake, poezinë humoristike satirike dhe poezinë për fëmijë. Niveli artistik i poezisë është mjaft heterogjen. Me pasurinë e përmbajtjes poetike ajo ka

zgjuar interesimin e lexuesve dhe të kritikës letrare. Poezia e Relës vlerësohet drejt duke pasur parasysh kohën dhe rrethanat në të cilat është krijuar, si edhe vetë specifikat e krijimtarisë letrare të arbëreshëve. Ajo nuk është botuar në tërësi, prandaj nuk është e njohur sa duhet nga lexuesit dhe studiuesit letrarë. Poezia e botuar shquhet me vlerat poetike relevante për kohën dhe është mjaft transparente. Kritika letrare ka vënë në dukje meritat e poetit, vlerat e qëndrueshme artistike dhe të metat e dukshme të poezisë. Përmbledhja poetike "Vjersha" është botuar më 1964. Deri atëherë nuk ishin botuar shumë përmbledhje të poezisë së autorëve shqiptarë të Kosovës. Poezia e Relës ka vlerën artistike të poezisë shqiptare të etapës së parë dhe, bazuar në kriteret e sotme të vlerësimit të poezisë, lë shumë për të dëshiruar.



Hyjnesha në Fron, Neolithic clay statue of the sitting goddess, from Tjerrtorja in 1955. a suburb of Pristina. It dates back to 3500 Pristina's city emblem.

Proza tregimtare po ashtu ka veçori të etapës së parë të zhbillimit të prozës shqipe. Ajo shquhet me temat dhe idetë interesante, me karakteristikat e letërsisë së arbëneshëve, e cila vetëm më vonë ka marrë fizionomi më të plotë dhe është pranuar si vlerë e qëndrueshme e letërsisë kombëtare shqiptare. Duke filluar nga vitet pesëdhjetë dhe veçanërisht gjatë dekadave vijuese, është zhvilluar një proces i na-

tyrshëm i njohjes dhe i studimit të letërsisë së diasporës shqiptare, pra edhe i letërsisë së arbëneshëve të Zarës, me qëllim që edhe ajo të gjejë shtratin adekuat dhe të rrjedhë natyrshëm në deltën e gjerë të letërsisë kombëtare. Proza tregimtare si lloj i epikës, paraqitet me tiparet e veçanta origjinale dhe medoemos me veçori të përbashkëta të prozës shqipe.

Dramaturgjia e Josip Relës për kah vëllimi, tematika dhe cilësia artistike e saj ka befasuar këndshëm lexuesit dhe shikuesit shqiptarë. Gjatë viteve ’40, siç është e njohur, janë botuar pak tekste të veprave dramatike në gjuhën shqipe dhe me këto drama ka filluar të plotësohet kërkesa e ngutshme e teatrit shqiptar, për të vënë në skenë dramat origjinale në gjuhën shqipe. Deri në vitin 1952, kur në Prishtinë është botuar vepra e parë dramatike e Josip Relës në gjuhën shqipe “Martesa”, janë botuar vetëm dy drama, të cilat kanë vlerë modeste artistike. Ndonjë tekst tjetër dramatik, deri atëherë i pabotuar, është shfaqur në skenën e teatrit. Repertori i teatrit shqiptar është plotësuar me vepra të përkthyera të dramaturgëve të huaj. Veprat dramatike të autorëve shqiptarë, të botuara në Tiranë, nuk janë shfaqur në Kosovë dhe as në viset e tjera shqiptare të ish Jugosllavisë, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve politike dhe kulturore me Shqipërinë. Në këto rrethana të vështira të zhvillimi të jetës kulturore, Josip Rela është autori që më së miri e ka pasuruar dramaturgjinë shqipe dhe ka sjellë freski në skenën shqipe me krijimin dhe shfaqjen e veprave dramatike origjinale, siç janë: “Martesa”, “Kungulli”, “Nita“, “Zani i fëmiut”, “Ik, Jak, ik”, “Dila”, ‘Fisi i mallkuom”, “Në liri”, “Tallasat e dybëjes” etj.

Me Josip Relën letërsia shqipe, dhe veçanërisht ‘... literatura dramaturgjike në gjuhën shqipe ndër ne ka shkrimtarin e parë serioz që në mënyrë permanente merret me këtë gjini të artit’. Në fushën e dramaturgjisë Josip Rela është afirmuar si krijues i dëshmuar dhe i adhuruar. Ai ishte shkrimtar i talentuar. Gëte ka pohuar: “Një talent i madh mund të bëjë shumë kur kapet pas temave që i përshtaten atij”. Josip Rela me të vërtetë me këtë prirje origjinale, me këtë dhunti të natyrshme dhe me këtë qasje letrare, dhe sidomos me gjuhën e përdorur, është pritur mirë si shkrimtar shqiptar, si një zë që vjen prej së largu, prej Arbëneshit të dashur të shqiptarëve.

Në veprat dramaturgjike Rela ka krijuar gati të gjitha llojet e gjinisë dramatike: komedinë, melodramën, dramën me temën e luftës, dramën me temën sociale, dramën psikologjike dhe tragjedinë. Lexuesit dhe shikuesit shqiptarë e kanë identifikuar këtë fenomen letrar si një pjesë organike të letërsisë dhe të kulturës shqiptare.

Dashuria, patriotizmi, dhembshuria, mallëngjimi, krenaria etj., janë gërshetuar në jetë dhe në krijimtarinë artistike dhe bashkëjetojnë drejt ardhmërisë. Kujtimi për jetën dhe vlerësimi për krijimtarinë letrare të Josip Relës, prania e përjetshme e shkrimtarit me veprën letrare në letërsinë dhe në kulturën shqiptare, dëshmon në mënyrë autentike për një udhëtim të përbashkët, që ka nisur dikur, kur nuk ishim njohur, që ka vazhduar rrugëtimin e gjatë sa vetë jeta, për të synuar në të ardhmen përjetësinë. Studimi i krijimtarisë letrare të shkrimtarit Josip Rela është një mision shkencor që ka synuar ndiçmin e aspekteve të artit letrar dhe vlerësimin e fenomenit artistik të këtij shkrimtari. Ky është kontribut i veçantë në fushën e studimeve të historisë së letërsisë shqiptare.

BIBLIOGRAFIA

Veprat e botuara

1. *Martesa*, Dramë në tri akte, *Jeta e re*, Prishtinë, 1952. nr.2, f.89-120.

2. *Kungulli*, Dramë në tri akte, Akti i parë, *Jeta e re*, Prishtinë, 1953, nr.1, f.36-46;

Akti i dytë, 1953, nr.2, f.134-143;

Akti i tretë, 1953, nr.3, f.189-198.

3. *Nita*, Dramë në katër akte, Akti i parë, *Jeta e re*, Prishtinë, 1954, nr.1, f.29-37;

Akti i dytë, *Jeta e re*, 1954, nr.2, f.109-119;

Akti i tretë, *Jeta e re*, 1954, nr.3, f.204-214;

Akti i katërt, *Jeta e re*, 1954, nr.4, f.316-325.

4. *Lundërza e Jozhës*, Dramë në tri akte, *Jeta e re*, 1962, nr.6, f.884-899.

5. *Lundërza e Jozhës*, *Jeta e re*, Prishtinë, 1962.

6. *Zani i fëmiut*, Dramë në tri akte, *Jeta e re*, Prishtinë, nr.6, f.838-866.

7. *Zani i fëmiut*. *Jeta e re*, Prishtinë, 1963.

8. *Vjersha*. *Jeta e re*, Prishtinë, 1964.

9. *Dila*, Dramë në tri akte, *Jeta e re*, Prishtinë, 1965, nr.2, f.75-97.

10. *Dy drama*. *Jeta e re*, Prishtinë, 1965.

11. *Fisi i mallkuom*, Dramë në katër akte me epilog, *Jeta e re*, Prishtinë, 1966, nr.4, f.539-575.

12. *Fisi i mallkuom*. *Jeta e re*, Prishtinë, 1966.

13. *Tallasat e dybëjes*, Dramë në pesë akte, *Jeta e re*, Prishtinë, 1966, nr.6, f.908-950.

14. *Tallasat e dybëjes*. *Jeta e re*, Prishtinë, 1967.

15. *Sot tetë ditë*, Komedi, *Jeta e re*, Prishtinë, 1968, nr.5, f.936-963.

16. *Në liri*. *Rilindja*, Prishtinë, 1968.

17.*Vepra I*. *Rilindja*, Prishtinë, 1968.

18.*Vepra II*. *Rilindja*, Prishtinë, 1971.

19. *Nita*. *Naim Frashëri*, Tiranë, 1973.

20. *Nita*. *Rilindja*, Prishtinë, 1976.

21. *Nita*. *Rilindja – Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës*, Prishtinë, 1997.

ARKIVI. DORËSHKRIMET DHE MATERIALET E TJERA

Poezia

1. *Intima* (1916-1944)

2. *Për fëmi* (1951-1959)

3. *Për të mëdhenj* (1951-1954)

4. *Vjershë në dialekt t'arbënisht*

5. *Në mars* II (1953-1966)

6. *Stihovi* (1951-1956)

7. *Krvavi plamenovi* (1941-1945)

8. *Prevodi iz arbanaškog: Atdheu. Dhimbjet e mija*

Proza

9. *Proza – arbënisht* (1951)

10.*Crtice*

11. *Kujtimet*

Drama

12. *Probe*

13. *Tallasat e dybëjes. Ndërgjegja*

14. *Zani i fëmiut*

15. *Ik, Jak, ik*

Artikuj

16. *Predavanje o Masariku*

17. *Do□ivljaji u nastavi*

18. *Predavanje o jugoslavenstvu*

19. *O arbanasima kraj Zadra etj.*

20. *Arbëneshët e Zarës*

21. *Çish kan dash fashistat*

22. *Studentët e Prishtinës në Arbënesh të Zadrës, Zani i rinisë*, Beograd, 1953, nr.8, 2.X. f.11.

23. *Pionir Grujo u izvedbi sedmogodišnje škole Arbanasi, Glas Zadra*, 1951, nr.30, 12.VII, f.5.

Epistolari

D o k u m e n t e

BURIMET

a. Burimet. Materiali arkivor

1. ARKIVI I SHTËPISË – OBORRIT DHE SHTETIT (Haus-Hof.Und Staatsarchiv) Vjenë. Arkivi politik – Shqipëria I (Politisches Archiv – Albanien I)

Fondet:

P. A. XIV/4, Fashikulli I, II.

P. A. XIV/10, Fashikulli V/7 - 13.

P. A. XIV/16, Fashikulli XII/1, 3, 7.

P. A. XIV/18, Fashikulli XII/2.

P. A. XIV/31.

2. Materiali arkivor i mikrofilmuar nga Arkivi i Vjenës, që gjindet në Institutin e Historisë dhe në Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë, i përkthyer në gjuhën shqipe:

Filmi Nr.I/1, kuadro 71 (1897-1898)

Filmi Nr.I/2, kuadro 79 (1901)

Filmi Nr.I/3, kuadro 69 (1903)

Filmi Nr.I/4, kuadro 72 (1901-1904)

Filmi Nr.I/5, kuadro 69 (1901)

Filmi Nr.I/6, kuadro 68 (1901-1902)

Filmi Nr.I/7, kuadro 70 (1902-1903)

Filmi Nr.I/8, kuadro 70 (1902-1903)

Filmi Nr.I/9, kuadro 70 (1903-1905)

Filmi Nr.I/10, kuadro 71 (1905-1906)

Filmi Nr.I/11, kuadro 72 (1906)

Filmi Nr.I/12, kuadro 84 (1906-1907)

Filmi Nr.I/13, kuadro 70 (1907-1909).

P. A. XII/315, Fashikulli XXXIV/5-6 (Kultusprotektorati austrohungarez në Turqi dhe Shqipëri).

P. A. XII/315, Fashikulli 11-13.

3. Arkivi Historik i Zarës (Historijski arhiv Zadra)

Spisi I austrijske vladavine 1799.

Spisi generalnog providura za Dalmaciju i Albaniju.

Zbirka zadarskih bilježnika u zadarskom historijskom arhivu, Knjiga I. "Alfabeto di Erizzovo selo..." (zbirka zadarsog arhiva nr.231/2.)

Spisi Pokrajinskog školskog vijeća. (Fasc. VII.c 1870-1924), sv. br. 14;

Spisi o Učitelskoj školi u Arbanasima, Fasc. VII.c. 1903- 1921, etj.

LITERATURA

1. AGANI Hilmi, Kujtime nga vizita që i bamë Arbëneshëve, *Jeta e re*, Prishtinë, 1951, nr.4, f.238-243.

2. AJETI Idriz, Istorijski razvitak gegijskog govora kod Zadra, Sarajevo, 1961.

3. AJETI Idriz, Një ndihmesë në fushën e leksikologjisë shqiptare, (Kruno Krstić, Rječnik govora zadarskih Arbanasa, izdanje Mjesne zajednice Arbanasi, Zadar, 1987.

4. AJETI Idriz, *Vepra I*, Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës, Akademia e Shkencave dhe e Arteve Kosovës, Prishtinë, 1997.

5. Ali Pasha i Janinës, *Rilindja*, Prishtinë, 1955, 11 Dhetuer, f.10.

6. ALIU Ali, *Dila* e Relës dhe *Jeta e re,* nrumër 1. *Flaka e vëllazërimit*, Shkup, 1965, 30 maj.

6. ALIU Ali, Josip Rela: *Gjaku i mallkuom* (Dramë), *Flaka e vëllazërimit*, Shkup, 1966, f.6.

7. ARAPI Fatos, Fjalë për letërsinë, *Naim Frashëri*, Tiranë, 1987.

8. Arhiv za arbanašku starinu III, Beograd, 1926.

9.BARDHI Shpend, Arbnesh – Arbresh, *Leka*, Shkodër, 1935, nr.5, f.185-186.

10. BELAJ Ismail, Veprimtaria dramatike e Josip Relës, *Fjala*, Prishtinë, 1977, nr.2.f.7.

11. B. Rr. / BERISHA Rrustem /, Dhetë gurë të çmueshëm (In memoriam), *Zani i rinisë*, Prishtinë.

12. BERISHA Anton, Studim i denjë mbi veprimtarinë e shkrimtarit, Ali D.Jasiqi: *Josip V. Rela*. Botoi *Jeta e re*, *Zëri i rinisë*, Prishtinë, 1969, nr.7, f.30-31.

13. Bibliografija radova dr.prof. Aleksandra Stipčevića. Zagreb. *Knjižnica grada Zagreba – Gradska knjižnica*, 1992, f.26.

14. BJELAJAC Slobodan, Zadarsko naselje Arbanasi, *Slobodna Dalmacija*, 20 studenoga, 1976 godine.

15. BOURCART Jacques, L'Albanie et les Albanais, Paris, 1921.

16.Bračo Arbanasi, / Shpallje /, Zarë, 1896.

17.BRAHIMI Razi, Disa probleme të dramaturgjisë sonë, *Nëndori*, Tiranë, 1965, nr.5, f.105-135.

18. BUDA Aleks, Çështja shqiptare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në vitet 1878-81. *Konferenca e parë e studimeve albanologjike*, Tiranë, 1965, f.591-601.

19. Të dhëna mbi lëvizjen kombëtare shqiptare në vitet 1859-1861, *Studime historike*, Tiranë, 1965, nr.2, f.55-68.

20. BUNJAKU Abdyl, Rela, ai njeri i urtë, *Zëri i rinisë*, Prishtinë, 1969, nr.40, f.5

21. Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, Vëll. III, Tiranë, 1962.

22. BUŠKULIĆ Ante, Josip Vladović Relja. Povodom njegove prve godisnjice smrti, *Zadarska revija*, Zadar, br.4, str. 314-319.

23. BUXHOVI Jusuf, Një zë nga Arbëneshi (Shime Deshpali: *E vërteta, Rilindja*, Prishtinë, 1972. *Rilindja*, Prishtinë, 1972, 29 II, f.12.

24. BUZOLIC Stjepan, Zadarski Arbanasi i prabiskup Zmajević, *Narodni kalendar*, Zadar, 1866, f.76-84.

25. C. J. / CERAJA Jakup /, Tue lexue vjershat e Relës...

26. CERAJA Jakup, Dila / Dramë e Josip Relës /, në interpretimin e nxënësve të Normales dhe Gjimnazit "S. Tomazini" të Mitrovicës, *Flaka e vëllazërimit,* Shkup, 1966, 13 mars, f.5.

27. ÇABEJ Eqrem, Ngulimet shqiptare jashtë atdheut, *Ylli*, Tiranë, 1967, nr.1, f.22-24.

28. ÇABEJ Eqrem, Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, MCM, Tiranë, 1966.

29. ÇABEJ Sami, Parathënie, Josip Rela: *Nita* – dramë, *Naim Frashëri*, Tiranë, 1973, f.3-7.

30. ÇELAJ Zenun, Jeta e arbëneshëve / Reporteri ynë për vizitë enkase Zarës /, *Zani i rinisë*, Prishtinë, 1967, nr.26, f.10.

31. Ç. Z., Nga jeta në Arbnesh të Zarës, katund – votër kulturore, *Zani i rinisë*, Prishtinë, 1962, nr.16-17, f.17.

32. ÇELAJ Zenun, Relës as vorrin s'ia dijmë, *Rilindja*, Prishtinë, 1967, 6.VIII, f.9.

33. ÇELAJ Zenun, Zani i scyptarit mbeti pa dalë, *Rilindja*, Prishtinë, 1967, 29.X, f.12; 30.X., f.6.

34. ÇIRAKU Ymer, Dramat e para të Kolë Jakovës, Studime për letërsinë shqiptare II, A SH e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1987, f.629-669.

35. ČOLIĊ, M. Nesvakidašnji doživljaj, *Politika*, Beograd, 1955, 10 maj, f.5.

36. ČURKOVIĊ, Don Mijo, Povijest Arbanasa kod Zadra, Šibenik, 1922.

37. D. A., Edhe nji pjesë teatrale origjinale, Josip V. Rela: *Lundërza e Jozhës*, botoi BKA dhe *Jeta e re*, Prishtinë, 1962. *Rilindja*, Prishtinë, 1963, 25.II., f.7.

38. D. E., Flet arbëreshi i ri nga Zara (Monolog), *Zëri i rinisë,* Prishtinë, 1969, nr.35-36. f.13.

39. DANÇETOVIQ Vojisllav, Dy fjalë mbi Arbëneshët e Zarës dhe melodramën *Martesa. Jeta e re*, Prishtinë, 1952, nr.2, f.85-88.

40. DEMA Ali, Edhe nji çfaqje e *Nitës* së Relës, *Rilindja*, Prishtinë, 1963, 14.V., f.8.

41. DEMA Ali, *Nita* e amatorëve të Gjilanit, *Rilindja*, Prishtinë, 1963, 13. V. f.7.

42. DOMI Mahir, Momente dhe aspekte të kontakteve e raporteve kulturore të Shqipërisë me vendet e Perëndimit e të Lindjes, *Studime historike,* Tiranë, 1965, nr.2.

43. D. /OMI/ M. /ahir/, Arbëneshi, Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1985, f.32-33.

44. DESHPALI Shime, *Tregime arbëneshe*, *Jeta e re*, Prishtinë, 1968.

45. DESHPALI Shime, *E vërteta, Rilindja*, Prishtinë, 1972.

46. DESHPALI, Shime, *Agimet e parambomjet të Arbëneshit*, *Rilindja*, Prishtinë, 1968.

47. DORT Bernard, Théatre reél (1967-1970), Paris, 1971.

48. DRUGOVAC Miodrag, Drama dhe etosi popullor, Josip Rela: *Nita,* / Botim në gjuhën serbokroate /, *Rilindja*, Prishtinë, 1968, 27.VII., f.13.

49. DUKAGJINI Vorf, Gjuha é Shcyptarvé t' Arbnéshit, *Albania*, Bruxelles, 1905, nr.2, f.35-36; nr.3, f.69.

5O. DUKAGJINI Vorf, Vjersha popullore t'katundit t'Arbnéshit, *Albania*, Bruxelles, 1905, nr.4, f.82-84.

51. ELSIE Robert, Historia e letërsisë shqiptare, *Dukagjini*, Pejë, 1997.

52. Enciklopedia e Jugosllavisë I, Botimi në gjuhën shqipe, Zagreb, 1984.

53. Enciklopedija Leksikografskog zavoda, sv. I, Zagreb, 1955.

54. ERBER Tullio, La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara, Ragusa, 1883.

55. ERBER, Tullio, La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara, Zara, 1939.

56. FERGOSON Frensis, Suština pozorišta, *Nolit*, Beograd, 1970.

57. FISHTA Filip, Istorija albanske književnosti, Drugi deo. Prvi književni rad italo – albanaca. *Misao,* Beograd, knj. 36, sv. 3-4, juni, 1931.

58. FISHTA Gjergj, Përmbledhje artikujsh, Shkodër, 1941.

59. FISHTA Gjergj, Pika voeset, Zadër, 1909.

60. Fletë nga historiku i shkollës sonë, Tiranë, 1963.

61. Folklor shqiptar I. Proza popullore, Vëllimi i parë. Instituti i Folklorit, Tiranë, 1963.

62. GASHI Skënder, Mbi shqiptarët e Zarës, *Zani i rinisë*, Prishtinë, 1970, nr.34, 35, 41; 1971, nr.1.

63. GINESTIER Paul, Le théatre contemporain dans le monde, P.U.F., Paris, 1961.

64. GRADILONE Guiseppe, Studi di letteratura albanese, *Urbinati Editore*, Roma, 1960.

65. G. F. Manifestime përkujtimore për J.V.Relën, *Rilindja*, Prishtinë, 1967, 23.II, f.8.

66. GUNGA Fahredin, Mbi valë – jeta, *Rilindja*, Prishtinë, 1967, 31. XII dhe 1, 2 kallnor 1968, f.12.

67. GURAKUQI Mark, Mësimi i shqipes dhe mësuesit e parë në Borgo Erizzo (Arbanasi) dhe në Zarë (1901-1907), *Arësimi popullor*, Tiranë, 1963, nr.3, f.71-84.

68. GJEÇOVI Shtjefen, Kanuni i Lekë Dukagjinit, *Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore*, Prishtinë, 1972.

69. GJEVORI Mehmet, Mati Logoreci – mësues e lavrues i gjuhes shqipe, *Rilindja,* Prishtinë, 1969, 13.II, f.11.

70. GJOÇAJ Mirash, Nji plotësim mbi biografinë e Josip Relës, *Rilindja*, Prishtinë, 1967, 9.IV, f.11.

71. HALIMI Kadri, Gjuha origjinale e arbëneshve (Nga folklori i Arbëneshëve), *Flaka e vllaznimit*, Shkup, 1958, 21. 2., f.8.

72. HALIMI Mehmet, Fjalor me vlerë të shumëfishtë. / Kruno Krstiq: Fjalori i të folmes së arbëneshëve të Zarës, *Rilindja,* Prishtinë, 1987, 12.XI, f.13.

73. HAMITI Sabri, Besa e Nitës, Tema shqiptare, *Rilindja*, Prishtinë, 1993, f.88-93.

74. HAMITI Sabri, Tragjedia e Nitës, Arti i leximit (Sprovë për një poetikë), *Rilindja*, Prishtinë, 1983, f.275-290.

75. HASANI Hasan, Josip Vladoviq – Rela, Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501-1990, *Shkëndija*, Prishtinë, 1994, f.248-249.

76. Historia e letërsisë shqiptare, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1983.

77. Historia e popullit shqiptar II, *Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore*, Prishtinë, 1969.

78. Historia e Shqipërisë, Tiranë, 1959.

79. HORVAT Rudolf, Hrvatski preporod u Dalmaciji, Zagreb, 1935.

80. HOXHA Hysni, Trajta të vjetra e të reja në vjershat e Relës. Josip V, Rela: *Vjersha*, *Jeta e re*, Prishtinë, 1964. *Rilindja*, Prishtinë, 1964, 29, 30 nëndor dhe 1, XII, f.17.

81. HOXHA Hysni, Kritika, *Rilindja*, Prishtinë, 1977.

82. HOXHA Hysni, Dokument i traditës së arbëneshëve të Zarës (Shime Deshpali: *Agimet e parambromjet e Arbëneshit*, *Rilindja*, Prishtinë, 1968), *Flaka e vëllazërimit*, Shkup, 1968, 19 dhjetor, f.5.

83. HOXHA Ismail, Nga jeta në teatër, nga teatri në jetë, *Naim Frashëri*, Tiranë, 1972.

84. HYSA Mahmud, Impresione nga përmbledhja *Vjersha* e Josip Relës, *Flaka e vëllazërimit*, Shkup, 1967, 23.II; 2.III; 9.III.

85. HYSA Ylber, Kujtesa mbi shekuj. K.Krstić: Doselenje Arbanasa u Zadar, Zadar, 1988. *Fjala*, Prishtinë, 1990, 1 shkurt, f.12.

86. INGARDEN Roman, Doživljaj, umetničko delo i vrednost. Beograd, 1975.

87. ISAKU Murat, Arbneshës në Zarë, në *Zani i malit*, *Rilindja*, Prishtinë, 1960, f.68.

88. I. N., Njëqind – vjetori i shkollës fillore n' Arbnesh të Zarës, *Rilindja*, Prishtinë, 1964, 4.V., f.7.

89. ISLAMI Nehat, Nji za e mallkon luftën, (Bisedë me Josip Relën), *Rilindja*, Prishtinë, 1964, 24.V., f.12.

90. ISLAMI Nehat, 15 pyetje kompozitorit dhe dirigjentit Pavle Deshpali, *Zani i rinisë*, Prishtinë, 1961, nr.17, f.22.

91. ISLAMI Nehat, Udhëtar i përhershëm, (Bisedë me Pal Deshpalin, *Rilindja*, Prishtinë, 1967, 18.VI., f.12.

92. JASIQI Ali D., Asnji diell nuk nxen si i vendlindjes, Josip Rela: *Në liri* – dramë, *Rilindja*, Prishtinë, 1968. *Rilindja*, Prishtinë, 1968, 12.X., f.12

93. JASIQI ALI D., Fabulë fërgluese, Josip V. Rela: *Fisi i mallkuom*, *Zani i rinisë*, Prishtinë, 1967, nr.1, f.14.

94. JASIQI Ali D., Fisniki dhe virtyte, *Jeta e re,* Prishtinë, 1967, nr.2, f.312-329.

95. JASIQI ALI D., Gërshetime mjeshtrie epizodash lirike, Josip V. Rela: *Martesa* – melodramë. *Zani i rinisë*, Prishtinë, 1967, nr.12, f.13.

96. JASIQI Ali D., Historia në dramën *Nita, Rilindja*, Prishtinë, 1967, 15.I., f.10.

97. JASIQI Ali D., *Josip V. Rela, Jeta e re*, Prishtinë, 1968.

98. Josip Rela: *Dy drama, Jeta e re,* Prishtinë, 1965, nr.6, f.992-996.

99. JASIQI ALI D., Josip Rela: *Në liri*, Premtime e realizime, *Rilindja*, Prishtinë, 1976, f.195-200.

100. JASIQI Ali D., Në thelbin e marrëdhënieve familjare, Shime Deshpali: *Tregime arbëneshe*, *Zani i rinisë*, Prishtinë, nr., f.14-15.

101. JASIQI Ali D., Nji vjet pa (me) Relën, *Rilindja*, Prishtinë, 1967, 31.XII, dhe 1,2 kallnor 1968, f.12.

102. J. A., Qfaqjet ma të mira në Hvar dhe festivalin republikan, *Rilindja*, Prishtinë, 1967, 15.V., f.7

103. JASIQI Ali D., Rela dramaturg e poet, Me rastin e dyvjetorit të vdekjes, *Rilindja,* Prishtinë, 1969, 24.XII; 31 XII-1-2.I., f.18.

104. JASIQI ALI D., Sugjerim i një simbolike, *Flaka e vëllazërimit*, Shkup, 1967, 16.II.

105. JASIQI Ali D., Shprehje ndjenjash të sinqerta, *Jeta e re*, Prishtinë, 1965, nr.5, f.821-826

106. JASIQI Ali D. , Vepra dramatike e Josip Relës, *Rilindja*, Prishtinë, 1968, 16.XI., f.12.

107. JASIQI Ali D. , Vepra dramatike e Josip Relës, Parathënie në librin e Josip Relës *Vepra I*, *Rilindja*, Prishtinë, 1968, f.7-22.

108. JOKLI Norbert, Raport provizor mbi studimin e dialektit të gegnishtes së verilindjes, Dorëshkrim (1916).

109. JOKL Norbert, Zur Erforschung der albanischen Mundart von Borgo Erizzo in Dalmatien, Firenze, Leo S. Olschki, 1940.

110. J. N. /JORGAQI Nasho/, Rela Josif (1895-1966). Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1985, f.913.

111. JORGAQI Nasho, Zëra prej së largu (Takime me Arbëneshin dhe arbëneshët e Zarës), Larg dhe afër, (Udhëtime dhe meditime), Tiranë, *8 Nëntori*, 1987, f.261-279.

112. JORGAQI Nasho, Poezia e arbëneshëve të Zarës, *Drita,* Tiranë, 28 janar, f.14.

113. Jubilarni broj Narodnog Lista (1862-1912), Zadar, 1912.

114. KADARE Ismail, Ftesë në studio, *Naim Frashëri*, Tiranë, 1990.

115. KALESHI Dr. Hasan, Arkivi i Vjenës dhe rëndësia e tij për historinë shqiptare, *Rilindja*, Prishtinë, 1970, 12 shkurt, f.34.

116. KALESHI Hasan, Dokumente të Arkivit të Vjenës mbi mësimet e shqipes në Arbënesh të Zarës, *Vjetari* II-III, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1970, f.151-208.

117. KAMBERAJ Sinan, Takimi me Relën, *Zani i rinisë*, Prishtinë, 1966, nr.23, f.18.

118. KARUC Niko, Djelovanje jugoslavenske omladine u Zadru, *Glas Zadra,* Zadar, 2.III.

119. KARUC Niko, Kako je Tulije Erber pisao o zadarskim Arbanasima, *Zadarska revija*, Zadar, 1954, br.1, str.71-74.

120. KARUC Niko, Mještani o svom mjestu, *Glas Zadra*, Zadar, 1954, br.136, str.4.

121. KARUC Niko, Pjesnik Buzolić o zadarskim Arbanasima, *Glas Zadra*, Zadar, 1956, br.240, str.5.

122. KARUC Niko, Uzroci seobe zadarskih Arbanasa, Glas *Zadra, Zadar*, 1954, br. 153, str. 4.

123. KASTRATI Jup, Kontribut për historinë e arsimit në rrethin e Shkodrës deri në vitin 1912. *Arsimi popullor*, Tiranë, 1963, nr.2.

124. KELMENDI Ahmet, Diaspora shqiptare, *Rilindja*, Prishtinë, 1970, 12 shkurt, f.37.

125. KELMENDI Ramiz, Disa fjalë para paraqitjes së dramës *Nita* në Theatrin Populluer të Krahinës. *Jeta e re*, Prishtinë, 1954, nr.6, f.558-562.

126. KELMENDI Ramiz, Nga epistolari i Josip Relës, *Rilindja,* Prishtinë, 1970, 4.XI-10.XI, f.13.

127. KELMENDI Ramiz, Një dorëshkrim i panjoftun i Relës ("*Vampiri*"), *Fjala*, Prishtinë, 1968, nr.3, f.1.

128. KELMENDI Ramiz, Pasthënie. Në librin Josip Rela: *Vepra II*, *Rilindja*, Prishtinë, 1971, f.271-275.

129. KLAJN Hugo, Pojave i problemi savremenog pozorišta, Novi Sad, 1969.

130. KOCI Akil, Kujtim mbi Arbënesh të Zadresë, *Zani i rinisë,* Prishtinë, 1967, nr.25, f.19.

131. KODRA Ziaudin, Letërsia e vjetër shqipe dhe arbëreshe, Tiranë, 1957.

132. KODRA Ziaudin, Lëvizja letrare – kulturore shqiptare e Arbëreshëve të Italisë si kontribut në çështjen kombëtare shqiptare (Shek. XIX-XX), *Konferenca e parë e studimeve albanologjike*, Tiranë, 1962, f.300-307.

133. KOLIQI E /rnest/, *Hija e maleve*, Zara, 1929.

134. KOLIQI Ernest, Giacomo Vuxani, patriota Italo – albanese di Zara. *Shejzat,* Roma, 1964, nr.5-6, f.155-158.

135. Komparativna književnost, Zagreb, 1973.

136. KONICA Faik, Facia é dréitorit, *Albania*, London, 1905, nr.ll, f.210.

137. KONICA Faik, Shoceria kombetare é Borgo – Eritsos. Shcipetaret n'Austrie, *Albania,* Bruxelles, 1901, nr.5, f.66-67.

138. KRAJA Mehmet, Modesti dhe sinqeritet, (Me rastin e dhjetëvjetorit të vdekjes së Josip Relës), *Rilindja,* Prishtinë, 1976, 30.XII, f.9.

139. KOTTE Kostandin, *Shpërblimi i gjaksis*, (Dramë në tre akte), Zara, 1929.

140. KRASNIQI Bajram, Letërsia dhe vetëdija historike, Rilindja, Prishtinë, 1984.

141. KRISTAJ Frok, Zëra të mirëfillta të arbëreshëve të Zarës. Udhë-përshkrim nga Dalmacia. *Rilindja javore*, Tiranë, 1995, 24-30 shtator, f.11.

142. KRSTIQ Kruno, Arbanasi, Enciklopedia e Jugosllavisë, lib.I, Zagreb, 1984, f.243.

143. KRSTIĊ Kruno, Doseljenje Arbanasa u Zadar, Zadar, Zbornik, Zagreb, *Matica Hrvatska*, 1964, f.169-194.

145. Dyndja e Arbëneshëve në Zarë, *Rilindja*, Prishtinë, 1.XI-13.XI.1968.

146. KRSTIĊ Kruno, Zadarski Arbanasi, *Glas Zadra*, Zadar, 1951, 21 VII.

147. KRSTIQ Kruno – CANA Zekeria, Arbëreshët e Zarës, *Bota e re,* Prishtinë, 1988, nr.3-4, f.20; nr.5, f.17; nr.6, f.17; nr.7, f.17; nr.8, f.17.

148. IPPEN Theodor, Kultusprotektorati dhe politika austrohungareze në Shqipëri, (Pjesë të përkthyera në gjuhën shqipe. Dorëshkrim)

149. KYÇYKU Kopi, Një poemë arbëreshe në Zarë (Traditat tona), Mbi poetin, prozatorin e dramaturgun Josip Rela. *Drita*, Tiranë, 1978, 17.XII, f.12.

150. L'écrit et la communication, Paris, 1973.

151. Letërsia si e tillë. Probleme të vlerësimit dhe të trashëgimisë letrare, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1996.

152. LAMBERTZ Dr. Maximiliam. Raport. Mbi studimet e mija lingvistike në Shqipni prej mesit të Majit deri në fund të Gushtit 1916. (Përktheu: Veniamin Dashi)

153. Littérature et société, Bruxelles, 1967.

154. LUBOTENI Gani, Dramaturgjia shqiptare, Studime dhe kritikë letrare, *Naim Frashëri*, Tiranë, 1983, f.24-47.

155, LLOSHI Xhevat, Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe, *Rilindja*, Prishtinë, 1988.

156. MANXHUKA Sebahate, *Përpjekja* në Zarë, *Përpjekja*, Beograd, 1980, nr, 2, f.3-4.

157. MARIJAČIĊ Ivica, Zadarski Arbanasi u filmu Muse Ahmetija: Hrvati, nacionalna manjina ili etnoskupina? Poglavarstvo grada

Zagreba odbilo film o Arbanasima. *Zadarski list,* Zadar, 1995,br.27, str.2-3.

158. MAROVIĆ Niko, Nešto o Arbanasima kod Zadra, *Novo Doba*, Split, 1941, nr.99, f.5.

159. MAŠTROVIĆ Vjekoslav, Kako je izvršena okupacija Zadra 1918. Zadar, 1951.

160. MAŠTROVIĆ Vjekoslav, Prilog povijesti hrvatske kazališne umetnosti u Zadru. *Zadarska Revija*, Zadar, 1953, br.4, str.159-160.

161. Mbi lëvizjen kombëtare shqiptare, Tiranë, 1962.

162. Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar I, Tiranë, Instituti i Folklorit, 1964.

163. Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) III, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1962, f.487-489.

164. MEKULI Hasan, Agimet e parambromjet e Arbëneshit. *Jeta e re*, Prishtinë, 1969, nr.6, f.1131-1136.

165. MEKULI Hasan, *Jeta e re* në vjetin e kaluem, *Jeta e re*, Prishtinë, 1964, nr.1, f.107-120; nr.2.f.290-304.

166. MEKULI Hasan, Mbi zhvillimin e letërsisë së pakicës shqiptare në Jugosllavi, *Jeta e re*, Prishtinë, 1953, nr.3, f.177-185.

167. MEKULI Hasan, Një krijues arbresh – shkrimtar i njoftun kroat. *Përparimi*, Prishtinë, 1968, nr.6-7, f.801-818.

168. MEKULI Hasan, Rrugët e zhvillimit të letërsisë shqipe në Jugosllavi. *Përparimi,* Prishtinë, 1958, nr.11-12, f.774-787; 1960, nr.3, f.153-164.

169. MEKULI Hasan, Shime Deshpali: *Tregime arbëneshe, Jeta re*, Prishtinë, 1967, nr.1, f.144-156.

170. Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare I (1879-1908), Tiranë, 1971.

171. MIRABEL André, Littérature albanaise. Në "*Histoire des littératures"*, Paris, *Librairie Gallimard*, 1956, f.1404-1412.

172. MORINA Bajrush, "Zogu i bukur ka këndue se na jena arbënesh", *Zëri i rinisë*, Prishtinë, 1991, nr.1402-1403, f.24-25.

173. Mrekullia në Arbënesh, *Zëri i rinisë*, Prishtinë, nr.26, f.14-15.

174. MUMXHIU Samedin, Josip V. Rela – lirik i hollë edhe në poezi edhe në dramë.(In memoriam), *Jehona*, Shkup, 1967, nr.1-2, f.3-6.

175. MUNISHI Rexhep, Harmonizimi koral i këngës popullore. Gjashtë këngë korale për kore të përziera të Shime Deshpalit të botuara në përmbledhjen "Këngë shqiptare", *Rilindja*, Prishtinë, 1983, 24.IX, f.11.

176. MURSELI Maxhide, Në orën 13 ose 21, *Rilindja*, Prishtinë, 1975, 11.II, f.43.

177. MUSLIU Beqir, Ars poetika (ose meteori i humbur), *Bota e re*, Prishtinë, 1969, nr.7, f.15.

178. MUSLIU Beqir, Poezia si vizion koloriti i një ambienti, *Zëri i rinisë*, Prishtinë, 1968, nr.37.

179. MUSLIU Beqir, Vdekja e poetit /Josip V. Relës/, *Zani i rinisë,* 1967, nr.6, f.17.

180. MUSTAFA Xhemail, Josip Rela i "Nitës", *Rilindja*, Prishtinë, 1986, 31.XII-12.I.1987, f.14.

181. NAÇI Stavri, Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatlinjve (1757-1796), Tiranë, 1964.

182. NEXHIPI Reshat, Në Arbanasin e Zarës, *Flaka e vëllazërimit,* Shkup, 1972, 10 mars, f.12.

183. NEZIRI Zeqirja, Arbëneshët: ndërmjet të kaluarës dhe ardhmërisë. Skicë nga historiku i arbëneshëve të Zarës gjatë shekullit 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të. *Flaka e vëllazërimit,* Shkup, 1993, 31.I, f.13; 3.II, f.13; 5.II, f.13; 7.II, f.14; 10.II, f.13; 12.II, f.9; 14.II, f.12; 17.II, f.12; 21.II, f.14; 24.II, f.13. / Me shkurtime është botuar edhe në "*Rilindja*". Zyrih – Tiranë në 22 vazhdime, nga 20.VII, deri më 13.VIII.1993. /

184. NEZIRI Zeqirja, Hrvati o Albancima, Zagreb, 1994.

185. NIKPALI Berisllav, Njerëzit nga lartësitë e tjera (Kushtuar 250-vjetorit të arbëneshëve të Zarës. *Fjala*, Prishtinë, 1977, nr.8, f.9.

186. NOVAK Grga, Prilog poznavanju rada i delovanja Vicka Zmajevića – Perastanina, Radovi IJAZU u Zadru, Zadar, 1957, II, str.317-326.

187. NOVAK Grga, Političke prilike u Dalmaciji 1862-1865. *Radovi* IJAZU u Zadru. Zadar, 1959, IV-V, str.5-33.

188. OSMANAJ Shaban, Arbneshit të Zarës, *Jeta e re*, Prishtinë, 1966, nr.6, f.1022.

189. OSMANI Shefik, Mësuesit dhe shkollat e para në Shkodër për gjuhën dhe lirinë kombëtare, *Arsimi popullor*, Tiranë, 1963, nr.3.

190. P. A. /PASHKU Anton/, Drama "*Ik Jak, ik*" fitoi shpërblimin e tretë. *Rilindja*, Prishtinë, 1965, 1.II, f.7.

191. PERIĆ Dr. Ivo, Neostvarane težnje. Ciljevi učenja arbanaskog jezika u zadarskim školama uoči Prvog Svjetskog rata. *Skolske novine,* Zagreb, 1974, nr.14, f.15. (Në gjuhën shqipe është botuar në *"Rilindja"*, Prishtinë, 1974, 10.VIII, f.11.

192. PEROVIQ Budimir, Dashuria nëpër ikje / Libreto në dorëshkrim /.

193. PEROVIQ Budimir, Foljet ndihmëse në gjuhën e arbëneshëve të Zarës. Zarë, 1978. / Dorëshkrim /

194. PEROVIQ Budimir, Nji shikim në trajtat e futurit në të folmen e Arbëneshëve të Zadrës, *Jeta e re*, Prishtinë, 1954, nr.4, f.353-358.

195. PEROVIQ B.,Nji vështrim mbi gjuhën e Shime Deshpalit. *Jeta e re*, Prishtinë, 1965, nr.3, f.470-471.

196. PETROTTA Gaetano, Popolo, lingua e litteratura albanese, Palermo, 1931.

197. PETROTA Gaetano, Sagio di bibliografia albanese 1500-1930, Palermo, 1931.

198. PETROTA Papas Gaetano, Svogilimento storico della litteratura albanese, Palermo, 1950.

199. Përzemërsia e shprehur me zemër (Mbas vizitës në Zarë dhe Zagreb), *Rilindja*, Prishtinë, 1967, 16.X, f.6.

200. PODRIMJA Ali, Letërsia nuk njef kufij, / Intervistë më Shime Deshpalin /, *Flaka e vëllazërimit*, Shkup, 1965, 12.X, f.9

201. PODRIMJA Ali, Poezia e një prozatori, Shime Deshpali: *Agimet e parambromjet të Arbëneshit, Rilindja,* Prishtinë, 1968. *Rilindja*, Prishtinë, 1968, 29.VI, f.12.

202. Poezia popullore arbëreshe, Tiranë, 1957.

203. Pravilnik "Arbanaškog društva S. Josipa" ustrojena u varošu Arbanasi, Zadar, 1885.

204. PRELA Zef, Aspekte ekonomike të depërtimit paqësor të Austro – Hungarisë në Shqipëri (1900-1912), *Studime historike*, Tiranë, 1966, nr.2, f.77-101.

205. PRELA Zef, Mbi politikën austrohungareze në Shqipëri në çerekun e fundit të shekullit XIX, BUSHT, *Seria Shkencat shoqërore*, Tiranë, 1960, nr.1

206. PRELA Zef, Problemi kombëtar shqiptar dhe Kultusprotektorati austrohungarez (fundi i shek. XIX-fillimi i shek. XX), *Studime historike*, Tiranë, 1965, nr.3, f.143-152.

207. Prigodom otvora kafane "Skanderbeg" u Abanasima na dan uskrsa, *Pravi Dalmatinac*, Zadar, 1901, 13.IV, f.2-3.

208. QOSJA Rexhep, Antologjia e lirikës shqipe, *Rilindja*, Prishtinë, 1970.

209. QOSJA Rexhep, Josip Vlladoviq Rela (1895-1966), *Gjurmime albanologjike*, Prishtinë, 1968, nr.2, f.71-101.

210. QOSJA Rexhep, Josip Vlladoviq Rela (1895-1966), Parathënie, Josip V.Rela, *Vepra II, Rilindja*, Prishtinë, 1971, f.7-37.

211. QOSJA Rexhep, Josip Vlladoviq – Rela, Rexhep Qosja: Shkrimtarë dhe periudha, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1975, f.189-238.

212. QOSJA Rexhep, Panteoni i rralluar, *Rilindja*, Prishtinë, 1973.

213. QOSJA Rexhep, Prej tipologjisë deri te periodizimi, ASHA e Kosovës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1979.

214. QOSJA Rexhep, Shkrimtarë dhe periudha, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1975.

215. RAIFI Mensur, Aspekte të kritikës analitike, Ali D. Jasiqi: *Josip V.Rela, Jeta e re*, Prishtinë, 1968, *Rilindja*, Prishtinë, 1969, 1.II, f.12.

216. RAIFI Mensur, Bremjet e ndërgjegjes, Me rastin e botimit të dramave të Josip Relës *Vepra I*, Mbi *"Tallasat e dybëjes"*, *Rilindja,* Prishtinë, 1969, 15.III, f.12.

217. RAMADANI Musa, Duert e Deshpalit (Portret), *Rilindja*, Prishtinë, 1968, 1.VI, f.11.

218. RAMADANI Musa, Tragjika e Nitës dhe e kohës, *Rilindja*, Prishtinë, 1979, 28.IV.

